

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

824-9

A 64

SOTIR TH. ANDONI

# Lufta Partizane



TIRANË, 1959

Redaktor: Moisi Zaloshnja  
Redaktor teknik: Pal Doçi  
Piktor: Fatmir Haxhiu

Tirazhi: 2000

Formati 78 x 109 1/32

Stash: 2204-55

Shtypur në N. I. Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë

16 Mars 1943

I rëndë dimri i sivjetmë. Veriu e tufani nuk kanë të pushuar. Dëbora ka pllakosur fusha e male dhe ujçërit ulërijnë posht e përjetë.

Fshati më duket i shkretë. Veç këmishëzinjtë e Italisë sillen moropateve të veshur rëndë me kaskat në kokë, me armët peshë, me bajonetat mbërthyer.

Dhë njerëzit rrinë mbyllur brënda, ndezin nga pak zjarr, flasin ngadalë, hetojnë nga dritoret, nga të çarat e portave.

Gjyshi po ndreq parmëndën, gjyshja falet në ikonat, gratë ronitin kallëpët e misrit, kalamanët rrinë të nemitur e unë prapa dritores i zymtë e mëndje marë, rri e mendohem.

Që nga dritorja vështroj Moravën. Eshtë e bardhë si vezë. Ngadale bije mbrëmja. Hije t'erëta, si të murme, si mavi zvarisen pas pllajave. Ujërat nuk pipëtinë. Shtrati i lumit është veshur me një savan t'akulltë me krongjij të kristaltë. Veç gërçhet përjetë duket sikur i përmbahen suferinës dhe nëpër bardhësinë e dëborës nxjerrin shkëmbinjtë e tyre t'ashpër e të larë nga veriu.

Vëllai im i vogël po mëson abetaren. Pastaj më afrohet e më pyet:

— Shqiptarë jemi ne?

— Shqiptarë!

— Po tashti do bëhemi Italianë?

— Jo, Italianët i kemi armiq.

— Po ata në rrugë ç'janë?

— Italianë.

— Po ti ke bomba fshehur në mur; pse nuk u bije?

Unë rri e mendohem.

Dhjetë ditë më parë u bë luftë në Hoçisht. Atje u vranë tre partizanë. Midis tyre komandanti i çetës, Fuat Babani.

Italianët janë në lëvizje. I mbushën rrugët e Devollit me tanksa, me autoblanda, me trupa. Po vrasin e internojnë njerëz, po djegin shtëpi, po plaçkitin fshatrat. Karabinierë e spiunë me lista të gjata ndër duar po vërtiten posht e lart.

Këtij i thonë pushtim i huaj.

Shokët e mij ka kohë që zgjodhën rrugën e malit. Dhe atje janë. Vuajnë vërtet, mundohen, luftojnë.

Dhe pasi mendohem shumë, më duket se dëgjoj zërat e shokëve të mij aty në mal. Më bëhet sikur ata e kanë mëndjen veç tek unë, e hera herës sikur thonë:

«Ç'tën akoma në fshat ay i humburi? Si shumë mënd na shiste dikur!»

## 17 Mars

Vendosa të shkoj partizan në çetën e Moravës. U ngrita herët, u vasha mirë, nxora nga vrima e murit katër bombat, i futa në xhepat dhe u nisa malit përprjetë. Pas nja dy orësh arrijta në Sinicë. U drejtova në shoku Andrea. Ay po thertë një keç e më mbajti për drekë. Më vonë ardhi edhe një shok tjetër nga Poloska. E quajnë Hysen. U bëmë dy. Pas dite Andrea na nisi për në Dardhë. Na tha se atje ose në Boboshticë do të takojmë çetën t'onë.

Rruga ishte e shkurtër, por e ftohta na e thau trupin, se frynte veri me dëborë. Kur arrijtëm në Dardhë, na thanë se çeta ishte nisur për në Boboshticë qysh në mëngjez. Një djalë i njisitit na shpuri në një bazë ku ishin edhe dy partizanë të sëmurë.

Sa hymë në bazë, vumë re se dhoma ishte e madhe dhe plot me njerëz. Dy shokët e sëmurë rrinin pas zjarrit. Disi më ardhi turp midis gjith atyre njerëzve të panjohur. Kur m'u mësuam sytë në gjysmë errësirën e dhomës, vura re se atje ndodhesin edhe nja dhjetë vajza dardhare të njisitit. Duart më kishin rënë «për thonjsh» e

nuk i urdhëronja dot. Dikush më tha t'i fut në ujë të ngrohtë e t'i fërkoj me raki.

Një vajzë ezmere shtat-hedhur me një legen ujë të nxehtë në dorë; më ftoi në koridor. Vajta. I futa duart në ujën e ngrohtë e vajza m'i fërkoj pëllëmbët me raki. Unë rrinja më këmbë me sytë përdhe. U ndodha si ngushtë dhe më bëhej t'i flisnja vajzës, por nuk i fola. Në dhomën më tej bëhej një bisedim i zjarhtë. Vajzat bisedonin për pushkë, për bomba dore, për kapsollë. Zinin në gojë markat e armëve, emrat dhe hollësi të tjera. Ja këtu ndjehet pulsi i luftës. Ngadalë duart m'u ngrohën dhe fillova t'i hap dhe t'i mbyll gishtat lirisht.

— I ke më mirë? — më pyeti vajza dhe më vështroi e gëzuar.

— Mirë i kam. Ta paça borxh për gaz e për të mirë. Po si e kini emrin?

— Joana.

M'u desh t'i tregoj emrin edhe unë, e ajo më dha një yll të qëndisur për ta vënë në kapallë.

Pas pak u nisëm për në Boboshticë. Po as këtu nuk e gjetëm çetën. Na thanë se ishte nisur për në Kozel.

## 19 Mars

Sot herët në mëngjez u nisëm nga Boboshtica bashkë me dy djem të njësitit që na shoqërojnë. Kaluam nëpër Kamenicë, u ngjitëm nga rëzët e Gramozit nëpër dëborën e ngrirë, kaluam nëpër pyje e pisha dhe zbritëm në Kozel. Është ky një fshat i vogël, i futur disi thellë mb'anë disa përrenjsh të rreptë. Për rreth ka pyje, gërxhe e shkëmbenj. Sipër mezi duket një copë qiell. Edhe këtu nuk e gjetëm çetën. Na thanë se partizanët e çetës Morava kishin shkuar një ditë më parë në Shtikë. Vijuam rrugën për atje. Pas nja dy orësh arrijtëm në Shtikë. Kryetari i Këshillit Nacional Çlirimtar të katundit na priti shumë mirë, por na tha se çeta në mes natë qe nisur për në Qafzes.

Muarëm rrugën tatëpjetë, me shumë kujdes kaluam nëpër xhadenë e madhe ku vozitnin italianët dhe pas

dite arrijtëm në Qafëzes. Diku mb'anë një dyqani të vogël, rreth një tryeze, disa burra losnin letra. U drejtuam për atje. Njeri nga ata i foli tjetrit:

— Ç'të jenë këta, o Hasan Bej?

U ngritën më këmbë, por, sa u thamë se ç'farë kërkojmë, ata u mvrejtën nga fytyra e na vështruan vëngër.

Më tej na qëndroi një djalë i ri me një sopatë në dorë. Na tregoi se çeta që kërkonim ishte nisur për në Roshanj qysh në mëngjez.

Kaluam nëpër katundet Psar i Zi e Roshanj e në mbremje arrijtëm në Selenicë të Pishës. Në të hyrë të fshatit një njeri i armatosur bënte roje. Menduam se ish partizan dhe i folëm:

— Vdekje Fashizmit!

— Vdekje tradhëtarve — na u përgjegj.

Pra këtu «mërzen» çeta e ballit.

Sejfullahu, Kryetar i Këshillit N. Çl. të katundit, na mori në shtëpin e tij e na tha se çeta e Moravës kaloi për në Qytezë.

Sonte qëndruam në Selenicë të Pishës se u lodhëm jashtë masës.

## 20 Mars

Në mëngjez u nisëm nga Selenica e Pishës, por çetën tonë nuk e gjetëm as në Qytezë, as në Qesarakë, as në Kaltanj e as në Orgockë. Këtu hëngrëm bukë e Kryetari i Këshillit N. Çl. na tha se çeta kaloi për në Zavalan.

Dy shokët e njësitit të Boboshticës që na shoqëruan gjer këtu, u kthyen e unë me Hysenë vijua rrugën. U ngjitëm përprjetë malit Radom, kapërxyem kulmin e malit dhe hodhëm vështrimin tej nga Jugu. Që atje dukej Zavalani, Frashëri dhe më tej Përmeti. Në të hyrë të Zavalanit, pranë disa gërmadhëve, në njëshkollonë, po kalonte çeta jonë. Më në fund i gjetëm shokët. Na pritën me shumë gëzim. Komisari na pyeti çka i duhej e na regjistroi emrat në një defter të vogël. Pushkë për ne nuk kishte, prandaj na dhanë nga një kasetë me municion.

## 22 Mars

Ndodhemi në Barmash. Këtu takuam edhe çetën partizane të Kolonjës. Jam në një bazë në krye të fshatit bashkë me Seçin. Është nga Hoçishti Seçi, moshatar me mua; ka dy sy të zinj, fytyrë ezmere e një vështrim të thellë. U bëmë shokë të ngushtë.

Qysh në mëngjez iu vura Seçit të më tregojë mbi luftimet që ka bërë çeta e Moravës gjatë kohës që ka qënë edhe ay vetë. Dhe Seçi më tregoi:

«Në mbrëmjen e 9 Shkurtit që kaloi, rrethuam postën e kufirit në Braçan, kur armiku mbante një dymbëdhjetë roje finance. Prgatitjet dhe planin e kishin bërë komunistët që punojnë nëpër katunde, të cilët na udhëhoqnë asaj nate.

Vonë natën e ngushtuam rrethimin. Nëpër mugëtirë shquhej ndërtesa e postës. Ishim kaqë afër saj sa që i dëgjonim tërë muhabetet e të rrethuarve. Nga bisedimet dukej se losnin kumar. Dritoret i kishin të zëna me kuverta e dritë nuk dukej, veç tyta mitrolozash delnin nga disa frëngji. Roja që rrinte para portës po ndizte cigaren kur ne i u turëm sipër. Ay nuk bëri zë, po përkundrazi na ndihmoi të hyjmë. Loni shtyu derën me një shkëlmë, ne u drejtuam armët nëpër derën. . . .

— Duart lart!

Ata ngrinë në vend. Një marshall italian i shtrirë në krevat mbuloi kokën me batanije. Nuk bënë asnjë qëndresë. Ngritën duart dhe u muarëm armët. Veç njeri u ndodh trim i marrë. Kërceu në qoshe të dhomës, kapi një bombë dore dhe bërtiti:

— Mos më prekë kush se e shkrepë bumjen e të digjena të tanë!

Ne nuk deshëm të bëhej gjak e i folëm me të urtë e me mirësi, po ay nuk merrte pykë. Na hante me sy me ballin të mvrenjtur. Pastaj foli:

— Oj burra përse luftoni ju?

— Për Shqipëri, — iu përgjegj një nga ne.

— Më kanë thanë se luftoni për grek e për Moskov. . .

— Të kanë gënjyer.

— Po të luftoni për Shqipni, po vij me ju, pushkën nuk e jap...

— Të qoftë, — ja kthjem ne. Dhe ardhi bashkë me pesë shokë të tjerë. Gjashtë nga rojet e postës ishin italianë dhe i lëshuam të shkojnë. Pastaj mblodhëm armët, municionet e veshmbathjet dhe i vumë zjarrin postës.

— Kjo ngjau në Braçan, — më tha Seçi. — Tashti dëgjo si ngjau në Pojan:

Ka qënë dita e 20 Shkurtit që kaloi. E gjithë çeta e jonë ishte e ndarë nëpër baza. Nga ora dy pas dreke një kamion italian hyri në fshat. Rojet tona e qëlluan, por shoferi ja shkeli gazin motorit sa arrijti në mes të fshatit. Atje qëndruan italianët dhe zunë vënd në disa themele shtëpije. Ata filluan të shtijen dhe ne ua kthjem. Filloi luftimi, por armiku ishte i mbrojtur mirë dhe luftonte qenërisht. Ne na duhej t'i çfarosnim shpejt sepse një dy kilometra më sipër ishte garnizoni i Zëmlakut që kish edhe artileri të rëndë. Po ashtu si kishin zënë vend ata po deshe shko e i çkul. Atëhere shoku Raqi Themeli, komisar i çetës, duke u zvarosur ndënë qitjet e armikut mundi të hyjë në xhami. U ngjit maje minaresë dhe q'atje vërtiti granatat mbi kokat e këmishëzinjve. Ky ishte një aksion vendimtar. Armiku u çfaros. Ne nuk patëm asnjë humbje. U muarëm armët të vrarëve dhe u tërhoqëm në drejtim të Malit të Thatë.

Një aeroplan i armikut na diktoi dhe filloi të na mitralojë. Ne u futëm në një përrua afër Koritës. Pak më vonë një aeroplan tjetër bombardoi shtëpitë e Pojanit. Italianët po merrnin hak kundër popullit të pambrojtur. Afër mbrëmjes artileria e Zëmlakut filloi të pambrojtur me predha topi. Partizani Abaz Aliu u plagos në gju nga një gur i flakur prej shpërthimit të gjyleve.

Kështu mbaroi ajo ditë.

Seçi vazhdon të më tregojë dhe unë kam qejf dhe e dëgjoj me ëndje. Ai më tregoi:

Herën tjetër që kemi rënë në luftë ka qënë data 7 Mars. Ka qënë ajo një ditë e dhimbëshme. Ishim në Hoçisht, armiku kishte marrë vesh që ne ishim atje dhe



ishte përgatitur të na çfarosë. Dhe duke u gdhirë dita e 7 Marsit, 700 ushtarë italianë, t'armatosur gjer në dhembë, u përpoqën të rrethojnë Hoçishtin. Ish asaj nate një errësirë e thellë me mjergull, erë e dëborë. Në largësi asgjë s'mund të diktonje. Italianët ishin nisur në tri kollona. Kollona e tyre e parë duhet të kalonte midis Hoçishtit e Gracës për të kapur bregoren e Sotivraçit; kollona e dytë duhet të kalonte midis Hoçishtit e Vërrenit dhe të kapte majën e Shëndëllisë. Pastaj të dyja kollonat e armikut duhet të bashkoheshin sipër Hoçishtit në mulliri, ndërsa kollona e tretë duhet të marshonte drejt kaktundit.

N'agim rojet tona diktuan lëvizjet e armikut e dhanë alarmin. Një grup partizanësh trima u vërtitën të kapin ndonjë lartësi mbi fshat, por në kodrën e Sotivraçit dhe n'atë të Shëndëllisë u goditën me armikun; atëhere partizanët u vërtitën drejt kodrës mbi fshat atje ku duhet të takoheshin midis tyre të dy kollonat e armikut për të mbyllur rrethimin. Dhe në çastin që partizanët kapën lartësinë mbi fshat, pikërisht atëhere u afruan edhe pararojet e të dy kollonave të armikut për t'u bashkuar. Partizanët i goditën. Luftimi filloi. Bataretë nisën të shkëmbëhen, mitralozat filluan t'ulërijnë, krisën bombat e dorës, shungulluan mortajat. Me shpejtësi, partizanët që ndodheshin në fshat, filluan të tërhiqen drejt majës së kapur nga shokët përmbi fshat dhe gjithënjë ndënë qitjet e armikut që qëllonte me zjarr të vazhdueshëm. Por gjatë asaj tërheqjeje, duke kaluar nëpër një përrua ndënë Shëndëlli, tre shokë partizanë ranë ballë për ball me forca t'armikut. Qëlluan me pushkë, flakën bombat e dorës, por mitralozat e armikut hapën kundër tyre zjarr të përsëritur. Dhe të tre shokët tonë ranë atje. U vra Fuat Babani, komandanti trim e sypatrembur i çetës, komunisti i palodhur që aq shumë ka punuar për organizimin e Lëvizjes N.Çl. në rrethin e Devollit. U vra Demir Muharremi, intendent i çetës dhe Avdulla Progridi, përgjegjësi i Rinis antifashiste në Devoll.

Duke më treguar këto Seçi, sot në bazën tonë në

Barmash, u ndje një uturimë aeroplani. Pas pak zhurma u afua dhe si pa prituri fare, ndjemë disa fishkëllime të mprehta. Aeroplani po bombardonte Barmashin. U dëgjuan plasje bombash, shtëpija ku ishim u tund që nga themelet. Kërcyem më këmbë, po sesi u ndodhëm në fund të shkallëve unë s'e mora dot vesh. Bombardimi vijoi një dhjetë minuta dhe pastaj aeroplani u largua. Dualëm përjashta. Për çudi nuk u dëmtua asnjëri. Veç disa kafshë u vranë në një katua nga plasja e një bombe mbi çatinë e tyre.

Në mbrëmje arrijtëm në Novoselë.

### 11 Prill.

Jemi në katundin Kolanec. Sot ardhim këtu nga Devolli komunisti i terrenit shoku Mitat Poloska. Passi u përshëndetëm me 'të ay na tregoi:

«Armiku në Devoll po bën presion mbi fshatarët. Spiunët e fashizmit sillen hapur nga një fshat në tjetrin, kallzojnë bazat t'ona, aktivistët, familjet e partizanëve. Njerzit e ballit kombëtar po përfitojnë nga aktiviteti i armikut dhe nga mungesa e çetës partizane. Ata po bërtasin, se çeta e Moravës u zhduk dhe se Lëvizja N.Çl. në Devoll nuk ka vënd. Por populli dhe aktivistët e Lëvizjes nuk janë përkulur. Kjo i ka egërsuar fashistët italianë. Dhe egërsinë e tyre ata e shfrynë para dy ditësh në Vishocicë. Atje fashistët vranë sekretarin e celulës së terrenit shoku Raqi Grabocka. Në Çipan, me tradhëti, vranë partizanin e plagosur Abaz Aliu. Një spiun i fashizmit e kish kallzuar shokun Raqi si komunist. Dhe një kompani këmishëzinjsh rrethuan shkollën e Vishocicës në kohën kur Raqi po u jepte nxënësve mësim. Një nga nxënësit e Raqit, më tregonte më von, se në çastin kur këmishëzinjtë rrethuan shkollën dhe u vërsulën brenda, n'ato çaste Raqi po jepte një mësim të lirë. Po u fliste nxënësve për dashurinë që duhet të kishin për atdheun, për popullin tonë, për urrejtjen që duhet të kishin kundrejt pushtonjësve të huaj. «Shqipnija është atdheu i ynë i dashur» po iu fliste Raqi fëmijëve, «ne duhet të luftoj-

më që t'i nxjerrim jashtë pushtonjësit e huaj, ne duhet të tregojmë se jemi stërnipat e denjë të Skënderbeut. . .», po pikërisht në këtë çast porta e shkollës krisi me të madhe dhe këmbë të rënda gjëmuan mbi dysheme. Dhjetë fashistë iu vërsulën Raqit sipër. E lidhën me zinxhira, e zvarosën përjashta dhe e pushkatuan.

### 15 Prill.

Pas dy ditësh komunistët e çetës, komisarët e komandantët, janë në një mbledhje me një të deleguar të komitetit qarkor të Korçës. Ndër partizanët pëshpëritet se do t'ikim në Devoll. Por mua nuk ma merr mëndja. Afër mbrëmjes u mblodhëm në një livadh përmbi Kolo-nec. Atje e mori fjalën Komisari, shoku Myzafer, dhe na njoftoi se 17 shokë, me Zv/komisar shokun Raqi Themelin në krye, do të nisen për në Devoll. Atje do të kryejnë aksione të befasishme dhe të shpejta: të ekzekutojnë spiunët e armikut, të marrin lidhje me aktivistët tonë, t'i tregojnë gjithë popullit se çeta e jonë rron dhe lufton. Pjesa tjetër e çetës, 60 partizanë, do të shkojnë në zonën e Malit të Thatë, atje ku ballistët po përpiqen ta detyrojnë popullin të jetë me 'ta.

Mbas Myzaferit e mori fjalën i deleguari i Komitetit qarkor i cili tha:

«Me vendim të Komitetit qarkor të Korçës, çeta e Moravës paskëtaj do të ketë komisar shokun Myzafer, Zv.komisar shokun Raqi Themeli». — Ai na njoftoi gjithashtu edhe se kush do të ishte komandant i çetës.

Pastaj u përqaftuam me shokët që do të nisen për në Devoll dhe u uruam rrugën e mbarë. Njëshkollona e tyre u vu në lëvizje dhe ne i vështronim me zili.

### 19 Prill.

Këto katër-pesë ditë kaluam nëpër katundet Bulgarrec, Rëmbec dhe sot mbërritëm në Podgorije. Fshati është mjaft i madh dhe shtrihet në këmbë të Malit të Thatë. Fshatarët na pritën me gëzim, por disa me droje dhe me frikë. Këtu e ka bazën komandanti i ballit Dule Aia-

rupi. Në shkollën e katundit u bë një mbledhje me fshatarët. Komisari i ynë i shpjegoi popullit qëllimet e Luftës N. Çl. Njeri desh ta turbullojë mbledhjen me pyetje dhe parulla të ballit, por komisarit nuk i la kusur. E shkajroi popullin me durim, me fjalë të matura, me arsye. Pastaj u bë zgjedhja e dy antarve të këshillit që mungonin.

Në mbremje populli u mblodh para kosheres së dhjetarit. Vasili, me një vare në dorë, qëlloi me forcë kyçin e madh të kosheres dhe e dërrmoi. Porta u hap dhe kryetari i këshillit me një listë në dorë, nënë dritën e një feneri, nisi të thërresë emrat e kryefamiljarëve të katundit. Fshatarët nxitonin në koshere kush me thasë në dorë, kush me kuverta e kush me këllëfe jastëku e dysheku.

Podgoricarët e siguruan bukën e vitit.

## 28 Prill.

Gjithë fshatrat e Malit të Thatë i kaluam një për një. Nga Podgorija në Alarup, Bradomirë e gjer afër Pogradecit. Pastaj kaluam në Zboq, Çauslli, Kakaç, Grybec, Manastrec e sot ndodhemi në Gjonomadh. Afër katundit Grybec, ndërsa ishim duke u çlodhur në një pyll, na u afruan katër çuna të vegjël dhe na njoftuan, se aty në një vënd të fshehur, ishin tre njerëz t'armatosur. Rrëmbyem armët dhe rrethuam vëndin. Por të panjohurit na diktuan dhe u vunë në ikje para se ne ta mbyllnim krejt rrethimin. U folëm të qëndrojnë, por ata vrapuan. I qëlluam. Të panjohurit mundën dhe u futën në një përrua dhe q'atje u zhdukën. Më vonë muarëm vesh se ishin tre kriminelë vrasës, që para disa kohe për çështje hasmërie je kishin vrarë një fshatar nga Pirgu.

## 2 Maj.

Dje ishte festa nderkombëtare e puntorëve. Ndodheshim në Goskovë. Në mbremje dualëm jashtë fshatit në disa ara. Komisari na foli shkurt mbi rëndësinë e ditës. Pastaj çeta u nda në katër pjesë e dolli ky urdhër:

Gjithë natën, nër vënde të caktuara, të shkatërrohet  
rjeti telefonik i armikut.

Dhe në gjer n'agim këputëm tela, premë shtylla te-  
lefoni herë me sopatë, herë me sharë e herë duke i dje-  
gur.

### 10 Maj.

Sot n'agim mbërritëm në Voskopojë. Qëndruam në  
manastirin e Shën Prodhomit që gjendet në një pyll kun-  
drejt fshatit. Vëndi për rreth është i veshur me pishë, ka  
lëndina me bar të njomë e kroje të shumtë. Na pritën kë-  
tu partizanët e çetës së Gorës, që kanë ardhur para nesh.  
Neve, të çetës së Moravës, na u caktuan katër dhoma të  
mbëdha për bujtje. Lluca, që është një plak i moçëm dhe  
ekonom i manastirit, na dha çelsat. Vendosëm brënda  
armët e çantat dhe sërish dualëm përjashta. Takuam kë-  
tu mjaft shokë e shoqe të terenit që punojnë në këto anë.  
Pas dreke mbërriti edhe një çetë tjetër partizane që ve-  
pron në rëzë të Korçës.

Në mbrëmje Jorgo Plaku me njësitin e Pendavinjit  
scllën dy që të mëdhenj prej race të huaj që janë sekues-  
truar në çifligun e Koço Kotës në Pendavinj.

### 11 Maj.

Mbrëmë fjeta fare pak. Për gjithë natën, nga dritorja,  
shihnja hije të shumta njerëzish t'armatosur, që hynin  
në manastir nga porta e madhe ndënë këmbanoren.

Në mëngjez vura re se Shën Prodhomi është mbu-  
shur plot me partizanë. Ka këtu edhe disa gra nga Korça që  
kanë ardhur për të meshuar.

Sipas llogarisë simë bëhemi nj'a katërqind partizanë.  
Nga çetat partizane të qarkut tonë mungon vetëm ajo e  
Kolonjës. Mar me mënd se përqëndrimi këtu i gjithë çe-  
tave të qarkut tregon për ndonjë aksion luftarak.

N'oborrin prapa manastirit një grup partizanësh mun-  
dohen të therin qetë e sjellur mbrëmë. Mundimi i parë  
shkoi kot. Qetë janë shumë të shëndoshë dhe i këputën

litarët që u kishin lidhur në këmbë. Kafshët u egërsuan dhe sillen si të tërbuara nëpër oborr. Dualën pastaj ca kasapë të tjerë dhe i qëlluan qetë me plumb në ballë. Kazanët e manastirit u vunë në zjarr. Ҡuzhinierë dualën vullnetarë shtatë partizanë italianë. Këta janë ca djem të qeshur, të cilët nuk kanë më shumë se një javë në malet t'ona si partizanë. U afrova t'u ndih dhe fillova të laj pjabat. Pastaj hapëm fjalë. Më tregojnë se kanë qënë në garnizonin italian të Drenovës. Dezertuan prej andej natën e tre Majit që kaloi dhe muarën Moravën përpjetë. Tre ditë e tre netë ishin sjellë nëpër pyje pa takuar njeri. Pastaj kishin takuar partizanin Soto nga Dardha. Njerin e quajnë Piçulini, tjetrin Bogotai. Ky më tregoi: sikur mos kish qënë Sotua shumë i shëndoshë do t'ja kishim thyer koskat së përqafuari e shtrënguari.

Bogotai më kërkoi t'i mësoj këngën «Pararoja». Ay këndon «Avanti Popolo». Piçulini, duke punuar, tregon barçoleta me kripë për Musolinin. Dhe pas disa orësh Bogotai mori një pamje trishtimi dhe më foli:

Pecato <sup>1)</sup>, ne u kemi shtërnguar të lini arat dhe shkollat tuaja dhe të merrni malet... ver re, ty edhe nuk të kanë dalë mustaqet...»

— Jo juve, — ja ktheva, — por Musolini, edhe juve nuk i latë me qejf arat dhe shkollat tuaja.»

Më drekë u caktova kamarier. Shpërndava gjellë duke i mbajtur pjabat mbi një tepsi të madhe bakri. Buka gatuhet këtu. Raqi Qirinxhiu ka sjellë mjaft bereqet të dhuruar nga fshatarët për rreth. Pas dite dualën skuadrat e pastrimit dhe gjithë u urdhëruam të dalim në pyllin mb'anë manastirit. U mblodhëm grumbuj grumbuj ndënë hijen e pishave. Filloi muhabeti, këngët dhe vallet. Disa tregojnë ndodhitë dhe episodet e luftimeve të kaluara. Një partizan qimeverdhë tregon mbi luftën e Voskopojës. Në pëqi mban një mitroloz belgjian që ua kanë kapur milicëve n'atë luftim. Kondaku i mitralozit është prej druri të kuq dhe tytën e ka të mbështjellë me një veshje të dy-

---

(1) Pecato — mëkatë, gjynah.

fishhtë metalike të shpuar me vrima të vogla. Këtu pata rastin të mësoj hollësitë e të gjitha luftimeve të bëra në qarkun e Korçës nga çeta partizane kundër italianëve.

Partizanët e çetave të tjera na pyesin ne të çetës së Moravës mbi luftën e Pojanit. Disa prej nesh e tregojnë jo pa një farë kryelartësi. Kjo ngjet sepse lufta e Pojanit është aksioni më i rëndësishëm dhe më i suksesshëm kundër italianëve në qarkun tonë.

Ndërkohë mbrijtën një tridhjetë partizanë të rinj vullnetarë. Të gjithë janë nga Korça. Disa i njoh, janë studentë të konviktit të shkollës teknike. Midis tyre është edhe shoku im Fariu, që është bursist, nga një fshat shqiptar afër Manastirit.

Dikush më pyeti:

Si bëhet që juve devollinjtë jeni më të shumtë e më të veshur se neve?

— Eh po ja, o shok, ne sikur na ka ndihmuar fati më shumë... ca nga italianët e ca na ka dhënë populli dhe kështu jemi rregulluar..

Dhe ç'është e drejta ne jemi të veshur më mirë dhe jemi më të shumtë. Sot çeta jonë (me gjithë ata që ndodhen në Devoll e që janë shtuar) ka një efektiv prej afro njëqind e dhjetë partizanësh. Për këtë ndjehemi kryelartër. Por edhe për një arsye tjetër rreh gjoksin e mburret sot Serveti në muhabet me Gorarët:

— Jemi çeta më e madhe, or vëllezër, këtë s'e lot as topi; mitraloza ne kemi më shumë.

Pas dite u dha urdhër të pastrojmë armët. Dualëm sërish në pyll. Gjithë e më shumë po kuptoj se përgatitemi për luftë. Todua, duke ma vulosur si sekretin më të madh, më tha se do t'i biem garnizonit të Vithkuqit.

Gjatë pastrimit t'armëve pata rastin të shoh pushkë nga më të ndryshmet. Shumica janë italiane të kapura armikut. Ka pastaj pushkë franceze, austriake, gjermane, belgjiane, greke, turke etj. Një partizan me emërin Sotir, që gjatë jetës civile ka qënë boksier, mban një maliher grek që ka qënë i Thlemistokli Gërmenjit. Se ku janë gjetur dhe ca dyfekë me çarg, që mbushen nga gryka e

kanë gurrzjarri në vënd të kapsollit. Një mokrar mban një farë arme të gjatë për hata sa pa frikë mbi të mund të flejnë n'ja njëzet këndezë. Nga ata koburet e mëdha të Karadakat ka shumë, por i mbajnë nër torba, se janë aqe të rënda sa po i vure në brez ta shëmbin mezin.

Afër mbrëmjes të gjithë çetat u mblodhën secila më vete. U bë një ndarje e re në përbërjen e skuadrave dhe na u ndanë edhe nga njëqind fishekë e nga katër bomba dore për shok.

Tashti edhe komandantët dhe komisarët tonë nuk po e fshehin se nisemi për një aksion me rëndësi, por se ku, askush nuk tregon. Dikush flet për Vithkuqin, dikush për Ersekën, një tjetër për Qafën e Qarrit. Janë të gjitha hamëndje.

## 12 Maj.

Natën që shkoi celulat e partis të çetave patën mbledhje. Besoj mbi goditjen që do kryejmë.

Sot nga ora tetë në mëngjez u mblodhëm dhe u vumë në njëshkollonë për nisje. Intendentët na ndanë nga dy çyrekë bukë misri e nga një copë mish të pjekur. Shtrenguam mirë këpucët, lidhmë çantat në shpinë dhe u vumë në rrugë. Kaluam nëpër Voskopoje në njëshkollonë me flamurin kuq e zi përpara e duke kënduar:

**Sot lipset me flamurë  
Malit të dalimë,  
Përmbi shkëmbinj dhe gurë  
Liri të ngjallimë!**

Në fytyrat e gjithë partizanëve vihej re një gëzim i papërmbajtshëm

Udhëtuam nëpër një farë xhadeje që kalon nga Voskopoja për në Gjergjevicë. Gjatë rrugës na përshëndetnin fshatarët që prashitnin misrat. Herë pas here kalonim gojë më gojë urdhërat që vinin nga përpara për disa shokë që ishin pas



BIBLIOTEKA E SHKOLLËS "G. S. PETRIU"

Afër mesditës arrijtëm në Gjergjevicë. Është një fshat i varfër i ngritur mbi një shkëmb të lartër dhe të frikshëm. Fshatarët dualën e na pritën me dashuri. Na dhanë drekë dhe shpejt u nisëm. Vazhduam rrugën në drejtim të Jugut. Kaluam një a katër kilometra mbi Vithkuq dhe vijua udhën nëpër disa livadhe me bar të rritur. Afër mbrëmjes mbrijtëm në fshatin me emër Katund. Dikur do të ketë qënë fshat i madh se ka shumë gërmadha. Tashti ka një a njëzet shtëpi, një kishë të madhe e një godinë të re që ka qënë zyra e komunes. Kundrejt Katundit shquhen një sërë katundesh: Treska, Trebicka, nga e majta Selenica e Pishës dhe më tëhu Stratobërda.

### 13 Maj.

Gjithë ditën ndëjtëm shtritur mbi një livadh afër kishës. Koha u prish dhe veson shi. Fryn një erë e ftohtë si në Nëndor. Dikush më tha se prej këtu e tutje do vazhdojmë udhëtimin natën në mënyrë që armiku të mos mundë të kuptojë lëvizjet tona. Nga bisedimi që po kënin afër meje dy komisarë, mora vesh se do goditim garnizonin italian të Leskovikut. Afër mbrëmjes u nisëm.

### 14 Maj.

Sot në mëngjez mbrijtëm në një lartësi të malit Radom. Rruga gjer këtu ishte e keqe dhe shumë e përpjetë. Mbrëmë prej Katundi u nisëm në drejtim të Qesarakës, duke kaluar nëpër disa monopate të pyllit. Ecnim duke mbajtur duart të ngritura përpara mbassi rruga ishte e ngushtë dhe shpesh përpqeshim pas trungeve të borigave. Errësira ish e thellë dhe qielli s'dukej fare. Kaluam afër teqes së Qesarakës. Atje, nënë dritën e një llampe vajguri, pashë një dervish që po therte një dasn. Vijua tatëpjetë, kaluam lumin mbi një urë të gurtë ndënë Orgockë afër një mulliri, lamë më të djathtë Kurtezin gjer sa mbrijtëm këtu. Pllaja ku jemi është krejt e çveshur nga drurët. Aty këtu ka ndonjë dëllinjë. Era fryn e ftoh-

të dhe veson shi. Çkulmë dëllinja dhe ndezmë zjarre në një përrua të madh. Shumica e shokëve flejnë. Afër mbrëmjes na arrijtën gjashtë mushka të ngarkuara me bukë e teneqe me gjizë. Bëhemi gati për nisje. Jemi të çlodhur dhe gazi e kënga buçet majë Radomit. Ndahen racionet e ushqimit. Këtë herë na dhanë nga dy çyrekë bukë misri që për djall kanë harruar ose nuk kanë patur t'u hedhin kripë, si dhe nga një dorë gjizë. Vete mirë gjiza pas mishit. Mistua ka përveshur mëngët përmbi ato llërët e tija topolake dhe bashkë me gjizën e pakripur ndan edhe shakara me kripë:

— «Hajde shokë, merrni gjizë, o m'u rjepsha kurri-zë... Ushqyer me katër teneqe gjizë do luftojmë si burrat... po sikur të kishim më shumë?! Besa po çudira do bënim...»

Po nisemi drejt Jugut në terrin e një nate me shi.

### 15 Maj.

Gjithë natës që shkoi udhëtua m pa ndaluar. Prej Radomi zbritëm në drejtim të katundit Novoselë, diku afër Mbreshtanit, dhe lamë më të majtë Barmashin. Vijuam në një copë xhadeje të përpjetë e më kthesa. Aty pararoja dërgoi prapa një lajm gojë më gojë: Takuam çetën partizane të Kolonjës. Më tej u takuam edhe me kolonjarët. U përqaftuam me 'ta n'errësirën e natës. Janë gjithë të qeshur. Dikush po jepte një shënjë duke kllithur si kukumjaçkë. Pyeta një partizan kolonjar që më rrinte pranë dhe që u bëmë shokë ashtu pa u parë:

— «Cili është ay fshati ku duken ata kandila?»

— Është Poda, — m'u përgjigj — fshati i Zylyftarit.

— Atij q'i këndojnë këngën?

• — Po. Ay fshati më tej është Sanjollasi, më tej Gërmenji.

Vijuam rrugën, lamë Shalësin në të majtë, pastaj Arëzën dhe Gërmenjin dhe n'agim u futëm në pyllin me boriga të Sotirës. Këtu afër rrjedh një lumë i vogël dhe i vrullshëm.

## 16 Maj.

Me Puçilinin ngritëm një farë kasolleje me degë borigash për t'u mbrojtur nga shiu. Gjithë shokët kanë bërë po kështu. Përpara nesh shtrihet një fushëzë e vogël. Xhadeja kalon në mes saj. Rojet tona qëndruan dy kamiona që kaluan këtej dhe sollën shoferat në «limerin» tonë. Kamionët janë të ngarkuar me djathë dhe me paqeta cigare. Shoferat e kuptuan hallin tonë dhe flasin huzëqeshur:

— Na jepni veç nga një copë vërtetim, se kusurin e rregullojmë vetë.

Së fundi bëmë shkëmbimin. Komisari lëshoi një dokument të rregulltë, ku thuhet se Lëvizja N. Çl. i detyrohet t'i paguajë filan dhe filan tregëtari kaqë e aqë të holla për kaqë e aqë djathë e cigare.

Mistua na ndau racionet duke i bërë reklam djathit verdash. E hëngrëm drekën me bukë e djathë dhe iu shtruam më bark atij lumi të vogël që zbret nga pylli me boriga. Tymi i cigareve po ngrihet duman.

N'orën katër mbas dite u mblodhëm të ndarë secili në njësin e tija. Komandanti i gjithë grupit na mbajti fjalë, na dha udhëzimet e fundit për sulmin që do bëjmë kundër garnizonit të Leskovikut. Nga fundi i fjalës së tij u ngritën thirrjet dhe brohoritjet. Një entuziazëm të tillë as e kam parë as e kam dëgjuar. U kërkuan vullnetarë për një skuadër guximtarësh, e cila gjatë luftimeve do të lëvizë në drejtime të ndryshme nga të shihet e nevojëshme. Shpjegohet që vullnetarët të kenë parasysh se puna e tyre do guxim të madh dhe...

Pa mbaruar shpjegimin, të gjithë partizanët, pa përjashtim, bënë nga një hap përpara: Të gjithë vullnetarë!

Komandanti zgjodhi vetë. U caktuan edhe dy njësi me nga tridhjetë partizanë e dërgohen për prita në rruget që hyjnë në Leskovik nga Përmeti dhe Korça për t'i ndaluar armikut çdo ndihmë që mund t'i vijë. Në pritën që ruan nga ana e xhadesë së Korçës caktohem edhe unë. Pjesa kryesore e çetës Morava përbën një kompani sulmi mbi Leskovik.

N'orën 8 të mbrëmjes u nisëm duke u puthur dhe përqaftuar me shokët. Të gjithë janë të qeshur dhe fytyrat janë të skuqura nga thirrjet dhe brohoritë. N'errësirën e thellë, kur po fryn një erë e ftohtë dhe po bie shi, zëmë pritën ne ura e Shalësit. Prishëm vënd-kalimin ndën urën (ura është prishur me kohë) dhe në dritën e një elektriku të dorës premë linjën telefonike t'armikut.

### 17 Maj, mëngjez, dit e djelë.

Ka katër orë që nga drejtimi i Leskovikut dëgjohen batara mitrolozash dhe plasje bombash. Shokët andej po luftojnë ndërsa ne jemi në pritë. N'orën dhjetë kaiuan mbi ne një valë aeroplanash italianë dhe u drejtuan mbi Leskovik. Pas pak u dëgjua bombardimi ajror. Bombardimi vijoi gjithë ditën me tridhjet e gjashtë fluturime. Lufta ndjehet gjith e më e ashpër. N'orën tre pas dite ardhën ndër ne tre partizanë të plagosur në Leskovik. Njeri është goditur në kokë dhe e mban plagën të lidhur me fasha të bardha. Prej tyre mësuam ngjarjet. Në goditjen e parë, që filloi n'agim, ishin vlarë gjithë rojet e armikut. Të trëmbur, italianët e kishin braktisur qytetin, qenë mbledhur në kazemat e betonuara dhe luftonin që nga frëngjitë. Në mesditë njeri nga aeroplanët e armikut u kishte hedhur italianëve të rrethuar disa parashuta dhe furnizime. Një parashutë me një fuçi ujë dhe disa municione kishte rënë afër vijave tona. Të tjerat armiku nuk mund t'i merrte kursesi mbassi s'mund të nxirrite përjashta as edhe gishtin. Populli i Leskovikut ka mbajtur një qëndrim burror dhe u ka ndihmuar partizanëve. Nga mungesa e armëve shkatëruese ishte e pamundur të merreshin gazemat, ku armiku luftonte qenërisht dhe i mbrojtur nga fortinat.

Lufta në Leskovik kish 16 orë që kish filluar. Armiku në Korçë dhe në Janinë kish pregatitur forca të mëdha për t'i vajtur në ndihmë garnizonit të Leskovikut. Kjo po kuptohej nga zhurmat e mëdha të motorave që ndiheshin nga gjithë anët. Armiku po afrohej në Leskovik

nga dy drejtime. Në një rast të tillë viherhin në rrezik të gjitha forcat tona që po luftonin në Leskovik. Atëhere Shtabi operativ i luftimeve mori vendimin që të tërhiqen forcat. N'orën pesë mbas ditë filloi tërheqja.

N'orën tetë në mbrëmje ardhni radha të hyjë në luftim grupi ynë.

### 18 Maj, mëngjez.

Është një mëngjez i zyrtë dhe i vrejtur. Veson shi dhe fryn erë e ftohtë. Me tre shokë ndodhemi në një majë mali shkëmb e gurë diku në drejtim të Gërmenjit mbi vijën e kufirit Grek.

Mbrëmë në orën tetë ramë në luftë. Një autokollonë italiane me tre autoblanda përpara, ra në pritën t'onë. Ne ishim tridhjetë partizanë kurse ata rreth njëmijë. Vet' i tretë u ndodha afër xhadesë duke mbushur pagurin me ujë në përrua kur u dha autoblanda armike. S'kishim kohë të arrinim llogoret tona dhe u kapëm pas një shkëmbi përmbi rrugë, bash afër vëndit të urës. Tri autoblanda mbrijtën ne ura. Ushtarët zbritën nga kamionat për të ndrequr vënd kalimin në përrua. Motorat gjëmonin, zëmra më rrihte me forcë. Ndënë helmetat e gjelbërta shihnja sytë e shqetësuar e fytyrat e zbehta të oficerëve fashistë që jepnin urdhëra dhe shanin me potere. U dha shënja e zjarrit. Armët tona qëlluan. Disa bomba dore u flakën mbi kamionet. Ushtarët u vërvitën pas përroit për t'u mbrojtur, të tjerë u shtritën në vënd. Një i plagosur rënkonte dhe kërkonte ndihmë duke u hequr zvarë diku ndënë shkëmbin afër nesh.

Autoblindat, me ato tytat e gjata të mitrolozave, filluan të qëllojnë me batore pas llogoreve tona. Muzgu i natës ra i plotë dhe flaka e armëve fekste si dritë vetëtimash. Gati një orë vijoi një shkëmbim qitjesh të ngatëruara. Pastaj heshtje. Veç disa motora punonin më hava. I plagosuri ndënë ne po zvarosej dhe kërkonte ndihmë. Errësira ra e thellë. Atëhere ngjau diçka, që nuk e pëndeheim. Armiku kuptoi nga zjarri i pakët i ynë se ne ishim një njësi e vogël dhe na rrethoi. Unë isha me tre

shokët mbi shkëmbin pa asnjë lidhje me shokët e tjerë. Muarëm drejtimin nga ana e Arrëzës duke u zvarrosur nëpër shkëmbinj të që këtu janë zotër të vëndit; më tej u zvarrosëm tatëpjetë në një rëzim. Hije ushtarësh kalonin posht e lart. Rëzimi ishte me gurë që rrokulliseshin sa po vinim këmbët; vijoi një zhurmë e gurëve që shtynin njeri tjetrin. M'at'anë bërtitën:

— Chi va la!<sup>1</sup>)

Askush nuk u përgjegj; u shkreh një mitroloz dhe plumbat e tij sikur muarën zjarr pas gurëve. U ndez një raketë e verdhë, pastaj edhe një tjetër. Ne u shtrimë njësh me tokën. Së fundi zbritëm rëzimin buzë lumit. Dy shokët janë më të pjekur nga unë dhe kaluan lumin pa u lagur, por unë rashë i tëri në një pellg dhe më kaluan nja dy gllënqka ujë. Nëpër bataret e armikut kaluam me shpirt ndër dhëmbë e hymë në një pyll me boriga. Nxituam përpjetë nëpër shi fare të lagur dhe mbërdhinim sa më dri-dhej buza. Diku nëpër pyll u gërvishta dhe po më ënjtet faqja. Me mundim ndezëm një zjarr me lëkurat e borigave. Ndejtëm ashtu deri sa u dha dita. Gjithë natën armiku qëndroi në vënd e afër agimit u vu në lëvizje drejt Leskovikut. Që nga maja shkëmbore ku jemi duket Konica me një varg katundesh malorë; kurse këtej nga ana jonë, në drejtim të Leskovikut, ka mjergull e nuk duket asgjë. Në mëngjez zbritëm në Arrëzë e takuam shokët. Nuk kemi patur asnjë humbje. Faqja e djathtë po më ënjtet më shumë. Në Arrëzë kanë ardhur gati njëqind partizanë nga ata që luftuan në Leskovik. Janë shumë të lodhur dhe flejnë. U nisa për në Gërmenj të takoj çetën t'imë. Pas gjysmë ore arrijta në një bazë dhe pyeta tre partizanë që hanin drekë. Këta janë nga çeta e Kolonjës dhe më treguan se disa shokë nga çeta e Moravës ndodhen në Shalës. Nga tigani i madh që kishin përpara në një tryezë delte një aromë e ngrohtë. Hanin bukë me gjizë të tiganisur. I zoti i shtëpisë më mbajti edhe mua. Nuk e bëra të gjatë dhe u shtrova. Pastaj u nisa për në Shalës. Rrugës përsëri më rrahu një shi i hollë; robat disi duruan,

1) Chi va la = Kush kalon

por këpucët m'u lagën nëpër baltë. Në Shalës takova një pjesë të shokëve. Më treguan se Enver Dajlani, i çetës s'onë, qe vrarë në Leskovik gjatë bombardimit ajror. Rreth një vatre të madhe, nga ato të zamanit, ku digjet një zjarr i madh, janë nj'a dhjetë shokë të lagur nga shiu dhe terin robet të veshur siç janë. Serveti del si më usta dhe më flet t'i nxjerr këpucët që i kam shumë të lagura. (Këtu filloi taksirati im i vërtetë). Po kështu u thotë edhe Hysenit dhe Seçit. Serveti i futi këpucët tona thellë në gllanik prapa flagëve që të teren.

Disa shokë që kishin shkuar ne ura e Shalësit për të vështruar vëndin e luftimit të mbrëmëshëm, kishin gjetur atje mjaft roba, fishegje e disa pushkë të hedhura nga armiku. Midis të tjerave gjetëm një çantë oficeri të lyer me gjak e cila mban emrin Colonello Saltari Mario 80 Legione CC.ZZ. dhe bashkë me të edhe gjashtë kufoma ushtarësh.

Por ajo lufta e Leskovikut me ato tregimet e shokëvevet m'a bëri mëndjen ujëm dhe harrova këpucët aty prapa flagëve në gllanik. Dhe kur u kujtuam për këpucët ishin prerë urët dy herë. I nxuarëm nga gllaniku të ngrohta e të buta si bukëvale, por sa ndëjtën pak u thanë dhe u mblodhën shuk e trokë e nuk na nxinin kur-sesi. Mbetëm zbathur.

«— Hajde, s'është gjë, — më foli Hyseni, — djem jemi ne, do taresim zbathur». (Një fjalë goje).

Ne kisha e Shalësit janë mbledhur një grup shokësh dhe bëjnë qitje. Midis tyre është një djalosh partizan me fytyrë të mbushur me pantallona kaqi dhe pallto lëkure, mban një maliher greku dhe një çantë me ilaçe në shpinë. E quajnë Taqi dhe kryen detyrën e mjekut. Ka studjuar dy vjet për mjekësi. I tregoj faqen t'ime të enjtur.

— «Është një infeksion, — më tha — do t'a mjekojmë dhe më vonë mund ta çajmë me brisk».

M'a leu faqen me një ilaç të zi dhe m'a lidhi me fashio. Të tjerët më pandehnin të plagosur.

Duke ma lidhur faqen dëgjoj se këtu po mblidhen gjithë forcat tona. Dikush thotë se armiku do të tentojë të tër-

hiqet për në Korçë dhe duke kaluar këtu afër nëpër xhade. Kjo fjalë e fundit duhet të jetë e vërtetë, sepse po dëgjohen shumë zhurma motorash që afrohen nga ana e Leskovikut.

## 19 Maj

Armiku, pasi kishte plaçkitur Leskovikun, dje pas dite mbërriti në pritën tonë në ura e Shalësit. Autokollona armike ishte aq e madhe sa gjëmonin malet për rreth nga zhurma e motorave. Kur hyri e gjithë autokollona në pritë, pararoja e tyre kishte kaluar mjaft përpara. Një njësi e çetës së Moravës u muar me pararojën e armikut, kurse forcat e tjera gozhduan armikun gjatë xhadesë në ura e Shalësit, pikërisht atje ku u bë prita e pardjeshme.

Vëndi këtu është i ashpër. Pozitat partizane janë në një vijë të drejtë gjatë një shpati shkëmbor. Jemi të futur në disa istikame të mbrojtur mirë. Këto istikame i kanë ngritur vetë italianët që atëhere kur i dualën zot Daut Hoxhës...

Sapo filloi luftimi, armiku i braktisi automjetet dhe filloi të qëllojë me mitroloza dhe me predha mortaje. Pas ndonjë gjysmë ore, një grup partizanësh guximtarë, duke kaluar nëpër rreshtat e armikut, hipnë në shkëmbin e Gërmenjtit. Që nga aty shkëmb duket për së gjati e gjithë rrjedha e lumit të vogël. Zjarri që hapën partizanët që nga shkëmbi ishte me të vërtetë i tmerrshëm për armikun. Një grup tjetër dualën nga istikamet dhe filluan të shtyjnë shkëmbinjtë tatëpjetë në drejtim të armikut. Atëhere u dëgjuan të thirura dhe lebetitje, më tej u ndjenë kërcitjet e karocerive të kamionave që thyeshin ndënë peshën e shkëmbinjve.

Në luftim me pararojën e forcave armike njësi i çetës së Moravës e spastroi krejt një kamion me tridhjet e gjashtë ushtarë, ndërsa autoblanda, e dëmtuar, u vu në ikje dhe shtinte veç me një farë pushke mbassi mitrolozat nuk i punonin.

Lufta mbaroi vonë natën kur ne na u mbaruan fi-



shkët dhe nuk mbetën më shkëmbinj për t'u rrëkëlyer. E gjithë ajo forcë armike e goditur rëndë, e sakatosur dhe e pakësuar, natën n'errësirë mblodhi aqë sa mundi, të gjallë dhe të vdekur, dhe u vu në ikje.

Afër agimit takova shokët e çetës sime. Më treguan se në xhepat dhe në fuskat e pantallonave të milicve italianë kish sende të plaçkitura në dyqanet e Leskovikut. I pashë me sy këto plaçka të grumbulluara në disa thasë kur intendenti i rregjistronte në dritën e një zjarri. Kishte rrotka penjë, shishe brilantinë, brisqe, karamelle, sardele, sparmaceta etj. të gjitha «plaçkë lufte». . . (Kanë ardhur të na qytetërojnë pipinot, si thonë shaka). Komisari dha urdhër që të gjitha sendet e kapura të shpihen në Leskovik për t'ua dorëzuar pronarëve të tyre.

Komanda e jonë llogarit humbje të shumta t'armikut. Vetëm në lumi i Shalësit u vranë lart nga 80 armiq, midis tyre edhe një kolonel. Materiali luftarak i kapur është i shumtë, por nuk mund të bëhet një llogaritje e saktë mbassi partizanët një pjesë të mirë të këtij materiali e kanë përdorur gjatë luftimeve dhe çetat nuk ndodhen në një vënd për t'i nëmëruar.

Nga ana jonë, gjatë gjithë luftimeve, u vranë katër partizanë dhe u plagosën dymbëdhjetë.

## 20 Maj

Të gjitha çetat partizane që mbarën pjesë në luftën e Leskovikut, udhëtuan të ndara nga njera tjetra. Çeta partizane e Kolonjës dhe ajo e Leskovikut shkuan në qytetin e Leskovikut, ngritën atje flamurin kuq e zi mbassi armiku i goditur gjatë këtyre ditëve e braktisi.

Në devollinjtë kemi me vete pesë partizanë nga çeta e Kolonjës si udhëtregonjës. Jemi pa gjumë, por gazi i fitoreve për grushtet që i dhamë armikut sikur na jep krahë. Gjer pas dite unë me Seçin dhe Hysenin ecmë në rregull, po kur zuri të thyhej dita atëhere e ndjemë se kishim marë përsipër diçka që nuk e mbanim dot. Duke marshuar këmbëzbathur, nëpër pyje e gurë, driza e ferrra, këmbët na u gërvishtën, na u gjakosën dhe na u ënj-

tën. Në ndonjë tatëpjetë rrëkëlleheshim që mos ecnim. Rrëkëlleheshim dhe qeshnim. Mirë e thotë fjala: «Me gaz hahen dhe mollët e tharta». Komisarri na hoqi vërejtjen pse nuk kërkuam këpucë me kohë. Tashti na dhanë këpucë po ç'i do? Si u katandisën këmbët t'ona nuk durojnë dot as çorapet. Hyseni kërkon të çfajësohet para komisarit:

— Na vinte turp, shoku Myzafer, na vinte turp të kërkonim llusa në mes të luftës».

— Ç'llusa mor vulë-humbur?! Tashti si do ecni?!

— E po s'është gjë e madhe, gjer në mbërmje do të bëjmë si të bëjmë, do t'ecim dosido, s'jemi keq, më tej shohim e bëjmë.

Serveti druhet të na dalë përpara.

Qëndruam për çlodhje në katundin Qesarakë. Me Seçin dhe Hysenë qëndruam afër teqesë. Një dervish na vështrroi shtërmbër. Këtu balli kombëtar ka mjaft njerëz të tij. Na u afrua një fshatar me moshë të thyer, veshur me roba shajaku dhe na vuri re kur ne po lidhnim ca farë leckash pas këmbëve. Na foli ngadalë, na pyeti dhe iu përgjigjëm, por dukej si i lehtë. Fshatari u ngrit dhe thëriti një kalaman:

«— Hidhu gjer në Jahua, thuaji të vijë shpejt këtu.»

Pastaj na u drejtua neve.

— Pritni sa të vijë Jahua, është toktor i mbaruar, usta për këmbët... Aty njëditëzaj m'i kish rënë thundra gomarit dhe Jahua ma shërci fët e fët....

Më ardhi inat dhe s'e mbajta dot:

— «Dale more, unë jam njeri nuk jam gomar, s'ka punë thundre këtu...»

Fshatari u zbeh dhe iu muar goja. Iku kokë ulur. Shokët më hoqën vërejtjen. «Nuk bëre mirë, më thanë, ndofta nuk e kish me qëllim». Dhe vërtet ashtu dolli. Kur Këshilli N.Çl. solli tre mushka për ne, ardhi vullnetar për të na shoqëruar ay fshatari me moshë të thyer. Rrugës u bëmë miq të mirë me të. I kërkova ndjesë. — S'është gjë, më tha, i riu si veriu, nuk ta marr për keq, të kam si djalin tim.

X

21 Maj

Jemi në katundin Gostivisht. Mbrëmë, sapo mbrrijtëm këtu, Maqua i kërkoi këshillit të na futëte të parët në një bazë në tre këmbë-ënjturit. Në bazën ku vajtëm, na pritën shumë mirë. Gratë na suallën kos dhe bukë gruri. Po ne ishim aq të lodhur sa u shtrimë në gjumë si të vdekur. Tashti që po shkruaj, po mendoj se sa të drejtë ka patur ay shqipua i vjetër kur e tha i pari atë fjalën e urtë:

«E mira të vjen andej nga nuk e pandeh!»

Shokët ishin ngritur nga gjumi dhe i zoti i shtëpisë, një plak nja gjashtëdhjetë vjeç, po i pyeste si jini e nga na vini. Uunë rrinja me sytë mbyllur e dëgjonja bisedën e tyre.

— Prej nga u kemi o djema?

— Jemi devollinj, iu përgjegj Seçi.

— Prej cilit fshat?

— Ja, unë nga Hoçishti; ky shoku nga Poloska.

— Si the?

— Unë nga Hoçishti e ky shoku nga Poloska.

— Po nga Ziçishti nuk kini ndonjë shok?

— Kemi ore si nuk kemi, ja ky shoku që fle është prej Ziçishti.

— Ashtu? Kur të zgjohet do ta pyes më nge. Kam një mik të ngushtë atje në Ziçisht të Devollit, mik me kokë, më ka shpëtuar jetën andej nga kurbeti, nuk ja harroj sa të më mbijë lëndina përsipër.

— Na thuaq cilin, se mund ta njohim, Devolli është i ngushtë.

Plaku tha emrin e mikut të tija, unë çela sytë dhe ngrita kokën, Hyseni rahu me pëllëmbë garin e vatrës:

— Po ja, ky është i biri!

Dhe vërtet dualëm mi!

Plaku i shtëpisë më përqafoi me dashuri. Pastaj na tregoi se gati dyzet vjet me radhë ka qënë në kurbet me babanë tim në malet e Athos. Atje kishin ndihmuar njëri tiëtrin. Plaku tregonte, sytë i njomeshin me lot dhe dridhej nga gazi.

Kur ardhni dreka, ne lëshuam «protesta» se sofrë u mbush me gjellë të tepërta, por plaku i ra me të prerë:

— Hani dhe mos bëni fjalë, juve luftoni dhe ne na bije t'ju presim mirë.

## 22 Maj

Edhe sot jemi në Gostivisht. Plaku na tregon histori të lashta dhe një djal i ri si një katërmbëdhjetë vjeç na solli nga mali disa fletë bimësh që kurojnë këmbët e enjtura. U çlodhmë mirë, këmbët disi na u lehtësuan, por këpucë dhe opinga s'mund të mbathim. Faqja e djathtë po më ënjtet gjithënjë e më shumë.

## 23 Maj

Sot u nisëm nga Gostivishti. Plaku i shtëpisë na solli para portës tre kuajt dhe na i mbushi çantat me bukë e gjellë. Ndresat që i dhamë të na i përvëlojnë nuk na i kthyen më. Në vënd të tyre plaku na solli ndresa të reja. Edhe pantallonat dhe xhakëtën t'ime, të bëra cop e trokë, nuk ma kthyen më kur ja u dhashë të m'a arnojnë. Në vënd të tyre më suallën një palë roba shajaku të reja. Plaku i shtëpisë na përcolli gjer larg dhe dërgoi të nipin pas nesh për të këthyer kuajt.

Gjatë rrugës infeksioni i faqes m'u ënjt shumë e më duket sikur po ma heq kokën për tatëpjetë. Ndjej dhëmbje dhe kam të nxehtë. Afër drekës mbrijtëm në Katund. Gjetëm këtu edhe dy çeta të tjera që kanë ardhur përpara nesh.

U shtriva në krevatin e një dhome të ish komunes që tani përdoret si spital ose si infermieri (ose si të dyja bashkë). Më thanë se do të ma çajnë faqen me brisk. Jashtë koha është e mirë. Shokët kanë ngrënë drekën dhe tani po kërcet kënga dhe vallja në sheshin afër kishës. Shoh nga dritarja grupet e valltarëve: Ka gorarë, devollinj dhe mokrarë, që hidhen dhe kërcëjnë. Nuk e di përse, por

devolliça e lojtur prej devollinjsh më pëlqen shumë. E lozin devollinjte vallen t'onë sa «e qajnë me lot», të shkathët e buzëqeshur, me hov dhe burrëri, ta ka ënda t'i shikosh dhe t'u pish dollinë me fund.

Gjer dje në luftë dhe në rrugët e saja këndonim «Pararoja» dhe «Hakmarrje Rini», sot e kanë zënë vëndin devolliça dhe gazi derdhet lumë.

Pas dite më ardhi mjeku. «Bëj durim më tha, do shpëtosh. Në dorë mbante një brisk berberi dhe e dogji në flakën e një qiriri. Një partizane ma pastroi vëndin pas faqes me pambuk dhe alkool. Së fundi filloi «operacioni». Unë shtrëngonja dhëmbët dhe shihnja në tavan. Mjeku m'i ra një herë faqes me brisk. Ndjeva një dhëmbje të mprehtë... Pastaj rashë në një gjëndje rehatije e ashtu më mori gjumi.

U zgjova vonë natën; në dhomë ndrit zbehtë një llampë vajguri. Faqen e kam të lidhur, dhimbje nuk kam më. Dikush fle në një shtrat aty në qoshe. E ve re mirë. Ka shumë flokë dhe është partizane. Druaj ta zgjoj, por kam shumë uri sa më dridhet trupi. Kollitem një herë dhe vajza u zgjua. Ajo u ngrit duke qeshur dhe hapi llampën. «Më fal më tha, më kish marrë gjumi». Më solli bukë e gjellë që e hëngra si i babëzitur.

## 24 Maj

Sot jam fare mirë; këpucët i mbatha. Në mëngjez u nisëm dhe pas dite mbrijtëm në Vithkuq. Armiku e ka tërhequr garnizonin që mbante këtu nga frika e ndonjë sulmi si ay që ngjau në Leskovik. Fshati është i madh dhe i ndarë në tri lagje. Ka dyqane e kafenera. Mb'anë fshatit punon hidrocentrali që i jep dritë Korçës. Populli i Vithkuqit doli e na priti me dashuri. Vithkuqarët na folën të gjithë buzagaz:

— Bëhuni tre-katër veta dhe hyni ku t'u duket më mirë, të gjithë u presin, portat janë hapur.

Po trapitnim me Seçin dhe Hysenë kur na doli përpara një djalë i ri dhe na mori në shtëpin e tija.

## 26 Maj

Na u bënë dy ditë e dy netë në Vithkuq. Këtu u lamë e u pastruam edhe një herë. Disa shokë ishin keq me morrat aqë sa u pashë me sy thërija në vetullat dhe në vrimat e ripit. Populli i Vithkuqit na priti me shumë kujdese, na ushqeu mirë, se ishim dobësuar mjaft nga ditët e luftës me bukë e pa bukë. Sot në mbrëmje çeta jonë u mblodh në një vënd jashtë fshatit ndënë disa vidha të moçëm. Prej aty u nisëm për në Polenë. Një grup shokësh (nja njëzet veta) nënë komandën e Mitit, që është komandant kompanije, u nisën për në Devoll. Ne të tjerët lakmojmë fatin e shokëve q'u nisën. Gjaset janë se fare shpejt edhe ne do të kthehemi në Devollin tonë.

## 27 Maj

Sot ardhi nga Devolli një korier i yni. Ay na tregoi se shokët tanë që ndodhen atje që më 15 Prill, ja kanë prishur pllanet armikut. Spiunët nuk po gjejnë vend ku të futen. Janë ekzekutuar tre spiunë dhe janë grumbulluar mjaft materiale ushtarake. «Populli tha korieri, po pret gjithë çetën».

## 28 Maj

Nga Polena u nisëm sot në mëngjez dhe mbrijtëm në Vinçan afër mbrëmjes. Me lutjen e komandës sonë këshilli i Vinçanit lajmëroi popullin të na jepte darkë pa rënë muzgu. Mora vesh një lajm të mirë. Sonte nisemi për në Devollin tonë. Fjala shkoi vesh më vesh. U mblodhën ne shkolla e katundit. Komisari me gaz në buzë na njoftoi «zyrtarisht» lajmin gazmor se do nisemi për në Devoll. Ndjenemi më të çelur dhe vajosmë armët; rruga që do bëjmë kalon nëpër xhadenë e kontrolluar nga armiku.

## 29 Maj

Mbrëmë udhëtuam gjithë natën. Sapo ra errësira, u nisëm nga Vinçani në njëshkollonë me pararojë e anarojë.

Kaluam xhadenë pa ndonjë ngatëresë. Pas mesnate mbrijtëm në Boboshticë. Populli e dinte ardhjen tonë dhe kish dalë e na priste. Boboshtica ndodhet në zonën e çetës sonë. Kemi këtu shumë shokë e miq. Shokë ilegalë rrinë këtu për ndërlidhje me qytetin. Nuk do ta harrojmë kurrë pritjen e Boboshticarëve. Nj'a dy kilometra prej këtu ndodhet një njësi armike.

Na dhanë të hamë më këmbë diku anës fshatit ndënë disa drurë manash. Më takoi racion një copë sallo e tymosur, që e hëngra me një barrë shije. Kisha mbante në dorë një shishe raki dhe na qiraste «partizance» sa për t'u nxehur. Kasua dhe Fehimi i rrinin pranë. Kur filloi të zbardhojë nga lindja, u nisëm nga Boboshtica. Kaluam skërkën gjatë xhadesë dhe muarëm rrugën nga e majta në thellësi të Moravës. Nga ora tetë në mëngjez mbrijtëm këtu në bredhin e Drenovës. Afër nesh ndodhen disa kalive çobenësh.

Ilua, intendent i çetës, po vriste mëndjen për drekën. Arka e çetës, e ndodhur larg nga baza e vet, është thuajse bosh. Ilua iu afrua çobenëve dhe hyri në pazarllëk për t'u blerë nj'a pesë shqerra. Nuk ranë në ujdi. Sesi shkau fjala dhe pazarllëku u zgjidh si jo më mirë. Një nga çobenët u ankua se këshilli N.Çl. i Drenovës ua mer pagesën e kullotës sa u merte dikur kryepleqësia.

Ilua hapi krahët dhe gojën:

— Po folë, o t'u haptë dera, po ku je ti?! Këshillin e Drenovës paguan juve?

— Po

— Unë do t'u jap një të shkrojtur për këshillin e Drenovës që na dhatë pesë shqera; ata do t'ja u zbresin nga llogarija. Çobenët pranuan me qejf.

I thermë pesë shqerat dhe i shkuam në hell. Më ra radha e rojës. U ngjitëm me Sofon majë një çuke. Q'atje duket Dardha me sy të lirë. Duket Shënthanasi i betonuar me grykat e katerive ngritur. Për rreth silleshin si milingonjat një mizëri ushtarësh. Më tej roje në Shënpjetër, roje në Guri i Vjeshtës, roje në Bigëll. Xhadeja ulërin nga motorat. Po vështronja Dardhën, fshat i madh

në pëqi të malit. Atje është edhe ajo Joana që më shërbeu ditën e parë që dolla partizan. Dhe e kujtoj gjithënjë. Dhe thur ëndërra dhe imagjinata rreth saja. . . . Sikur t'i dijë njeri mendimet e mija, sikur t'i dijë!

N'orën dymbëdhjetë ndamë mishin e pjekur mbi një bythak pishe. Do ta hanim pa bukë e pa kripe, po ku të lënë Bobohticarët! Ilos, që i kishte djersitur edhe maja e hundës, i qeshi nuri. Nga një pllajë u dukën dy mushka të ngarkuara, pas tyre ecnin nxituar nj'a dhjetë Boboshticarë. Kishin sjellë njëzet byrekë. As i prisnim as i pandehnim. Kemi ngrënë sa lëpimë edhe gishtat.

N'orën tre u nisëm nëpër patekat e dhive në drejtim të Devollit. Ne Guri i Capit qëndruam për çlodhje. Këtu është udhëkryq dhe takuam shumë devollinj që ktheheshin nga qyteti. Midis tyre Papa Thanin hipur në një mushkë. Është një kapedan prift dhe e kemi patur krah gjithënjë. Kur zbritëm më poshtë dukej Devolli; ndjemë gaz e mallëngjim. U unjëm mbi një çukë e nuk çmalloheshim dot me Devollin t'onë; disave u shkonin lotë. Është i ngushtë Devolli. Të dyzet e ca katundet e tij janë pranë njeri tjetrit; rrugët e automobilin e presin kryq e tërthori. Që nga Bilishti, ku italianët kanë një garnizon të madh, armiku mund të qëllojë me artileri çdo fshat të Devollit; brënda disa minutave mund të mbërrijë me autoblanda në kazat tona më të largëta. Malet e Moravës dhe xhadeja e Janinës, që e kontrollojnë armiku, e ndan çetën t'onë nga njësitë e tjera partizane të qarkut të Korçës. Për këto arsye zona e jonë është tepër e vështirë për ne. Por ne do të qëndrojmë këtu. Jo vetëm do të qëndrojmë, por edhe do të luftojmë pushtonjësit e huaj.

### 31 Maj

Ndodhemi në Vërlen. Populli na priti me shumë gëzim. Antarët e njësiteve guerile të fshatrave po vijnë nxituar të na takojnë. Shumë djema ardhë sot vullnetarë partizanë. Midis tyre edhe shoku Stavri Gjerazi, i cil'



ka mbaruar një akademi ushtarake në Itali dhe ka dalë me gradën n/Toger.

### 3 Qershor

Gjithë partizanët e çetës janë grumbulluar në Gjyres dhe Bradvicë. Komunistët e çetës gjithë ditën dje e sot kanë qënë në mbledhje. Në Bradvicë partizanët sollën një oficer englez që ardhil këtu nga Greqia. Flitet se do të ndihmojë çetën tonë me armatime të hedhura me parashuta.

### 10 Qershor

Qendra e çetës është ngritur në Shënkostandin të Bradvicës; këtu është një kishë e vogël në mes të një pylli në pëqi të Moravës. Një pjesë e çetës ndodhet në zonën Vërnik-Shuec. Në katundin Zagradec u vra një kapter i milicisë, i cili, me tradhëti, u kish dorëzuar italia-nve shokun tonë Abaz Ali.

Gjatë këtyre ditëve grupe partizanësh kanë qënë posht e lart nëpër Devoll. Kemi mundur të shohim dhe të dëgjojmë nga afër popullin dhe tashti ndjejmë mirë përse rreh zemra e tij. Balli kombëtar, gjatë mungesës sonë, ka qënë aktiv dhe ka mundur të bëjë me vete mjaft njerëz, që më parë ishin me Lëvizjen N.Çl. Safet Butka është sjellë këtyre anëve dhe ka derdhur pa kursim oratorinë e tija. Por pjesa dërmuese e Devollit është me ne. Një farë lufte politike zhvillohet në popull dhe secila anë mundohet të bindë anën tjetër. Ardhjen tonë balli e pritë me nervozizmë dhe po vërshëllen posht e lart: «Ardhën ata që dogjën Leskovikun». Njësitë tona shpesh herë janë takuar me çetën e ballit që bëhet prej nja 30 vetash. Kemi me 'ta veç një tungjatjeta e asgjë tjetër. Cili është komandant i tyre nuk e marim dot vesh se ata të gjithë hiqen komandantë. Duke na imituar ne ata kanë edhe komisar. I tillë, në çetën e ballit, është Hythi Tresteniku, një djalë një tridhjet vjeç, kuqërem, me një trup të bëshëm dhe një tip i qetë. Populli vë re se në ballin komandantë e komisarë janë të gjithë

bejlerë, agallarë e oxhakllinj. Kurse ne si udhëheqës kemi ata që e meritojnë dhe që kanë treguar zotësi në luftë e organizim. Ne kemi komandantë qymyrxhinj, bujq, çobanë, puntorë etj.

Gjithë pas modelit tonë balli ka ngritur në fshatra edhe këshilla të pushtetit lokal. Ngjet që ndër disa fshatra ka dy palë këshilla: të Lëvizjes N/Çl. dhe të ballit. Ne mbajmë si stemë në ballë një shqiponjë me dy krerë dhe mbi të një yll të kuq me pesë cepa. Balli mban veç një shqiponjë.

Nëpër katunde balli ka shtruar programin dhe synimet e tija. Thotë: «Armikun mos e luftojmë, sepse ay na djeg. Luftën do ta bëjmë kur të vijë koha.»

Lëvizja N.Çl. shtron një program të gjërë: «Luftë të paprerë kundër shkelësit të huaj, për një Shqipëri demokratike popullore ku të ketë për të gjithë bukë, liri e barazi.» Në programin e Lëvizjes N.Çl. shtrohet si nevojë e domosdoshme reforma agrare. Këtë balli nuk e zë fare në gjë. Kjo ngjet mbassi krerët e ballit janë thuajse të gjithë pronarë tokash. Por edhe shumica e përkrahësve të ballit i takojnë klasës të së pasurve. Populli, që është i dhënë pas L. N. Çl., nuk i beson fjalët e ballit. Çeta e ballit një pjesë të mirë të ushtarve të saja i mban me pagesë, herë u jep nga një shinik misër dhe herë vete qefil i vëllaj për të vëllanë. Vullnetarë në ballin janë veç disa xhandarë, ca bejlerë e aty këtu ndonjë festelli plak.

Çetën e ballit e pashë një ditë në Ziqishtë. Ne ishim aty një 15 partizanë që kaluam rastësisht. Komandanti i ballit po i mbante fjalë popullit ndënë hijen e një arre. E filloi me historinë, nga pellazgët ne ilirët ne Skënderbeu dhe Ismail Qemali. Lëvdoi racën shqiptare që i ka dhënë Turqisë 36 vezirë; dhe më në fund e mbylli fjalimin e tij duke thënë: «Të mos e luftojmë armikun se nuk ka ardhur koha» Por ne partizanët kësajë parulle i themi: «Prit gomar të mbijë bar».

Në ish këngë apo s'ish këngë, unë s'e mora vesh. Veç aty nga mezi i «këngës» kuptova që këndohej hymni i flamurit.

Një nga shokët tanë, djalë i ri, ra në fjalë me një ballist. Ky i fundit, tërthorazi, e ftoi partizanin të vejë në çetën e ballit; dhe djaloshi gjaknxehtë ja ktheu:

«— More, le që unë nuk vij, por edhe në ardhsh ti me ne, më thuaj ç'të të duam e ç'të të bëjmë!...»

— Je gjaknxehtë si djalë dhe nuk ta ve re, — ja ktheu ballisti.

Më vonë ushtarët e ballit u nisën. Ne ndejtëm aty e ja thirëm këngës. Na u mblodh fshati i tërë. Na shihnin në sy. Ardhëm pesëmbëdhjetë dhe ikmë tetëmbëdhjetë. Vullnetarët e rinj janë, Gaqua, Andoni dhe Thomaj.

## 19 Qershor

Një lajm i gëzuar! Na u komunikua sot në një mbledhje të përgjithëshme: Me vendim të Shtabit të Përgjithshëm çeta jonë mer emrin batalion. Me vendim të Komitetit Qarkor të Partisë Korçë, batalioni mer emrin «Fuat Babani» për përjetësimin e emrit të komunistit të shquar që u vra në Hoçisht më 7 Mars 1943. Batalioni organizohet në tri kompani me komandantë e komisarë. Në krye të batalionit caktohet një komandant, një komisar dhe një zv/Komisar.

Duke folur Komisari i batalionit na tha:

Ta mbajmë lart e më lart emrin e Fuatit. Le të mos e turpërojmë atë. Le të bëhet Batalioni i ynë tmer i armikut.

Pylli ku ishim mbledhur buçiste nga brohoritjet. Ishim të gëzuar. Ishim krenarë. Tani quhemi batalion e jo më një çetë e vogël. Radhët tona janë shtuar. Jemi më se dyqind partizanë.

## 20 Qershor

Me urdhër të Shtabit të Batalionit, njëzet e pesë partizanë u nisën për në Vithkuq. Këta kërkohen nga Shtabi i Përgjithëshëm si partizanë të zgjedhur. Midis tyre janë: Raqi, Maqua, Mitati, Kotepanua etj. Më duket se po shkojnë për ndonjë Leskovik të dytë.

## 25 Qershor

Ndodhemi në pyllin me boriga të Braçanit mbi vijën e kufirit Grek. Drekën na e sollën nga Braçani djemt e njësitit. Mbas dite ardhni nga Korça një vullnetar i ri. Nga robat që i mbajnë erë benzinë duket se është shofer ose mekanik. Solli edhe një letër nga disa shokë partizan: të cilët e rekomandonin si shok guximtar. Iu mbloodhëm për rreth dhe e pyetëm për nga qyteti. Dikush e pyeti nëse doli partizan nga qefi apo e «shtërngoi këpuca». Ndhimës shoferit i ndritën sytë:

— Hajde, hajde, po ku të lënë ata të njësitit t'u ikësh? Unë kisha ndërmend të dilnja me kochë, por jam marë me nxjerje materialesh nga qyteti... gjersa sa sot u mbush kupa.

Ndhimës shoferi kish qejf të tregojë, por si dukej i yinte rëndë të lëvdohej.

— Po si të vajti filli? — e pyeti dikush.

— Ç'e do, ma bëri borxh një qën bir qeni, s'kisha ç'i bënja, e vrava në një bostan!

— Si ore e vrava?

— E vrava, ja për atë bukë e vrava.

— Ama unë e kam zët kështu, — ndërhyri Fatja, — tregona me radhë.

— E vrava, për atë bukë e vrava...

Ne ja dhamë gazit. Partizanit të ri i ardhni rëndë. Kish mbledhur këmbët, kish qarkuar gjunjët me krahët dhe shihte për tokë. Si duket vrasja që kish bërë i kish lënë mbresë të thellë. Së fundi filloi të tregojë:

«— Më dha njësitit i qytetit nja dyqind kollona fi-shekësh për t'i nxjerë nga qyteti. T'i nxirnja me automobil ish e pa mundur mbassi në postbllok, ata të kuesturës, nuk lënë gjë pa kontrolluar. Kërkova e gjeta një kalë. I ngarkova me zor kollanët se kali u ndodh xanxar. Mora rrugën tatëpjetë qytetit. Asaj nate kisha parë dhe një ëndër sikur fluturonja me krahë e nuk më shkonte mëndja për keq. Kur dolla ne banka e shtetit, zuri të më ndiqte pas një polic kuesture:

— Me ngadale ore trim, se unë ty ta di tymin... a do t'ja lyesh rrotat qerres apo të kthehemi në kuesturë?

Unë gjashtaren e kisha në xhep dhe ja ngrita kokoshin. U mata t'a ndez atje në mes të qytetit e mirëpo rruga e mbushur plot ushtarë, m'i hapi punë mëndjes. Ja që nga një herë i duhet thënë derrit dajë.

— Aman ore vëlla, — ja ktheva, — derman më përcill gjer ne fabrika e miellit pa kërko sa të duash.

Ay ma ktheu:

— Duhet nj'a dyqind napolona.

— Mirë, ore, shqiptarë jemi ne, nuk prishemi për aqë gjë.

Ay përpara e unë pas, kaluam nga Vaselli, bëmë më të majtë e u ndodhëm ndënë fabrikën e miellit, aty ku janë nj'a dy kasolle në fund të qytetit. Atje polici qëndroi dhe vështroi për anash:

— Hajde tashti, tundu, nxir paratë.

— Aman, — i fola, — një çikë më pak se jam familjar. Ay mori zjarr.

— Prapa ktheu, qen bir qeni, drejt në kuesturë.

Atëherë bëra sikur të nxjer paratë dhe si vetëtimë ja lëshova me gjashtaren mu në bark. Ay u zbyth i lemerisur, palli si ndonjë gomar mashkull, kafshoi dherin e një hendeku në ca rrënjë pelini. Kali im u trëmb, më shpëtoi nga kapistra dhe u thiri këmbëve fushës tatëpjetë. Unë e ndoqa pas me vrap sa mundja. Më tej kalit i prori barra, po u ndodh qengla e shëndoshë dhe e mbajti. Afër Bulgarecit nj'a dy kositës i dualën kalit përpara dhe e zunë.

Ja kështu shpëtova, por e vrava qenin, ja për atë bukë e vrava!»

Në ditët e 26 e 27 Qershorit kaluam nëpër katundet Braçan, Ponçarë, Menkulas. Natën flinim përjashta. Populli na ka pritur shumë mirë. Komisari merrej me organizimin e këshillave dhe me njësitet guerile. Më datën 27 Qershor një aeroplan italian hodhi trakte mbi pyjet e kufirit. Na bëjnë thirrje të dorëzohemi duke na premtuar

parajsën mbi tokë. Ne mblodhëm trakte aqë sa mundme, dhe me 'to ndezim zjarret, se në agim bën ftohtë. Pasditën e 27 Qershorit në Kurilë ardhni një shofer nga Bilishti.

Pa dashur kish shtypur me automobil një ushtar italian dhe u kish thirur këmbëve. Komisari e pyeti mbar e prapë, por s'dukej të ishte njeri i mirë. Nuk e pranuam.

## 1 Korik.

Para disa ditësh ardhë nga Lavdari i Oparit tre partizanë. Të tre nuk i njoh dhe emrat nuk ua mësova dot. Komisari i njeh dhe i respekton shumë. Nj'a njëzet partizanë u ngarkuan t'i shoqërojnë për në Llëngë të Greqisë. U caktova dhe unë me grupin e të njëzetëve. Udhëtuam dy ditë e dy netë nëpër pyjet e Gramozit. Vura re se nëpër katundet greke njësitet bëjnë roje ditë e natë e na shoqëruan prej një katundi në tjetër. Llënga ish një fshat i madh malor. Kish disa dyqane gati të zbrazur dhe për rreth silleshin kopera të mëdha me dhen. Na pritën një shumicë e madhe andartësh të EAMit. Tre shokët që sollëm u takuan me disa grekë udhëheqës të EAM-it dhe një ditë e një natë patën bisedime. Mora vesh se bisedohet për koordinimin e luftimeve kundër armikut të përkashkët. Kur u nisëm të ikim, dualën të na përcillnin gjer larg. Qëndruam për t'u përshëndetur në disa lëmenj. Por atje u hap një punë që zgjati nj'a tri orë. Eshtë bërë zakon tashti që kur hasen partizanët bëjnë qitje. Një grek i dha shokut unazën e tij të mbështjellë me letër. Shoku e mbante unazën me tregonjësin e me gishtin e madh. I pari nga katër metra larg qëlloi me revolver dhe e kaloi plumbin nëpër unazë. U habitëm. Partizani grek na ofroi edhe neve unazën por ne nuk na e mbante. Një grek tjetër vuri një çerek tulle mbi një strumbullar dhe e qëlloi nga dyqind metra larg. Qëlluam edhe ne. Disi e afruam, por jo në mes. Do të mbeteshim ne turp, kur dolli Alicja në ballë. Ali e

ka emrin, por Aliçe e thëresim. Eshtë nj'a gjashtëdhjetë vjeç gjithë jetën ka qënë pojak. Ka qënë dhe në luftën e Vlorës më 1921. Aliçja vuri një kallamidhe mbi një strumbullar dhe u foli grekëve:

— Kush e ndan kallamidhen më dysh me plumb maliheri nga 200 metra larg?

— Dhen mboro <sup>1)</sup> foli greku i unazës.

Me gjith atë qëlloi. Kallamidhja mbet e pa prekur. Atëhere dolli Aliçja. Në na ndritnin sytë. Mori shenjë, hoqi tempon e parë të këmbzës, qëndroi frymëmarrjen dhe e shkrepiti. Kallamidhja s'u duk më. Rendën grekët dhe e morën. Ishte këputur mu në mes.

— Ton qerata, ton alvanos <sup>2)</sup>. Do ta kish patur plumbi rrugën. Hajde, akoma ena <sup>3)</sup>

Aliçja, i shkurtër dhe koperdak, qeshte me ata sytë e tij që ndritnin nga gazi. Qëlloi përsëri drejt e në shenjë.

U përqaftua me grekët e nisëm rrugën. Nj'a njëzet andartë e morën Aliçen në mes dhe bënë me ne nj'a tri orë rrugë. Pastaj u kthyen.

### 3 Korik.

DERI NJË

Ndodhemi në bazën tonë të Bradvicës. Këtu shokët kanë grumbulluar mjaft ushqime dhe kanë vënë kazanet me gjellë në zjarr. Mbas dite dolla me shokë për të prerë dru. U ngjitëm lart në një majë të Moravës. Prej atje dukej gjithë Devolli. Diku lart, nga ana e Gramozit, dukej edhe Dardha. M'u kujtua sërish ajo Joana që më pati shërbyer ditën kur dolla partizan. Dhe përsëri mendimet e mija trapitën një copë herë pas asaj.

Duke prerë dru, rëzuan një ah të madh të çarë përgjysëm nga rufeja. Kur po e krasitnim, godita gjurin me mykën e sopatës. Për disa minuta ndjeva një dhëmbje

1) Dhen mboro = nuk mundesh

2) Ton qerata, ton alvanos = qerata shqipo

3) Hajde akoma ena = Hajde akoma edhe një.

therëse, nuk zinja dot vënd për tokë e perpelitesha si peshku në të thatë.

Tashti dhëmbja është m'e pakët, por nuk mundem të bares. Zura një qcshe në një nga dhomat e manastirit të vogël dhe po e fërkoj gjurin. Llambi infermieri më rri pranë. Në një dhomë tjetër shokët kanë sjellë atë spiunin që kallxoi shokun Raqi Grabocka.

## 5 Korik.

Dhëmbja e gjurit vazhdon të më lerë pa gjumë. Bares duke kërcyer mbi këmbën e djathtë. Këtu janë edhe dy shokë të sëmurë. Llambi na rri pranë, por gjurit t'im s'di çfarë t'i bëjë. Gjithë shokët ndodhen posht e lart Devollit. Hera herës dëgjohen shkëmbime armësh nëpër fushë. Sot bëra një punë më kokën t'ime dhe fshehur nga infermieri. E di që do më heqin vërejtjen, por të bëhet c'është për të bërë. Lajmërova një kushëririn tim në fshat të më sjellë mushkën. Pas ndonjë ore ardh. U bëra gati dhe duke ecur çalë çalë dolla në pyll si për shëtitje. Ja hipa mushkës dhe zbrita në Korçë bashkë me druvarët e Bradvicës që kishin ngarkuar mushkat me qymyr. Ishte ditë pazari dhe dyshonja mos më nihte nieri. Vajta ne mjeku. Im kushëri më rrinte pranë. Në paradhomën e mjekut kish një tufë njerëz që prisnin radhën të vizitohen. Për fat asnjë prej tyre nuk njihnja. Zura vështronia fotografitë e varura në mur. Kish atje radiografi të kopjuara në pozitiv: ulçer duodenal, sifiliz në gjuhë, fëmijë rakitikë. Kisha droje se mos vinte njeri i njohur. Rrinja me fytyrë nga muri. Pa pandehur mjeku nxori kryet ne dera:

— Ka nieri për pyetje?

— Si urdhëron shoku doktor, jam unë...

Nxitova nga dera e tij por ndjeva se veshët «më kishin marrë ziarr». Pa dashur kisha thënë «shoku doktor». Kjo fjalë është e malit dhe aty mund të më kushtonte shumë shtrenjtë. Hyra ne mjeku. I tregova gjurin.

— Pse nuk ke ardhur më parë?

— ...

— Me se e ke goditur?



- Me mykën e sopatës.  
— Po ti dukesh shumë i dobët o djalë, pa çvishu, me  
ç'punë meresh? Pse nuk prite radhën, ti je për vizitë?...




Fig. Nr. 1

Nxora xhaketën, hoqa revolverin dhe e vura mbi tryezë. Mjeku po më hante me sy. Tashti po më shihte me dyshim e me urrejtje. Ndofta kish të drejtë. Gjithë spiunët mbajnë revolvera.

Më vështroi mbar e prapë, më qëlloi shpinën, mer frymë, jep frymë, më fort, çlodhu, kollitu.

— Ke punë të rëndë? D.m.th. të rendura shumë...

— Malit o doktor...

— Hë, hë!

Mjeku mbylli sytë përgjysëm dhe qeshi duke tundur kokën.

— Si e ke emrin?

— Ashtu si ti.

— Po mbiemrin?

— S'kam mbiemër, e kam lënë në mal.

— Nga je?

— Nga mali...

— Po pse ardhe ne mua?

— Emri i yt atje në mal na është i afërmë.

Mjeku më futi në një dhomë tjetër, më vështroi mir e mirë, më pyeti për disa shokë e miq të tija partizanë, pastaj bëri recetën dhe thirri nga oborri:

— Vaso!!!

Rendi një djalë i shkurtër me robe të bardhë.

— Nxir roben e bardhë, rëndë në farmaci dhe bli këto ilaçe.

Mjeku më kërkoi të falur dhe vazhdoi vizitat me ata që prisnin n'obor. Unë mbeta vetë në dhomën tjetër e zu më punonte mendja për keq. Sikur të vinin të më kapnin atje? Sikur të më kishin njohur? Të më kishin rënë pas?

Vasua u kthye shpejt. Hyri tek unë me gjithë mjekun. Vasua tashti më shihte me shumë kuides. Më dhanë barnat, këshillat se si t'i përdor. Më ngarkuan me të fala për këtë e atë shok e së fundi më dhanë një pako të madhe me cigare Diamand për t'ua ndarë shokëve. Ika shumë i kënaqur. Nga qyteti dolla sërish me druvarët. Në bazë Llambi më priti me këmbët e para:

- Eh, që s'të kapën andej pa ta shikonje!
  - Pusho, bre, se të solla Diamand!
  - Ja, tashti kërkon të më marësh me të mirë... lajmërova komisarin, kur të vijë ay e mer vesh.
- Dhe vërtet kur ardhi komisari hëngra të shara.

## 21 Korik.

Sot ardhën shckët që luftuan në Kuqar e Përmet. Janë ata të njëzet e pesë që shkuan në Vithkuq më datën 20 Qershor. Sofua më tregoi ndodhitë e asaj lufte. Më tha se lufta në Përmet dhe Kuqar ish e përgjakëshme. Ajo zgjati më se pesë ditë. Armiku la më shumë se pesëqind të vrarë. Përlëshjet u bënë edhe me bomba dore. Aty ishin grumbulluar gjithë çetat e batalionet partizane të jugut. Luftimet i drejtoi Shtabi i Përgjithëshëm. Por duke u kthyer nga Përmeti çeta jonë e vogël prej 25 partizanësh u godit me tradhëti nga një pritë e ngritur nga ballistët në Kurtes të Kolonjës. Megjithse në befasi partizanët kishin luftuar si trimat dhe kanë vrarë komandantin ballist që organizoi pritën. Por edhe shcku i ynë Todi i vogël mbet i vrarë nga plumbat e ballistave.

## 22 Korrik.

Sot në mëngjez ardhi këtu në Bradvicë një korier nga Ziçishti me një letër nga këshilli i katundit për komandën tonë. E hoqa më një anë korierin dhe e pyeta si qëndronte puna. Ay më tregoi:

- Na kanë ngjarë tri ndodhi të pa pëlqyera. Në mëngjez Roku zuri në kopësht vajzën e tija duke biseduar me djalin e Ilos dhe u të një sher i madh.

- Vetëm bisedonte e bija?

- Jo more, ashtu... ngatëruar.

- Hë, hë. Po të tjera?

- Para disa ditësh Vangjeli kapi të bijën me Spiron që bënin dashuri. Tashti nuk e qas çupën në shtëpi. Ja shpuri ne porta me priftin dhe me psalltin.

- Ç'bëni kështu, bre burra? Po na nxini faqen, ne luftojmë ju bëni dashuri? S'na janë mjaft punët tona po të vimë të bëjmë gjyqe edhe me juve? Po tjetër?

— U zu mullxhiu ynë me fshatarët e Shënkollasit për punën e ujit të vaditjes; puna vajti gjer sa të lozë kopaça.

— Lojti?

— Jo, edhe s'ka lojtur, por nëqoftëse nuk vë dorë komanda, do të lozë edhe këmbëza.

Zbritëm në Ziçisht. Jorgo Plaku u bë gjykatës. Thirmë në shkollë dy vajzat, dy djemat dhe prindërit e tyre. Gratë shanin e vërshëllenin me rënjë e degë dhe u vërsulën të kapen me njera tjetrën. Jorgua me durim e gjakftohtësi mezi i ndau. Të rinjtë pranojnë se dashurohen e janë gati të martohen, por nënat e djemve nuk duan. Gjer në mesnatë mezi u bë pajtimi dhe caktuan ditën e martesës. Pastaj filloi gjyqi i ujit të vaditjes. Edhe për këtë u gjënd një farë pajtimi që të lihen dy qeramidhe ujë për vaditje.

### 23 Korik.

Ndodhemi që herët në livadhet e Grapshit. Sot u mblodhën këtu njësitet guerile, këshillat N. Çl. e popull nga gjithë Devolli. Munguan veç nga Piluri, ku balli si duket ka zënë rënjë e nuk ka lënë njeri të vijë. Mitingun e hapi komisari i ynë. Ai i foli mbledhjes për një bashkim më të madh rreth Lëv. N. Çl., mbi politikën e jashtëme, mbi frontet e luftës, mbi luftën që po bën populli shqiptar e mbi ata që predikojnë se «s'ka ardhur koha». Në fund bëri thirrje për të dalë vullnetarë në Batalion. Dualë gjithsejt 65 vullnetarë. Pastaj fshatarët na ftuan për drekë e hapën torbat e tyre. Hëngrëm drekë sëbashku. Lojtëm valle e kënduam gjer vonë. Disa pyetnin mbi luftën e Leskovikut dhe të Përmetit. Shokët tregojnë me nge. Kur u largua populli, komanda jonë organizoi 65 vullnetarët në skuadra. Veç na doli një pengesë: mungojnë pushkët për t'i armatosur shokët e rinj. Ata që sollën armë me vehte bëhen nj'a njëzet veta, të tjerëve u dhamë arkat e municioneve dhe nga një tytë rezervë të mitrolozit.

Sonte natën u bë një provë alarmi i përgatitur që

më parë. U dha alarm me një të shtënë pushke nga katundi Pustec i Prespës dhe rojet e çdo katundi e përsëritën me radhë të shtënë fshat më fshat dhe mal më mal sa arijti në krye të Devollit në Dardhë. Këtu, sipas planit, u zbraz një kombë dore. Prova pati sukses të plotë.

## 26 Korik.

Jemi në Shënkostandin të Bradvicës. Dje u mbledh këtu gjithë Batalioni ynë. Komisari na mbajti fjalë. Na tha se Ushtria N. Çl. nga çetat e vogla kaloi në Batalione e tashti zgjerimi i luftës dhe vullnetarët që po vijnë për ditë, kërkojnë një organizim më të gjërë. Së shpejti do të organizohet Brigada e Parë Sulmuese.

Pastaj filloi regjistrimi i vullnetarëve. Gjithësejt do të shkojnë për në Brigadën e Parë 100 partizanë nga Batalioni i ynë. U regjistruan më shumë, por u nisën vetëm numuri i caktuar. Batalioni «u gjymtua», por ne prapë do të shtohemi.

Sot ardhë nga Korça një tufë komunikata të luftës. Ndër 'to lexuam se Musolini ra nga fuqia dhe vendin e tij e mori Mareshalli Badoglio. Nga Korça kanë dezertuar gjashtëmbëdhjet xhandarë me komandantin e tyre e janë hedhur në radhët tona. Në mbremje zbritëm në Hoçisht. Aty dëgjuam radion. Në gjithë Italinë janë tërë demonstrata kundër luftës.

## 2 Gusht.

Ndodhemi në Sul të ftuar nga populli i katundit. Gjithashtu kanë ftuar edhe çetën e ballit. Do të bëhet një mbledhje e popullit në shkollë, ku do të flasë komisari ynë dhe ay i ballit. Në fund populli do thotë mendimin e tij: nëse është me ballin apo me Luftën N. Çl.

Në bazë takova një shok fshatar që sapo kish ardhur nga Korça. Më tregoi se Italianët e kanë humbur toruan kurse xhandarët e policët janë në pikë të hallit. Dualëm në oborin e xhamisë. Atje ishte edhe çeta e ballit. Ballistët rëndom janë burra me moshë të thyer; rrinë më bisht ndënë strehët pas hijes dhe pushkët i mbaj-

në më një anë. Ne jemi thujse të gjithë djem të rinj, tërë zjarr e s'na mban vendi. Disa nga ne filluan të bëjnë mundje, disa kërcime dhe një grup u mblodhën pas një paraleli prej druri në obor të shkollës aty pranë e filluan të bëjnë gjimnastikë. Disa ja morën këngës:

**Shqipja jonë mori malet,  
Theu zinxhirat përsëri...**

Por kënga sjell këngën dhe s'kishin ndërmend të pushonin. Ushtarët e ballit deshnin edhe ata të këndojnë. Dikush i mblodhi për rreth e ja nisën:

**Rreth flamurit të përbashkuar...**

Disa prej tyre nuk ja thonë fare (po hiç ama) dhe mbajnë zë. Ne shtërngonim dhëmbët që mos qeshnim. Më von u takuan atje edhe shtabet e të dy palëve. Bënë toka dhe biseduam më këmbë. Komisarari i tyre kish ne dorë një trëndafil dhe ja dha komisarit t'onë:

— Na, zoti Myzafer, një trëndafil të kuq, si i kuq që je.

Myzaferi e mori.

Shokët e këtyrë na goditën prapa krahëve e na vranë Todin e vogël në Kurtës. I vështronim vëngër se na djeg në shpirt, por urdhëri është i prerë: Asnjë fjalë që mund të shkaktojë sherr.

U mblodhë në sallën e madhe të shkollës gjithë burrat e djemtë e fshatit. Në fillim e mori fjalën komisarari i ballit. Si zakonisht e nisi me Pellazgët, Ilirët, Skënderbenë. Ismail Qemalë, me racën e kombin. Pastaj foli për bashkimin e popullit, për çlirimin e Shqipërisë, urtë e butë pa aksione, se armiku është i fortë dhe na djeg. Tha se balli është gati të bashkohet me L. N. Çl. me disa kondita. Në fund tregoi se ka qënë në një shkollë me komisararin t'onë dhe janë miq të mirë.

Pastaj e mori fjalën Myzaferi.

— «Ne do të luftojmë shkelësin e vatrave tona gjer në fund, kush ka frikë le të fshihet, kush i thotë vehtes

patriot e shqiptar, të dalë në luftë. Me të drejtë mburemi për Skënderbenë, por ay nuk ka ndenjtur urt' e butë e duar kryq. Në do të tregojmë se jemi stërnipat e tij të denjë».

Pastaj filluan pyetjet e përgjigjet. Në fillim kaloi di-si mirë e në rregull, por më tej pyetësit ziheshin midis tyre dhe u prish rregulli.

Në fund u ngrit një fshatar e tha këto fjalë:

— Unë jam me ballin se andej e kam tarikun e mi-qësisë, por idenë e kam komuniste se jam fukara...

Gjëndja në fshat mbeti e ndarë dysh. Një pjesë aga-llarët me ballin dhe një pjesë me L. N. Çl. Rinija në pjesën dërmonjëse është me ne dhe këshillat e pushtetit lokal mbetën dy; e jona dhe e ballit. Në mbrëmje u nisëm për në Vërlen.

#### 4 Gusht.

Mbrëmë isha roje e patrullë nëpër fshat. Në shtëpinë e kryetarit të këshillit kish mbledhje celula e batalionit. Kjo tregon se përgatitemi për ndonjë aksion luftarak.

Sot gjithë ditën komisarri e komandanti i Batalio-nit vizituan bazat e partizanve të kompanisë ku bëj pje-së edhe unë. Na pyetën për fishekët e bombat që kemi, na i nëmëruan një nga një e na vështruan pushkët. Tash-ti vetkuptohet se kompania e ime do niset për ndonjë luftim. Mas dite dolla në oborin e xhamisë. Kish atje edhe një dy shokë të tjerë që po vajosnin armët. Më tej ardhi një partizan i panjohur. Iu afrova dhe e përshën-deta. M'u duk si çudi. Ay tha se vinte vullnetarë në ba-talion. Kish pushkë të mirë greke, kostum oficeri italian, yll të kuq metalik, revolver, dylbi, sahat dore prej ari. Më tregoi se ishte kushëriri i filan komandanti partizan dhe se kish mbaruar shkollën e oficerëve në Orvieto. Tha se kish patur gradën Toger.

Renda ne komisarri dhe i tregova mbi «partizanin» e ri.

— Është oficer i karrierës, shoku komisar. Ta shikosh të lot mëndja.

Myzaferi po mblidhte supat kur foli Hamdiu.

- E, e, do jetë ay katrani, ay Latifi, ç'ta ka hedhur...
- Ay është oficer.
- Rri mo, se i ka të rrëmbyera ato roba, unë kam qënë ushtar me të.
- Ka mbaruar në Orvieto...
- Ay mezi shkruan...

Dhe vërtet doli si tha Hamdiu. Oficeri «profesionist» paskëshe qënë, një kapadaji mëndjemadh. Komisari, si ja pa targën mir, e mirë e këshilloi të shkojë si efektiv i njësitit gueril të katundit të tij.

Në mbrëmje dy kompani, bashkë me 'to edhe Komisari i Batalionit, muarën një drejtim të paditur. Kurse kompania jonë, me komisar Mitatin dhe komandant Zianë u nis në drejtim për në Progër. Nata na zu rrugës. Isha pararojë me Kotepanon dhe Hamdinë. Kur iu afruam Babanit dhe duallëm mbi një çukë, na goditi syrin një pamje e çuditëshme në errësirë. Në një si vijë valavitëse ndizeshin e shuheshin dhjetra gulshe të vogla zjarri. Lajmëruam prapa. Zunë pozicionin kur Hamdiu me zërin e tij t'ashpër bërtiti:

- Ndal, kush jini?

Si përgjigje morëm zhurmën e një rendjeje nëpër ara. Kish qënë çeta e ballit në çlodhje duke pirë duhan. Në mesnatë mbrijtëm në Progër.

## 5 Qusht.

Ndodhemi në Progër. Fshati na priti shumë mirë. Progri është katund i madh. Vetëm një katër familje agallarësh janë me ballin, të tjerat janë lidhur me luftën N.Ç. Gjithë ditën nëpër baza bënë vizita grupe djemsh e vajzash. Sa ra nata e gjer nga ora dymbëdhjetë, dualëm dy skuadra poshtë fshatit nga ana e xhadesë. U futëm në disa rakita dhe ndejtëm në pritje. Njësitë i Progri kish rënë në lidhje me një grup ushtarësh italianë. Këta kishin dhënë fjalë se do të dezertonin nga gazerat e tyre e do vinin partizanë. Më kot i pritëm se nuk ardhën.



## 7 Gusht.

Agimi i sotëm na zuri në majën e Ivanit. Mali është krejt i çveshur dhe shkëmbor, gjithë gurë të kuq dhe shkrepa t'egër. Vëndi ku ndëjtëm ishte i çarë dhe i tme-luar me istikame mbetur nga lufta italo-greke. Herët në mëngjes, tre djem nga Pusteci, na treguan gjëndjen ndër ato anë: Krimineli Et-hem Bej Maliqi ka dalë kaçak dhe synon t'i mbajë çiflik dhe paskëtaj fshatrat e Prespës.

Me emrin e tij krimineli është lidhur historia e n-dhur e Prespës dhe e Goricës së shkretuar. Ne na bie detyra të ngarendim në Prespë e t'a varim beun kaçak të kolovitet në ndonjë degë lisi. Gjer n'orën tre pas dite kishim çlodhje. Pastaj u nisëm. Kaluam Ivanin nëpër shkrepa dhe monopatet e dhive dhe arrijtëm në vargun shkëmbor të maleve të thatë. Që aty dukej Prespa: li-qeni me ngjyrë të thellë mavi, shtrijtur sa gjatë gjërë në mes malesh të shkretë e rrallë të pyllëzuar, katundet zbardhonin gjatë bregut, varka të vogla shkisnin nëpër ujrat e liqenit. Në mes dukej ishulli i vogël i Shënpalit me kishën e vogël, që fshihet nëpër degët e drurëve. Më tej nga perëndimi, gjarpëron një vijë e bardhë e plunro-sur ku kalojnë autokollonat e italianëve për në Manastur. Rreth ishullit diçka lëvizte. Shikuam me dylbi dhe u na-bitëm: një tufë kuajsh hynin e delnin në bregun më tut-je, çobenët lundronin me varkat e ngarkuara me dhën e cepinj me zile e delnin në bregun tjetër.

Në mbrëmje zbritëm në Pustec bashkë me barinj-t e tufat e dhënëve. Fshati doli na priti me dashuri. Ndih-ej një lëvizje e zhurmë e këndëshme; këmborë e zile, blegërim e thirrje. Edhe liqeni si përshëndetje përplaste në breg dallgën e shkumëzuar të ujrave që i ngiste era. U shpejtuam të nisemi. Darkën e hëngrëm nxituar dhe pimë ujë liqeni që mban një erë të rëndë. Na dhanë bu-kë e gjellë edhe nëpër çantat.

## 8 Gusht.

Udhëtuam gjithë natën që shkoi. N'agim kapërcyem qafën e Gollomboçit dhe zbritëm në një pyll me ausn-

kerë ndënë rrugë. Më sipër mërzenin dhën pranë një stani, por burime me ujë nuk gjetëm. Të gjitha patrullat që ishin nisur për t'i gjetur gjurmën Etem beut u kthyen pa takuar gjë.

Filloi e nxehta e shtatë ditëve të para të gusnit. Hëngrëm bukë me cironj të kripur edhe me plper (gjelë e vëndit). Etja na mundonte, ujërat e liqenit na e bënë me sy por ishim shumë larg. Nga Gollomboçi erdhën një grup të rinjsh, pas tyre, disa fshatarë më të shkuar nga mosha, u ngjitën nga arat; të tjerë zbritën nga stanet. Vinin gjithë të qeshur. Ishin bujqër e peshkatarë të nxirrë nga dielli dhe të veshur me roba shajaku. U përqafuam me 'ta si miq të vjetër dhe shtruum fjalë. Nga biseda kuptuam se populli është shqetësuar nga krimineli i vjetër Etem beu. Është i gjallë kujtimi i goricarëve që Etem beu me xhandarët i shkulën nga vatrërat dhe i bënë syrxyhyn në kohën kur mbretërinte «madhërija e tij» Ahmet Zogolli.

Një bari, që është antar i këshillit N.Ç. të fshatit, na tregoi se para dy ditëve kishte parë nga larg tre kurra t'armatosur dhe qentë i kishin ndjekur gjer thellë në pyjet nga ana e Goricës. Lart në xhade herë pas here kalon ndonjë autokollonë italiane dhe motorat ushtojnë në të përpjetën e madhe të qafës së Gollomboçit. Në mesditë njësi i fshatit na solli drekën me ujë liqeni në varrela ngarkuar në mushka. Mbassi hëngrëm bukë, komisarri i ynë i dërgoi një letër komisarit të një batalioni partizan maqedhonas. Pastaj u nisëm për aksion.

Ishte ora dy, pisku i vapës. Nëpër shkëmbinjtë e monopatit zbariseshin shumë gjarpërinj. Rruga ishte shumë e përpjetë. Ishim pa gjumë, dielli digjte, etja na mundonte, diersët na kullonin, armatimi rëndonte, por me gjithë këto sepse ndjeheshim lehtë! afër qafës së Gollomboçit është një arë trekëndëshe rrethuar me mure t'unjta, kundrejt sajë dredhon xhadeja. Pa prituri aty dëgjuam zhurmë automobilash që ngjiteshin. Ne nxituam të arrijmë përpara autokollonës, se ishim në një shkrep të zbuluar. Pararoja zuri vëndin sipas planit, të tjerët po rëndnin. Kur në kthesën u dha me një herë balli i autokollonës.

Nëpër kamionat këndonin të çkujdesur: Viva il corpo degli alpini! <sup>1)</sup>

Pastaj krisën armët. Makinat ca u ndalën ca u rru-kullisën. Krismat e mitralozave e të bombave i shoqëro-nin të thirrurat e luftës. Në thërrisnim «bjeruni!» dhe «dorëzohuni!». M'at'anë disa ulurinin «arendiamoci» <sup>2)</sup>. Të tjerë shanin dhe qëllonin.

Disa këmishëzinj, futur midis disa thasëve me çimento në njërin nga kamionat qëllonin me mitroloz dhe flaknin bomba dore. Plumbat tanë ngelnin në çimenton e thasëve dhe ata shanin dhe qëllonin të vendosur gjer në fund. Atëhere Pjetër Pregna u vërsul sipër me bomba dore. Thasët e çimentos lojtën nga vëndi, disa u rrokullisen, por fashistët qëllonin gjithënjë dhe ishin si në një forti-në të përgatitur. Pjetri, kur e pa kështu, u fut ndënë ka-mion dhe i griu me automatik që nga poshtë. Brënda gjy-sëm ore armiku u dorëzua. U mblodhën robërit në një fushë të vogël bri rrugës. Ishin dymbëdhjetë oficera dhe shtatëdhjetë ushtarë italianë, si dhe katër xhandarë shqip-tarë. Pastaj mblodhëm armët. Ishin afër 100 pushkë, tre mitraloza të lehtë, një i rëndë, një arkë me bomba dore, tetëmijë fishekë, pajime ushtarake dhe dy arka konser-va të ndryshme. Në një çantë lëkure gjetëm pesëmijë na-polona kartë që komanda italiane e Carisvorit ja dër-gonte një firme tregëtare në Korçë për të blerë verë.

Para se t'i lironim robërit, u foli shkurt Komisari, u shpjegoi luftën tonë dhe i porositi të mos luftojnë më për fashizmin. Të llahtaritur robërit prisnin që t'i vrisnim dhe qanin me kuje. Na binin ndër gjunjë, ngrinin krahët nga qielli dhe betoheshin për të gjithë shënjtoret se qenë mërzitur së renduri nëpër frontet e luftës. Disa na trego-nin fotografitë ku kishin dalë në mes të fëmijëve të ty-re. Një alpin i ri tregonte fotografinë e të fejuarës që e priste ç'prej gjashtë vjetësh; ishte një vajzë e hijëshme dhe e mbushur ndejtur në mes një kopështi me domate e shihte larg e me trishtim. Ne na vinte keq sinqerisht për ata djema të huaj, por në fund të çdo arsyetimi ata ishin shkelës dhe zaptontës të tokës sonë.

(1) Viva il corpo degli Alpini. — Rroftë korpi i alpinëve.

(2) Arendiamoci — dorëzohuni

I lamë ushtarët të marim plaçkat personale dhe u vu-  
më zjarrin gjithë kamionave. Një caporal shamataxhi du-  
ke kënduar: «Avanti popolo» filloi të merte në fotografi  
kamionet që digjeshin. Sapo u futëm në pyllin për bri  
rrugës, u duk një aeroplan italian që filloi të sillet mbi  
ne; por ishte vonë, se ne qemë larguar të ngarkuar me  
materiale e kapura si dhe me oficerat e zënë rob e pa  
ndonjë humbje.

Etja po na mundonte tmerësisht. Ujë këtyre anëve  
nuk ka përveç liqenit dhe ndonjë burimi shumë të rallë.



Fig.Nr. 2

Të hash bukë me peshk të kripur e të piperosur, të  
rendësh me vrap në të përpjetë, të luftosh e përsëri me  
vrap të futësh në pyll i ngarkuar dhe më rëndë, në mes  
të Gushtit nën një diell përvëltonjës, qiellëza të bëhet tro-  
kë si në rrezhdë, buzët të zënë shirit mavi dhe të çahen,  
të duket sikur koka të lëshon tym.

Pagure zumë mjaft por ç'i do? Janë bosh.

Ja dhe Kotepanua përpara ka marrë një pagur në kra-  
hë po ç'e do? e ka bosh. Zgjata dorën dhe kapa pagurin  
e tija. Dëgjova një si zhurmë uji... Përpëlita sytë? Ay  
ktheu kokën buzëqeshur, dhe buzët i kish të njoma.

— Është pak raki, — më tha, — regullorja e ndalon  
rakinë.

— More sille këtu, pa shafran le të jetë!

U shtrita mbi një shkëmb dhe ngrita pagurin. Sipër  
aeroplani sillej dhe kërcënohej. Dy shokë të tjerë ma  
muarën pagurin dhe e thanë krejt. Aty e mësova që ra-  
kija ta shuan etjen për bukuri. Por u ndodha i pangrënë  
dhe koka m'u bë si gjym i zbrazur dhe lisat filluan të  
ngjiteshin më shpejt se unë.

Në mes një tumbe me lisa u unjëm mbi një shkëmb  
të madh mbuluar me myshk të gjelbër. Hija ish e theië,  
dielli nuk na shihte. Fletët shushurinin, pylli ushëtonte  
nga thirjet. Larg, poshtë nga xhadeja dëgjoheshin kriz-  
mat e zjarrit.

Tëmthat më rrihnin me vrull, lisat po rrotulloheshin  
në sfondin e qiellit, mëndja po më trapitëte larg...

— O Kotepano!

— E, o?

— Atje në Dardhë, në fshatin tënd, e kam mëndjen.

— Pse?

— Dikush atje më ka shërbyer ditën e parë që dolla  
partizan, dhe që atë ditë nuk e harroj dot; dua t'a harroj,  
por nuk mundem.

— Kush është ay?

— S'është ay por ajo.

— Hë, hë, po si e ka emrin?

— Është një ezmere, qafë gjatë e gushëbardhë, me ta-  
qe të kuqe, me sy të zinj...

— E ore vëlla, le rakiya po ty të paska edhe qymyr!...  
Nga cila anë e fshatit është?

— S'e di.

— Sidoqoftë, shiko mos jetë nga lagjia lart, se mund  
të ndeshemi bashkë!

— Jo, jo, e ka shtëpinë poshtë nga kroi.

Dhe fjala do të shkonte thellë e më thellë aty në mes të pyllit mbi shkëmbin me pulla myshku, por u dëgjuan batore mitralozash nga xhadeja.

U vumë në udhë, arrijtëm në kulmin e malit dhe filuam të zbresim gjithë nëpër pyll me dushk. Tutje, në këmbë të malit, dukej një stan. Më tej, nëpër një lëndinë, kalonin një grup grash ngarkuar me bucela, veshur me shegune të zeza, me këmisha të gjata e të bardha. Nxitonim se ujëb e bucelave na ndillte. I arrijtëm dhe u thirrëm:

— Voda majko!¹).

Ato na përkëdhelnin me sy buzëqeshur, lëshuan ndër duart tona bucelat e rënda që mbanin erë pishë dhe na bënë kryq mbi ballë. Neve të rakisë (katër veta jemi) na dhanë dhallë stani e hirrë gjize. Dhe, si për çudi koka na ardhni në vënd. Edhe këtë nuk e dinja, por atje e mësova.

Mbasi u çlodhëm pak, ra nata dhe u vumë në rrugë. Gratë na përcuallën duke bërë kryq dhe i luteshin zotit.

Hënë nuk kishte, por disi dukej. Kaluam nëpër ara. Kallëpet e mbushur të misrit na rrihnin gjunjët. Zkri-tëm afër Pustecit dhe iu shtruam gjolit më bark me kokën ndë ujë sa u ngopëm mirë. Atje u nda darka. Intendentit e lëshoi dorën për grupin e ri të pararojës dhe na dha një konservë të madhe pa emër dhe pa markë prej atyre që u kapëm italianëve. Syrjai e gjeti me mënd:

— Është me mjaltë!

— Të shohim.

Përsëri nismë marshimin. Po bëhen tri ditë e tre netë pa fjetur, po askush nuk po ankohej. Jeta e malit me bukë e pa bukë, me gjumë e pa gjumë, me marshime të gjata e rendje të befasishme në luftë, na ka regjur. Kaluam gjithë buzë liqenit dhe këmbët na goditnin bute në kumin e lagështë. Aty këtu shihnim fenerët e peshkatarëve që lëshonin një dritë të dobët mbi ujrat. Lamë më të djathtë Pustecin, pastaj Zaroshkën dhe qëndruam

---

¹(1) voda majko — ujë nëne.

sipër një burimi të madh që buron nga shkëmbi. Kompania zu vënd më poshtë. Urdhër të hamë darkën. U nis Kotepanua të mtushë me ujë atë pagurin e bekuar që akoma mban erë raki. Ne me Hamdinë u vumë të çelëm kutinë e konservës me një copë bajonetë (është një nga tetë meleon bajonetat e Duçes). Syrjaj preu bukën dhe ngulte këmbë që konserva ishte me mjaltë; çkulëm lugët nga brezi dhe pritëm me ankth me bukë në dorë. Pritnim të shohim se ç'do të kishte brënda, por Syrjai ndjente erën e mjaltës. Së fundi e çelëm kapakun: një qull i trashë dhe ngjyra nuk i dukej n'errësirë. Vumë pak në gojë: salcë domatesh... e thartë si narden.

Hamdiu preu të qeshurat e mori fjalën:

— Peshk të bleva, peshk të ha e llafe s'ka. Hajde djema për shëndet të intendentit dorëlëshuar... Ore Syrja, mjaft vajtove mjaltën, ty ore të them, të kam gjetur me pesë lugë salcë.

— Mirëse të vish, të pres si burrë, ti që më gjete mua të gjetë e mira!

Hëngrëm darkë duke qeshur si djem se si e thotë edhe fjala: «Gazi i ha mollët e tharta».

Muarëm të përpjetën e gjatë mbi Zaroshkën dhe lamë në të majtë burimin e madh t'ujit. Rruga ishte e keqe, plot gurë dhe driza. Vonë arritëm në një pyll me lajthishta. Aty qëndruam për çlodhje dhe ja muarëm këngës:

**Zëri i pushkës me furi  
Po buçet sot an' e mb'anë...**

Pastaj kur gazi u ngrit në majët, drodhëm edhe vallen tonë devolliçe të pashoqe:

**Pa dilni e shihni qafsorkallen,  
Se sa me naze e dredh vallen,  
Gjunj mbi gjunjë e hedh fustanen.**

Gjëmonin brigjet nga kënga jonë në terrin e natës, qent' e staneve lehnin me potere, ndonjë buf i trëmbur vajtonte prapa drizave.

Afërdita po ngjitej mbi Ivan. Larg e rrotull liqenit të përgjumur ndritnin shumë kandile. Aty këtu çante ujrart ndonjë shkëndi drite. Në ishullin e vogël të Shën Palit digjej një zjarr i madh. Veç xhadeja e madhe e Manastirit tashti nuk pipëtin më.

### 10 Gusht.

Dje n'agim mbërritëm në Rakickë të lodhur e të kapitur. Asnjëri nga ne nuk desh të hajë bukë. U ndamë shpejt ndër baza për të fjetur. Komanda caktoi dhjetë shokë që të rrinë roje mbi robërit italianë. Më caktuan edhe mua, por unë nuk qëndrova dot me këmbë. E ndjenja, se po të rrëzohesha për tokë, do të më zinte gjumi. Shabani më ardhni në ndihmë.

— Fli ti, se do rri unë në vënd tënd; je çunak e nuk duron dot.

E mirëpo nuk fjeta dot, se ja, pa pritur e pakujtuar, u ndje uturima e një aeroplani dhe fill atëhere fishkëlluan plumbat. Aeroplani po mitralonte katundin. Spiuni kish qënë shumë i shpejtë. Po deshe, mëshiroje kur e kap.

Mitralimi vazhdoi gati gjysëm ore, pastaj aeroplani u largua. Doli urdhër të dalim në pyllin mb'anë katundit.

Atje muarëm vesh se nuk patëm asnjë humbje në njerëz. Ishte vrarë veç një ka kur po shkante në kullotë.

Sot në mbërrime lamë Rakickën dhe muarëm drejtimin për në Devoll. Diku afër Trenit, te një burim, njësi i Progrit na solli bukë. Kur kaluam afër Pilurit, vumë re se një nga robërit na kishte ikur. Komisari i kompanisë u nxeh. Qëndruam afër disa lisave. Kush e pati fajin? Kujt i iku? Askush nuk përgjigjej. Më në fund foli Fatja:

— Ngjau kjo, o shoku Mitat, mënd për tjetër herë, fajin askush nuk e mer, mir e thotë fjala: faji u bë qyrk e s'e mori njeri.

N'agimin e datës 11 Gusht qëndruam në korijet e Babanit. Ardhën këtu edhe dy kompanitë e tjera të Bata-



lionit. Shokët duan shpjegime e hollësira për luftimin ne qafa e Gollomboçit, por ne na flihet. Dorëzuan roberit dhe ramë në gjumë.

### 15 Gusht.

Nga korijet e Babanit ikmë në mbrëmjen e datë 12 Gusht. Darkën e hëngrëm në Sotivraç. Kapitenin italian e shtrëngonin çizmet dhe komisari ynë, Mitati, nxori e i dha këpucët e tija. N'agim qëndruam në korijet e Sulit. Prej këtu u nisëm në drejtim të Alevicës. Alevica është një mal i lartë brënda kufirit grek dhe dominon mbi gjithë Devollin. Këtu ardhën për të na takuar një batalion partizanësh të EAM-it. Në Alevicë mësova hollësitat e marëveshjes që ka L. N. Çl. dhe EAM-i mbi koordinimin e planeve të luftës kundër okupatorit, mbi hyrë-daljet në tokën tonë e në tokën e tyre, dhe mbi ndihmën që duhet t'i japë njer tjetres kur të shihet e nevojshme gjatë luftimeve.

Andartet e EAM-it kishin orkestër dhe filluan të he-dhin valle; të tjerë këndonin e disa bënin qitje. Më tej disa grekë këndonin:

Alvanites penemeni  
Pu ine o Ali kaimeni  
Ine mesa qe qimate  
Qe kanena dhenfovate <sup>1)</sup>

Grekët e EAM-it na mbajtën për drekë. Hëngrëm bukë e rrush. Pasdite na ardhni një ultimatum nga komanda italiane. Kërkonin t'u dorëzonim roberit përndryshe na kërcënonin se do t'na zhdukni e do t'a djegin gjithë Devollin. Robërit e muarën vesh përmbajtjen e ultimatimit. Dy prej tyre filluan të qajnë. Një skuadër mori në dorëzim roberit dhe u nis t'i shpjerë në komandën partizane të qarkut.

Dikush më tha sot se Shtabi operativ Greko-shqiptar kish marrë informata dhe italianët do të sulmojnë

---

<sup>1)</sup> Shqiptarë trimë, ku është Ali trimi, është brënda e fle, dhe askujt nuk i a ka frikën.

Devollin me dy kollona. Njera kollonë do drejtohet nga Korça në Devoll e tjera nga Greqia nëpër Nestram, drejt Devollit. Dhe në fakt sot kollona italiane ish nisur nga toka greke për në Devoll, por u godit nga partizanët e ELLAs-it, dhe tashti po dëgjohet gjëmim i madh artilerie. Batalioni grek që është me ne në Alevicë po gatitet të shkojë andej nga gjëmon topi dhe ne do nise-mi për në Devoll. Kërcënimit të armikut, që kërkon të djegë katundet, do t'i përgjigjemi si duhet.

## 16 Gusht.

Mbrëmë zbritëm nga Alevica në Menkulas. Fshati ishte në alarm e njerëzia të trembur; i gjetëm duke fshehur plaçkat e ushqimet në tokë. Komanda italiane iu ka dërguar letra me kërcënime të gjithë katundeve. Në mesnatë qëndruam në Lajthia e Çipanit. Komadanti e komisari urdhëruan të qëndrojmë në gadishmëri. Kudo që të drejtohet armiku, ne do të ngarendëm t'i dalim përpara.

Sot filluam të vështrojmë me dylbi nga Bilishti. Rreth gazermave dukej lëvizje, zvariteshin topa, tankse motorat buçisnin. Patrullat tona silleshin nëpër fushë. Në mesditë komanda më dërgoi në Zicisht me dy shokë për të kërkuar bukë. Sot këtu është festa e Shënmarisë. Sipas zakonisht, në çdo shtëpi kishin therur nga një shqerë. Këshilli u mbledh në shkollë e shpejt u vu në punë.

Çdo shtëpi, veç së tjerave, dha kokën e pjekur të shqerës (ndër ne koka e pjekur e shqerës i jepet mikut në moshë më të madhe për nder). Nëpër fshat silleshin katër mushka ngarkuar me kosha e qëndronin portë më portë. Sipas një zakonisht të lashtë, plaku i çdo shtëpije hedh në koshat lëkurën e shqerës së therur. Lëkurat e mbledhura shiten nga epitropia e kishës dhe paratë shkojnë në arkën e kishës. Kryetari i këshillit dhe disa djema që na ardhën pas gjer në fund, më thanë se gjithë fshati kish vendosur që të ardhurat e lëkurave simvjet do t'i dhuroheshin batalionit tonë.

Lëvizja dhe përgatitja e armikut rreth gazermave

të Bilishtit vazhdoi gjer mbasdite. Pastaj kollona e tyre u nis. Në krye ishin motoçiklistët. Topat e rëndë i ngritën tytat lart. Ne përgjonim me dylbi dhe rrinim gati. Fjalët na ishin prerë. Ndjenja përbrënda një drithmë të lehtë. Ja, këjo ishte frika. Shtrëngonja dhëmbët dhe rrudhnja ballin. Druanja se mos kuptonte njeri shqetësimin t'im. Dhe ky shqetësim, kjo droje është turpi. Dhe kur luftëtari i ka gjallë ndjenjën e turpit, ay e mund frikën.

Këto gjëra nuk i dinja, por shokët më të pjekur në luftë e të regjür m'i kanë treguar nëpërmjet hollësirave të luftrave të kaluara,

Kur ne po rrihim mëndjen se ç'drejtim do të merrte armiku, pa pritur kollona e tyre qëndroi. Ndejti ashtu për ndonjë gjysmë ore dhe pastaj u kthye sërisht në gazerat. Si duket Devolli u mbante erë barut.

## 18 Gusht.

Mbrëmë ishim në Sul. Mora lejë nga komisari dhe vajta në fshatin tim për njëzetekatër orë. Vonë, nga mesnata, nuk vajta të flë në shtëpi, por u futa në një plevicë me kashtë. U shtriva mbi disa dengje me jonxhë e shpejt më mori gjumi. Mbasi kisha fjetur nja dy orë, dëgjova se më thërisnin. U ngrita. Ishin tre shokë të njësitit të katundit. Më thanë se disa djem nga njësitit i Vërlenit kanë sjellë t'arestuar një burrë që dyshohet të jetë spiun i armikut. M'u desh që bashkë me tre djemat e fshatit t'im të shpiem në Sul njeriun e dyshimtë. Sulli me Ziçishtin janë fare afër dhe nuk u vonuam. Po kur u nisëm të kthehemi në Ziçisht, Kolja më foli:

— A nuk kthehemi këtu në vreshtat e Sulit e hamë ndonjë rrush?

— Mirë, kthehemi.

Hymë në vreshtë dhe fillova të zgjedh ndonjë rrush sa për të ngrënë. Kështu bëra unë, kurse të tre shokët e tjerë kishin tjetër mendim. Ata kapedanëit nxuarën nga një këllëf të madh e të bardhë prej jastëku dhe filluan t'i mbushin me rrush. U foli se nuk bëjnë mirë, u thashë të shkojmë se është turp, u luta me të mirë e me

të keq, por nuk më dëgjonin. Atëhere zura të rendja, zbraza një herë me automatik në hava dhe thira:

— Na zuri pojaku. . .

— Të tre shokët lëshuan për tokë këllëfët e bardhë dhe i thirë vrapit aq shpejt e rrëmbyer sa kur dolla në xhade ata kishin dalë që më parë dhe po iknin tatëpjetë. Mezi i qëndrova.

Kur iu afruam Ziçishtit Kolja më tha:

— Me kujdes se mos na qëllojnë rojet e fshatit.

— Kush është roje, — e pyeta.

— Sençi me Vangjelë.

— Ku e kanë postin e rojës;

— Prapa kishës.

Vajtëm atje, po nuk dukej shënjë prej roje. I thërita me emër por nuk mora asnjë përgjigje. Heshtje an'emb'anë. Pa pritur dëgjova një gërritje.

— Hë, hë, këta po çajnë dërasa, ia kanë marë me gjumë.

U afrova në një ledh e hipa mbi të. Poshtë në fund të ledhit, mbuluar me plevin me thekë flinin të dy «rojet». Vendosa t'u jap një mësim të mirë. Ngrita automatikun mbi kokat e tyre dhe hoqa këmbëzën. Krizmat ushëtuan. Njeri kërcëu si iriq, u mblodh kuspull e mbuloi kokën. Tjetri, duke u zvarosur me një shpejtësi prej shkjarthi si zvarrë si me vrap u lëshua tatëpjetë arës. Ikte i lemerisur duke lëshuar disa klithma të çjera si njeri që merret me dallgët.

## 28 Gusht.

Sot ndodhemi në Bozhigrad. Komisari u mundua të riorganizojë këshillin N.Ç. të katundit. Pati shumë kundërshtime. Si duket këtu balli ka zënë rrënjë. Simpathizantët e luftës N.Ç. kanë mbetur pakicë. Me gjith'atë këshilli u ngrit.

Nga ana e Vithkuqit dëgjohen gjëmime artilerie. Italianët po sulmojnë duke dashur të shkatërojnë brigadën e I-rë Sulmuese. Sot na erdhi vullnetar partizan italian Mario.

## 8 Shtator

I gjithë batalioni sot ndodhej në Ziçisht. Pasdite më thiri komisarari e më ngarkoi të bredh Devollit për disa ditë me radhë. Duhet grumbulluar në një bazë të gjitha radiot, bateritë, makinat e shkrimit dhe dengjet me letër që i kemi kapur armikut deri më sot. Nxora fletoren dhe mbajta shënim: një radio në Progër, një në Grapsh e një në Dardhë; dy makina shkrimi në Hoçisht, një në Bradvicë dhe disa dengje me letra po në Bravdicë. Komisarari i Batalionit dhe një kompani u nis për në Mienkulas, një kompani u nis për në Vërlen kurse kompania tjetër do të nisej më vonë për në Sinicë.

Ndodhesha në një mik duke uruar një martesë, kur një vajzë hyri brenda e trëmbur.

— Nga ana e Çipanit po vijnë ballistët dhe pushkët i mbajnë në duar.

Renda nga shkolla, gjeta aty nj'a tetë shokë. Edhe ata kishin marrë vesh se po vinte çeta e ballit. U thashë se i mbajnë armët në dorë.

— Vërtet? — më pyeti Maqua?

— Kështu më tha një vajzë që i kish parë me sy.

Pas pak u duk një ushtar i ballit. Pushkën e mban-te peshë në dorë, dy kollane ngjeshur pas gjoksit, e dukej i emocionuar. Ishte pararojë. I fola se e kisha të njohur, kish qënë polic i komunes:

— Për ku kështu o Hilmi?

— Ay nuk m'u përgjigj dhe vijoi rrugën.

— Ku e njeh ti? — më foli Maqua.

— Hilminë? si nuk e njoh, ky gjithë ditën këtu rrinte, loste kumar me kumarxhinjtë e fshatit.

Pas një minute u duk njëshkollona e ballit.

Në krye ishte komisarari i tyre. Për çudi të gjithë i mbanin pushkët peshë e shihnin me inat.

Shokët tanë dyshuan e po shihnin për rreth. Ne ishim aty nj'a dhjetë partizanë, kurse ata po mblidheshin të gjithë. Të dy palët qëndruam me nj'a katër metra largësi. Maqua i pyeti:

— Ç'është kështu, o Hytbi? pse kaq me tërsëllëmë?  
Dhe Hytbiu diçka u përgjegj nëpër dhëmbë. Po bisedonin. Atëhere u duk nga radhët e ballit komandanti i tyre i qarkut, Zija Gashi, revolen e kish në dorë e lëshoi një të sharë.

— E ç'ar Shqipnie do bani o... të bardhë apo të kuqe?

Gjëndja po merrte zjarr. Maqua iu përgjigj:

— Mos me të sharë, se inati është dëm i kokës.

Maqos po i dridhej një dell i faqes (është shënja e tij kur inatoset) por po e mbante veten dhe me sy pishë po vështronte me kujdes çdo lëvizje të kallistëve. N'ato çaste një plumb ballisti qëlloi mbi ne por nuk munda të shoh se kush qëlloi. Lufta plasi. Ishte mbrëmje e mugëtirë. Flaka e armëve llapste e u ndjenë klithma grashë e lebetitje fëmijësh që nga shtëpitë për rreth. Kur hyra në shtëpinë t'ime aty pranë sheshit ku krisi pushka, pashë komisarin e ballit të plagosur rëndë. Gjyshi, e kish shtrirë në dysheme dhe po i vështronte plagën. Mori një thikë e ia preu këmishën. Plumbi e kish goditur brinjë më brinjë. Gjaku i ridhte çurkë e gulshe gulshe sipas rahjeve të zëmres. Plaku i hodhi në plagët një tar që mbanë në ikonat. I plagosuri bërtiti nga dhimbja. Gjaku iu pre nga plagët dhe zu i delte nga goja. Pas pak vdiq. N'ato çaste hyri atje një komisar tjetër i ballit me revolver në dorë. E pa shokun e tij të shtritur, flaku revolverin për tokë dhe bëri një gjest dëshpërimi.

Unë shkova pështymën dhe nuk i fola. Qëndruam kundrejt njeri tjetrit dhe shiheshim si të shastisur.

Të them të drejtën më ardhni keq për këtë vëllavrasje që plasi këtu, por e ndjej mirë e qartë se ne nuk u patëm asnjë faj. Të ish për ndonjë grackë të pregatitur nga ne, nuk do ishin nisur sot kompanitë t'ona për gjetiu.

Komandanti i kompanisë sonë shoku Refat Poloska, u vra nga plumbat e ballistave. Ishte një komandant trim e i dashur. Ay gjithënjë me buzë në gaz u fliste shokëve dhe kishte një humor të hollë sa nuk linte njeri të mërzhitej.

Shkëmbimi i armëve vijoi gati një orë Maqua, Ham-

diu, e Sofua u çquan në mënyrë të veçantë gjatë luftimit. Nga balli u vranë gjashtë veta. Të gjithë komandantë e komisarë. Mëdis tyre edhe Zija Gashi, që për mendimin t'im u bë shkaktar i asajë gjak derdhjeje. Mbasi mbaruan qitjet e armëve, arrijti aty edhe kompania e jonë që ishte nisur për në Vërlen. Ata treguan se kishin takuar çetën e ballit në befasi në një çukë të rrugës, por nuk kishin folur. Shokët e sapo ardhur nuk besonin kursesi që Fatja të ishte vranë. Komisari i kompanisë Llaqi, kur e pa Faten të shtrirë e pa frymë u bë si i prishur mënç. U shtri mbi të vvarin, e puthte, e shtrëngonte:

— O Fate, o Fate!

Ahere nuk i mbajta dot lotët.

Nga Menkulasi, ku kish shkuar kompania me komisar-in e Batalionit, krizmat e armëve po shtoheshin dhe flagët e tyre vetëtinin n'errësirë. Si dukej andej do t'ishin tërhequr forcat e ballit dhe do t'ishin gaditur me shokët tanë. Dualëm ne sheshi i shkollës; hera herës dëgjoheshin zbrazje armësh nëpër fshat.

Kush shtie? A kanë ikur të gjithë ballistët?

Në lagjen e poshtëme të fshatit nuk kish patur parti-zanë e as që mund të kishte. Tashti duhej kontrolluar lagjeja e poshtëme. Duhej kaluar nëpër të.

Llaqi dhe Hamdiu u gatisën të nisen për andej. Më thirrën edhe mua. Kisha frikë të vinja, por nga turpi vajta. Kur mbërritëm ne shtëpia e Çekrezit dhe muarëm kthesën, me njëherë u shtritëm barkazi. Para nesh dukeshin një sërë hije të zeza.

— Ndal, kush je!

Asnjë përgjigje. Një zë gruaje u ndje sikur delte nga dheu. Si duket fliste nga ndonjë qilar.

— Janë pallto e dyfegje, i hodhën ballistët.

Ashtu ishin vërtet. U afruam dhe i shkelëm me këmbë: pushkë, pallto, çanta, kapella. Vijuam tatëpjetë me kujdes: Gjunjët më dridheshin lehtë.

— Mos ke frikë? — më pyeti Llaqi.

— Jo more, jo — dhe shkova pështymën. Kur mbërritëm në një kthesë tjetër sërish u shtrimë, tashti nuk kish dyshim se përpara nesh ndodhej armiku. Ndjemë



Fig.Nr. 3

zhurmë këmbësh pas rrugës dhe prapa një avllije u dukën nëpër arrësirë dy koka që tundeshin ngadalë.

— Ndal, kush je? folë se qëlluam!

Asnjë përgjigje. Llaqi ish gati në të qëlluar, kur u ndje hingëllima e një kali. Këmbët që përpiqeshin ishin të dy kuajve me shalë që kish traktisur balli. Kokat që lëviznin ishin dy fletë kungulli të rrumbullakta që i rrihte era.



Zumë kuajt. Njeri kish një palë hejbe me libra e deftera. Gjetëm aty një ditar, kopje shkresash të ballit, disa letra të komisarit tonë që i kish peshkuar balli nëpër këshillat e katundeve. Këto të fundit ishin mbështjellë në një dosje të kuqe ku shkruhej përsipër: Letra të komisarit komunist Myzafer Spaho.

## 9 Shtator.

Herët në mëngjez rojet t'ona lajmëruan se nga ana e Menkulasit po afrohej një njeri i armatosur. Vështruam andej me dylbi. Ecte rrugës drejt e si pa të keq. «Duhet të jetë i yni», tha Ziaj. Më tej i panjohuri u afrua dhe hyri në fshat nga ana e kishës. Ishte partizan Selmani. Aty afër disa shokë po thurnin një kurorë me lule për shokun që na u vra mbrëmë. Selmani pa përshëndetur u foli me shaka:

— E o fashizmit ia gatitni atë kurorë?

Shokët e vështruan vëngër dhe nuk iu përgjegjën.

— Ç'kini që nuk flitni? apo u ka ngrënë derri brumët?! Nuk po festoni?

— Ç'farë të festojmë ore, ne na u vra Fatja në luftë.

— Si!!! nuk ishin për festë të shtënat e mbrëmëshme?

I shpjeguam ç'na kishte ngjarë.

— Po juve nuk luftonit mbrëmë në Menkulas?

— Jo, ne festonim.

— Ç'far festonit?

— Pse nuk e dini juve? fashizmi ngriti duart.

Italia kishte kapitulluar.

Dhe mbrëmë shokët në Menkulas kishin pandehur se ne festonim. Dhe ne mbrëmë në Zicisht pandehnim se ata luftonin.

Nga ora dhjetë para dreke ardhi nga Suli një dërgatë e ballit prej gjashtë vetash. Ishin pleq të mykës. I pritri Llaqi diku para një porte.

— Ç'farë kërkoni?

— Na dërgoi balli për marrëveshje.

— Ama marrëveshje të bukur, tashti u kujtuan ata, dje këtu desh përpinin retë.

Le tërë e tërë, — foli një nga ata, — po nuk na thoni kush u vra mbrëmë?

— Llaqi nëmëroi të vrarët me emër. Disa nga pleqtë nisën të qajnë. N'orën dymbëdhjetë varrosëm në një kodër afër fshatit Refatin, që na u vra mbrëmë. E mbuam me lule. Komisari mbajti fjalë. Shumica nga ne nuk i mbanin lotët, zbrazëm një batore për nder të shokut të rënë dhe kënduam marshin partizan:

**Me dhimbje iu përcjellim  
Në të varrit errësirë,  
Se ne të gjithë skllëvërit  
E urrejmë robërinë.**

Fill mbas mbarimit ardhni nga Dardha korieri Petro. Kish një letër për komisarin. Ushtria italiane kish kapitur dhe ish tërhequr nga Dardha. Komiteti qarkor urdhëronte të hyjmë në Dardhë dhe në Bilisht.

Filloi një shkrehje armësh për gaz. Komandantët mezi i vunë fre atij gazit me zarar, se fishekët janë të pakët. Dy skuadra u nisën për në Dardhë, të tjerët për në Bilisht, kur dualëm ne përroi i Thellë, vështruam me dylibi nga Bilishti:

Një autokollonë italiane po largohej në drejtim të Korçës. U vunë në rresht për tre dhe nisëm marshimin me nxitim. Drekë nuk hëngrëm fare, por muarëm nga një copë bukë në duar. Zëvendës komisari i batalionit i kish hipur një kalit me shalë që kapëm mbrëmë. Kali ishte i madh. Ne ishim duke nënqeshur. Edhe ay qeshte disi me droje. Njëri hodhi një romuz:

— Ho, ho, u ngrit pjaca!

— Rrini or djaj.

Dhe i zbriti kalit. Gjer në një vënd marshuam «ush-tarakisht», por pastaj ia thirrëm vrapit shqiptarçe. Një gëzim i papërshtuar na gufonte përbrenda. Do të hynim në qëndrën e Devollit, në Bilishtin t'onë, atje ku armiku kishte qëndrën e tij, atje ku ngriheshin planet për të na çdukur, atje ku ishin topat që na kishin goditur kushedi sa herë.

Afër vreshtave të Poloskës u dukën disa kalorës. Si na panë ne, qëndruan. Ishin të veshur si pasanikë. I pyetëm:

— Ç'kërkoni?

— Duam Myzaferë ose Maqon.

Dolli në krye Maqua.

— E, more, ç'kërkoni?

— Na dërgoi balli për marëveshje, jemi delegatë, të hyjmë në Bilisht të dy palët, pushtetin t'a ndajmë për gjysmë: N/Prefekti të jetë partizan e komandanti ballist.

— Jo ore... po juve ç'far jini?

— Jemi delegatë.

— Ballistë?

— ...jo, jo, asnjans.

— Po ti kush je?

— Jam aga bej filani i biri i filan beu.

— Po ti tjetri?

— Unë efendi filani i kunati i filan beu.

— Po ti?

— Unë jam tregëtar filani nga oxhaku i filanit.

— Jo, ore.

Maqua i dëgjonte dhe i dridhej një dell në faqe nga inati. Pastaj lëshoi zvarë atë zërin e tij të ashpër:

— Mbushuni, larot e djallit, se u njohim mirë cilët jini, de-le-ga-të hë pizevengë...

«Delegatët» kthyen kuajt dhe s'panë nga ikën.

Nj'a dhjetë shokë u kthyen në Poloskë për të lajmëruar familjen e Refatit q'u vra mbrëmë.

Pas një lëmi me dhe të kuq ish shtëpia e Refatit. Hymë atje. E shoqja u ngrit të na presë. Nuk dinte asgjë. Dy fëmijë katër-pesë vjeç na u vërsulën:

— Ku është babi?

Ç'farë t'u thoshim ne?

— Kasua më bëri me shënjë të nxjerr fëmijët jashtë.

E mora njerën vajzë nga krahu dhe dolla. Disa gra hynë. Filluan të qarat, thirjet, leketitjet.

M'u kopësitën lotët në mjekër, dhe vajza e vogël që kisha në krah më pyeste me ngulm:

— Ku është babi jonë?

— O fëmij' e gJORë, o jetimë e njomë, o zëmër e dhëmshur. Yt atë nuk rron më. Yt atë u vra në luftën e çlirimit. Po ti nuk më kupton dot o fëmijë, ti nuk di ç'të gjeti ty, nuk di ç'na gjeti ne, ti je e vogël. Tashti ne mbetëm baba për ty, ne do të kujdesohemi për ty, se ti do rritesh, o fëmijë, do të rritesh, o bija e Refatit. Dhe unë të shoh ty nesër tutje, larg pas vjetësh. Të shoh vajzë të rritur, të shoh nxënëse në shkollë, të shoh mjeke me rroba të bardha, të shoh në rrugën e madhe të jetës, të shoh njeri të mësuar e të ditur! Unë të shoh nesër bije të denjë të Refatit dhe vonë pas vjetësh mbase do të takohemi përsëri dhe atëhere unë do të të tregoj ty se si u vra yt atë, se si u vra shoku i ynë, do të të tregoj unë dëshirat e tija, rrugën e Refatit, endërrat që thuri ay për fëmijët e tij dhe për fëmijët e gjithë popullit.

Dhe vajza e vogël e Refatit, fëmijë e njomë me sy të kulluar, me faqe të buta më shikonte si e topitur.

Shtëpia e Refatit u mbush me njerëz dhe na u desh të largohemi. Shokët i arrijtëm ne ura e madhe e Polokës.

Duke vrapuar tatëpjetë për në Bilisht na ngjiteshin pas grupe vullnetarësh t'armatosur. Gjer afër Bilishtit batalioni ynë që gjer dje kishte 250 partizanë, sot, u bë me nj'a pesëqind luftëtarë. Diku m'at'anë urës së Polokës, komisari i kompanisë, Llaqi më hodhi një fjale:

— Ki mëndjen: kur të hyjmë në Bilisht, meru emrat gjithë partizanëve të rinj.

Kur iu afruam Bilishtit italianët na vunë re. Me nxitim u hipën kamionave dhe muarën xhadenë e Korçës. Ushtria italiane ishte urdhëruar nga Viktor Emanueli që të luftonte kundër Gjermanëve. Mirëpo ata po largoheshin nga ne e nuk dukej të kishin ndër mënd të luftonin gjermanët.

Ndodheshim ndër disa ara me misër kur u ndje urdhëri i komandës:

— Në Bilisht, në fillim, kapni dyert e depove. Partizanët që ardhën sot të qëndrojnë prapa; të tjerët pas meje në formacion luftimi; hapuni! Përpara!

Mora xhadenë. Përkrah kisha Syrjanë. Pushkët i mbanim peshë, flokët na qenë ngritur përpjetë dhe rendnim me sa fuqi kishim. Në plepat pamë një djalë te ri që na preu rrugën. Ishte Tefik Çausi, shok i ynë që punon për Lëvizjen në Bilisht. M'u hodh për qafe, u puthëm vënçe. Më tej na doli përpara Mukja, dhe ky është i yni. Kish një shishe raki në dorë dhe ma dha të pi. U puthëm e u përqaftuam. Syt e Mukes ndritnin nga gazi. Dhe nga gazi ose nga sebepi (ose nga të dyja bashkë) sot Mukja e kish pirë pa ujë.

Më tej populli i Bilishtit kish dalë e na priste me flamur përpara. Unë isha me Syrjanë fill në të hyrë të qytetit. Dikush nga populli desh të na mbajë fjalim.

— U lutemi hapni rrugën, pastaj fjalimin!

Dikush më foli me emër.

— Shihemi më vonë, ja ktheva i nxituar.

Ne thertorja hasmë një grup xhandarësh të vënë për tre. Vinin të «bashkohen» me ne.

— Prapa ktheu, marsh përpara!

Ata nguruan. Një marshall kërkonte të bisedojë.

— Prapa ktheu se qëllova, futuni në komandën t'uaj!

Syrjajt i vinin djersët çurkë. Xhandarët u kthyen me vrap duke kthyer kryet prapa. Pas u shkoi Syrjaj.

Depot e ushtërisë italiane janë në godinat kundrejt N/prefekturës. Zura portën e madhe. Disa vullnetarë të rinj deshën të hyjnë brenda «për të kontrolluar». Nëpër rrugë ngarendnin partizanë në drejtime të ndryshme. Vullnetarët e rinj përsëri ngulnin këmbë të hynin në depo. Disi po hezitonja kur Maqua kaloi atje:

— Në asnjë mënyrë mos u hap portën, ver roje të forta, ke përgjegjësi! Shiko mblidh radiot e makinat e shkrimit.

Syrjaj doli nga N/prefektura.

— O Syrja, o Syrja! Eja këtu.

Ardhi. Lamë roje ne porta një partizan të vjetër dhe me Syrjanë hymë në depo. Në një sallë të madhe kish 11 mitraloza të rëndë «Breda» të montuar dhe të vënë në

radhë. Më tej uniforma, çarçafë, pushkë, bomba, arka me municion. U ngjitëm në katin lart. Hapëm një derë. Ish kuzhinë oficerash; një kazan me makarona akoma po zjente mbi stufë. Shkallmuam një derë të kyçur. Ish dhomë banimi. Në qoche një gardirob me pasqyrë. E çelëm gardirobin me ndihmën e një kasature. Kish dy kostume oficeri në kremastare dhe plot tesha të tjera. Nxorëm lekat tona dhe veshëm ato që gjetëm. Kostumet mtajnë erë parfum dhe kanë shirita gradash. Kontrolluam dhomën. Prapa gardirobit gjeta një automatik italian nga të marinës. E shkëmbeva me pushkën t'ime. Vijuam të kontrollojmë dhomat. Ishin plot e përplot me municione, veshmbathje, ilaçe, tura telash telefoni e me gjemba, batanije, barella, pushkë, enë kuzhine.

Dualëm përsëri ne porta e madhe. Llaqi po kalonte atje para portës.

— Ç'ini veshur kështu?

— Plaçkë lufte shoku Llaqi...

— Çfarë ka nëpër dhomat? i kontrolluat?

— Po shoku Llaqi, veç nënë e babë nuk gjen këtu, se nga të tjerat ka sa të duash.

Duke ngjitur shkallët më foli Maqua:

— Hiqi këto shiritat dhe stemën nga kapella.

— Nuk kam brisk.

— Të jap unë thikën.

Në kuzhinë hëngrëm makarona me djathë. Çelëm disa arka me kuti mishi dhe bashkë me kazanin e makaronave ja dorëzuam intendentit.

Shtabi i batalionit thirri aty nj'a dhjetë partizanë dhe i nisi nër katundet për rreth me një urdhër të prerë:

— Të gjitha kafshët e samarit, qerret e karrocat të vijnë në Bilisht.

Pas ndonjë ore filloi transportimi i mallrave për në Hoçisht. Nga nxitimi, italianët nuk kishin tërhequr depot e as u kishin vënë zjarrin ashtu si kanë bërë në Dardhë. Kështu që në duart tona ranë sasira të mëdha material ushtarak dhe ushqime. Transportimi, me mjetet që sollën fshatarët, vazhdoi gjithë ditën dhe natën.

## 10 Shtator

Edhe sot vazhdoi transportimi i «xhepaneve». Nga gazerat dualën pa pushim ngarkesa me municione, mjell, sheqer, cris, makarona, fuçi me vaj. Në mëngjez komandantëve tanë nuk u zinin këmkët dhe. Rendnin posht e lart duke organizuar karvanët e transportit.

Në një qoshe vura re Maqon që i ishte qepur pas një kurbat i gjatë.

— Lemë tashti të lutem, — i thoshte Maqua, — kam shumë punë, mundësisht meru vesh me ndonjë tjetër.

Po kurbati as që i ndahej:

— Aman të keqenë, ti je më i madhi, aman të lutem...

Siç mora vesh, kurbati ish nga Bitincka dhe Këshilli i fshatit (nuk di për ç'arsye) e kish ndaluar t'i bjerë daulles për ramazan. Tashti kurbati kërkonte lejë nga komanda partizane. Maqua, kur më pa mua, më thiri:

— Mbaroji punë këtij shokut.

Kurbati po shihte nga unë, po si duket nuk ja mbusha synë.

— Aman të keqenë, shoku Maqo...

— Nisu me këtë shokun, se ta bën lejën ky më mirë se unë.

Me kurbatin shkuam në zyrat e ish N/prefekturës. Aty, në një makinë shkrimi, duke qeshur me vehten t'ime, shkrova një farë leje me urdhër «kategorik» që të lejohet Kaman Koshari t'i bjerë daulles tërë natën e tërë ditën.

Pastaj bëra një listë emërore të partizanve të batalionit. Nga 250 që ishim, numëri i partizanve arrinte në 490. Midis plaçkës së luftës gjetëm edhe gjashtë radio marëse dhe katër makina shkrimi «Everest» dhe «Oliveti».

Kur po hanja drekë në një gazermë m'u afrua partizani Tefik:

— Të kam gjetur një radio të madhe sa një hambar, veç ta shikosh.

— Ku e ke?

— Eja me mua.

Zbritëm tatëpjetë e hymë në një godinë të vogël afër gazermave.

— Ja, — foli Tefiku dhe shtyjti derën.

Ç'të shikoje?! Një central telefonik, i madh nga dyshemeja në tavan.

Duke dalë, pash tre partizanë që po hynin nxituar në Bilisht nga ana e rrugës së Poloskës. Kur u afruan vura re se ish Komisari i Batalionit me dy shokë të tjerë. Po vinin nga Janoveni. Ishin të gëzuar që po na takonin në Bilisht. U treguam shkurt ngjarjet dhe i udhëhoqëm në qendrën e shtabit të batalionit.

Pas pak ardhën një tridhjetë partizanë që patën shkuar në Kapështicë për të çarmatosur postën kufitare t'italianëve. Suallën prej andej mjaft armë dhe municione. Gjithashtu ata treguan se në Kapështicë kishte arrijtur një autokollonë e madhe gjermane prej Follorine dhe si dukej do të drejtohej për në Bilisht.

Norën dy pas dreke shtabi i batalionit ndodhej në *sheshi* prapa bashkisë së qytetit. Më ra rruga andej dhe dëgjova që jepeshin këto urdhëra:

— «Kompanija e parë të vendoset nga ana e Kapështicës prej bashkave mbi kovaçanat gjer në kodrat e pazarit të kafshëve; kompanija e dytë të rjeshtonet në sokakët mbrapa shtëpive që ndodhen në rrugën kryesore që shkon për Korçë; kompanija e tretë të zërë vënd në bregoret, në veri të Bilishtit, nga ana e Bitinckës.

Filloi lëvizja e kompanive nëpër pozicionet e caktuara. Në këtë kohë u ndje zhurmë motorash. Një autokollonë gjermane po hynte në Bilisht. Një grup gjermanësh zbritën nga një kamion dhe me automatikët ndër duar kaluan nga thertorja. Atje vunë re tre partizanë që po kalonin. Me shpejtësi gjermanët u hidhen sipër partizanëve dhe mundnë t'iu marrin armët gjatë një kacafytjeje kur krisi edhe pushka.

Urdhëri i komandës ishte që gjermanët të goditeshin kur e gjithë autokollona të futej në Bilisht, por ky urdhër nuk u zbatua dot për shkak të rjedhimit të ngjarje-



ve. Pushka krisi nga gjithë anët. Filluan qitjet e mitrolozave gjermanë «Dod» dhe «Sharës», shungulluan bomba dore, fishkëlluan predhat e automatikëve. Gjermanët shtinin nga kabinat, nga karoceritë, nga parafangot dhe njëkohësisht u shkelën gazin motorave dhe ikën me shpejtësi. Një grup shokësh nga kompanija e parë u vërsulën mbi xhade dhe e mbuluan me granada një kamion që po nxitonte të largohej. Kamioni ngeci në vënd dhe zuri rrugën. Mbrapa tij mbetën edhe gjashtëmbëdhjetë kamiona të tjerë. Atëhere gjermanët dualën nga kamionat dhe zunë vënd nëpër hendeqet e rrugës, në godinat e P.T.T.-së dhe në kovaçanat. Zjarri u ndes i ashpër dhe era e barutit kundërmonte nga gjithë anët. Atëhere vura re disa nga «vullnetarët» që ardhën këto ditë ndër ne: po iknin përpjetë të trembur dhe t'alarmuar. Ja këta kishin ardhur jo për të luftuar, por për të rrëmbyer raqe.

U vërsulëm tatëpjetë nga pazari i drithit. Përpara meje ish Llaqi dhe Andoni. Gjermanët nga P.T.T.-ja na panë dhe na qëlluan. Në nxituam dhe u futëm prapa postafit të shatrivanit. Atje vumë re se kamionët e nazistëve kishin ngelur që ne P.T.T.-ja e tutje, në drejtim të Kapështicës. Rrethi përçark gjermanëve po ngushtohej. Shokë të tjerë po u merrnin krahët nga ana e vreshtave, të tjerë nga xhadeja e Poloskës. Lamë shatrivanin dhe zumë vend prapa një grumbulli me tulla. Plumbat fishkëllonin, qëllonin nëpër tullat dhe ngrinin pluhur të kuq. Një gjerman kish zënë vend prapa një guri të kilometrazhit afër thertoresh dhe qëllonte nxituar. Edhe ne e qëllonim, por ay nuk tundej. Ndodheshim pas tullave një dhjetë shokë. Llaqi, Jorgua, dhe Qemali iu vërsulën prapa N/Prefekturës dhe dualën tutje P.T.T.-së. Që aty na thirrën:

— Mëkani zjarr të hapur!

Disa bomba dore u flakën pas autokamionave. Një autobuz mori flakë. Gjermanët që ishin në P.T.T. u trembën dhe i thirrë vrapit. Ne i qëllonim. Ata duke vrapuar bënin disa zik-zake e kollotumba dhe nxirnin disa thirrje të çjera.

Grupi i sulmit që u nis nga ne doli ne thertorja. Gjermani që ish ne guri i kilometrazhit ishte vrarë. Rrugën e kishim të çelur. Rendëm për nga kovaçanat. Dikush na tha se Llaqi është plagosur në kofshën e djathtë. Lufta vazhdonte ne xhadeja ndënë gazermat. Bataretë e gjermanëve nuk na linin të nxjerëm kokën. Te hendeku, ku ndahet xhadeja e Poloskës me atë të Follorinës, shtriheshin tre gjermanë të vrarë. Një i katërtë i vrarë, ish shtrirë në shpinë me duart përpyetë. Në llërën e majtë mbante një sahat dore Omega.

Vijuan edhe disa qitje të tjera, dhe gjermanët që kishin zënë vend në një kodrinë kundrejt gazermave, u vunë në ikje.

Por shokët që na i rrëmbyen nuk i gjetëm dot.

Në fushën e luftës kishim mbajtur shtatëmbëdhjetë kamiona.

Hyra në një kamion. Karoceriya ishte e mbuluar me mushama dhe kish si ngarkesë një a njëzet thasë me paketa ushqimesh, që i dërgonin gjermanët në familjet e tyre. Gjeta atje dy parabela dhe i vura në brez. Ishte aty edhe një dylbi mortaje me gjithë trekëmbësh. U mundova ta çkul dylbinë nga trikëmbëshi, por nuk munda; e zvarosa ashtu si ish.

Në batalion kemi shoferë Jorgo Pllakun dhe Shaban Qamilë. I provuan kamionat dhe veç tre mund të viheshin në rrugë, të tjerët gjatë luftimit ishin goditur nëpër motorat. Na ardhni vullnetar edhe shofer Thimi që u ndodh aty afër. Pastaj, u vunë zjarrin katërmëdhjetë kamionave që lamë aty, dhe u nisëm të hipur mbi tre kamionat që morëm me vehte, drejt rrugës së Devollit. Një pjesë shokësh po vinin më këmbë duke rendur, mbase nuk kish vend në kamionat. Llambit i dhashë një nga revolverat. Kur hymë në Shënkollas kish rënë nata. Atje na qëndruan antarët e Këshillit N.Çl. të katundit. Ata na thanë se ballistët, duke përfituar nga mungesa e jonë, donin të hynin në Hoçisht për të grabitur depot tonë. Zkritëm nga makinat dhe u vërsulëm arave në drejtim të Hoçishtit. Në kamionat u lanë një a tridhjet par-

tizanë. Dëgjova se dikush më thirri. Ishte Llaqi në kabinën afër shoferit. Iu afrova.

— Si dukesh, të dhëmb?

— Jo shumë, por e ndjej këmbën si të mpitë, mos ikë ti. rri këtu.

Ndejta.

Kur iu afruam Menkulasit, qëndruam. Një urë e vogël ishte e prishur dhe nuk kalohej. Me Llaqin shkuam në një bazë. Ay ecte duke kërcyer mbi këmbën e majtë. Në bazë na pritën shumë mirë. Fjeta si i vdekur. Në mëngjez Llaqi më tregoi se nuk e kish zënë gjumi fare. Kish temperaturë.

## 11 Shtator

Në mëngjez herët ardhën kamionat në Menkulas. Hipëm mbi ta dhe u vunë në rrugë. Duke kaluar nëpër Bozhidrag, populli u alarmua dhe mori pyjet përpjetë. Kishin pandehur se vinin gjermanët. Po kështu ngjau edhe kur kaluam afër Qytezës dhe në Sinicë. Afër Dardhës qëndruam sa ndreqëm një copë rrugë, që nuk kalohej, dhe u dërguam fjalë Dardharëve se, po vinim: të «motorizuar».

Pra sot do të takoj atë Joanen që dikur më ka shërbyer dhe për të cilën kam menduar shpesh.

Kur dualëm ne kthesa e Dushkut, na doli përpara panorama e Dardhës me kurorën e maleve për rreth; fshati i madh shtrihet si një brez në pëqirin e një kodre të gjërë. Shtëpitë janë të mbuluara me plloça dhe aty këtu feksin çati me llamarinë. Fshati kish dalë e na prishte me flamur përpara. Midis turmës njoha Joanën, dhe ja mbërtheva sytë. Edhe ajo më pa. Qeshi e tundi një shami të kuqe që mbante në dorë.

Qëndruam në një shesh të vogël para godinës të ish komunës. Kryetari i këshillit na mbajti një fjalim të shkurtër mirseardhjeje. Një grup pionerësh na u vunë prapa dhe donin të hipnin mbi kamionat. Pionerët mbajnë një yje të kuq mbi kapella dhe kanë nga një revole drase në brez.

Joana po rrinte afër një akasje me një çun për dorë. U afrova dhe i dhashë dorën.

— Që atë ditë marsi, kur u kujdesët për duart e mi-ja të ngrira, që atë ditë ndjehem shumë i detyruar kundrejt jush. Ju kam kujtuar gjithnjë.

— Edhe unë... kam pyetur për ty.

Dhe Joana qeshte. Era loste me flokët e saja dhe unë gati po e hanja me sy. Është e bukur, shtat-hedhur dhe nuk e di pse u trubullova aqë shumë kur e takova.

— Të na vish nga shtëpia, — më tha kur u ndamë.

— Ashtu?

— Posi, të presëm...

Më përkëdheli me vështrimin e saj, më dha dorën, më nënqeshi, duke mbajtur kryet më nj'anë, i mbylli syte përgjysëm e iku

Më bëri «shënd e verë».

Shoku im Vaska, që është Dardhar, më ftoi në shtëpinë e tij.

— Eja, — më tha, — të të tregoj puntorinë e këpucarve të batalionit.

Vajtëm. I vëllai ishte duke punuar në bango. Partizan Gaqua po punonte më tej. Vaska m'i paraqiti:

— Ky është Gaqo Bullgari, partizan këpucar, dhe ky tjetri është im vëlla Kaleshi; punojnë këpucë për partizanët.

— Kalesh e ka emrin?

— Jo, jo, Gaqi e ka emrin po e thëresim Kalesh.

Raftet e puntorisë ishin plot me këpucë me qafa. Ndënë bangot kish këpucë e opinga partizanësh, që prisnin të meremetohen. Më tutje nj'a dy çuna ndreqnin thumba.

Nëna e Vaskës u vu shpejt në magje.

— Mos, — i thashë, — mos u harxho se kam tri konserva gjermane. I hapëm.

Të trija ishin me një farë gjaku të konservuar. I flakëm tutje.

Pas dite dëgjuam vajtime grash në një shtëpi aty afër. Pyetëm se ç'kishte ngjarë dhe na treguan se në datën 9 Shtator, në një demonstratë në Korçë, fashistët ki-

shin vrarë pesëdhjet e nëntë qytetarë dhe kishin plagosur njëqind e njëzet e nëntë të tjerë. Midis të vrarëve ishin edhe dy nuse prej Dardhe. Njëren e quanin Lisaveta Balli dhe tjetrën Aspasia Gjino.

## 12 Shtator.

Sot afër mbrëmjes hipëm mbi tre kamiona dhe muarëm rrugën drejt Boboshticës. Ishim njëra njëzet partizanë. Fërveç Jorgos dhe Shabanit ardhni vullnetar si shofer shoku Mihal nga Dardha. Komanda jonë ka vendosur që të tre kamionat t'i shpjerë në Vithkuq. E për të vajtur gjer atje duhet kaluar nëpër xhadenë e madhe ku vozitnin nazistët. Plani është i guximshëm dhe i rrezikshëm. Në Boboshticë mbrijtëm natën. Pastaj kaluam nëpër disa ara. Njësitë e Boboshticës na ndihmoi sa dualem në xhade. Atje u ndezëm dritat kamionave dhe vijuan rrugën. Një kollonë gjermane na arijti dhe na kaloi, të tjera kalonin në drejtim të kundërtë. Ne rrinim prapa gati me automatikë ndër duar. Ne ura e Floqit zbritëm pesëmbëdhjetë partizanë e muarëm rrugën e kthimit. Më tej, rruga për në Vithkuq, nuk kishte rrezik. Kamionat vijuan rrugën andej.

## 16 Shtator.

Natën që kaloi u vra shoku ynë Syrja Ali Poloska. Kjo është një humbje e ndjeshme për ne. Ay ishte një shok i mirë, një tip i qetë, i dashur dhe trim. Vrasja e tij ngjau në këto rrethana:

Ishim duke hyrë në Çipani, nga ana e livadheve. Syrjai ishte pararojë me Nevruzë dhe Ramadanë. Dy ballistë nga Çipani kishin zënë vënd diku pas një avllije dhe qëlluan pararojën tonë. Syrjai u godit në gjoks. Veç dy fjalë mundi të thotë:

— Më vranë, o shok, merrmëni hakun!

I dëgjuam zbrazjet e armëve dhe rendëm në vëndin e ngjarjes. Shokët e pararojës (djem trima e sy patrembur) u vërvitën mbi vrasësit. Njërin e vranë, po tjetri u iku.

Më kot kërkuam vrasësin tjetër. (Nuk e gjetëm dot, Quhet Hysën.

Familja e Syrjait ndodhet në Ziçisht. Vajtëm atje. E gjetëm batanë e Syrjajt në oborr kur po roniste disa kallëpë misri. Na priti buzë qeshur dhe nxori kutinë e duhanit. Mendova:

— «A ku di ti, o baba i gjorë, se ç'gjëmë do të të dëgjosh?»

Ardhi edhe nëna e Syrjait dhe na ftoi të hyjmë brënda. Por plaku e kuptoi. Ay kish lexuar mënxyrën në sytë t'anë. U mbajt si burrë, unji kokën dhe krahët iu varën poshtë si të këputur. Nënë gjorës i ra alivan. Dikush zbrazi një batare me automatik dhe babai i Syrjait na u hodh përfaqe e na shtrëngonte.

Sot u nis një kompani e jonë për në Rëzën e Korçës. Muarëm vesh se kompania jonë do të arrijë, në Goskovë e Porodinë, sipas urdhërit të Komandës partizane të qarkut. Në Goskovë ndodhen forca të ballit me Safet Butkën në krye.

## 21 Shtator.

Më datën 19 Shtator u bombardua në Korçë depua e benzinës prej aeroplanëve aleatë. Dje gjermanët hynë në Hoçisht dhe plaçkitën disa familje. Sot u nis për atje një kompani e batalionit.

Sot u zhvillua në Bradvicë një luftë me gjermanët. Ishim në Sinicë e po i gëzoheshim shokut t'onë Haxhi Dobranjit, i cili — i rrëmbyer nga gjermanët në Bilisht më 9 Shtator mundi t'u ikë nga kampi i Follorinës. Atëherë arrijti një korier dhe lajmëroi se gjermanët kanë hyrë natën në Bradvicë. U dha alarmi dhe u vumë në rrugë duke rendur. Kur dualëm në majë të një mali, dalluam zjarre që digjeshin në Bradvicë. Gjermanët i kishin vënë flakën katundit. Qarkuam Bradvicën nga larg dhe pas sinjalit filluam të ngushtojmë rrethimin.

Ndërsa kompanitë afroheshin, një luftim i izoluar po bëhej në Bradvicë. Në spitalin e vogël të batalionit ndodheshin tre shokë të plagosur. Në mes tyre edhe par-

tizani i vjetër Nevruz Hyseni. Gjermanët, që kishin marrë informata të sakta, i qenë afruar spitalit të vogël por shokët i kishin diktuar dhe i qëlluan. Gjermanët hodhën bomba zjarri. Shtëpija mori flakë. Partizanët dualën përjashta me duar e këmbë të lidhura me fashio të bardha, dhe filluan të shtien gjithënjë kundër armikut. Por ata nuk mundënin t'i qëndronin gjithë asaj hordhije që hapi kundër tyre zjarr të përsëritur. Shokët ranë duke luftuar.

Kur po e mbyllnim rrethimin gjithnjë e më shumë, vura re se gjermanët kishin vënë përpara kopetë e bagëtive me gjithë banorët e katundit dhe qenë vënë në rrugë për t'u larguar. Ne i qëlluam. Pushkët e para u shkëmbyen mbi një kodrinë të vogël në veri-perëndim të Bradvicës. Atje ndodhej një grup gjermanësh. Haxhi Dobranji sulmoi drejt tyre, qëlloi me pushkë dhe u flaku një granatë. Gjermanët u vunë në ikje, por oficeri i tyre qëndroi. Mori shënjë me revolver dhe e goditi Haxhiun në ballë. Partizani i vjetër dhe trim, që sapo u kish ikur gjermanëve u vra duke sulmuar. Lufta vijoi në ndjekje të gjermanëve. Fshatarët e sapo çliruar u këthyen në fshat. Disa djem rëmbyen sopatat. Pashë Nasin me një latë në dorë duke u vërvitur pas një gjermani në një ugar mbi Grapsh.

Ndjekja e gjermanëve vazhdoi e ethëshme nëpër Grapsh, Vërlen e gjer në Borsh. Por të gjithë nuk arriheshin. Ata ishin shumë. Disa mundën dhe u fshehën nëpër pyjet e Moravës.

Ishim me Mihallaqin duke rendur në një sternishte, kur pa pritur po na vërvitej një bombë dore me bisht. Në çast kërcyem më nj'anë dhe ramë në një hendek (sa i shkahtët është njeriu para rezikut). Bomba u hodh nga dy gjermanë që ishin fshehur në disa manafera. Më tej shokët i kapën gjermanët të gjallë. Ishin dy djem të gjatë me nga një bajonetë të zezë në brez. Shihnin për rreth me inat. Mihallaqi po i gjykonte me shenja:

- Juve na hodhët bombën? desh na vratë, kaput...
- Hail Hitler! — u përgjegj njëri dhe ngriti dorën lart.

Kur u kthyem mbrëmanet në Vërlen mësuam se gjermanët kishin vrarë në Bradvicë dy fshatarë: Ilo Bodin e Ilo Çingon.

Gjithsej gjermanët humbën sot njëzet e tre ushtarë të vrarë, të cilët mbetën përrenjëve që nga Bradvica e gjer në Borsh.



Fig.Nr. 4

### 25 Shtator.

Jemi në Dardhë. Sot ardhi këtu batalioni Partizan «Hakmarja» i Kolonjës. I pritëm si shokë e si miq. Ne sheshi i shkollës kolonjarët mundoheshin t'ja kalojnë vales së devollinjve.

Ata na treguan mbi Kolonjën e tyre ne mbi Devollin tonë.

Në mbrëmje shkova bazë ne Joana. Me mua ardhi edhe Vaska. Ndejta aty shumë i turbulluar dhe si në gjemba. Sikur t'i dijë njeri mendimet e mija... sikur t'i dijë...

### 30 Shtator.

Qysh mbrëmë ndodheshim në Vërlen. Një kompani ndodhej në Hoçisht. N'agim gjashtë kamiona me gjermanë



në ishin nisur nga Bilishti dhe donin të hynin në Hoçisht. Rojet tona i pritën mirë, por ishin pak. Gjermanët zbritën nga makinat dhe hapën zjarr. Luftimi po vazhdonte kur ne dollëm nga Vërteni dhe u sulëm drejt Hoçishtit në ndihmë të shokëve. Duke ndjerë rezikun, shoferat gjermanë i kthyen makinat prapë dhe filluan të ikin. Dielli edhe nuk kishte dalë. Disa tufa dhensh harbonin të trëmbura nëpër ara. Mitralozat ulërinin si të tërbuar. Gjermanët tërhiqeshin dhe qëllonin. Vijuam ndjekjen e tyre gjer në të hyrë të Bilishtit. Atje gjermanët filluan të na qëllojnë që nga frëngjitë e kazermave. Lufta u ndez e ashpër. Gjermanët na sulmuan dy herë me forca të reja, por ne nuk u tundëm. Atëhere na qëlluan edhe me top e mortaja të rënda. Pastaj hapën zjarr të dëndur me mitraloza automatikë «Dod».

N'ormanet rreth urës së Poloskës hasëm një regjiment italianësh të shpërndarë nëpër gropa dhe hendeqe. Ishin robër të gjermanëve, por një pjesë mbanin armë. Ishin të trembur, të hutuar, disa qanin, të tjerë faleshin dhe nuk ishin të rallë ata që kishin futur kryet në pëllëmbët dhe rrinin si të mekur. Kampin e italianëve e pushtuam krejt dhe disa roje gjermane që ishin fshehur andej u spastruan.

Shaban Qamili mori një kamion italian të ngarkuar me këpucë dhe u nis për në Ziçisht. Mihallaqi mori një motorçikletë. Dolli një urdhër:

— Të gjithë ata që kanë kapur plaçkë lufte, t'i hedhin në kamion plaçkat.

Kush u ndodh afër u bind. Edhe Idrizi që kisha pranë mbante në shpinë një çantë.

— Dorëzoje, o Idriz!

— E ore e, se më merren mëntë mua ta mbaj?!

— Dorëzoje, se prish rregullin.

— Folë, ti, folë se ja ke ngenë.

Idrizi është mitraljer, trup madh e koskëfortë, i shëndoshë si dem, e ka zverkun si me gllënj; çantën e kapur e kishte të madhe sa një harar. Kish brënda çizme, kostume, batanije.

Më tej, pas hendekut, ishin disa djem nga njësitet e katundeve që po luftonin. Kishin ardhur në ndihmë të batalionit. Midis tyre njoha Todin nga Gjyrezi. Municionin e kish pranë në një torbë kozine me ngjyra.

Sulmet e gjermanëve u përsëritën edhe dy herë të tjera. Vija e frontit të batalionit fillonte nga xhadeja e Hocishtit dhe gjer në Meranë e Vishocicës. Ajo shtrihej në një distancë prej pesëqind metrash pas jazit. Tek ura e vogël në xhade, pas hendekut, ish Shtabi i batalionit. Nga gjithë anët gjylet shungullonin. Mbannte erë barut dhe njeri i gjallë nuk dukej nga ana e armikut. Dielli ishte mjaft i nxehtë dhe duart na përvëlonin nga armët.

Ishte ora n'ja dy e pasdrekës kur dëgjova se komisari po më thërriste:

— Mer Andonë e Xhuzepen dhe futuni nër Italianët. Ata që janë mjekë merrini dhe nisni për në Ziçisht.

— U futëm ndër italianët. Mjekët kanë shënja të kuqe rreth gradave. Gjetëm disa prej tyre, por nuk donin të vinin. Andoni desh t'i vinte në sedër:

— A kini bërë betimin e Hipokratit? Juve jini mjekë, ne kemi nevojë për ju; a ju lejon profesioni i juaj të refuzoni ftesën e të plagosurve?

Xhuzepja desh i përpiu. I mbyti në një breshër fjalësh. Njeri ish napolitan. Atë Xhuzepja e kapi për jake dhe iu vërvit në dialektin e tija, por aq shpejt fliste sa nuk munda të kuptoja asgjë.

Në fund mjekët pranuan, u nisën për pjetë, dhe Xhuzepja filloi të këndonte dhe t'i binte kitarës:

Quando spuntà la luna al mare chiare <sup>1)</sup>

Për rreth plumbat fishkëllonin, mjekët ecnin krrusur pas hendekut. Diku pas një kodrine Andoni u foli:

— Ecnì më këmbë, këtu nuk ka rrezik.

Por ata kruseshin më shumë dhe e shihnin Xhuzepen vëngër.

→ Po ja edhe ky italian është!

---

1) Kur lind hëna në Mare Chiarë.

— Lui? e imbecile, Santa Madona é un uomo terribile...)

Dhe Xhuzepja qeshte. Éshtë aqë trim i krisur sa e çpërfill vdekjen dhe kur e ka ndënë hundë. Të këndosh në luftë kjo është diçka jo e rallë nër partizanët por t'i biesh kitarës me aqë shkathtësi, kur për anash pëlcastin gjylet, kjo është diçka që nuk ta kap truri.

U ktheva përsëri në vëndin t'im. Idrizi me çantën e madhe në shpinë vazhdonte të qëllonte. Djersët i kullonin pas tëmthave dhe ankohej se i digjnin sytë nga era e barutit. Dikush erdhi e më tregoi se Stojan Kazanxhieve ish futur në prapavijat e armikut dhe e kish mbuluar me bomba një komandë të gjermanëve. Zeneli kish kapur një gjerman të gjallë, në një shelgishtë gjatë vijës së frontit, dhe e kish mbaruar passi e kish gjykuar mir e mirë.

Nga e djathta jonë, diku pas lumit, nj'a dhjetë partizanë u tërhoqën me nxitim. Pas i ndiqnin gjermanët me bomba dore. Një shok mbeti i vrarë në një mezhde. Një gjerman ja mori pushkën dhe e qëlloi me shkëlme. Lajmëruam Zianë që ishte nj'a pesëdhjetë hapa më tej.

Nuk vonoi e Ziaj erdhi ndër në. Kontrollloi me dylbi vëndin e lëshuar dhe caktoi dhjetë shokë. U nisëm pas Ziajt. Kapërxyem lumin duke vrapuar. Gjermanët na vunë re dhe qëlluan. Plumbat fishkëlluan nëpër ujë si zaret kur flaken në pellg.

Sapo kaluam lumin, një hap para meje, partizani Thoma Zhuri nga Grapshi u përplas në tokë i goditur. U shtrimë barkas. Bomba dore me bisht druri na u vërvitën sipër. E pritëm vdekjen çast për çast... Thomaj po kërkonte ndihmë. Hapa sytë për një grimë: tym, pluhur, erë baruti! Dikush po shihte të plagosurin. Ziaj u ngrit më gjunjë dhe thirri me të madhe:

— O burra, shokë, se po ikin!

— Po ç'far të ikur? Ata po na qëllonin akoma. Siç e pashë vëndin më vonë, veç katër metra ishin larg gjermanëve.

---

1) Ay? është hajvan. Për atë Shën Mëri është njeri i tmer-shëm.

manët nga ne. Na kish ndarë veç hendeku dhe një copë mezhde.

Ziaj vërviti tri granata. Këto nuk i pashë kur i hodhi, por veç i kuptova nga krizma e tyre e rëndë. Disi mua-rëm kurajo.

— Flakni bombat e dorës! — thirri Shabani.

U ngritëm përgjysëm dhe hodhëm bombat që kishim. Edhe gjermanëve u dhimbte koka.

— Ha, ha, ata po ikin, o burra t'i ndjekim!

U vërsulëm pas tyre. Vërtet ata po ikin, por ne i bëmë hesapet pa hanxhinë, sa ngritëm kokat, një breshër mitrolozi këputi degët e shelgjeve për rreth. Llambi po mjekonte Thomanë. Ish goditur për vdekje në kryqet tej m'at'anë dhe gjaku nuk i mbahej.

I lëmova ballin të plagosurit.

— Mbahu, Thoma! ki kurajo!

Ay më vështroi me një palë sy të këputur dhe më shtrengoi dorën. Dora më dhëmbi... Disa cifla bombe m'a kishin çarë pëllëmbën. Gjaku më ridhte. E futa dorën në lumë, por Shabani më hoqi vërejtjen:

— Mos e fut n'ujë, përmire një herë se do të ta lidh. -- Dhe ma lidhi.

Pastaj e mori Thomanë në kurriz dhe u lëshua me vrap m'at'anë lumit.

Zjarri i armikut po shtoej. Një autokollonë e madhe me rreth njëqind kamiona hyri në Bilisht nga ana e Follorinës. Në krye të autokollonës ishin disa tanksa dhe autoblanda, të cilët hynë në rrugën e Poloskës drejt nesh. Tanksat filluan qitjet me topa të vegjël automatikë; prapa u vinin togje gjermanësh me automatikë krahe-qafë. Nga lëvizjet e armikut kuptohej sheshit se ata donin të na rrethonin. Dhe këtë mundnin ta bënin mbassi ata ishin shumë (gati njëqind kamiona me trupa). Atëhere shtabi i batalionit vendosi të tërhiqeshim. U dha urdhëri: Kompanija e Ziajt, gjatë lumit Devoll, të tërhiqet drejt Braçanit; pjesa e qëndrës së frontit drejt vreshtëve ndënë Poloskë dhe pjesa tjetër pas përrenjve drejt Çipanit.

Tërheqja filloi, por nuk ishte e lehtë, sepse gjermanët:

mbanin zjarr të dëndur e pa ndërprerje. Kur zhurma e tanksave na ardh fare pranë, gjithë forcat e batalionit kishin lëvizur në pozicione më të mbrojtura. Por kjo nuk na shpëtonte.

Dy tankse e një autobлиндë muarën rrugën drejt Poloskës të pasuara nga turma ushtarësh. Një tanks e një autobлиндë tjetër kaloi mullirin dhe mori rrugën drejt Vishocicës. Qëllimi i armikut dukej i qartë:

Të rrethohej me zjarr të dyanëshëm batalioni i ynë në mes të fushës.

Duke rendur diku përmbi Kuç, ndënë disa kreka të larta, pashë një mushkë që ishte lidhur pas një kreke. Kafsha e gjorë, e trembur, hidhej e përpiquej, por nuk mundëte ta këpuste kapistrën. E kishin sjellë aty shokët të ngarkuar me municion. Duke iu afruar (atje më binte rruga) nxora thikën dhe i preva kapistrën. Kafsha rëndi si e tërbuar nëpër fushë. Më tej pashë Idrizin. Çantën e madhe e kish mbi shpinë, rendëte duke gulçuar.

— Mbahu, Idriz! — i foli dikush. Por Idrizi shante e shkrofëtinte, dhe djersët i shkônin rrëke.

— Mbahu, Idriz!

Afër një bostani Idrizi u mënjanua nga e djathta, pastaj nga e majta duke tundur krahët e supat. Kish hedhur çantën.

— Dale, Idriz; çanta, të ra çanta!

Hé, hé, Idrizi s'kthente kokën.

Në afërsitë e Borshit vumë re një autobлиндë që u lëshua nëpër fushë në drejtimin tonë. Ne ishim aty një grup nja njëzet partizanë. S'kishim asnjë vend mbroje. Do të na grinte me siguri. Fryma zu më mbahej; nga lodhja m'u prenë gjunjët, dhe koka sikur më lëshonte tym. Autobлиндës i mbetej të kalonte një kallmishte dhe pastaj e kishim ne koka! Zarifi e mblodhi vehten.

— Nxirni bombat, po ikëm, do të na grijë me siguri. Le t'a shesim shtrenjtë lëkurën.

Gjithësej kishim katër bomba e dy granada. Ato mbaronin punë, por duhej guxim, duhej kurajo, duhej precizion.

Zarifi i mori granadat dhe u fut pas një trëndafili të egër. Autoblinda ishte brenda në kallmishte. Pastaj motori i saj filloi të gjëmojë me të madhe. Majat e kallamave u mënjanuan e ne me dhëmbë të shtërnguara prisnim të dalë.

E pritëm, por ajo nuk ardh. Kish ngecur në baltë. Na shpëtoi balta, balta jonë!

Atëhere ja muarëm vrapit në drejtim të Çipanit. Pas gjysëm ore u futëm në një orman. Takuam shokë të tjerë. Atje mora vesh se ishin vrrarë: komandanti i kompanisë, shoku Stavri Gjerazi, si dhe shokët Zahir Myslimi, Hodo Caneja, Sokrat Hoçishti dhe dymbëdhjetë shokë të tjerë.

Vazhduam rrugën dhe u ngjitëm ne Lajthia e Çipanit. Atje vështruam Devollin me dylbi. Kollonat gjermane vazhdonin të qëllonin katundet me predha ndezëse. Kishin marrë zjarr katundet Poloskë, Kuç, Braçan, Shënkollas e Dobranj. Turma e karavane fshatarësh po rëndnin përpjetë nëpër pyje. Vështrova nga fshati im, s'kish asnjë shënjë jete, ish zbrazur krejt.

Dora po më dhimbte dhe kisha temperaturë. Me tre shokë të plagosur u nisa për në Sinicë. Duke kaluar nëpër livadhet e Zicishtit vura re se në një pyll atje pranë ishin futur gjithë banorët e katundit. Kaluam për atje. Takova dy vëllezërit e mij të vegjël. Rrinin të trëmbur pas një ahu dhe më shihnin të hutuar. Një tufë gra na vunë në mes. Pyetnin për djemtë e tyre partizanë. I sigurova se ishin gjallë e shëndoshë, por nuk më besonin. Frika e dyshimi i kishin trëmbur sa dridheshin e qanin me dënesë. Vajta ne burimi. Aty ishin vajzat e fshatit. Më shihnin me ngashërim. Veç njera nuk më foli për një fajin tim të vjetër.

Në Sinicë takuam edhe tre shokë të tjerë.

Sot armiku pati pesëdhjet' e tre të vrrarë. Të plagosurit e tij nuk dihen. Edhe humbja e jonë e sotme është më e madhja që kemi pësuar. Përveç gjashtëmbëdhjetë shokëve të vrrarë, kemi edhe njëzet e tre të plagosur. Katër të plagosur rëndë i dërguam në një spital të Gramozit,

Lufta e sotme, për mendimin tim, ka qënë m'e madhja dhe m'e rrepta që është zhvilluar në Devollin tonë. Në 'të mori pjesë jo vetëm batalioni, por edhe gjithë njësitet guerile të fshatrave.

## 2 Tëtor.

Jemi në Dardhë. Dorën e kam më mirë dhe e mbaj të lidhur me fashio. Qysh në mëngjez vendosa të shkoj nga shtëpia e Joanës. Po sa nisesha e vinja deri afër shtëpisë së saj, menjëherë ndronja mendimin dhe kthehesha prapë. Rri e thellohem shumë në mendime rreth «asaj». E lëshoj tutjë imagjinatën time, po pastaj fillon e më vjen turp prej vehtes, prej plagës së vogël që kam në dorë, prej pushkës që kam në krah. Çdo të thonë shokët sikur të dijnë mendimet e mija? Pra vendosa një herë mos shkoj nga ajo. Pas dite, kur isha në shkollë bashkë me Vaskën, vura re vëzjat e fshatit që po delnin nga shkolla. Si duket do të kishin patur mbledhje.

Joana, sa më pa nga larg, m'u drejtua:

— Ne të prisnim, pse nuk ardhe?

— Kush ne?

— Unë, mamaja, Todi... ne muarëm vesh që je plagosur, Todi po të kërkon nëpër fshat; po dorën si e ke?

Gjë fare e vogël, nuk vlen të bisedojmë për 'të.

— Po pse nuk ardhe?

Unë po e humbisnja toruan, por Vaska më ardhni në ndihmë:

— E dinim që nuk ishe në shtëpi, se fundja për të parë plakën nuk ja vlen barra qiranë...

Ajo përpëliti qerpikët dhe u kuq nga fytyra. Unë shkova pështymën dhe unja kokën.

— Kështu, të presëm nga shtëpia.

Kur u largua ajo, m'u kthye Vaska duke qeshur:

— Ti, or vëlla, s'i ke punët mirë. Ja, punë i thonë kësaj? Vjen fusharaku në fshatin e botës dhe na ngjet si përalla që tregojnë, le që e pranojnë në fshat, po pastaj na kërkon edhe çupën e priftit...

— Mblidh mëndjen se unë s'kam gjë me 'të.

— E, o e, se unë ha kashtë! Ju të dy sa u takuat u bëtë flakë nga fytyra.

### 3 Tetor

Dje ardhi nga Ponçara një kompani e jona. Mungonte partizani plak Hysen Agolli. Zarifi më tregoi se xha Hyseni ishte pirë e bërë tapë te një mik në Ponçare dhe nuk loste dot nga vendi. Pas dite do të bëhet gjyq partizan për Hysenin.

Dhe vërtet, sapo mbaruam drekën, ra bori ja dhe u mblodhëm lart në shkollën e katundit. Edhe Hyseni sapo kishte ardhur, por rrinte i menduar e pik e vrer.

Passi u mblodhëm dhe mbyllëm derën, doli në krye, kundrejt *nesh*, gjyqi partizan: Maqua, Koçi dhe Lefteri. E gjithë salla ra në heshtje. Gjyq partizan ky. Shkon pa prift e pa hoxhë. Maqua u ngrit më këmbë dhe kërkoi të paraqitet partizan Hysen Agolli.

I verdhë e çere vrarë, me kokën unjur, xha Hyseni kaloi nëpër shokët dhe doli përpara gjyqit. Iu drejtua Maqua:

- Ti, Hysen, kishe pirë raki dje?
- Si urdhëron.
- Shumë kishe pirë?
- Të të them të drejtën, isha tapë fare.
- Kur të thamë ngreu se do shkojmë, pse nuk u ngrite?
- Vallahi nuk di gjë, dje edhe dru të prisnje mbi mua, hiç nuk mernja vesh.
- Po nuk e di ti rregulloren partizane?
- Si?..?..?
- Nuk e di ti se gjer më tre kupa mund të pish?
- Po këtu ta kam fjalën, o shoku Maqo. Pikë së pari rregullit është me tri kupa. Shumë mirë. Po ka kupë e kupë ama. Kupë i thonë edhe asaj të voglës sa një gisht, kupë i thonë edhe asaj që është sa një havan. Pastaj, o shoku komisar, unë piva një kupë, brenda rregullit isha; piva të dytën gjene brenda rregullit, dhe gjith brenda rregullit isha kur rrëkëlleva edhe kupën e tretë. Po me të pirë të tretën, o shoku Maqo, me të pirë të tretën, vallahi e humba fare, e harrova edhe rregullin dhe dyfegun, edhe komisarin, edhe gjyqin...



Faji është i juaji që e kini lënë me tri dhe nuk u kini vënë masën kupave...

Dikush qeshi. E sapo njëri qeshi edhe të tjerët ja dhanë gazit. Gjyqtarët u munduan sikur ta mbajnë të qeshurën, por nuk e mbajtën dot. Kështu që xha Hyseni shpëtoi mirë me një vrejte në sy të batalionit.

#### 4 Tetor

Balli po bëhet i paduruarshëm. Çeta e tij po çirret posht e lart Devollit duke bërë thirrje për sabotimin e luftës kundër armikut.

Por po ngjet e kundërta e asajë që mendon balli. Gjatë ditëve të fundit edhe gjashtëdhjetë vullnetarë të rinj ardhën partizanë në batalionin tonë.

#### 10 Tetor

Sot u ndodhëm në Grapsh. Herët në agim, një kollo-në gjermane zuri të rrethonte katundin. Rojet tona e diktuan dhe e qëlluan armikun nga afër me bomba dore. Ndodhesha bazë ne At Thanasi. U zgjuam nga krizmat e armëve dhe dualëm nëpër fshat. Mitrolozat gjermanë (ata Dod-ët e mallkuar) nuk na linin të mblidhnim mën-djen. Mitralleri i ynë, Pandi, si dhe ndihmësi i tij, u ndo-dhën në pozitë të mirë, dhe duke i shpëtuar syrit të ar-mikut, u ngjitën një katërqind metra përmbi fshat në një rrëpinë afër kishës së Shëngjergjit. Q'atje mitralieri trim lëshoi bataretë kundër gjermanëve që donin të mbyll-nin rrethimin nga kodra e Shënpjetrit. Komandanti i kompanisë, Miti, dhe partizani Sofo treguan kurajo dhe trimëri. Nëpër plumbat e armikut u futën në shkollën e Grapshit, morën mitrolozin e rëndë që ndodhej aty, dhe pasi e ngritën, filluan të qëllojnë armikun me zjarr të pa prerë. Gjermanët nuk na rrethuan dot dhe gjithë njësia e jonë shpëtoi pa asnjë humbje. Me ne u ndodh edhe togeri i ndërlihdjes aleate Geri. Në mbrëmje mora vesh se gjermanët kishin vrarë priftin e Bradvicës, At Naumin, tek ishte duke i rënë këmbanës. E kishin aku-zuar se me anën e këmbanës u bënte shënja partizanëve.

## 11 Tetor.

Koha u prish dhe filluan shirat e vjeshtës. N'agim bie brymë dhe bën shumë ftohtë. Sot shkuaam në Arëzë për të zgjedhur Këshillin N. Çl. të katundit. Në të hyrë të Arëzës muarëm vesh se në një shtëpi të këtij katundi ndodheshin tre ballistë. Llaqi me një grup shokësh rendën t'i kapin. Kur arijtëm ne të tjerët n'oborr, ata i kishin çarmatosur dhe po bisedonin. Ne ndejtëm përjashta. Më tej Llaqi nxori kryet nga dritorja dhe iu drejtua xha Hysenit:

— O shoku Hysen, sillna një krahë me kopaçe.

Llaqi i kërkonte kopaçet se ishte shojtur zjarri, por Hyseni pandehi se me kopaçet do të lonte druri, e ia ktheu:

— Ç'thua? një krah kopaçe! Silli, ore, këtu se kemi afër edhe sërën e druve.

## 12 Tetor.

Balli ka filluar të bashkëpunojë hapur me gjermanët. Ditët e fundit ballistët kanë qënë kallauzë të gjermanit në veprimet ushtarake të këtyre të fundit. Mbrëmë forcat tona kanë goditur të gjitha post-bloket e armikut në Korçë. Në kufirin grek, në katundet Janoven, Pilkat e Slimnicë, dje kaluan disa kollona gjermane. Nga larg, në drejtim të perëndimit, dëgjohen gjëmime të rënda. Si duket do të jenë luftime në det. Para disa ditësh batalionet partizane që veprojnë në rëzë të Korçës i kanë vënë përpara forcat gjermane që ishin futur në Vithkuq.

## 16 Tetor.

Dje gjithë batalioni ynë u nda në baza në Zicisht. Në mbrëmje më thirri komisar i batalionit; atje ndodhej i thirrur edhe Koçi me Todin. Në një kënd ndodhej me një libër në dorë mitralier Pandi. Komisar na urdhëroi të shkojmë në Qytezë ne togeri englez Geri, i cili do të na jepte një letër të firmuar dhe vulosur prej tij dhe drejtuar ballit kombëtar. Sikundër na shpjegoi komisar, duhej manovruar me zgjuarësi që dokumenti në fjalë të

na jepej në dy kopje. Një kopje t'ja dërgonim ballit në Bozhigrad dhe një kopje të na mbetej neve, si dokument. Toger Geri kishte biseduar vetë me komisarin tonë mbi çeshtjen e kësaj letre.

Udhëtuam natën në drejtim të Sinicës ku mbrijtëm afër mesnatës. Koha ishte e mirë, qielli i kthjellët dhe frynte një erë e lehtë. Në Sinicë Koci trokiti në një portë. Na e çeli Kostë Shamata e na priti me dashuri. Na dha darkë dhe thirza të gatuar me vaj e me hudhra. Vonë, pas mesnate, u nisëm për në Qytezë. Këtu arijtëm në agim. N'oborrin e shtëpisë ku banon toger Geri ndejtëm gjer sa u ngrit dielli nja dy hostene lart. Përkëthenjësi Pandi e lajmëroi togerin për ardhjen tonë. Mbassi hëngri bukë, toger Geri na thirri brenda. Këtu varej suksezi i udhëtimit tonë. Pas një triku togeri na dha edhe kopjen e dytë të dokumentit. Kopjet ishin shkruar inglisht, firmuar e vulosur. Pandin e pyetëm mbi përmbajtjen e letrës dhe na tha se balli nër 'to quhet plaçkaxhi e bashkëpuntor i gjermanve. Të gëzuar u nisëm për në Ziçisht. Arrijtëm pas dite. Komisarin e takuam në shkollë, na njohu që ktheheshim me duar plot dhe sytë i xixëlluan. Na përgëzoi, na rahu supat dhe doemos ndjehemi të kënaqur e na u bë qejfi mal.

## 18 Tetor

Balli e hoqi maskën. U deklarua hapur kundër luftës. Nuk do kursesi që të luftohet armiku. Thotë: «Le të luftojnë të tjerët, ne jemi të pakët». Në një sërë traktesh, të ndarë nëpër katundet, balli ngre lart pasivitetin dhe miqësinë me gjermanët. Sot më ra në dorë një trakt i ballit. Midis të tjerave shkruajnë:

«Partizanët janë të shitur, ata duan të zhdukin Shqipërinë nga faqja e dheut. Po vazhduan kështu, gjermanët do ta shuajnë popullin dhe katundet tona. Ne balli kombëtar i paralajmërojmë se do t'i godasim nëqoftëse ata do ti ngasin gjermanët. Përpara për një Shqipëri të lirë, demokratike, ethnike. Përpara nën hijen e flamurit të Skënderbeut».

Sikur të ngjallej për një çast Skënderbeu!

## 28 Tetor

Sot çeta balliste e Emin Kadiut priti në Sul një kompani gjermanësh. Hëngrën drekë bashkë. Ngritën do-llira e pas dite, të vëllazëruar, shkuan në Bilisht; Kështu balli kombëtar zyrtarisht u bashkua me gjermanët.

Koha po prishet më keq. Fryn erë e ftohtë dhe në mbrëmje qimtoi dëborë e parë.

## 3 Nëntor

Gjermanët filluan të sillen nëpër fshatrat afër Bilishtit të shoqëruar nga ballistët. Kanë arrestuar shumë simpatizantë të Lëv. N.Çl. dhe i kanë internuar. Informatat që vinë në shtabin tonë thonë se armiku po gatitet të qëllojë bazat tona më të rëndësishme. Në radhët tona ndihet një farë nervozizmi.

Sot shkua në Hoçisht. Atje vura re materialet e kapura në Bilisht më 9 Shtator, ishin transportuar thuajse të gjitha për në shtabin e qarkut. Dikush më tha se në Voskopojë partizanët kanë ngritur linja telefonike me telat dhe centralin që u dërguan neve.

## 6 Nëntor

Dje para dite, nga ora dhjetë, çeta e ballit po delte nga Menkulasi. Na lajmëruan se atje kishin plagosur një simpatizant të Lëv. N. Çl.

Kur u afruan pranë Sulit, ne u vërsulëm në ndjekje të tyre, por nuk i arrijtëm dot. Ata nxituan dhe hynë në Koshnicë. Rrethuam fshatin dhe hapëm zjarr. Pas një luftimi që zgjati nj'a gjashtë orë, shumë rob tetë ballistë. Katër të tjerë mbetën të vrarë në vend. Nga ana e jonë u vra mitralieri Bektash Dobranji dhe Taqi Treni. U plagosën dy partizanët, Myftari e Kroni.

Në mbrëmje, nëpër një errësirë dhe shi të dendur, shkua në Sinicë. Partizani Fazlli që është vendës, më mori në shtëpinë e tij. Nuk arija të ha darkë se më kish marë gjumi.

## 7 Nëndor

Ndodhemi në Hoçisht. Dëgjuam radion: Ushtria e kuqe ka çliruar Kievin. Pas dite u bë mbledhja e batalionit në shkollë. Foli mbi rëndësinë e çlirimit të [Kievit] Zv/Komisari i batalionit. Ay na tregoi në hartë pozitat ku ndodhet tashti Ushtria e Kuqe. Nër partizanët filloi të ndjehet gjallëri e gëzim.

Duke lëvizur grepin e radios, rastësisht kapëm një stacion që flitte shqip. Ishte radioja gjermane e Donaut. Kievin nuk e zu në gojë, veç foli për një farë tërheqjeje strategjike.

## 13 Nëndor

Sot mora një letër të pa pritur. Më shkruante mësuesi im i fillores nga Korça. E hapja dhe e lexova me kurresht. Më shkruan se e kanë marrë gjermanët me përdhuni në këto rethana: çeta balliste e Emin Kadiut e kish «vizituar» në shtëpin e tij në Ziçisht. Duke ikur, ata i kishin rrëmbyer kitarën. Mësuesi, si pa gjë të keq, kish shkuar të ankohet në Bilisht. Aty takon një major gjerman. Mësuesi im e di mirë gjermanishten (ka studjuar në Insbruk të Austrisë) dhe i kish folur majorit. Ky i fundit, kur e pa se dinte të flasë mirë gjermanisht, nuk e kish bërë të gjatë por ja kish kthyer: «Kitarën e gjejmë kollaj, por ti do vish me ne si përkthyes dhe fjalët t'i lësh më nj'anë.»

Mësuesi im nuk kishte dashur, por ata e kishin detyruar. Në letrën që më shkruan, mësuesi më thotë: «Ta dini se më muarën me zor e po shërbej për 'ta, se kam frikë t'u ik. Veç mos u shkojë mendja për keq gjithë ju djemve të mij që jini atje.»

Ja shpura letrën Mlyzaferit. Ky po hante bukë. Më tha: «lexoma.» Ja lexova dhe i dhashë shpjegimet e duhura. Ay e la bukën përgjysëm dhe m'u kthye.

— Po ay është një xhevahir për ne...

— Pse?

— Si pse... Nuk e mer vesh? Shkruaj një përgjigje

të bukur. Thuaji që të takohet përditë me sjellësin e letrës.

Dhe mësuesi i im, ay burrë i ashpër që kushedi sa herë m'i ka ratur pëllëmbët me stap thane, ay që më vinte veshë kartoni kur nuk mësonja, ay që më ka vënë një barrë mënd, ay do të punojë për Lëvizjen partizane.

### 18 Nëntor

Na njoftuan se spiuni i gjermanve Lefter Ruço u vra në Korçë nga një partizan i batalionit tonë, i cili kish shkuar në qytet apostafat për këtë punë. Vrasja ka ngjarë në këto rrethana: Lefter Ruçua e kish vënë re atentatorin dhe e kish qëndruar ne dyqani i Qirinxhiut. Atje i kish kërkuar letër-njoftimin. Partizani, i veshur civil, ja kish dhënë. Spiunit nuk i qe mbushur mëndja me atë dokument dhe e kish pyetur nëse kish dokument tjetër.

— Po kam edhe një dokument të dytë, — i kish thënë partizani.

— Pa ma jep ta vështroj.

Dhe partizani kish futur dorën në xhepin e prapmë të pantollonave dhe kish nxjerrë... dokumentin e dytë! Ky «dokumenti i dytë» na paskëshe që në një njëzetshe austriake, që Lefteri i llahtaritur e kish ngrënë me fund!

### 25 Nëntor

Balli dhe gjermanët po bëjnë arestime, djegëje e vrasje në popullin e gjithë katundeve.

Koha u prish dhe po bije dëborë. E ftohta grin e pret. Sot na dezertoi një partizan prej Bilishti. Kish ikur natën nga trupi i rojes dhe aty kish lënë edhe pushkën.

Komunikata e ardhur sot nga Korça njofton se një njësi partizane, në mbrëmjen e datës 20 Nëntor, rrethoi teqenë e Turanit dhe vrau tre krerë të ballit: Baba Zylfon, Sabri Panaritin dhe Refat Goskovën.

### 26 Nëntor

Me urdhër të komisarit, ditët e fundit ndodhem në Sinicë. Këshilli më caktoi bazë në shtëpinë e Ferezit dhe

atje banoj. Kam mbledhur këtu disa makina shkrimi, dy radio, tri bateri, letër dylli dhe një shaptillograf të thjesh-të. Po shumëzoi shumë komunikata e trakte. Komisari më solli edhe një dorëshkrim për ta shumëzuar. Mban ti-tullin «Dhjetë ditë që tronditën botën» nga Xhon Rid.

Përsa i përket shaptillografit që kemi, ky është një novacion i shokëve të Korçës. Nga jashtë duket si një ka-setë nga ato që lozin zaret. Passi çelet, në njërën anë duket një rjetë e hapur në një kornizë teli. Mbi rjetën çpaloset letra e dyllit e prapa lyhet me bojë. Mbi të vi-het letra dhe një shul dore prej llastiku kalohet mbi le-tër. Kështu kopjohet përmbajtja e fletës së dyllit. Kopjet e para shkojnë dëm mbassi përlyhen shumë, por më tej puna shkon mirë dhe dalin nga treqind kopje.

Sot instalova njërën radio dhe u mundova të kap ndo-një stacion. Më ish e pamundur mbassi akumulatorët janë të zbrazur e kanë fare pak energji. U mundova të insta-loj një dinamo të vogël në mullirin e fshatit, por nuk munda. Më duhet një pendë e vogël, rulemanë, ripa, tela. Provova e vura një pulezho druri në vendin e gurit të mullirit. Dinamon e montova pas faqes së brendëshme të govatës, atje ku bije mielli. Vërtitjet bëheshin të shpej-ta, por ripi prej litari që vura unë u këput shpejt. Du-het rip i mirë dhe i gjatë. Dhe ripa ka, por duhen sjellë prej Korçe. U ngjita në Dardhë dhe bisedova me Komis-sarin për këtë çështje.

### 3 Dhjetor

Armiku e kish shtuar presionin mbi katundet që janë të lidhur me luftën N.Çl. Në të gjitha katundet kanë dje-gur shtëpi të partizanëve dhe kanë arrestuar njerëz të pa fajshëm. Ajo që na revoltoi së tepërmi është ndodhija që dëgjuam sot. Ballisti Emin Kadiu ka marrë peng vajzën e madhe të partizanit Shaban Qamili dhe e mba në burg. Vajzën e Shabanit e kam parë disa herë. Është një te-tëmbëdhjet vjeç.

Sot mësuam se n'afërsit e Tiranës është formuar Bri-gada e II-të S.

## 8 Dhjetor

Pardje një kompani e jonë ishte në katundin Dobrënjë.

Sot një kompani e batalionit bashkë me komisararin (Myzafer) u nis për në Polenë. Pa tjetër do t'a kenë të vështirë se ka rënë shumë dëborë dhe rruga është krejt e mbyllur. Urdhëri i nisjes është dhënë nga Shtabi i qarkut.

## 10 Dhjetor

Edhe sot një kompani tjetër e jona, u nis për në Voskopoje me urdhër të Shtabit të qarkut. Në Dardhë mbetëm vetëm dyzet partizanë me Maqon e Hamdinë në krye. Nuk po dimë përse kërkohen shokët asaj ane.

## 13 Dhjetor

Pjesa tjetër e batalionit ndodhet në Dardhë. Lëvizjet tona nëpër katundet e fushës po bëhen të vështira. Armiku informohet rregullisht nga balli për të gjitha lëvizjet tona. Dëborë ka mbuluar fusha e male dhe veriu fryn me tërsëllëm. Ushqimet në katundet e malsisë janë të pakta. Në Dardhë kemi grumbulluar me kohë një sasi ushqimesh, por në qoftë se do vazhdojnë punët kështu, ato do na mbarohen shpejt. Në mes të Dardhës është ngritur kazani. Në mëngjez partizanët hanë patate të pjekura. Në drekë supë fasulesh dhe në darkë një farë supe me gjizë. Herë herë vijnë lajme se armiku po gatitet të na sulmojë në Dardhë, ku majat e ashpra të maleve janë mburojë për ne. Në gjithë anët e Shqipërisë gjermanët janë vënë në sulm kundër njësive partizane. Shokët tanë po luftojnë me trimëri dhe në këto ditë të vështira, kur ndërlihdja me anën e korrierëve po bëhet e rallë nga konditat e vështira të kohës dhe të sulmit armik, në Dardhë e Sinicë po marrim vesh se shokët luftojnë në gjithë anët e Shqipërisë. Burimi i lajmeve në këtë rast është radioja gjermane e Donaut, e cila po flet natë për natë me një zë të trashë të thellë si i dalë nga



varri: — «Nëpër malsitë e Shqipnis janë tue u zhvillue luftime t'ashpra kundër bandave komuniste».

Kaqë thotë gjermani, po kusurin ne e marrim me mend.

Gjermanët detyrohen të flasin për luftën tonë sepse nuk na heqin dot prej qafe. Dhe kjo na gëzon e na jep kurajo: në hesapin e luftës kundër gjermanve është brenda edhe lëvizja partizane, e popullit shqiptar, i cili po i reziston me vendosmëri operacionit të dimrit që kanë ndërmarrë gjermanët.

Në mëngjez u ngjita në Dardhë se ishte mbledhja e partizanve në shkollë. Komanda kërkoi njëzet partizanë «për një udhëtim të rezikshëm dhe me rëndësi». Edhe kureshtja bëri punën e saja dhe u vura edhe unë në rrugë. Kur dualëm nga Dardha, na thanë se do të vemi në Vërnik ku do të takojmë një shok. Po cili është ky shok? Hamdiu e di, por nuk na tregoi.

Na u desh të kalojmë në errësirë nëpër fushën e mbuluar me dëborë dhe të kontrolluar nga armiku, larg rrugëve dhe burimeve të ujit. Në mesnatë arritëm në Vërnik. Fshati na priti shumë mirë. Na dhanë darkë nxituar dhe sërish muarëm rrugën e kthimit. Shoku që takuam këtu dhe që ardhni me ne është një nga udhëheqësit e luftës partizane. Njërën sy e ka pak të prishur por unë nuk e njoha. Dikush më tha se është Haxhi Lleshi. Ka ardhur në Vërnik duke kaluar nëpër Maqedhoni. Shokun Haxhi Lleshi e shoqëruam gjer në Dardhë dhe prej këtej vazhdoi rrugën për në shtabin e përgjithëshëm.

## 16 Dhjetor.

Dje bëra një rrugë të gjatë dhe gëlltita një dëshpërim të thellë. Rojet tona, që ndodheshin ne Guri i Vjeshtës, njoftuan se në Ziçisht po kërciste pushka që në agim. Dolla në një majë mali dhe pashë me dylli. Vërtet fshati im ishte mbuluar me tym e flakë. U vërvita tatëpjetë dhe pas dite, duke rrëshqitur nëpër dëborë, arrija në një pyll me lajthishta një dy kilometra afër

Ziqishtit. Flakët edhe nuk ishin shojtur; këmbanat e kishës tingëllonin më zi.

Medet! Në fshat ishin vrarë njerëz. Po kush? Asgjë s'mund të kuptonja. Mbeta si i goditur aty në mes të lajthishteve e prita sa të binte nata. E ftohta po më mundonte. Më dridhej mjekra dhe më kërcisnin dhëmbët. Pylli ishte i shkretë, era fishkullonte nëpër degët e thata. Pa pritur ndjeva një zhurmë fare afër. Dikush po zvarisej drejt meje. Zemra më rahu me forcë dhe kapa automatikun. Nga lajthishta më tej dolli qeni im. Kafshë e ndijshme dhe sa e dashur. Si e kishte ndjerë qeni im qënëjen t'ime afër fshatit? E mora ndër krahë, e putha, e përkëdhela, e shtërngova fort pas gjoksit. Balua më lëpinte duart e ngrira, faqet e thara, e nxirte disa zëra si të zgjatura.

Ja, Balua e dinte ç'i kishte ngjarë fshatit. Ay e dinte kush ishte vrarë, ay e dinte çfarë qe djegur, ay e dinte llahtarën e fshatit, por ay nuk ma tregonte dot. Balua vetëm më përgëzonte, më lëpinte pëllëmbët dhe më shihte drejt në sy.

— Balo, o Balo! Ç'ka ngjarë në fshat? Kush u vra? Çfarë u dogj?

Por ay veç më shihte në sy, zgjaste qafën dhe shtrinte kokën pas dëbcrës ndënë këmbët e mijs. Dhe nga fshati dëgjchej këmbana që binte më zi. Vinte era e tymit dhe e shkrumbit. Për një çast m'u duk sikur ndjeva erën e temjanit. Pastaj këmbanat tingëlluan më nxituar. Këtë e kuptonja kuartë. Edhe vetë kur isha i vogël shpesh u binja këmbanave në ditë vdekjeje. Dhe i nxitonja tërheqjet e litarëve, atëhere kur të vdekurin e afronin në kisha.

Ja edhe tashti këmbanat i nxituan tingujt. Më vinte të vërvitem drejt fshatit dhe të ndaja atë dyshim që po më gryente përbrenda. Por këtë nuk e bënja dot. Shpesh herë dëgjonja edhe krizma pushkësh e bombash që binin nga fshati.

Kur ra nata, u nisa. Balua më vinte pas. Ecnja i kru-

sur pas gjendheve. Po hynja si hajdut në fshatin tim. Dhe një pyetje e lemerisur sikur më buçiste në kokë:

— Kush është vrrarë?

U solla përçark katundit duke hetuar nga larg. Flagët edhe nuk ishin shojtur. Mijra e mijra xixa ngriheshin drejt qiellit. Nuk ndjeheshin zëra. Edhe qentë ishin nemitur. Fshati dukej si një gërmadhë e zezë, e ndriçuar nga gjuhë flakësh. Dhe flakët, duke lëpirë trarët, delnin nga hatullat nëpër strehët e çative. Më sëmboi thellë në shpirt, dhëmbët m'u shtërnguan dhe sytë m'u mbyllën për një çast. Dhe n'atë çast pashë fshatin t'im kur isha i vogël. Atë fole të botës s'ime kur bridhnja i qeshur nëpër mezhdat anës lumit, atje ku kullotnin kuajt dhe shqerrat. Ahere fshati im zjente si në koshere bletësh. Edhe në dimër punonin njerëzija. Dhe në netët e Shënëndreut si kjo, gjyshet për rreth vatrës me furkën nër duar na tregonin përralla për divat, për të bukurat e dheut, për hajdutët e maleve dhe për trimat me nam të fshatit tim. Po tashti? Po tashti, o fshati im, ç'është kjo gjëmë?

Ajo q'u ngrit e u ndërtua me djersën e gjakun e kurbetit, ajo po digjet nga flaka e gjermanit. Jetën e qetë dhe të varfër të kësaj çerdheje bujqërishe e druvarësh po na e prish plumbi e zjarri i nazistit shpirtzi.

Mallkim paçi, o armiq t'egër! Mallkim edhe për juve, o katila, që u vini pas gjurmës si spiunë!

Ja këto mendime më zienin në kokë. Po vallë kush u vra? Ja kjo ish e tmershme.

Duke kaluar afër kishës, m'u shkrep diçka në kokë. Aty janë varezat. Kapërxeva avllitë dhe hyra në sheshin e kishës. Edhe Balua më ra pas. Nëpër bardhësin e dëborës shquajta ca si hije të zeza. Ishin varre të rinj. Toka sapo ish punuar. I nëmërova: një, dy, tre... Po ishin tre varre, tre të vrrarë. Po cilit ishin vallë?

Kapa kryet me duar dhe mbylla sytë. Dhe Balua më sillej nëpër këmbë.

U avita pas varreve dhe u mundova t'i gjej me mend pas grupit të fiseve.

Ja këtu varrosin fisi i Panove, atje Nishët, më tej Kristot.

E mirë kjo, po kush nga këta?

Me zemër të ngrirë hyra në fshat. Atje nga im gjysh mësova ç'kishte ngjarë:

«Që në agim, gjermanët dhe balli, kishin rrethuar fshatin. Djemt e rinj të njësitit ishin munduar të dalin nga rrethimi duke rendur nëpër grykën e lumit. Oresti, Panua dhe Elise Kristua ishin vrarë nga plumbat e gjermanëve. Pandi Nishin e kishin therur ballistët me bajonetë. Gjermanët e balli kishin plaçkitur fshatin dhe u kishin kallur zjarr disa shtëpive.

— Po gjer kur ikën? pyeta gjyshin.

— Afër drekës.

— Po pse dëgjoheshin pushkët gjer në mbrëmje?

— Kish patur bomba e fishekë të fshehura nëpër muret e shtëpive që u dogjën.

### 23 Dhjetor.

Mbrëmë fjeta në kalivët e Sinicës në pyllin e Propasit. Atje ishin edhe djemtë e njësitit. Midis tyre ishte edhe partizani i batalionit tonë, Kroni, i sëmurë rëndë. Sot në mëngjez u ngrita herët dhe u nisa për në Sinicë. Ish ftohtë dhe kish rënë mjergull e dendur. Automatikun e kisha hedhur shtruar mbi të dy supat si hosten dhe kisha mbështetur krahët mbi të. Hyra në Sinicë si pa të keq dhe po avitesha drejt shkollës, kur papandehur, që nga errësira e mjergullës, më dolli përpara një njeri i armatosur. Nuk më shkoi mendja për keq dhe pandeva se ishte ndonjë partizan. Iu afrova edhe më. Ndodhesha anës rrugës dhe nga ana e djathtë kisha një rëzim të pjerët. Pa prituri njeriu i armatosur më foli më emër:

— O filan i biri filanit, hidh armët poshtë!

Ngriva në vënd dhe e pashë vdekjen me sy. Njeriu kundrejt ishte ballist dhe e mbante pushkën peshë. N'atë çast të vështirë më shkrepri në kokë si vetëtimë një djallëzi që e kisha dëgjuar nga një partizan i vjetër. Nxora një bëlbëzim të trembur dhe iu përgjegja si i përlulur.

— Aman ore, se ja po e hedh...

Dhe duke hequr automatikun nga supat, si për ta

hedhur, ja hoqa këmbëzën, duke shkelur butonin e sigurancës me mollën e dorës...

Kërceva poshtë rëzimit ndërsa plumbat e mij fluturuan në hava.

Pse nuk qëllova në shenjë?

Këtë nuk munda ta bënja, se në ato çaste unë e kisha humbur toruan. Më e madhja ish ajo që bëra. Mund të më kuptojë veç ay që ka rrojtur ndonjë çast të ngjashëm.

Shkrehja e automatikut tim shkakëtoi frikë tek ballisti që më doli përpara, i cili ra barkaz duke më sharë. Unë i thira vrapit poshtë rëzimit dhe bëra përpjetë pas grykës së lumit. Më shpëtoi mjergulla, se ndjeva batatë mitrolozi që mu' qepën pas. Ballistin e njoha ashtu si më pat njohur edhe ay. Quhet Hysni dhe është njëri nga vrasësit e shokut tonë Syrja Ali Poloska, që na e vranë në Çipan më 14 Shtator të vitit të kaluar.

Pas mitrolozit shungulloi edhe topi. Bobo! thashë me vehte, po më ndjekin edhe me top. Më vonë mora vesh se gjermanët kishin pandehur se unë isha pararojë e ndonjë force partizane që vinte më pas.

Passi kalova rëzikun, mora rrugën pas një përroi të thellë. Në shpinë kisha një çantë me trakte dhe letra të tjera. I mbështolla në partesynë që kish veshur dhe i futta në një drizë. Më tej më arrijti një çoban. Ay më tregoi se gjermanët kishin kapur në Sinicë partizanin Palo Guta dhe e kishin vranë.

Kur arrijta në kalivet e Sinicës, nuk i gjeta atje shokët që kisha lënë. Dëgjova zërat e tyre diku më lart e unisa pas tyre. Ishin mbledhur në një çukë dhe mbanin vesh armët që kërcisnin në drejtim të Arëzës.

Nga mjergulla e dendur as më shihnin e as i shihnja. Qëndrova aty të çlodhem, se gati më ishte zënë fryma. Bisedat e shokëve aty më sipër i dëgjonja shkoqur. Ata thoshin se ish vranë Palo Guta dhe unë.

— Po ç'iu desh që u ngrit dhe iku aq herët, — po thoshte njëri.

— Kështu e kish të shkrojtur, — iu përgjegj një tjetër.

- Jo, ore jo! Jam gjallë akoma, nuk më kanë vranë.
- U ngrita dhe u afrova në shokët. Ata më përqaftuan.
- Po Palo Guta?
- Më thanë se e vranë.

I vëllai i Palos, një djalë një trembëdhjetë vjeç, zu qante me kuje.

Afër mbrëmjes ardhni një partizan nga Dardha. Na tregoi se ç'kishte ngjarë: gjermanët dhe ballistët, duke përfitur nga mjergulla, ishin ftur në Arëzë pa u diktuar dhe duke ditur se batalioni nuk ishte i tëri në Devoll. Shoku i terrenit Palua, kishte rendur drejt Arëzës dhe u kish thirrur rojeve tona se po afroreshin gjermanët, por ata nuk e kishin dëgjuar dot. Kish vijuar një shkëmbim armësh nëpër rrugët e fshatit. Shokët ishin kapur në be-fasi dhe qenë tërhequr në tre drejtime: nga kufiri grek, nga Nikolica e nga Dardha. Në luftim kishin rënë tre shokë. Pas hyrjes në Arëzë armiku kish marrë zemër dhe qe drejtuar për në Dardhë. Hyrja e tyre këtu do të ish e tmershme për ne. Armiku shumë herë është lëvdur se do ta bëjë Dardhën shkumb e hi. Po në rrugën që i çonte në Dardhë, kollona armike ishte goditur me zjarr mitrolozash nga një grup partizanësh. Trimi Petro Boboshtica kish luftuar si hero. Armiku qe detyruar të tërhiqej. Partizani që më tregoi këto më tha se gjermanët kanë qëndruar në Sinicë e s'kanë ndërmend të tërhiqen.

Kur ra mbrëmja, u menduam me shokët të gjejmë ndonjë ushqim se ishim fare pa ngrënë. Shoku i sëmurë kish temperaturë të lartë dhe nuk kish asgjë të verë në gojë përveç dëborës.

## 24 Dhjetor.

Mbrëmë u nisa natën që nga kalivët për në Sinicë. Me mua ardhë dhe dy pionerë. Njërën e quajmë Soto. Errësira ishte aqë e thellë, sa nuk dukej asgjë edhe sikur të të shponin në sy. Më shumë zvariseshim se sa ecnim. Vijuam rrugën nëpër një lumë të vogël që quhet Valëzë. Ecëm gjatë rrjedhës duke qënë të lagur e të qullur fund e krye. E ftohta na përsëllonte gjer në palcë. Nga një

majë kodre hodha sytë më hava nga Sinica, ashtu më hamëndje, më tym. Më thosh mëndja se mund të kish drita në kishë, se mbrëmë ish nata e Krishtlindjeve. Nuk dukej asgjë.

Hymë në Sinicë duke u zvarosur me kujdes e duke dyshuar se mos ishin aty gjermanët. Dy pionerët shkuan në shtëpit e tyre. Unë ndoqa një rrugë tjetër anës jazit. Kisha frikë se mos binja në ndonjë rëzim dhe u futa nëpër rjedhën e jazit. Këmbët më gërvishteshin nga copat e akujve. Afër një shtëpije, në errësirë të thellë shquajta një dritë kandili dhe u afrova ngadale në dritore. Vura veshin:

Ndjeva një zë gruaje që përkundte djepin duke i kënduar foshnjës ndagale e me frikë. Nuk dinja në cilën shtëpi ndodhesha dhe nënë dritën e dobët të kandilit he-tova fytyrën e gruas. E njoha dhe i fola:

— Olimbi! moj Olimbi!

Ajo u ngrit.

— Kush është?

— Çele se jam unë..

Ajo shoqti kandilë dhe hapi portën. Hyra. Fëmijët po flinin.

— A ka gjermanë në fshat?

— Jo, nuk ka, ata ikën, na vranë Palo Gutën. Po Palon tim e pe gjëkund?

— Mirë e ke, ay më dërgoi. Këtu e gënjeva, se unë arrija atje pa e ditur se ku isha.

Olimbija vuri dru në stufë dhe më hodhi raki në duar. Foshnja në djep zu qante. Një fëmijë m'i rritur nxori kokën nga jorgani në qoshe:

— E pe babin o?

— E pashë, e pashë, mirë është, po ti fli aty.

U ngroha në zjarr dhe Olimbija rendi të marrë ndonjë ushqim në shtëpinë e shokut të sëmurë që lashë në kalivet. Pas pak Olimbija solli ca kokrra mollë, një meshë e një shishe me mjaltë. Më dha një palë hejbe e m'i mbushi me bukë e gjellë. Ja lidha grykët e hejbeve, dhe pjesën e linjës që bashkon hejbet dhe që ka një të çarë

në mes e futa në kokë. I ngarkuar mora rrugën për në kalivet. Olimbija, nga pas, ndezi kandilin e ikonave dhe po bënte kryq.

Pas një udhëtimi të vështirë: në mjergull, në errësi të në të ftohtë, mbasi humba rrugën disa herë, munda të arrij në mëngjes te shokët. Isha i kapitur sa më dridheshin gjunjët. U dhashë shokëve hejbet. I sëmuri filloi të përtypë një mollë e më falënderoi nga zëmra.

## 25 Dhjetor.

Sot u ngjita në Dardhë. Takova shokët e batalionit, i pyeta mbi luftën e Arëzës. Më treguan plot hollësi. Më thanë se një grup shokësh, gjatë tërheqjes, e kishin humbur rrugën nëpër mjergull dhe ishin sjellë tri herë rjesht rreth malit të Kuq dhe përsëri binin në gjurmat e tyre.

Roje janë vënë mbi gjithë majat e maleve rreth Dardhë. Të gjithë shokët janë të një mendimi se, po të kishin hyrë gjermanët në Dardhë, do të hanim një grusht shumë të rëndë. Në atë rast fati i batalionit tonë nuk mund të merrej dot me mend. Tashti komanda e batalionit ka marrë të gjitha masat për t'i qëndruar çdo goditjeje të armikut këtu.

Armatime kemi pak, fishekët të nëmëruara, bomba dore nga një për shok; armë të rënda mund të nëmërojmë veç tre mitroloza Fiat nga ata që mundmë të mbajmë prej atyre që kapëm në Bilisht. Të tjerët i kemi dërguar në Shtabin e Qarkut. Kështu që ne u kemi dhënë armë edhe njësitë të tjera partizane. Dhe jo veç armë. Telefonat që sot janë ngritur në anët e Voskopojës, i kemi dërguar ne. Ne ua kemi dërguar edhe centralin telefonik, një mijë copë çarçafë spitali, mijra litra vaj, këpuccë, roba, pushkë, fishekë. Këto po i shkruaj sepse sapa i dëgjova që i zinte në gojë një shok atje ne furra e Dardhës. Veç po vë re se partizanët duken disi të shqetësuar. Kjo është e kjartë dhe e kuptuarshme. Nga të gjitha anët armiku ndodhet në sulm. Ay është i pajisur më së mirë, ka pas edhe kallauzët e ballit. Lëvizjet tona në fu-



shë po bëhen të vështira. Nga i gjithë Devolli veç Dardha ka mbetur e pashkelur nga armiku. Në të gjithë katundet e tjerë gjermanët hynë dhe u vunë zjarrin, plaçkitën, vranë, internuan, rrëmbyen gjënë e gjallë dhe ushqimet.

Pas dite disa grupe partizanësh shkuan për vizitë në familjen e dëshmorit Kiço Isak këtu në Dardhë.

Atje na pritën e ëma e dëshmorit, dy motrat e tij si dhe Joana, e kushërira. Në dhomën e pritjes vura re disa sende interesante: Mbi një tryezë ndodheshin tri vazo me zvaranikë të ballsamosur dhe një koleksion flutura e insekte të mbledhura nga dëshmori. Në mur, në një kornizë, dukej një diplomë e dëshmorit Kiço Isak, që i qe dhënë në vitin 1936 si kampion kombëtar i rendjes në 5000 metërshin. Fotografija e dëshmorit, e varur në mur, e tregonte një djalë të bëshëm, me trup të zhdërvjellët dhe të bukur. Kiçua ka qënë profesor bujqësije në një gjimnaz. Na treguan dorëshkrimet e dy librave të dëshmorit: njëra mbi fenë dhe tjetra mbi apikulturën. Motra e dëshmorit, Dhora, na tregoi episodin e vrasjes së Kiços ngjarë në Dardhë më 24 Dhjetor 1942:

«Ishte herët në mëngjez kur u hap fjala se ushtërija italiane rrethoi katundin. Kiçua shpejt takoi disa nga shokët e tij, dhe pasi bisedoi me ta, u nis të çajë rrethimin. Ish i armatosur vetëm me tri bomba dorë. Ne ura afër mullirit të Çomes ja prenë rrugën një grup fashistësh. Ata e qëlluan. Atëhere Kiçua u vërtiti bombat. Katër armiq mbetën të vranë, të tjerët u trembën dhe u shtritën. Kiçua u vërtiti të ikte po çerdhet e mitrolozave ishin ngritur dendur në të dy anët e rrugës dhe të lumit. Dhe ata e qëlluan.

«Kur renda ne vëndi i ngjarjes — tregonte Dhora, — më parë pashë shtrirë për tokë të vranë shokun Leki Panolli. Më tej nëna ime po qante e lebetitej mbi Kiçon. N'atë çast m'u errësua bota dhe u bëra si i prishur nga mëntë. Kur e pashë vëllanë shtrirë e pa frymë, më pikoi në zëmër. Po nuk di se si u bëra aqë e fortë e durova. Kiçua ish trupmadh dhe i rëndë. Unë nuk di ku e gjeta

atë forcë. E rrëmbeva vllanë e vrarë, e hodha mbi shpinë dhe u nisa drejt fshatit nëpër klithmat e grave. Leshrat më kishin mbuluar fytyrën. Mëndja më qe prishur. Im vëlla Petrua mbante këmbët e të vrarit. Kur e lamë dhe e ndruam, vura re se trupi i Kiços ish bërë shoshë nga plumbat. Fashistët e kishin qëlluar edhe passi ay kish vdekur. Po për çudi fytyra e tij nuk ish prishur e as zverdhur. Ay ruante tiparet e të gjallit dhe sikur nënë-qeshte».

Kaqe na tregoi motra e dëshmorit Kiço Isak.

Po atë ditë (24 Dhjetor 1942) fashistët, përveç Kiço Isakut, vranë edhe tre djem të tjerë të njësitit gueril: Leki Panollinë, Miço Zdrulin dhe Dhimitër Tollkon.

## 27 Dhjetor.

Mbrijtëm në Dardhë, sot aty nga ora 8 e mëngjezit, një grup partizanësh me gjith komisarin e batalionit që kishin shkuar në Voskopojë më 8 dhe 10 Dhjetor. Të gjithë u gëzuam. I pritëm me shumë mall dhe dashuri sepse kishim mbetur veç si një çetë e vogël. Por gëzimi i ynë sikur u pre: Shumica e shokëve që patën shkuar asaj ane nuk u kthyen më. Me urdhër të Shtabit të qarkut më se njëqind partizanë të batalionit tonë mbetën andej për formimin e brigadës IV-të S.

— Kundërshtuam, — na tha komisar, — po nuk na e vunë veshin.

Shokët e ardhur nga Voskopoja na tregojnë se pothuaj për ditë kanë luftuar andej me gjermanët dhe ballistët. Batalioni ynë kish mbajtur andej gjithnjë një sektor të caktuar. Kishin luftuar në Vinçan, Lozhan, Gur i Kamjes, Qafa e Panjës. Dhe vetëm pas pesëmbëdhjet ditë luftimesh, forcat tona të gjysmuara pse qenë mbajtur nga brigada e IV-të S., kishin marrë urdhër të kthehen në Devoll.

Sot pasdite u bë mbledhja e batalionit në shkollën e Dardhës. Komisar foli gadi dy orë. Ay është usta i fjalës, foli me vrull e me pasion duke i zgjedhur fjalët një për një. Dhe çdo fjalë e tij sikur është e veshur me zjarr.

Gjëndjen tonë e tregoi sheshit e ashtu si është. Nëmëroi goditjet që na dha armiku; foli për operacionin e madh gjerman në gjithë anët e vëndit dhe pastaj vazhdoi:

— «Këtu nder ne forcat gjermane janë në sulm. Armiku përfiton nga koha e keqe, nga informatat që i jep balli, nga armët tona të pakta. Por në frontet e mëdhenj të luftës makina gjermane po shkatërohet. Ushtria e Kuqe po pastron tokën e vet dhe po çliron Poloninë.

— «Ne këtu në zonën tonë të ngushtë nuk do të tërhiqemi, por do të luftojmë gjer në fund. Jemi pak, kjo është e vërtetë, por guri rëndon në vëndin e vet. Këto shkrepë e maja të larta që na rrethojnë, janë kështjella e mburoja për ne. Dhe ne, po qe nevoja, do të dimë të vdesim të gjithë, por nuk do tërhiqemi. Me armë në dorë e me trimëri në zëmër, në këto ditë të vështira ne sërish do të zbresim Devollit tatëpjetë.»

Fjalët e komisarit bënë punën e tyre. Fytyrat e partizanve u kthjelluan. Brohoritjet mbushën sallën. Ish atje një pamje e rallë: gati njëqind e njëzet partizanë, thuajse të gjithë djem të rinj e luftëtarë, ishin ngritur në këmbë. Fytyra të hequra, por sytë zjarr, mbanin kryet lart, shtërngonin armët dhe përqafonin shoku. shokun.

Lart, shumë lart, në Shënpijetër e në Guri i Vjeshtës, rojet tona vigjellojnë. Dhe veriu është ngritur më këmbë si një bishë dhe po gjëmon me të madhe.

## 28 Dhjetor.

E ftohta grin e pret. Muarëm vesh se gjermanët kanë sjellë në Korçë mercenarë nga Kosova. U kanë thënë se në Toskëri kanë hyrë Grekët e duhet t'i qitim jashtë.

Na zuri një hall i ri dhe i paparashikuar: Gripfi.

Gati pesëdhjet partizanë jemi me grip. Kryetari i këshillit të Dardhës qysh në mëngjez caktoi baza të tjera. Na ndau veç të sëmurët dhe veç të shëndoshët. Temperatura na ngrihet deri në 40C, kemi kollë e dhëmbje të gjymtyrëve. Pijmë çaj me nga pak sheqer dhe nga një aspirinë në ditë.

Shokët e shëndoshë u nisën për në Baban passit u

pregatitën mir e mirë. Mbetëm në Dardhë 50 të sëmurët dhe nj'a dhjetë shokë të shëndoshë. Dikush na qojti «garnizoni i të sëmurve». Po rrimë me këpucë mbathur dhe në rast alarmi do të rendim drejt majave mbi Dardhë.

Pas dite, kur sytë po më digjnin e koka më dhimbte shumë, ardhi Joana të më shohë.

Në çast sikur më shkoi dhëmbja e u ngrita më këmbë. Më kish sjellë komposto me oshafe dhe bukë të ngrohtë. Sa u gëzova, sa u gëzova! Rrinte mb'anë krevatit e më dukej sikur dhoma, dritoret, tavani, muret, tryeza, sahati, zjarri në vatër, fotografitë në mur... të gjitha shihnin atë. Më dukej sikur dhoma mori një nur të ri, më dukej sikur nuk kisha më të nxehtë dhe mëndja më fluturonte larg...

— Na thuaj gjësendi?

— Po çfarë të të them? Ja, u muar vendim në mbledhjen e rinisë që të vizitojmë partizanët e sëmurë.

— Domethënë nga vendimi ardhe?

— Jo, jo, unë do të vinja, bëme një listë...

— E ti zgjodhe, që të vinje këtu?

— Ashtu vërtet.

— Pse nuk vajte gjetiu?

— Pa di dhe unë? Pse ti, nuk deshe të vinja?

— Kisha një parandjenjë se do të vinje.

— Unë të dua si vëlla.

— Asfitu edhe unë, të kam si motër... Mendoj shumë për ty. Dhe dua të të them shumë gjëra, por nuk mundem.

— Si, çfarë për shëmbëll?

— Do të t'i them më vonë...

Ajo dëndur kalonte gjuhën mbi buzë. Dhe buzët e saja të kuqe pak të çelura, si petalet e një trëndafili të hapur, ato buzë që unë aqe shumë i lakmoj, ato buzë drëdheshin lehtë ashtu si dridhen fletët n'agim, kur shtrohet vesa. E mbante kryet më nj'anë; tinëz kish lënë t'i bjerë mbi sy një kaçurel i flokëve... Dhe nëpër fijet e kaçurelit unë shihnja dritën e syrit të saj.

2 Janar 1944.

Rojet lajmëruan se nga Devolli, nga ana e Babanit, kërcet pushka. Më vonë në mbremje ariji këtu në Dardhë komisari i batalionit. Ay na tregoi se si ishin goditur afër Babanit me forcat e ballit, të cilat ishin tërhequr në panik. Ish kapur i biri i një komandanti ballist të cilin e kish vrarë me kokën e tij partizani Pjetër Prenga. Ky i fundit, Pjetri, që ishte caktuar për të rojtur robin, kish patur llogari të vjetra me 'të. Kur Pjetrit i kërkoi llogari Shtabi i batalionit, ay zuri në gojë ngjarjen kur pikërisht ballisti i kapur kish dashur ta çarmatosë.

Komisari më urdhëroi të mbledh materialin e teknikës (quajmë kështu makinat e shkrimit, radiot, shaptillografin). Më duhet të shkoj në një kalive diku në pyllin e Bradvicës. Atje duhet të rri gjer në një urdhër të dytë. Temperatura akoma nuk më ka rënë mirë, por u nisa. Bashkë me mua ardhi dhe partizani i sëmurë Andon dhe dy djem të njësitit të Ziçishtit, Gaqi dhe Ilua.

5 Janar.

Ndodhemi në pyllin përmbi Kushëndim. U futëm në një kalive të qymyrxhinjve dhe ngritëm krevate mbi disa kanata dyersh. Natën zbritëm në Ziçisht dhe muarëm një sasi ushqimesh e disa levenxe. Koha është e keqe. Dëbora bie ditë e natë dhe e ftohta pret si brisk. Kalivja është prej gardhi. U munduam t'i zëmë vrimat e gerdheve me ca fjer të thatë që gjetëm në një kalive tjetër. Megjithatë era fishkëllon nëpër gjerdhet e kalives ndërsa tavani prej fieri është i mbuluar me dëborë të trashë. Po të bjerë dëborë edhe sot, ajo do ta mbështjellë krejt kaliven tonë dhe atëhere nuk ka se nga të hyjë era. Në një qoshe të kalives ndezim nga pak zjarr; aty zjejmë trahan dhe fasule. Ilua është usta i gjahut dhe po ngre leqe prej teli nëpër shtigjet nga mund të kalojnë lepurat. Leqet na bënë punë, se i kapëm sot dy ljepura. Njerin e gjetëm pa kokë dhe me kurrizin e çarë. Ja kish ngrenë sqifteri «pa lejen tonë». Na ishte bërë pjesëtar.

Andoni është i sëmurë dhe natën në gjumë rënkon. Ditën shtërngon dhëmbët dhe vë dëborën mbi ballë. Edhe unë hera herës ndjej dhëmbje në gju dhe më djeg parzmi nga dobësia.

Natën kemi të ftohtë dhe në mëngjez zgjohemi me kokën të mpirë dhe sytë të buhavitur.

Poshtë nga Devolli herë pas here dëgjohen shkëmbi-me armësh.

## 11 Janar.

Na ardhën për drekë dy shokë që punojnë në terren: Jani dhe Perika. Ata na dhanë një lajm të hidhur: Shoku Jorgo Plaku është vrarë afër Gjergjevicës në luftë kundër gjermanëve. Ay ish një partizan i dashur nga të gjithë. I shkathët, me kulturë, trim i rallë dhe shumë gjakftohët.

Tashti më kujtohet se një ditë, në vjeshtën e kaluar, Jorgua më pat shpëtuar kokën. Dhe ja se si:

«Ka qënë nga fundi i Shtatorit të kaluar. Komisari më dërgoi ne Jorgua në kalivet e Hoçishtit për të marrë një radio. Arrija aty në mëngjes pasi udhëtova natën. Jorgua po flinte, kurse e ëma, në qoshe të kalives, po gatuantë çervish në një tigan. E zgjoi e ëma. Ay ngriti kokën:

— E, mo Tirkë, si e ke punën?

I tregova. Ay u ngrit, u vesh dhe hëngrëm bukë bashkë. Pastaj e ngarkoi radion në kuriz, mori armët dhe u nisëm për në Sinicë. Me ne ardhi edhe një vajzë partizane që u ndodh atje.

Gjatë rrugës, ne lajthija e Çipanit, Jorgua më pyeti:

— Është ajo motorçikleta atje në korijet e Ziçishtit?

— Është, po.

— A nuk vemë e shohim një herë, ta marim për të mbushur bateritë.

— Mund të na vlejë për atë punë?

— Eja, se e ndreq unë.

Muarëm rrugën nga e majta. Kaluam Përrenjtë e Mëdhenj, kodrën Qesar dhe arijtëm në Vreshtat e Ziçish-

tit. Ne zbrisnim në një faqe kodre kur dikush na thirri:

— Ku vini! oooo shokëëë! A nuk shihni se gjermanët janë në fshat?

Unë shtanga dhe bashkë me partizanen u gatitëm t'i thëresim vrapit; por Jorgua e mblodhi vehten. Në një vështrim të shpejtë që hodha nga fshati vura re se një grup gjermanësh te shkolla po na vështronin në.

— Mos jepni dyshimin më të vogël, — foli Jorgua, — përndryshe na grinë e nuk kemi nga të ikim. Vijoni rrugën si e kemi nisur si pa të keq, sa të hyjmë në fshat, atje disi do manovrojmë, këtu na grin mitrolozi.

— Po vemi si capë ne kasapi... i fola unë.

— Mos kini frikë, allahile, ata na pandehin ballistë.

Dhe zbritëm tatëpjetë. Kur arijtëm në shtëpitë e para të fshatit, gjermanët nuk na shihnin më. Ata po na pritnin ne shkolla. Atëhere foli Jorgua:

— Tashti t'i thëresim vrapit. O burra përpjetë pas lumit.

Rendëm gjer ne korijet e aty qëndruam. Pas ndonjë ore, gjermanët iknë nga fshati. Dy vajza ardhën të na takojnë në korije. Na treguan se gjermanët pasi na pritën të vinim ne shkolla na kishin kërkuar nëpër fshat.

— Allahile o Tirkë, a u trembe? (Fjalën «allahile» Jorgua e përdorte shpesh).

— Si nuk u tremba!

— Tjetër herë, në rast reziku, mbaj gjakftohësinë, mos u trondit. Ki parasysh se edhe armikut i dhemb koka më shumë se ty që je djalë. Ay nuk është më trim se ne. Pastaj gjermani është në vënd të huaj. Ti je në vëndin tënd, ballisti është frikacak se është plaçkaxhi.

Vajtëm gjer ne motorcikleta që ndodhej ne korija e Flloros. Ja kishin qitur benzinën për të mbushur çakmakët. Kështu që nuk mund ta provonim dot në ishte në rregull ose jo. E lamë dhe ikëm. Gjatë rrugës unë isha i tronditur, por Jorgua bënte shakara me mua e me vajzën duke folur me atë gjuhën e tij të hollë e plot thumba.

Po ja tashi ay djalë qimë verdhë, me atë gojën e vögël dhe sytë e ndricëm, nuk jeton më.

17 Janar.

Këtu afër nesh, në një kalive tjetër, ndodhet edhe Ilua, kryetar i këshillit N. Çl. të Ziçishtit dhe Miti, një partizan i vjetër, e dy djem nga Bradvica: Vasili e Kolja, që janë antarë të njësitit gueril të fshatit. Kolja ardhni sot nga Korça dhe na solli një dhuratë të papritur. Na e dërgon Pali, një puntor nga Korça. Dhurata është një arkë me gjashtëdhjet kuti marmallatë. Ilua pati një ide të mirë. Gatuum një farë hallve me këtë përbërje: Dhjamë, në vënd të vajit; trahan, në vënd të miellit; marmallatë, në vënd të sheqerit. Pas dite u çel koha, retë u shpërndanë dhe doli dielli. Muarëm përpjetë dhe arijtëm në pikën më të lartë të Moravës. Nga ana e Gjonmadhit dhe Damjanecit bëhet luftë. Tutje nga Gramozi e Pindi i Greqisë gjëmon topi. Gjermanët andej po zhvillojnë një operacion të përgjithëshëm.

19 Janar.

Andonit i ka marë koka erë. Ay prej kohe ka marë, me dëshirën e tija, një transferim për në batalionin partizan të Pezës. Tashti kërkon të nisët. Komisari ja kish shtyrë ikjen për shkak të shëndetit të tij të dobët e kohës së keqe. Por ja tashti ay e mbushi mëndjen top dhe po nisët. Do të kalojë batalion më batalion e mal më mal gjer në Pezë. Ja nëmëruam vështirësitë një nga një; por ay nuk dëgjon. E përcuallëm gjer ne Guri i Capit dhe zbrazëm dy pushkë si urim për rrugë të mbarë.

Dje jam lodhur jashtë fuqive të mija. Një fshatar imi që kaloi nëpër Bradvicë, kish thënë se ballistët i kullojnë dhëntë e tyre nëpër arat e partizanëve ku është shkrirë dëbora dhe presin shelgjet.

U ngrita në mesnatë dhe zbrita në Ziçisht. Në krah kisha automatikun tim dhe maliherin e Mitit. Në torbë katër granada. Në Ziçisht takova disa fshatarë. U tregova planin tim, por nuk e aprovuan, ishin të trembur. Afër agimit u ndodha në qafë afër Sulit. Prita atje kur të vinin tufat e dhenve. Pas një dhjetë minutash e ndjeva të ftohtën që më hyri gjer në palcë dhe zu më dridhe-



shin gjymtyrët. Më kot prita gjer u hap drita. As njeri e as bagëti nuk ardhni kësaj anë. Më von mora vesh se në Sul kish vajtur një lajm nga Ziçishti sipas të cilit një pararojë e batalionit partizan ndodhej në Ziçisht. E kuptova: Armiku ka informatorë dhe duhen hapur sytë se të lënë pa kokë.

Më ndonjë orë ditë lashë pritën ku isha fshehur dhe shkova u futa në kishën e vogël të Shënthanasit mbi një kodër. Çaplova nja dy degë të thata prej vidhave aty pranë dhe ndeza zjarr brenda në kishë. Në një qoshe gjeta një shishe me vaj ulliri. Vaji ishte krejt i ngrirë. Përzhi-ta bukën në zjarr, dhe e hëngra duke e lyer me vaj. Që nga muret, shenjtorët më shihnin drejt në sy.

Më vonë ndjeva këmbanat e kishës së Shënmëri-së që tingëlluan si në ditë shenjtë. Raha mëndjen, por nuk e gjeta se cila ditë ishte. Herë pas here hetonja nga dritoret e vogla të kishës. Pas dite vura re dy vajza që po aviteshin nga kisha. I njofta, ish Athinaja dhe Olimbija. E shoja zjarrin, dolla dhe u futa prapa kishës. Vajzat më vunë re, por nuk më njohën, se unë disi e fsheha fytyrën. Ato hynë në kishë dhe u falën. Nga lutjet e tyre kuptova se dje ishte dita e Shënthanasit. D.m.th. se sot fshatarët nuk ardhën, sipas zakonit; në këtë kishë, domosdo nga frika e ballit. Pastaj vajzat i ranë kishës për rreth, edhe unë ashtu bëra e ato nuk më panë dot. Atëhere dë-gjova kuvendimin e tyre:

- Moj e gjurë, kush do t'ish ay që doli nga kisha?
- Pa di dhe unë...
- Oi, moj e gjurë, kish ndezur edhe zjarr!
- Do këtë që në Shënthanasi!
- Oiii, mirë thua, ndofta është zemëruar që nuk me-shuam këtu.

Filluan të falen sërish:

- Të paçim uratën, o Shenjt, nuk ardhëm dot të me-shojmë këtu nga frika...

Kur u nisën vajzat të iknin, i ranë kishës edhe një hë-rë rreth e rrotull. Por tashti larg nga njëra tjetra. Tashti s'kisha si t'u fshihesha dhe më panë. Më mbytën me fjalë:

— Ç'kërkon të të sjellim, thuaj mos ki droje.

— Nuk dua asgjë, veç mos bëni fjalë në fshat se më patë këtu.

Kur ra nata, iu afrova fshatit. Takova një pioner në rrugë afër çezmes. E quajné Nasi. I vëllai i tija, Vasili, është partizan në Brigadën e parë. Nasi m'u vu pas. E mora me vehte, se diçka m'u shkrep në kokë. U nisëm në drejtim të Sulit. Atje qëndron një çetë e ballit.

Diku afër Shëntriadhës, nxora këpucët, ja dhashë Nasit dhe e porosita të më presë atje. Dëbora ishte e ngrirë kallkan dhe më mbante sipër. Afër Sulit vura re tri roje me nga një sopatë në dorë. Njërin e njoha, por këta nuk ishin ballistë. Ishin pleq nga familje partizanësh. Eshtë kjo një taktikë e ballistëve: venë roje pleq që kanë djemat partizanë dhe u mbajnë peng familjet në rast se nuk e kryejnë detyrën.

Në të hyrë të Sulit, nga meraja, janë disa gropa të thella ku nxjerin baltë për tulla. Sa për të dhënë alarm flaka një granadë në gropë. Krizma ushëtui e rëndë si prej gjylejë. Zbraza edhe gjysëm krëhëri të automatikut. Nga fshati qentë ulërinë me të madhe. Pleqtë hodhën sopatat dhe i thirën vrapit. Dëgjova thirje e urdhëra, sharje e shamatë. E pata bërë hesapin pa hanxhinë: nga dritoret e Sulit m'u qepën prapa batare të përsëritura. Flakët e armëve vetëtinin n'erësirë. U futa pas një hendeku. Zjarri i ballistëve nuk pushonte. Më ish e pamundur të nxirnja kokën nga hendeku.

— De, o hall, de! Unë vajta aty sa për një alarm dhe ja tashti ata, duke pandehur se u sulmuan, vërvitnin bataretë pa kursim. Gati gjysëm ore vazhdoi zjarri i tyre i çrregulltë. Pastaj qëndruan si në pritje. Atëhere i thirra vrapit përpjetë. Pioner Nasin e gjeta ku e lashë. Ish strukur pas ferrave.

— E, mo Nasi, u trembe?

— Jo, nuk u tremba, po ç'u bë ashtu?

— Ja, iu harxhova fishekët.

— Kot e ke, ata kanë boll fishekë, u jep gjermani sa i shesin edhe në pazar...

— Bravo Nasi, qënke qerata!

Po tim vëlla Vasilë a e ke parë ndonjë herë?

— Nuk e kam parë, po kam dëgjuar për 'të. Është mirë, mos kini merak.

Nasi më mori në shtëpin e tija. E ëma, një nënë e mirë dhe e dhëmbshur, më priti me gaz zemre. Më puthi e më përqafoi, më dha çorape të reja nga pajë e çupës dhe më arnoi xhaketën. Unë ngroheshja pas zjarrit kur ajo filloi një far vetkuvendimi:

— «Po djali im vallë ku është? A ja arnon njëri çorapet? A ngrohet pranë zjarrit? Do të të kumandar, o bir, si djalin tim e ma do shpirti që gjithë nënat të kujdesen për djemat që u trokasën në portë. Le të pushojë lufta, o zot, e të më kthehet djali shëndoshë... gjallë e me shëndet ashtu si u nis. U rëndua dimri o zot, të paçim uratën a Shënthanasi i sotmë. Po djali im i gjorë ku më ndodhet vallë? E mjera unë sa e mirë ishte koha kur u nis.»

Në mesnate u nisa pasi ma mbushën torbën me bukë. Nuk shkova rrugës e as monopateve. Mora përpjetë pas brigjeve e pllajave nëpër dëborën e lëmuar si xham. Ishte ftohtë, frynte thëllim dhe ulërinin bishat. Kur çeli agimi, dhe nga lindja zu të skuqeshin retë, arija në kalivet. Shokët flinin. Njeri rënkonte në gjumë. Sapo i zgjova, më pyetën:

— C'ish ay dyfek q'u bë në Sul?

— Dale të fle, pastaj iu tregoj.

— Solle gjë për të ngrënë?

— Solla një torbë me bukë e trahan dhe një shishe vaj nga Shënthanasi.

## 21 Janar.

Muarëm vesh se rreth njëzet partizanë të plagosur të Brigadës së katërtë ardhën në Dardhë. Ata u shoqëruan nga Dardha për në spitalet e partizanve grekë në Gramoz. Me 'ta shkoi edhe komisari i batalionit tonë.

## 29 Janar.

Sot në mëngjes herët ardhni në kalivet një «mushtulluk». Po flinim kur dëgjuam nga larg zërin e Koles:

- Sihariq oreee!!! Ç'do më jepni? sihariq!  
 U ngritëm rrëmbyer dhe dualëm përjashta.  
 - Ç'ka ngjarë, o Kole?  
 - Ç'do më jepni sihariq?  
 - Aman folë, pa kërko ç'të duash?  
 - Flisni, ç'do më jepni.  
 - Në qoftë sihariqi i mbarë do të të japim një trahan-hallvasi; jo po ndryshe do të t'i vëmë këmbët në rip të dyfekut...

- E para e punës: batalioni i ynë është shëndosh e mirë. Ndodhej në Dardhë dhe tashti zbriti fushës. Merrni edhe këtë komunikatë të luftës. Mbrëmë e suallën nga Korça.

E lexuam komunikatën: Ushtria e Kuqe ka çarë krejt rrethimin e Leningradit. Në Vlorë është formuar brigada e V-të partizane dhe në Përmet brigada e VI-të.

Këto lajme na gëzuan. Kolja e meritoi trahan-hallvasinë.

### 31 Janar

Muarëm vesh se ballistët kanë arrestuar shumë familje partizanësh. Midis tyre edhe familjen e Myzaferit dhe të Hamdiut.

Qysh në mëngjez dëgjuam krizma armësh tatëpjetë Devollit. U ngjitëm lart në majë të Moravës dhe hetuam me dylbi poshtë në Devoll. Koha ka qënë e kthjellët dhe dielli na vriste sytë. Bëhej luftë në Ponçarë. Nga shkëmbimet e armëve dhe mënyrat e luftimit kuptuam se batalioni i ynë kish rrethuar ballin në Ponçarë. Kjo na gëzoi.

Me gjithë presionin e madh t'armikut, me gjithë operacionet dhe forcat e shumta armike, batalioni i ynë përhidhet në sulm dhe bash në zëmër të fushës.

Në mbrëmje na ardhni lajmi se gjatë rrethimit ishin vrarë katër ballistë dhe ish plagosur një komandant i tyre. Shokët nuk kishin patur asnjë humbje. Rrethimi kish mbajtur tetë orë. Batalioni ishte tërhequr vetëm pasi i ardhën në ndihmë ballit shumë gjermanë dhe tradhëtarë.

## 7 Shkurt.

Me Ilon sot shkuam në Dardhë. Udhëtuam shumë ngadale sepse dhëmbja e gjurit po më shtrëngon përsëri të ec vëngër e çalë. Kishim shpresë të takonim batalionin tonë, por nuk e gjetëm. Takuam vetëm një njëzet partizanë, disa të sëmurë, të plagosur, rojet e depos dhe shokët e puntorisë së këpucarëve me Vaskën në krye. Biseduam me Vaskën. Ky më tha se forcat partizane, në gjithë anët e Shqipërisë, janë hedhur në sulm. Brigada e parë dhe e katërtë kanë qënë shumë aktive në qarkun e Beratit, Dangëlli e Zagori. Në Korçë ballistëve u ka hyrë grindja e krerët e tyre zihen midis tyre për postet dhe kolltuket. Secili prej tyre shpall vetëveten komandant të përgjithshëm dhe të plotfuqishëm. Në Boboshticë ballistët kanë rrëmbyer pesëdhjetëdy kafshë të samarit. Në qytet kanë arrestuar shumë njerëz se duan të zbulojnë teknikën nga ku dalin traktet dhe buletinet e luftës. Me gjithë arrestimet dhe vrasjet, komunikata e luftës del gjithënjë në rregull.

## 18 Shkurt.

Para dite vura re se po delte tymb i zi nga fshati im. Nuk e bëra të gjatë; rrëmbeva automatikun dhe u nisa tatëpjetë. Arrijta në fshat pas një dy orësh. Që nga larg e ndjeva të keqen se mbante erë shkrumb. Kur hyra në fshat, pashë se po digjeshin pesë shtëpi. Gjermanët e balli, pasi i kishin plaçkitur, u kishin kallur zjarrin. Në shtëpinë time ish djegur dyshemeja e një dhome, por gratë kishin mundur ta shuajnë mbassi kemi afër lumin e fshatit.

Hyra në shtëpi. Dukej si e shkretë. Orenditë mungonin të gjitha. Ballistët, duke plaçkitur kishin çkullur edhe kanatat e dritoreve.

Në dysheme gjeta librat e mija, fletoret e shkollës, çantën, rigën, një fotografi të nënës. Të gjitha të shkyera, të grisura, të shkelura me këmbë. Më tej, gjeta të thyer copë copë, djepin ku jam rritur unë.

U unja dhe i mblodha një për një. Sytë m'u mbushën me lot.

Im gjysh po më tregonte:

«Nuk na lanë asgjë. Të gjitha i muarën: bereqetin, turshitë, trahanin, bagëtinë. Si i duron Zoti këto? Ay sho-ku yt i vjetër Asimi, edhe ay ish me ballistët. Dhe ay ish më i ligu, ay qëllonte me kondak xhamet e dritoreve sa i theu një për një, ay i grisi librat e tua dhe midis tyre gjeti edhe një fletore të tijën...»

— Asimi?

Me 'të kemi qënë shokë e moshatarë. Me 'të kemi vajtur në shkollë, kemi shëtitur, ay ka fjetur këtu në shtëpinë time, ay ka ngrënë bukë këtu, ay ka qënë në dasmën e tim vëllai. Po si u bë kështu? Ç'far i futën në shpirt atij njeriu?

## 28 Shkurt.

Para disa ditësh janë nisur për në Skrapar njëzetepesë partizanë të batalionit tonë me Guçen në krye. Shkojnë atje për t'u inkuadruar në brigadën e shtatë që po ngrihet në Skrapar. Nuk na vjen mirë kur na ikin shokë, po ç'ti bësh? Kështu urdhëron Shtabi i qarkut megjithatë ne gjithnjë shtohemi, se na vinë vullnetarë të rinj.

Kohët e fundit skuadra e «Spastrimit» me Maqon në krye ka qënë shumë aktive në zhdukjen e spiunëve t'armikut.

Sot një kompania jonë u godit ne meraja e Sulit me një tufë ballistësh, që ishin nisur për në Bilisht. Pas qëllesave të para ballistët u thirën këmbëve dhe u mbyllën në Sul.

## 6 Mars.

Sot mora një copë letër nga Myzaferi. Më shkruante: «Në se ndjehesh më mirë, eja në Kalevisht; materialet që ke aty nisi për në Qytezë me njësitin e Bradvicës «ajo e shkrimit» na duhet shpejt.»

U ngrita, shtrëngova mirë këpucët, kallcet e dhirta, vājosa automatikun dhe u lashë shëndet shokëve që mbetën në kalivet. Makinën e shkrimit e futa në çantën e madhe

dhe e mora me vete; radiot dhe materialet e tjera do t'i sjellë Vasili e Kolja në Qytezë.

Koha është e mirë. Dielli ndrit e të verbon sytë nga reflektimi i rrezeve të tija mbi shtresën e dëborës. Një plak qymyrxhi, që e hasa në rrugë, më mësoj diçka që nuk e dinja e që më vlejti shumë. Plaku m'i kallaisi me blozë të zeze qerpikët dhe krejt rrethin e syve. Kështu bardhësia e dëborës nuk t'i vret sytë e më duket sikur kam syze dielli.

Arrija në Sinicë e vijova për në Qytezë. Këtu takova batalionin tim.

U përqafova me shokët dhe shtruaam fjalë. Ndjehem i gëzuar dhe sikur i kam shpëtuar ankthit që më rrinte për-sipër. Atje, në kalivet e Bradvicës, në çdo zhurmë të dyshimtë më ngrinte gjaku; kurse këtu «ku rënça mos u vrafsha» si të tjerët edhe unë.

Në mbrëmje u nisëm për në Vidohovë. Arijtëm me muzgun. Fshati na priti shumë mirë. Antarët e këshillit N.ÇI. të katundit ndodheshin të fshehur, po, me të mbrijtur ne, dualën e na ndanë nëpër baza.

## 7 Mars.

Sot është përvjetori i parë i luftës së Hoçishtit, ku ra dëshmor Fuat Babani. Me emrin e tij është pagëzuar batalioni ynë.

Dhe sot në këtë përvjetor të rëndësishëm për ne, batalioni i ynë ra në luftim me armikun.

Në agim u dha alarmi. Forca të shumta gjermanë, ermenë e ballistë kishin rrethuar katundet Menkulas, Ponçarë, e Braçan. Në Menkulas ndodheshin tre partizanë, që kishin shkuar atje, në familjet e tyre sa për t'u larë e ndruar. Komandanti i kompanisë, Bariu, mblodhi një njëzet partizanë dhe u gatit të shkojë si patrullë për të vështruar ç'po ndodh e mundësisht për të ndihmuar shokët që patën mbetur të rrethuar në Menkulas. Dolli urdhër që armët automatike t'u jepen shokëve të patrullës. M'u drejtua shoku im Koci nga Drenova:

— Nema mua automatikun tënd, mos ki merak do të ta ruaj si sytë.

Ja dhashë Kocit automatikun dhe e gjithë patrulla u nis në drejtim të pyllit përmbi Menkulas.

Unë mora pushkën gjysmë të gjatë të Kocit. Pas nisjes së patrullës, batalioni u vu në marshim në njësh kolonë. Pas një ore udhëtimi, hymë në katundin grek të Kalevishtit. Plani i komandës sonë dukej qartë:

Ta goditnim armikun që nga lartësija e Kalevishtit.

Kur dualëm ne kisha e Kalevishtit, vumë re se armiku kishte kapur gjithë pikat e larta që ndodhen gjatë kufirit grek. U hapëm në një vijë të gjërë në formacion luftimi. Borizan Mihalit rrinte nënë hajatin e kishës afër shtabit. Pas pak borija dha shenjën e sulmit. Zëri i saja përhapej valë valë dhe dukej i ashpër. Ashtu u vërsulëm përpara me thirrje e URR!

Nga armiku na ndante gadi një kilometër. Dhe gjatë kësaj kilometre vendi është pllajë, thuajse krejt i zbuluar. Vende vende dëbora kish shkrirë. U vumë nënë qitjet e armikut, i cili nuk e priste që ne të ndodheshim asaj ane. Armiku dinte se na kish të rrethuar në njërin nga të tre katundet, mbassi ish goditur me tre partizanët në Menkulas si dhe me patrullën e Bariut. Agjentët spiunë të ballit nuk kishin dhënë lajme krejt të sakta.

Ndodhesha afër me partizanin Koço e me Xhuzepen, kur një sërë plumbash na u vërsulën për rreth. Dhe plumbat nuk fishkëllonin gjatë si bëjnë ata që kalojnë larg, por na kalonin afër duke nxjerë nga një «fësht» të llah-tarisur.

Pa prituri Xhuzepja lëshoi një të sharë napolitane me derr e Shënmari.

— Mi hanno colpito sulla spalla! <sup>(1)</sup>

Lëshoi mitrolozin për tokë dhe hoqi më një anë robat nga supi i majtë. Plumbi i kish ardhur që nga poshtë, i kish shpuar një pjesë të supit dhe duke hasur në hekurin e mitrolozit (që Xhiusepja e kish mbi sup) i qe mbështjellë si një kërmill e i kish mbetur në lëkurë.

Ja nxora plumbin, por nuk kishim me se ta mjekonim. Ngrita zërin dhe thirra:

— Infermieri, këtu infermieri, Llambi! o Llambi!

(1) Më goditën në shpatull.





Fig.Nr. 5

Askush nuk m'u përgjigj. Shokët iknin përpara. Na u afrua partizani plak, Fehimi.

— Mos të ndodhet gjë raki o Fehim?

— Ku të gjesh raki këtu! Unju Xhusepe se do të ta mjekoj shqiptarçe.

Fehimi ja përmori plagën Xhusepes dhe ja pllakosi me duhan. Dhe gjaku i reshti. Ja lidhëm plagën me një copë pëlhurë të nxjerë nga këmisha dhe Xhusepja rrëmbeu sërish mitrolozin dhe bëri përpara. Këto ngjanë në disa çaste e shpejt e shpejt.

Pas një rendjeje të vrullëshme, me sulm arrijtëm afër pozitive të armikut. Gjermanët ishin tërhequr dhe kishin mbajtur veç një lartësi në drejtim të Bozhigradit. Në disa vende ishin zhvilluar luftime trup me trup. Gjatë një përlëshjeje të tillë ishte vrarë partizani Nesim Çeliku. Tashti vija e kufirit ishte thuar se në dorën tonë. Hodhëm

një sy poshtë Devollit: Forcat e gjermanve po e ngrinin rrethimin nga Braçani. Një grumbull prej tyre ishin mbledhur në buzët e lumit të rrëmbyer dhe mundoheshin ta kalonin. Mitralierët tanë i vunë në shenjë dhe i detyruan të shpërndahen.

Nga kundërsulmi ynë, gjermanët pandehnë se do t'i lëshoheshim qendrës së tyre në Bozhigrad; prandaj atje po i grumbullonin forcat e tyre.

U ndodha me disa shokë diku kundrejt Menkulasit, përmi Ponçarë. Po vërenim lëvizjet e armikut në xhaminë e madhe, kur një djal i ri, arrijti aty duke rendur. I qe marë fryma e mezi flitte.

— «Ballistët kanë mbyllur gjithë burrat e Ponçarës në xhaminë e fshatit dhe u kanë lënë dy orë të mendohen. Pas dy orëve duhet t'u lëshojnë një deklaratë të përbashkët, me anën e së cilës duhet të zotohen të luftojnë kundër partizanve dhe të pranojnë armë nga gjermanët.»

«Kaqe tha djaloshi nga Ponçara. Dikush e pyeti:

— Po ballistët ku ndodhen tashti?

— Ja, tha djali, ja ku po rrinë ne ay lëmi i madh përpara fshatit.

Kur hodhëm vështrimin andej, pamë një tabor ballistë që po silleshin posht e lart. Petro Boboshtica ktheu andej mitrolozin dhe u dha një batore. Ata u shpërndanë.

Më vonë muarëm vesh se rojet balliste që mbikqyrnin burrat e Ponçarës në xhami, ishin trembur nga batoreja e mitrolozit tonë dhe kishin ikur. Ponçarasiit kishin patur rast të dalin nga xhamija dhe të marrin vrapin jashtë fshatit.

Vumë re se në Menkulas, ne sheshi para shkollës, ndodheshin një dhjetë gjermanë. Males i ardhi një ide e marrë:

— A nuk u vërsulemi?

— Po lumin si ta kapërxejmë?

— Po ne zbresim gjer ne lumi, pastaj shohim e bëjmë.

Ideja ish vërtet e marrë. Filluam ta vemë në zbatim pa lejën e komandës dhe me iniciativën tonë. Për pak desh e lamë kokën të gjithë.

Sapo u nisëm pllajës tatëpjetë, dëgjuam disa plasje në Menkulas. Askush nga ne nuk e mori dot më mënd se ç'ishin ato plasje, por ja në çast e kuptuam.

Në Menkulas gjermanët kishin lënë mortajat e tyre të rënda me pak ushtarë, duke e pandehur Menkulasin prapavijë të luftimeve. Ne tashti po u delnim nga një anë që ata nuk e pandehnin. Ushtarët e mortajave nuk kishin patur pushkë e mitroloza veçse nga një revolver. Kështu që na e vërvitën me gjylet e mortajave të rënda. Predhat e tyre të para shkuan diku larg dhe ne, n'atë zhurmën e përgjithëshme të luftës, nuk i vumë re; po kur arijtëm në një rëzim me pak dëborë, tre gjyle shungulluan bash në mes tonë. Për fat të mirë predhat e mortajës afrohen me ngadale dhe fishkullojnë nga larg. Ne ishim shtrirë njësh me tokën dhe tymi i plasjeve mend na verboi. Sapo nisëm të ngrejme kokën, na u vërvitën predha të tjera. Ishim në rëzim përball armikut dhe nuk kishim se ku të mbroheshim. U ndodha i shtrirë pranë Males dhe pata kohë t'i them:

— Kaqe e patëm, o Male!

Dhe mbetëm të shtrirë afër njëri tjetrit duke pritur «predhën tonë».

Një copë baltë e nxehtë m'u përplás pas faqes dhe zverkut. Ish nga balta që spërkatnin gjylet duke gërmuar tokën e qullur. M'u përvëlua zverku e faqja sa edhe pëllëmba që e përdora për ta hequr baltën.

Vendi kundërmonje barut dhe një si erë leckë të djezur. Si duket gjermanët, nga tymi, nuk po shihnin dot në ishim gjallë a vdekur dhe e ndaluan zjarrin. Atëhere, me shpirt ndër dhëmbë, i thirëm vrapit përpjetë nga kishim ardhur.

E pabesuarshme por e vërtetë:

Askush nga të dhjetë shokët e «inisiativës personale» nuk ish goditur. Pëtrua ma leu zverkun me vajin e mitrolozit dhe e lidha me një copë këmishë.

Gjermanët filluan qitjet përsëri, por ne ishim larguar.

Ndërkohë forcat tona po luftonin me armikun që vazhdonte të mbajë pikën strategjike në drejtim të Bozhi-

gradit. Vonë, afër mesditës, dëgjova andej zhurmë e brohori: shokët e kishin detyruar armikun të largohet edhe prej andej. Hollësira mbi atë luftim ardhi e na tregoi Endri e Lefteri. Ishin të mbytur në baltë nga koka në këmbët. Na thanë se luftimet mbaruan n'atë krah dhe armiku ish tërhequr plotësisht. Endri më tregoi se është vrarë, qysh në mëngjez, shoku ynë Koci Drenova, ay që unë i pata dhënë automatikun. Humbjet e armikut nuk dihen me saktësi. Disa flasin për 25 të vrarë, disa për 20.

Në mbremje u kthyem në Kalevisht dhe Këshilli i EAM-it na ndau në baza.

## 10 Mars.

Myzaferi dhe Maqua më thirrën dhe bashkë u nisëm për në Qytezë. Batalioni ndodhet në Dardhë. Gjatë rrugës na ndodhi një e papritur:

Ishim duke kaluar përmbi Vidohovë, kur na zu syri një njeri të veshur me roba të zeza shajaku, që po kalonte nga Greqia në tokën tonë. Në krahë mbante një torbë. E ndalua dhe i folëm të afrohet. E pyeti Maqua:

— Prej nga je?

— Nga Bozhigradi, — u përgjegj ay duke u dredhur.

— Ku ke qënë?

— Isha në Gramoz, bënja pishë.

Dhe vërtet torbën e kish të mbushur me spica pishe, por Maqua nuk e besonte kursesi. Iu kërcënua me revolver:

— Fol kush të ka dërguar këtej e përse të ka dërguar?

Ay zu dridhej dhe heshtete si mehit.

— Amani, o vëllezër, se nuk di gjë të keqe.

E kontrolluam mir e mirë, por nuk i gjetëm gjë të dyshimtë. Duheshin hapur sytë mirë, se armiku dërgon shpesh spiunë pas gjurmave tona. Maqua iu vu sërish:

— Ç'thua, more katran, këtej kërcet pushka gjithë ditën e ti na paske dalë për pishë! folë, përse ke dalë? se të vrava...

Të panjohurit i shpëtoi shura. Atëhere më ardhi keq dhe dolla «jallan shahit»:

— Lere, o Maço, se e njoh unë këtë, është i biri i filanit, ka kushëri filan partizan.

Të panjohurit i ndritën sytë. Kështu bëra e kështu ngjau, por unë gabova e mora një mësim të mirë:

E lëshuam të panjohurin. Mirëpo, sa u largua nja dyqind çapa e ariji në majën e një bregoreje, u kthye nga ne e thirri me të madhe:

— A më hani m... orece! — Dhe ja dha vrapit tatë-pjetë.

Maqua u bë si i prishur mënç. Nxori revolen e ma vuri ne goja:

— Ti e ke faqin që e lëshuam, si thua tashti?

S'po e mernja vesh në tallej apo e kish me gjith mënd.

— Eh i humburi, — thashë me vehte, — shiko kur të më vrasë me të vërtetë. Sidoqoftë Maqua kish të drejtë.

I fola Myzaferit:

— O shoku komisar, i ka mëntë ky, o?

Komisari zu qeshte. Me një të qeshur përzjerë me inat.

Bëmë një copë sher me Maçon. Më tej u pajtuam.

Në të hyrë të Qytezës takuam një italian të shoqëruar nga njësitë i Sinicës. Italiani ka qënë partizan dhe më vonë iku e thuhet se ka qënë agjent i gjermanve në Korçë.

Në Qytezë hëngrëm bukë dhe mjekova me vajpeshku qafën e djegur përmbi Menkulaş. Materialët e teknikës i kishin sjellë nga Bradvica djemat e njësitit. Komisar i me urdhëroi që materialet t'i ngarkoj në dy mushka të batalionit që kemi këtu. Pastaj u nisëm për në Dardhë. Mua filloi të më punojë mëndja për atje:

«Atë vajzën pa tjetër se do ta takoj. Po sikur ta ndreq të vete bazë në shtëpinë e saj?»

Afër një ure të vogël mbi Sinicë bëmë qitje me pushkë. Myzaferi dhe Maqua e qëlluan shënjën tre herë me katër të shtëna. Unë munda ta qëlloj vetëm një herë. Pastaj ata nxituan të shkojnë përpara, se mushkat mezi ecnin nëpër monopatën me dëborë. Unë mbeta prapa.

Kur mbrijta ne kthesa e Rahut më dolli Dardha përpara. Zemra zu më rihte shpejt e me nxitim. Zu binte llohë. Filloi të fryjë veriu. Ujrat e jazit mezi ndiheshin. Fshati, i mbështjellë me dëborë, dukej i qetë. Disa njerëz qëronin çatitë e rënduara nga dëborë. Oxhakët tymonin. Fëmijët e shkollës koloviteshin me saja mbi akuj. Monopatet e ngushtë e ndanin katundin në qindra ngas-tra, Vendosa të hyj në fshat nga rruga që e ka shtëpinë «ajo». Kur iu afrova çezmës, qëndrova. Aty po mbushte ujë një vajzë, po cila ish nuk mund ta dallonja, se lloha binte gjithënjë dhe era ngrinte lart cikërima dëborë. Pastaj m'u desh të ve dorën mbi zemër... ne çezma po mbushte ujë AJO. Po, ishte ajo me faqet e kuqe, me syt e zinj, me llërët e bardha!

Iu afrova dhe zumë dorë. Unë e humba, edhe ajo jo më pak.

Zuri me pëllëmbë sulinarin dhe i ndaloi ujrat që bënin zhurmë:

— Si ke shkuar?

— Ç'ka, nuk keq...

— Unë gjithënjë kam pyetur për ty.

— Unë nuk kisha se kë të pyes, veç kam menduar shumë për ty.

Kështu guxova dhe i thashë dhe unja kryet. Ajo hoqi dorën nga sulinari dhe ujrat gumëzhinë me potere.

— Do ma thuash ç'ka më ke premtuar?

— Akoma jo.

Desha në atë çast të isha si dikur. Pa armë në krah, pa bomba në brez, pa shqetësime, të isha në punën time, të ishte paqe. Dhe le të ish dimër, le të binte dëborë si tani, le të frynte veriu, le të buçisnin malet. Veç vrasës dhe të huaj mos kish në tokën tonë. Atëhere po. Nuk do t'isha i turpshëm si tashti, nuk do kisha droje prej asaj. Por me gojë, me zë të ngritur, me të thirrur do t'i sulesha asaj: Unë të dua dhe ti më do, e kam lexuar këtë në sytë e tu.

Po tashti jo. Tashti nuk mundem.

Të dy stomnat e saja kish kohë që ishin mbushur me ujë. Ajo i kapi dhe i ngriti peshë. Pandeha se desh t'ikë,

por. ajo nxituar e çapkëne, pasi hodhi sytë për rreth shpejt e vjedhazi, i derdhi stomat në postaf.

Desh t'i flisnja edhe më, desh të rrinja akoma, por nuk mundesha. Se mund të vinin njerëz e të na shihnin të dyve si të mekur e mëndje humbur.

— Mir u pafshim.

— Të na vish nga shtëpia.

— Do të vij.

Dhe u largova pas mushkave.

Vajta në bazën e komisarit dhe e thirra. Dolli bashkë me kryetarin e këshillit. Komisari iu drejtua Janit:

— Për këtë shokun, mundësisht të gjeni ndonjë bazë ku mos ketë shumë njerëz. Të ketë vënd për fshehjen e materialeve, në rast nevoje, dhe ahur për mushkat.

Jani filloi të mendohet, unë ndërhyra:

— Këtëj poshtë gjëkund.

— Ashtu?

— Mundësisht. — Zëmra më hidhej si zog i kapur në leq.

— E gjeta, — tha më në fund Jani. Dhe duke iu drejtuar Gjolekës që ndan partizanët në baza:

— Përpara Gjolekë, në shtëpinë e Laços.

Nuk u besova veshëve të mij.

— Ku?

— Në të Laços, përsëriti Jani.

Kur arrijta në baza ime, Joana dolli në porta. Dhe duke hequr llozin e hekurtë, duke çelur kanatat, duke nënëqeshur ajo, mëndja ime po fluturonte larg. Hyra n'oborr. Ndofta për të hyrë e dalë gjithënjë. E ëma më prití me shumë përzëmërsi. Meqënëse bën ftohët, më mbajtën të rri në dhomën e tyre ku kanë stufë. Vura makinën e shkrimit mbi tryezë dhe materialet e tjera i vendosa në një dhomë lart. I vëllai i Joanës, një çun n'ja tetë vjeç, më rri në prehër dhe më kërkon revole e kalla-midhe.

Në mbrëmje më ardhí komisarí. Nga fytyra e tij e qeshur kuptova se po sillte një lajm të mirë.

— Ç'kemi, shoku komisar?

— Mbrodh i kemi punët. Pranvera po vjen e mbarë. Në Dunicë të Mokrës Brigada e parë dhe batalioni «Re-shit Çollaku» kanë asgjësuar bandën e madhe të Haki Biloshmit. Kanë kapur pesëqind robër bashkë me të gjithë krerët e ballit të asaj ane. O burra të nxjerim një komunikatë...

Vura në makinë një letër dylli dhe unja shiritin. Komisar i diktonte, unë shkruanja. Mbassi shkruam mbi luf-timet që bëme pardje, shtuam edhe lajmin mbi zhdukjen e bandës së Haki Biloshmit, dhe më poshtë shtuam një koment të vogël. Me anën e shaptillografit tonë të thjeshtë përgatitëm treqind kopje.

Dhe këto janë botimi i parë i teknikës së batalionit «Fuat Babani». Mbasi do të mbetet në histori që sot me datën 10 Mars, nën dritën e një llambe me vajguri, këtu në këtë shtëpi të vogël ku Theodhori po lot me macen e më kërkon revole e fyshekë, filloi e mori rrugë botimi partizan i batalionit «Fuat Babani».

Tashti natën, ndërsa po shkruaj në ditar, ardhën këtu tetë partizanë. Komisar i dorëzoi komunikatat tona dhe i nisi për t'i hedhur tinëz në dyert e ballistëve nëpër Devoll.

Partizanët janë zgjedhur më të shëndoshët, pasi rruga është e gjatë dhe e vështirë. Dëborë po bie gjithënjë. Malja është përgjegjës i grupit që do niset. Vetë ky është shumë i shëndoshë, i gjatë dhe trup-ngjeshur. Megjithë lodhjet e ditëve të fundit, as do t'ja dijë fare. Koken e mban lart dhe ajo fytyra e tij e gjërë me qime të verdha, rri e qeshur dhe e qetë. I foli:

— Dësh e lamë lëkurën atje mbi Menkulas, o Miale.

Ay qeshi dhe m'u përgjegj.

— Tjetër herë duhen hapur sytë mirë xhanëm, po ti si vete më qafën?

— Më shqetëson nga ca, por do të kalojë.

## 11 Mars.

Në mëngjez u kthye Malja me shokët që u nisën për në Devoll. Malja e Guçja ardhë këtu në bazë dhe i rapor-



tuan komisarit: ishin futur në Baban dhe Stropan pa u diktuar fare. Komunikatat i kishin ngjitur në ato dyer ku kish ushtarë të ballit brënda. Malja kish hyrë edhe në shtëpinë e tij në Stropan. Atje njerëzit e tija i kishin treguar se balli e ka marrë vesh ngjarjen e Dunicës dhe ballistët janë bërë si mora të përvëluar.

#### 15 Mars.

Mësova një lajm shumë të hidhur. Shoku im Seçi është vrarë në luftën e Dunicës kundër ballistëve të Haki Blloshmit. Seçi ishte në Brigadën e parë. Me të kemi që në shumë shokë që në ditët e vështira të luftës së Leskovikut.

E kujtoj tashti fytyrën ezmere të Seçit, ata syt e tij të zinj dhe aqë të gjallë, e nuk më besohet se ay ka vdekur. Kur të ndodhem në Hoçisht, do të vete në shtëpinë e tij për ngushëllim.

#### 18 Mars.

Dje dhe sot, partizanët dhe fshatarët e Dardhës e të Sinicës, po hapin një monopati nëpër deborë gjatë xhadesë Dardhë-Boboshticë. Rastësisht dëgjova Myzaferë dhe Maqon që po bisedonin. Nga biseda e tyre munda të kuptoj se priten të vijnë këtu disa forca të Brigadës së katërtë partizane. Si duket shtabi i përgjithshëm e vështron si kritike gjendjen në Devoll për shkak të zonës së ngushtë dhe sulmeve të armikut. Monopati që po çelet duket si një kanal nja tre metra i thellë. Udhëheqësit e batalionit, që janë duke punuar edhe ata, diçka përshtetërisht midis tyre, por të gjitha pyetjeve që bëjmë ne, mbi hapjen e monopatit, ata nuk u përgjigjen. Pas dite ardhë nga Devolli një informator i ynë. Tregon se gjermanët dhe balli po përgatiten për të na goditur në zonën e Dardhës.

#### 19 Mars.

Mbrëmë, pas mesnate, me dy shokë isha roje nga ana e xhadesë së Boboshticës. Komisari, duke ma vulosur

si të fshehtën më të madhe, më tha se do të vinë mjaft shokë të Brigadës katërtë dhe duhet patur kujdes gjër n'agim.

Retë ishin të zeza dhe mugëtinte dobët. Era frynte si e marrë me suferimë dhe tutje përrrenjve ulërinin bi-shat. Të mbuluar me guna të vjetra, me armët poshtë, venim e vinim nëpër monopati. Vonë, pas mësate, ndjeva lodhje dhe u shtriva mbi dëborë sa për t'u çlodhur. Shokët harbonin duke përpjekur këmbët. Ngadale, pa ditur, pa dashur, pa e ndjerë m'u ulën qerpikët, m'u var koka, veshët nuk më dëgjonin, më mori gjumi. Sa kohë mbeta ashtu?

Pastaj disa si spica ngrice po më gryenin ijet, një dridhmë e thellë po më sillte në vehte. Një nga shokët më foli:

— Ej, çou!

U ngrita. Renda mbi dëborë, nofullat më dridheshin sa nuk i mbanja dot. Kisha një pagur të vogël me raki. Ma pat dhënë Joana. E hoqa nga brezi dhe nuhata me hundë grykën e pagurit, hodha pak raki në duar e pastaj e ngrita ne goja. U ndjeva më mirë dhe fillova të rend gjatë monopatit për t'u nxehur.

Më lindi një dëshirë e brëndëshme: Desha të mendoj diçka gazmore, diçka pa ngricë, pa dëborë, pa suferimë, pa luftë. Dhe e lëshova imagjnatën t'ime:

«Zbrita poshtë fshatit ne shtëpija e vogël bri rrugës, ne Joana. Ish një ditë e bukur pranverë. Kumbullat kishin lulëzuar, bletët zukatnin, hardhija kish lëshuar bisqe dhe nga degët e saj, të krasitura ridhte lëng i kulluar; në fund t'oborit mbi lëndinën e vogël kullotnin dy shqera të bardha, me lesh të butë; më tej, ne koka e pusit, midis karafilleve të kuqe cicëronin zogat. Qielli ish i kulluar, dielli e kish mbytur oborin me dritë dhe që tej nga pylli rënkonin millonjat e reja. Dhe lufta kish mbaruar. Isha gjallë; gjallë dhe shëndoshë. Ne shtëpija e vogël bri rrugës nuk hyra më fshehur dhe me droje. Hyra drejt e brenda si njeri i shtëpisë, si të kisha qënë aty kush e di sa herë. Joana ish n'obor, ish krehur me kujdes

dhe faqet i ndritnin. Qeshi e gëzuar dhe më vështroi ashtu si nga hera me kryet pak më nj'anë.

— E shikon, — më tha, — e shikon? Lufta mbaroi dhe nuk mbete rrugëve të saj, sa mirë. Po kur do të martohemi? Nëna pret t'i thuash ditën.

Dhe unë qesha, i lumtur, i gëzuar.»

Po vallë vetëm unë thur ëndëra të tilla? Shokët e mij a nuk janë të rinj edhe ata? Po ata shokë që u vranë? A nuk kishin edhe ata ëndërat e tyre, shpresat e tyre? Sigurisht që po. Edhe ata patën vajza që i pritnin, edhe ata patën menduar për të ardhmen e tyre. Por lufta, përpjekja e çlirimit vdekja, i rrëmbeu ata. Kështu mund të kujtoj shokun tim Seçin. Atë Seçin tim të mirë që ra dëshmor në Dunicë. Dikur ay më pat çelur zemrën: «Kam një vajzë në fshat» më pat thënë Seçi, «një vajzë flokverdhë me sy të mëdhenj. E dua shumë, edhe ajo më do. Shpesh vinim fshehur në vreshtët dhe shtritur pas hardhive putheshim e thurnim ëndëra. Ajo më do shumë dhe nuk di përse mallëngjehet aq shumë kur takohemi dhe zë qan. E kemi lidhur fjalën me besa besën...»

— Po kur vemi në Hoçisht, a e takon, o Seçi? — Kështu e kisha pyetur unë.

— E takoj posi; disi fshehur, po takohemi. Unë druhem ta zgjat, por ajo më uth e më përqafoi si e marrë.

— Po ti?

— S'do mënd, edhe unë. Do t'a marr grua sapo të mbarojë lufta.

Dhe Seçi më pat treguar emrin e vajzës, fotografinë dhe një tufë flokë të verdhë nga gërsheti i saja. Po ja tash-ti Seçi nuk rron më dhe ajo vajza flokverdhë atje në fshat e ndjen thellë në zemër humbjen e tij.

Prandaj është më mirë që unë të hesht. T'i ndrydh ndjenjat e mija dhe mos i them Joanës asgjë nga ato që kam përgatitur kushedi sa herë. Sa fatkeqe do të jetë ajo sikur të më ngjasë gjë mua! Ja, nga ana e Bigllës nuk po dëgjohet zhurmë, shokët që presëm mbase nuk do të na vinë dot në ndihmë. Armiku kërkon të na zhdukë, kërkon t'i djegë bazat tona. Dëborë po bije gjithënjë, rrugët

janë të mbyllura, dimri çfryn si i tërbuar. Përpara na presën luftra dhe përpjekje. Ne jemi vullnetarë dhe duhet të luftojmë. Askush nuk na detyroi të ndjekën rrugën e malit, ne vetë e zgjodhëm këtë. Pas lufte, pas çlirimit, qofshim gjallë e shëndoshë, do të fillojmë jetën tonë të re...»

Shokët e rojes m'u afruan. Njeri më foli ngadale:

— Po ndjehet zhurmë.

— Mos të buçasin veshët?

— Jo. Po deshe shtriu dhe ver veshin mbi koren e dëborës.

U shtriva. Vërtet ndihej një zhurmë e mbytur.

— Sidoqoftë duhen hapur sytë, mund të jenë edhe trupa t'armikut.

Qëndruam në pritje. Më tej zhurma u bë m'e fortë. Çapet goditnin rëndë sikur shkelnin mbi copra xhami. Pastaj u dëgjua një zë:

— Ooo Nuni! Zere mushkën, mushkën se po prjer!

— Mos ki frikë, mos ki frikë, e ka qenglën të fortë!

— Këta duhet të jenë shokë, foli një nga rojet. Zemra filloi të më rihete nxituar. Fytyrat na u kthjelluan, i ngri-tëm kokat lart. Pastaj zëra të njohura:

— Më mban erë patate të pjekura...

— Më mban erë turshi e zjarr.

— Na e paskan çelur rrugën pun' e madhe.

— Sikur kanë hapur kanal.

— Ngadale se shkava.

— Nuk të thashë t'i zbatësh këpucët!

— Me kujdes se do takojmë rojet e batalionit.

— Hë more, mos ki droje.

— Duan parullën ata.

— Dhe ne ja u japim.

Tri hije u dukën mbi dëborë. Ish pararoja.

— Ndalt, parullën!

M'at'anë një zë i nxituar:

— Pushkë! Kundërparullën.

— Prita!

Nuk u mbajtëm dot dhe u vërsulëm.

— O Nuni!!!

U puthëm dhe u përçafuam, por ata çapin nuk e ndalnin. Ishin të ngrirë si akull. Prapa vinte njësh kollona e batalionit me shtabin e brigadës.

— A ka bukë në Dardhë?

— Sa të doni!

— Po zjarr?

— Sërët e druve rënkojnë!

Batelli dhe Vangjua u sollën nëpër fshat gjer në mëngjez duke ndarë në baza miqtë e posa ardhur. Shokët «miq» janë dy batalione të brigadës së katërtë. Njëri nga batalionet përbëhet prej devollinjsh me Zijanë në krye. Këta janë tërë qejf dhe (me hak e kanë) rinë pak si foddullë e sikur na shohin nga lart. Me 'ta ka ardhur edhe teknika e brigadës me shokët Mihallaq e Volter. I bashkuam tryezat me shokët e sipërmë dhe punojmë bashkë. Sot ata u muarën me botimin e gazetës së xhepit të njërit batalion, kurse për të gjithë brigadën kanë ndërmend të nxjerrin një revistë. Natyrisht ata janë më në gjëndje se ne nga çdo anë, kanë më shumë shokë që meren me shkrime, kurse ne jemi një batalion teritorial që «milet» regullisht sa herë formohen brigada të reja. Dhe po të mos «milej» batalioni i ynë, pa tjetër që ne do ishim bërë dy brigada më vehte. Zona jonë vërtet është e ngushtë, por ajo është plot jetë e sulm në luftë kundër armikut. Edhe në ditët më të vështira të operacioneve gjermane, në batalionin tonë vinë vullnetarë të rinj.

## 21 Mars.

N'agim u zgjova nga krizma armësh. Çela dritoren dhe vura veshin: Bashkë me jugun që po çkrin dëborën ushëtojnë edhe plasje gjylesh. Korierët që ardhë në Dardhë tregojnë se batalioni i ynë mbrëmë natën, duke hyrë në Vidohovë, është goditur me gjermanët. Lufta ka qënë e shkurtër mbassi forcat gjermane ishin të shumta dhe të pajisura me artileri dhe mortaja të rënda.

Shtabi i brigadës, që ndodhet në një shtëpi këtu afër,

dha urdhër që gjithë partizanët të dalin ne Shkëmbi i Shënpjetrit. Burija dha shenjën e alarmit.

Kur arrija ne Kodra e Vogël, takova dy partizanë të batalionit tim. Më treguan se ishin tërhequr nënë pre-sionin e fortë të armikut. Gjermanët, pasi kishin push-tuar Qytezën dhe Sinicën, tashti drejtoheshin për në Arë-zë dhe Dardhë. Në borigat e Vidohovës kishte rënë në luf-tim partizani Mazllëm Karaskaqi.

Rreth meje partizanët po nxitonin në drejtim të Ko-rijes së Madhe. Atje dukej që luftonin disa forca të ba-talionit tim. Predha e gjyle po gjëmonin nga gjithë anët. Me hyrjen në luftim të forcave të brigadës, përparimi i armikut u ndal. Filloi atëhere artileria gjermane të që-llojë më zjarr të pa ndërprerë. Dikush zbriti nga Shkëm-bi i Shënpjetrit dhe tha se forca të tjera gjermane po i afrohen Dardhës nga ana e Kamenicës. Ja, atëhere ndje-va një farë frike dhe dyshimi. M'u duk se gjermanët do të na shtrydhnin fare. Me Endrin dhe Vaskën, duke u zvaro-sur me shumë kujdes, u ngjitëm në vijën e frontit në kulmin e Korijes së Madhe. Shpejt e nxituar hodha një sy nga vija e armikut. Gjermanët ishin të maskuar dhe nuk dukeshin fare. Veç qëllonin me armët e rënda. Si duket përgatinin sulmin. Afër meje ndodhej dhe Lefte-ri. Më tregoi se një skuadër e jona, sot n'agim, ishte tër-hequr në panik nga Vidohova në Janoven. Shoku para-shikoi se komandanti i skuadrës do të nxiret para gjyqit.

Tashti forcat gjermane ndodheshin në një fushëzë të vogël që shtrihet midis korijesh gjatë rrugës Sinicë-Arëzë. Prapa nesh, ne Shkëmbi i Shënpjetrit, filloi të gjëmojë mitrolozi. Si duket gjermanët ishin afruar edhe andej. Pastaj vura re disa lëvizje të forcave tona që m'u dukën të çuditëshme: Nj'a dyqind partizanë po zvarose-shin pas krahëve të gjermanëve nga ana e kufirit grek. Dhe kjo ngjiste në një kohë kur plumba mitrolozi po na arrinin në që nga ana e Kamenicës.

Disa djem nga Dardha na suallën katër thasë me pa-tate të pjekura në vënd të bukës. Njëri nga djemtë më thëriti me emër. U shkëputa nga shokët dhe iu afrova.

Ay mbante në dorë një pako mbështjellë në një picetë të bardhë.

— Mere këtë, — më tha, — e ke nga ajo...

— Nga kush more?

— Nga e zonja e shtëpisë, Athinaja.

E mora pakon. E dërgonte Joana me dorën e së jëmës. E zgjidha shaminë. Brenda kish ushqime: bukë të bardhë, patate të pjekura, djathë e dy kokra mollë. Më poshtë ish një shami e bardhë dhe brenda saj një shënim i vogël. E shkruante «ajo».

«Shoku... Në shtëpi jemi shumë merak mcs të ngjase gjë. Ki mëndjen. Mamaja ndezi kandilen dhe po fallet për ty. Plumba e gjyle po vijnë gjer në fshat, por unë kam dalë në dritore dhe vështroj andej. Të fala, Joana.»

E lexova letrën dhe harrova të ha bukë.

Një varg fshatarë nga Dardha po iknin me nxitim në drejtim të Slimnicës, duke menduar se gjermanët do të hynin në Dardhë.

Pas një pushimi të shkurtër të artilerisë, armiku filloi sërish të qëllojë, po këtë herë me mortaja të rënda. Dhe këtë radhë predhat na qëllonin ne që ishim pranë armikut. Zjarri i tyre vazhdoi gadi gjysmë ore, pastaj u pre. Po fill atëhere filloi sulmi i trupave të armikut. Që nga përrenjtë ndënë ne u shkëputën njësitë e sulmit me automatikë krah-qafë. Na u vërsulën duke qëlluar, ndërsa mitrolozat Sharës nuk na linin të ngrinin kokën. I pashë gjermanët me sy: trupmëdhenj e të shkathët nxirrnin disa thirje t'ashpra. Dhanë e muarën, qëlluan me bomba, e grinë dushkerën me mashinka, por ne qëndruam të patundur dhe me shpirt ndër dhëmbë. Dhe fill atëhere kur gjermanët nisën të kthehen në pozitat e tyre, u dha sinjali i sulmit tonë. Borizanët e brigadës i dhanë zjarr gjendjes me britmat luftarake të borive; thirjet ushëtuan an' e mb'anë. Pa dashur e pa ditur flokët m'u ngritën përpjetë. Ashtu u lëshuam në sulm duke i sharë dhe mallkuar me rrënjë e degë, me sojë sorollop. Armiku nuk u tund. Atëhere filloi një përleshje e gjakëshme

trup me trup. Me syt e mij pashë Tosunin, një intendent të brigadës, që ishte mbërthyer me një gjerman të madh sa një ari, dhe po vërtiteshin për jetë dhe vdekje pas një rëzimi me akuj. Një shok u vërsul mbi 'ta. Ishte Vaska. Ky ja lëshoi gjermanit me nagant në kokë, po aqe afër sa Tosunit iu dogjën vetullat nga flaga e revolverit. Nga gjithë anët filluan të skuqin mbi dëborë vatra me gjak. Pas një dëllinje të madhe na doli përpara një gjerman me duart lart. Ndënë këmbët e tija kish mitralozin e shkatëruar. Dhe gjermani pranonte ta rrihnim ose ta vrisnim, oo kursesi të ndreqte armën që vetë e kish prishur. Pas pak armiku filloi të tërhiqet në panik. Ne u vërsulëm pas tyre në një ndjekje t'ethëshme dhe t'egër.

Diku afër shkallëzës së Qytezës, gjermanët që iknin nëpër xhade u këthyen prapësht, u suallën vërdallë të çoroditur për disa çaste pastaj disa u hodhën poshtë në lumë e të tjerë nisën të ngjiten me këmbë e duar pas rëpinës së kodrave mbi xhade. Rruga e madhe ne Shkallëza e Qytezës u mbush me armë e municione të hedhura nga armiku. Atje vura re tre mitroloza Sharës prej atë superautomatikët e llahtaritur. Aty kishin lënë dhe tri mortaja të rënda, disa pushkë, municione dhe kapota. Nuk kuptonin çfarë po ngjiste. Nga e djathta e jonë, pas disa kaçubash, nxuarën kokat nj'a dhjetë partizanë. Na u hodhën për qafe dhe na shihnin në sy.

Ishin t'asaj skuadrës që ishte tërhequr në panik në mëngjez nga Vidihova. Pra këta u kishin dalë përpara gjermanëve që tërhiqeshin dhe i bënë të sillen vërdallë te shkallëza e Qytezës. Midis tyre ishte një andart grek. E quajnë Kapedan Jani. Ky u takua me një komisar tonin dhe i foli:

— Ja këta janë ata fajtorët e Vidihovës, fajin e kanë bërë, m'a thanë edhe mua, e pranojnë. Unë dal shahit se këta e lanë fajin, luftuan si burrat, këtu i kopanisëm gjermanët sa hodhën armët e nuk dinin nga të iknin.

Pyeta një nga ata shokët:

— Po si u ngjau në mëngjez, brë burra?

— Pa dimë edhe ne? Ashtu pa dashur, pa ditur, u tru-



llosëm, e humbëm toruan, zjarri i armikut ishte i pa pritur dhe i tmershëm.

Ndërkohë ndjekja vazhdonte. Një aeroplan i madh, i zi si katran, uturiu mbi kokat tona. Si duket desh të mbulojë tërheqjen e armikut. Pastaj zhgarkoi bombat që ranë me fishkëllima kërcënonjëse diku afër Qytezës. Po sa çudi! Asnjë nga bombat e rënda që hodhi aeroplani nuk plasi.

Nga gjithë anët kisha afër partizanë të brigadës. Ata tonët ishin në ndonjë sektor tjetër. Isha me Mihallaqin e tekrikës kur na thiri Myzaferi. Ky ishte me shtabin e brigadës dhe dëgjova që bënte fjalë për mua.

— Ja, ky partizani i di mirë rrugët për andej, — iu tha atyre.

Shtabi i brigadës më urdhëroi:

— Ti me Mihallaqin dhe me Volterë do të merni në dorëzim karvanin e kapur armikut dhe do ta shpini në Slimnicë, do t'u japim edhe një letër për komandantin e EAM-it andej. Do të rini atje në gadishmëri dhe në urdhërin tonë të parë do të ktheheni prapë.

U nisëm të marim në dorëzim karvanin. Ishin tri-dhjetë e gjashtë kuaj e mushka ngarkuar me armë e municione. Në fushëzën ku u zhvillua beteja, gjetëm edhe dy flamurë gjermanë. Disa partizanë po grumbullonin armët e hedhura nga armiku nëpër hendeqe.

Muarëm rrugën drejt Slimnicës, duke kaluar nëpër fushëzën ku u bë lufta. Pas një hendeku vura re tre ballistë të vrarë. Më tej shtriheshin kufomat e gjermanëve.

Fillova t'i nëmëroj po më ish e pa mundur, se shpesh herë barrët e kafshëve prinin, mëtej këpuqej cengla, më tej trëmbeshin e hingëllinin kuajt. Me ne vinin edhe disa fshatarë nga Bilishti, që ishin marë angari nga gjermanët.

Lamë më të djathtë Arëzën, pastaj Nikolicën, duke ecur gjithënjë pas lumit Devoll. Pastaj bëmë nga e majta dhe hymë në tokën greke.

Që kur u nisëm, unë gjeta një pelë me shalë ngarkuar me hejbe. Këto i hodha mbi samarin e një mushke dhe vetë i hipa pelës. Po kështu bënë dhe Mihallaqi

me Volterë, por kafshët që hipën ata, ishin me samar. U grindëm një copë herë se ata kishin pretendime për pelën t'ime me shalë, por unë ngula këmbë duke u kujtuar se ato ndodheshin në teritorin e batalionit tonë. Kur hyëm në tokën greke, ata sërish e ngritën çështjen e pelës.

Ndjeheshim të lodhur pas një dite aqë të vështirë. Unë isha në krye të karvanit me që dinja rrugët, ndërsa shokët rrinin prapa. Rruga ishte e keqe, monopati i ngushtë, vende vende ish mbyllur me dëborë. Veriu çfrynte si i tërbuar dhe malet e Gramozit buçisnin nga tërsëllima e erës. Por kafshët u ndodhën të shëndosha dhe sa herë që binin mundnim dhe i ngrinim përsëri.

Isha duke u kotur mbi pelën, mjekrën e kisha ngulur mbi gjoks, fytyrën mbuluar me kapuç dhe kafsha ecën pas qefit. Pa prituri ndjeva zhurmë e brohori përpara. Ngrita kryet: Një pllaskat e dëborës pashë një grumbull të madh andartësh të EAM-it që po vështrojnë nga ne me gaz e me kuresht. Ishim më të hyrë të Slimnicës. Kur u afruam një dyqind metra dikush nga ata dha një urdher. Pastaj ra burija. Si dukej po gatiteshin të na presën me nderime ushtarake.

Bobo, thashë me vehte, po tashti?

Ngrita kokën lart, u krekosha mbi shalën dhe i thira Mihallaqit:

— O Mihallaq, hajde përpara se e humba!

Mihali me Volterë ngarendën. Tashti ishim të tre përpara karvanit. Mihalë e morëm në mes. Partizanët grekë ishin radhitur në të dy anët e rrugës.

Sapo u afruam, dëgjuam komandën:

— Për nder arm!

Po kalonim në rivistë. Më tej qëndruam dhe zbritëm nga kuajt. Një komandant i EAM-it na përsëndeti me një fjalim të shkurtër; edhe ne iu përgjigjëm ca me gojë e ca me dorë. Pastaj na u lëshuan andartët. U puthëm dhe u përqaftuam. Një mustaqe kacaros i mbledhi shokët dhe ja thiri këngës së vjetër:

**Alvanites palikarja**

**Me spathja qe me hanxharja...!**<sup>1)</sup>

1) Trima shqipëtarë  
Me thika e hanxharë

I çgarkuam kafshët diku afër kishës dhe i grumbulloam materialet në një lëmë. Atëhere patëm kohë të shohim çfarë kishim kapur. Përveç tre mortajave të renda kusuri ishin arka me fishekë, bomba dore dhe predha mortaje. Shumë armë të tjera, pushkë e mitroloza kishin marrë shokët që vazhdonin ndjekjen e armikut. Midis të tjerave në plaçkën e luftës gjetëm edhe katër valixa me tesha pajrash të rrëmbyera nga armiku në Qytezë.

Disa grekë dinin përdorimin e mortajave gjermane. Muarën lejë nga ne dhe i montuan. Vunë shenjë një pishë në Gramozin kundrejt dhe qëlluan. Predha goditi mirë. Një komandant i EAM-it na tregoi se disa nga granadat e kapura gjermanit kishin gurë çakmaku në vend të barutit. Çelëm një granadë dhe i ndava gurët. Më tej më ndaloi komandanti i andartve të hap granada të tjera.

Afër mbrëmjes unë shkova në Qytezë të shpije vali-xet e plaçkitura nga armiku.

## 22 Mars.

Mbrëmë arrija në Qytezë me një dy orë natë. Passi takova komisararin tim, i shpura valixat në zyrën e këshillit të katundit Atje u thirën dy vajza që ishin zot malli mbi valixat dhe ua dorëzova. Më falënderuan dhe nxorën më dhanë nga një palë çorape deveje me vija të bukura, nga ato që mbajnë gratë e këtyre anëve. Shkova në një bazë. Atje gjeta dhe tre partizanë të brigadës dhe Xhiusepen tonë. Ky më tregoi se e kishin ndjekur armikun gjer tej Bozhigradit. Aty kishin kapur trofë edhe një top të gjermanit, një karo me ushqime, mitroloza të lehtë dhe pushkë. Armiku ish tërhequr edhe nga qëndra e tij e Bozhigradit. Shokët ishin futur atje, kishin dashur të hyjnë nëpër shtëpitë se bënte ftohtë, por banorët e lidhur me ballin nuk u kishin hapur portat. Komanda kish dhënë një urdhër të çuditshëm:

«Mos hyni me forcë, hiqemi në Qytezë dhe nesër në mëngjez, kthehemi prapë...»

Ndërsa po bisedonim me Xhiusepen, pa pritur na hyri brënda një partizan e kërkoi të ngrohet. Në dritën e zjarrit e vura re, e njohta dhe i foli:

— Ti, Petro, je?

Ay rrahu nxituar qerpikët dhe m'i nguli sytë.

— Po ti kush je?

— Po le unë, po ti ç'je kështu?

— Le, o lere, e pësova keq sot n'agim.

Petrua hoqi kapotin. Dhe ta shihnje Petron të vinte keq. Veshja e tij ishte një thes i zakonëshëm me vrima të çelura atje ku kish futur kokën dhe duart. Veç kapota që sapo nxori ja mbulonte mishrat. I hapëm vënd në zjarrin e na tregoi:

Në agim ndodhej në Qytezë dhe i kish dhënë robot për t'i larë. Pastaj ish dhënë alarmi. Për shokët e tij ishin gjëndur roba të tjera, kurse ai kishte gjetur atë thesin dhe qe lëshuar tatëpjetë. Gjer në mesditë kish nderjetur me thes dhe më tej kish kapur një kapotë gjermane.

Kur po dëgjonte këto, Xhiusepes i ndritën sytë dhe kërcëu përpjetë. Ai kishte parë aty afër një ballist të vrarë me xhakëtë e pantallona të reja. Ia tha këtë Petros dhe u nisën të dy bashkë.

Pas pak u kthyen me një palë roba shajaku. I vunë t'i terin pas zjarrit, se ishin qull të lagura. Atëhere hyjnë atje dy gra të shtëpisë. Njëra e mori fjalën:

— Bini të flini juve se jeni të lodhur, pa ja u terim neve.

Ashtu bëmë. Por sa vumë kokën në jastëk, një nga gratë bërtiti dhe i lëshoi robot për tokë. Kishin vënë re se robot ishin të qullura me gjak.

Rashë të fle edhe unë pas shokëve. Shaminë e bardhë që më dërgoi Joana e shtrova mbi jastëk dhe aty vura faqen.

Sot në mëngjes një kompani partizanësh shkoi të hyjë në Bozhigrad. Sapo ish afruar e kishin goditur nga dritoret forcat e ballit. Si duket do të jenë kthyer natën. Disa nga ne pëshpëritin:

— Ama urdhër na dha komandanti dje. T'i kishim shqyer portat nuk do të hanim më plumba në Bozhigrad. Më duket se kanë të drejtë.

Afër mesditës komisari më urdhëroi të nisem për në Slimnicë dhe të shpijem në Dardhë «xhepanet» e gjermanit. Komisari më tha të hetoj ndonjë vënd të përshtatshëm për të ngritur teknikën e batalionit.

Vajta në Slimnicë, Partizanët grekë na ndihmuan të ngarkojmë materialet dhe afër mbrëmjes arrijtëm në Dardhë. Këtu mësuam një lajm të hidhur. Komandanti i njësitit të Sinicës shoku Bajram Islami është vrarë sot nga një gjerman i plagosur që kish mbetur në një përrua.

Bajrami kishte kaluar atje rastësisht dhe pa ditur se ndodhej gjermani. Një rob gjerman, me gradë resh-teri, e kish kapur dje partizani Niko.

Natën ardhi dhe një lajm i çuditshëm: një gjerman, gjatë tërheqjes së djeshme, ish fshehur në një shtëpi në Sinicë dhe që futur në tavan. Plaka e shtëpisë ish ankuar në këshillën e katundit se i kishin vjedhur dy le-venxe, një jorgan, dy jastëkë dhe disa çyrekë bukë. Më vonë, si që zbuluar dhe vrarë gjermani në tavan, ishin gjetur edhe sendet e plakës që i pandehte se ja kishin vje-  
dhur fshatarët.

Në mesnatë ardhi një korier nga Devolli. Ay tregoi se armikun e kish kapur data për grushtin që hëngri dje. Korieri tregoi se në Gjyres, një ditë më parë kish vajtur një çetë balliste. Ata kishin marrë djaloshin 15 vjeçar Oresti Bilbilushi dhe e kishin vrarë në një vënd të fshehur pa lënë gjurmë.

## 24 Mars.

U ktheva përsëri në bazën time në Dardhë. Sapo nxora këpucët dhe nderja pranë zjarrit, Joana dhe e ëma filluan të qeshin.

— Ç'kini që qeshni?

— Jo, nuk kemi gjë, qeshim ashtu...

— Po më thoni përse që të qesh edhe unë.

Më në fund mora vesh se ato qeshnin me çorapet e bukura që kisha mbathur.

— Po ku i ke gjetur ato çorape?

— M'i dhuruan dy vajza në Qytezë.

— Kot do t'i prishësh, — më foli e ëma e Joanës, — ato janë të holla, po deshe të jap unë dy palë çorape leshi të reja dhe m'i jep ato me lule.

— Mirë, me gjith qef.

— Ty mor bir nuk të duhen të këtilla, — fliste nëna e Joanës, — këto janë për t'i veshur me kostum dardhar, unë do t'ja ve Joanës në pajë.

Më shkrepri një mendim në kokë: Sikur një ditë vonë, mbase pas vjetësh, paja e Joanës me gjithë këto çorape të vijë ne mua?

Pas dite me Mihallaqin dhe Volterë po bisedonim mbi luftimet e ditëve të fundit. Më vonë mbaruam komunikatat mbi luftimet në zonën tonë dhe pastaj u hap një bisedim që vajti larg...

Bisedonim mbi një shok, i cili para disa ditësh, në luftën rreth Vidohovës, ishte trembur dhe duke u tërhequr me atë skuadrën për të cilën kam shkruar më 21 Mars, kish hedhur pushkën. Më vonë për të mbuluar dobësinë e tij kish gërvishitur ballin dhe e kish lidhur me një vandak banda, gjoja si i plagosur, Kjo çështje po përshpëritet nër partizanët.

Dhe ne sot, si të ngeshëm, shkrojtëm në makinë një «urdhër dite» ku me humor dhe plot thumba vinim në lojë shokun frikaman. Ç'është e drejta, unë kam një respekt për atë shok, se është djalë i zoti dhe me kulturë, por kushedi se si u ndodh asaj dite. Dhe kështu mbassi shkrojtëm atë farë «urdhër dite» më kokën tonë dhe për ta lexuar vetëm midis nesh, i vumë poshtë firmat.

Mihallaqi u vetë quajt «Mareshall» dhe ne me Volterë «Çirak gjeneralë». N'atë kohë ardhni Maqua.

— Si jeni, o shokë, si vini?

— Mirë, të paçim sa malet; ç'kemi o Maço?

Ay i hodhi një sy «urdhërit të ditës», e lexoi, qeshi një copë herë dhe e futi në xhep. Ne u ngritëm të alarmuar.

— Aman, na e jep se do ta grisim.

Po ku merte vesh ay!

Iku tatëpjetë shkallëve duke qeshur.

Pas gjysëm ore na thirën në Shtab. U bëmë pik e vrer sa për të lidhur buzën. Vajtëm. Trokitëm në derë.

— Hyrë!

Mihallaqi përpara, ne me Volterë pas, hymë.

Sapo vumë këmbët brënda, komandanti foli me ironi:

— Ku je «Mareshall» Mihallaqi ku je!!!

Ne me Volterë rrinim prapa Mihallaqit si mijtë prapa poçes.

— Ç'kini bërë kështu? Ç'janë këto turpe? Prandaj shtrihi gjithë ditën atje? Po juve, more pa dilni përpara! Ç'janë këto që bëni?...

— (Ja që e bëmë shoku komandant, gabim është, e pranojmë.

Fytyrat e anëtarëve të Shtabit rrinin të mvrejtura. Vallë ç'dënim do na jepnin?

Foli njëri nga ata:

— O Myzafer, pa lexoje edhe një herë.

Myzaferi, serioz dhe tërë inat, fillon ta lexojë. Të tjerët rrinin mvrejtur. Ne kokë unjur. E mirëpo sa vajtji aty nga mezi i «urdhërit të ditës», dikush që nuk e mbajti dot ja plasi të qeshurës. Dhe e qeshura është sëmurdje ngjitëse. Të qeshet aty ku nuk bën të qeshësh. Kështu shkrepri gazi në të gjithë. Ne na dridheshin buzët, por dhëmbët nuk i çelëm. Ndofta e qeshura i hodhi zjarrit ujë dhe shpëtuam me një vërejtje verbale për t'i hapur sytë tjetër herë.

### 3 Prill.

Muarëm vesh se forcat e tjera të brigadës së katërtë që veprojnë në Rëzën e Korçës, janë përpjekur me gjermano-ballistët në katundin Melçan. Pas gjashtë orë lufte partizanët e kanë ndjekur armikun gjer në post-blokun e Korçës. Në fushën e luftës armiku ka lënë njëqind të vrarë dhe një major të dekoruar me fletë-lisi.

#### 4 Prill.

Afër mesditës një skuadër e brigadës së katërtë ndodhej në Boboshticë. Në atë kohë ishin duke hyrë në fshat një varg ballistësh me komandant Dervish Bejon. Partizan Gjeli e kish marrë në shënjë Dervishnë dhe e kish shtrirë për tokë. Sot balli me forca të mëdha, nën mbrojtjen e artilerisë gjermane, kish hyrë në Boboshticë dhe i kish vënë zjarrin gjithë fshatit.

Ata kanë vrarë dhe disa njerëz, kanë plaçkitur dhe kanë çnderuar vajza.

#### 6 Prill.

Dje u larguan nga Dardha në drejtim të Fushës së Korpës partizanët e brigadës katërtë që ndodheshin ndër ne. I përcuellën gjer në Bigëll. Sikur të mos ishin ata në sulmin gjerman të ditëve të shkuara, fati i batalionit tonë dhe i katundeve të malësisë nuk mund të merret me mend. Para se të iknin, Stavri më kërkoi «hua» njëqind fletë dylli për shaptilograf. Unë nuk i dhashë, por kur kontrollova gjëndjen sot, vura re të njëqind fletët më mungonin. Në vënd të tyre gjeta këtë shënim: kërkvoja; nuk t'i dha, merrja se nuk thotë gjë.

Me shokët e brigatës së katërtë shkoi edhe partizani i ynë italian Xhiusepe Pinjatale me gjith kitarë. Na bëri dëm Xhiusepeja se është djalë trim, plot jetë, gjallëri e këngë. Melodive napolitane u ka sajuar vargje partizane dhe nuk ngopesh duke e dëgjuar. Gjithashtu sot dualllen nga Dardha dhjetë vajza vullnetare dhe shkuan në brigadën e katërtë.

Mbas dite u mblodh gjithë batalioni në shkollën e Dardhës. Ndjehehim të dëshpëruar nga ikja e shokëve të brigadës së katërtë. Komisari na foli për luftimin e datës 21 Mars. Pastaj u bënë vrejjet dhe mësimet që duhen nxjerrë nga veprimet luftarake të ditëve të fundit.

Në fund komisari bëri thirje për të ndjekur shëmbujllin e partizanëve të brigadës së katërtë. Fjalimi i tij ishte gjithë zjarr e flakë.



## 19 Prill.

Shkova në Hoçisht. Me këtë rast vizitova familjen e shokut tim Seçit që u vra në Dunicë në ditët e para të Marsit. Më priti e ëma. Ish veshur e tëra me roba të zeza. Nuk më njihte dhe po më shihte në sy se çfarë do t'i thosha. Po kur më pa të trishtuar iu ronitën lotët.

— Mbahu nënë, Seçi na la, po ne kurrë nuk do ta harrojmë. Gjaku i tij nuk do të shkojë kot.

U gëlltit nëna e gjorë, ngritit kryet lart, më përqafoi e më shtërngoi fort ndër krahë.

— Më rrofsh, mor bir, të kam në vënd të Seçit.

— Kemi qënë shokë me Seçin, bashkë rrinim gjithënjë. Kur e kujtoi, më djeg në shpirt. Lufta i ka këto, ne nuk do ta lëmë kurrë rrugën e tij.

Në mur ishte fotografia e Seçit e rrethuar me një vual të zi. Seçi atje dukej i qeshur, me ata sytë e tij të zinj plot jetë.

M'u kujtua e dashura e Seçit, për të cilën ay më kish hapur zëmren. M'u kuituan gjithë ëndërat dhe shpresat e Seçit, m'u kujtuan fjalët e tij për vajzën lesnverdhë, për dashurinë e tyre, për takimet në vreshtët... Zëmra m'u drodh dhe sytë m'u mbushën me lot.

Pas dreke u largova nga shtëpia e Seçit shumë i dëshpëruar. E ëma më përcolli duke qarë. Më dhuroi nje këmishë të Seçit. Unë nuk desha ta marr, por ajo nguli këmbë:

— Merre, për shpirtin e Seçit!

## 20 Prill.

Një komunikatë e ardhur sot nga Korça njofton:

Forcat gjermano-balliste kanë sulmuar katundet Alarup, Bradomirë e Podgori. Njësitë partizane në atë zonë i kanë pritur si duhet dhe armiku është tërhequr duke lënë gjashtëdhjet të vrarë, dyqind e shtatëdhjet robër dhe afro njëqind të plagosur. Janë kapur treqind pushkë, tetë mitroloza të lehtë, dy të rëndë dhe dy mortaja. Nga ana e jonë ka mbetur i vrarë komisari trim Andon Xoxa dhe dy partizanë të tjerë.

Kjo është pranvera jonë. Gjermani u mundua të na zhdukë me ndihmën e dimrit. Por dimri kaloi. Tashti është radha e sulmeve tona.

## 21 Prill.

Më thiri komisari dhe më urdhëroi të mbledh gjithë materialet e teknikës dhe të shkoj të instalohem në Slimnicë. Nuk më ardhi mirë të lë Dardhën, por urdhëri është urdhër. Me mua ardhi edhe partizani Pandi që është elektriciist dhe radioteknik.

Ngarkuam tre mushkat me makinat, radiot, bateritë dhe disa materiale që na i dërguan për teknikën shokët e Korçës. Midis tyre ka disa rulemanë, ripa transmisioni, pulezho, llampa elektriku të vogla, acetoni, letër të bardhë e bojë shaptillografi.

Shkuam me Vaskën nga Joana dhe u lamë shëndet.

Në Slimnicë këshilli na caktoi bazën në fshatari Jani Pisho. Na lëshuan një dhomë të madhe në katin Iart. Dhoma është shumë e mirë me tavan drasash e mban erë-pishë. Kundrejt nësh duken pisha e ahe shekullorë. Më këtej buçet lumi Belica. Njerëzit e shtëpisë na sillen shumë mirë. Jani e di mirë shqipen mbassi e ëma është shqiptare prej Qyteze. Vëndësit këtu janë Sllavo Maqedhonas. Burrat e thyer në moshë dinë shqip.

## 22 Prill.

Gjithë ditën kemi punuar rëndë. Mullisi i katundit Mihali (që është nip shqiptari) na lejoi të ngrejmë një farë centrali të vogël për të mbushur bateritë e radiove. Hapëm një jaz të vogël mb'anë jazit të madh. Më këtej ngritëm një kade në dërrasa dhe mullisi na bëri një sop. Pastaj ngritëm krevatonë ku vendosmë pendën dhe dinamon. Kisha sjellë nga shtëpia ime një pendë të vogël dhe një dinamo automobili. Dinamoja na vlejti, por penda jo. Sotua nga Dardha na bëri një pendë druri të mirë Afër-mbrëmjes bëmë proven. Punë na dëlli mbarë. Penda sillët për bukuri me vërtitje të shpejta dhe pa xhioko. Pulezhua f'shton xhirot dhe dinamua lëshon korent. Vendosmë aty një bateri dhe e lamë të mbushet.

Herët në mëngjez vajtëm ne centrali ynë. Vazhdonte të punonte. Bateria ishte mbushur me korent dhe me anën e veglës automatike e kish shkëputur lidhjen me dinamon. I gëzuar e hodha në sup baterinë dhe nxitova nga fshati. Rruga e kthimit është thikë përpjetë, baterija është e rëndë dymbëdhjet voltëshe, por unë jam tetëmbëdhjet vjeç dhe më duket e lehtë si pendë. Ngritëm antenën e radios dhe pastaj çelëmë aparatit. Është një «Condor» me pesë llampa, punon për bukuri. Filluam të kapim stacionet. Nga Moska marim lajmet në italisht, nga Londra e Bari shqip. Edhe radio Bostoni jep një emision shqip herët n'agim. Vjen zëri valë valë dhe një shqiptar i vjetër ja jep fjalën komentatorit me këtë frazë karakteristike:

— «Tashti jastëkun e fjalës do ta marrë Zoti Drizari...»

Gjithashtu, sa për kuresht, dëgjojmë edhe radio Tiranën me pallavrët e ballit e të Staraveckës, të zotërinjve Mitrovica e të tjerë. Pas mbledhjes së lajmeve sot muerëm komunikatën e parë. Partizanët e plagosur. Nafisi e Ahmeti, më ndihmojnë. Unë shkruaj në makinë dhe ata më diktojnë dorëshkrimin.

Në mëngjez ardhni këtu edhe puntoria e partizanve këpucarë me Vaskën në krye. Janë edhe Llambi, Gaqua e Kaleshi.

U vendosëm të gjithë në një shtëpi tjetër dhe filluam nga puna. Ata punojnë këpucë të reja, gjerdhane fishekësh, pajime për kafshët e ngarkesës dhe meremetojnë këpucët dhe opingat e grisura të partizanëve. Drekë hëngrëm bashkë: përshesh me dhallë në një legen. Pas dite ardhën këtu edhe disa shokë të sëmurë. Kështu ngritëm një spital të vogël. Infermiere punon Vasilika, një shoqe e terenit nga Korça. Një mjek grek ardhni sot dhe vizitoi të plagosurit dhe të sëmurët. Na premtoi se do të vijë nga-hera. Tre nga shokët e shtruar në spital janë me këmbë të ngrira. Midis tyre është edhe një partizan i ri kosovar me emërin Dragush.

Na u bë barku dhallë. Mëngjez, drekë e darkë asgjë tjetër përveç përsheshit t'uruar. Sot n'agim, ardhni këtu komisar i batalionit dhe kontrolloi spitalin, puntorinë dhe teknikën tonë. Më dorzoi edhe materialin e gazetës së babatalionit që duhet ta daktilografoj në pesëdhjetë kopje. Që në mëngjez e mbajtëm radion çelur. Komisar i dëgjonte buzëqeshur. N'orën dhjetë kapëm Moskën dhe u dëgjuan tingujt e orës së Kremlinit. Kur do ikte komisar i folëm për ushqimin e të sëmurve. I treguam se edhe ata si ne, ushqehen me dhallë.

— Por nuk u dha para intendentit? pyeti komisar.

— Jo, shoku komisar.

— Po dhallën me se e blini?

— Po ja, disa vëndës vinë dëgjojnë radion dhe na sjellin nga një poçe dhallë. Edhe këpucarët diku bëjnë ndonjë meremet të vogël, po shumë rallë, se fshati është shumë i varfër.

— Mirë, tha komisar, do t'ju dërgojmë para, veç i shpenzoni me kujdes.

Ahere mora kurajo dhe i fola:

— Shoku komisar, ne mund ta sigurojmë vetë ushqimin, veç të na lejoni...

Ay u vrejti.

— Si do ta siguroni vetë?

— Po që se dalim e kapim ndonjë kondrabandist....

— Ashtu? po mirë. Po kapët, nuk është keq.

Dhe pastaj:

— T'i lëmë lamtumirë njeri tjetrit. Ndofta nuk shihemi më.

— Pse?

— Transferohem. Nesër largohem.

U puthëm dhe u përqafluam. Na ardhni keq për ikjen e komisarit tonë. Kur e përcuallëm gjer jashtë fshatit, ay nuk tha se në vëndin e tij mbetet komisar shoku Faik.

Shpirti i shtegtimeve më ka nxitur gjithënjë. Dua të bredh e të shoh vende e njerëz të panjohur. Gjatë jetës partizane kam bredhur mjaft, por nuk ndjej të njëjtën përvojë.

Sot në agim u nisa me Gaqon në drejtim të Gramozit për të kapur ndonjë kondrabandist.

Midis EAM-it dhe Lëv. N.Çl. është lidhur një marrëveshje e përkohëshme që mallrat e ndryshme të kalojnë kufirin me dijeninë e të dy palëve. Mirëpo ka edhe kondrabajtës që e shkelin rregullin dhe hyjnë e dalin fshehur me mallra. Këta janë kondrabandistët që ndjekim ne.

Me lindjen e diellit kapërxyem urën e madhe mbi lumin Belica dhe vijuan në drejtim të majave të Gramozit. Ky mal ka qënë dhe është për mua një vend i mbushur me kuresht. Në tregimet e pleqve tonë, sa edhe në përallat e gjysheve, Gramozi zë një vend me rëndësi.

Rrugës hasnim barinj e druvarë dhe prej tyre mësonim rrugën. Këtu ndër këto pyje shekullore mund të humbasish fare shpejt sa mos ta gjejnë as nishanin.

Mbasi kaluam katundin Zagar, dualëm në disa livadhe dhe kapërxyem sërish një bryll të lumit Belica. Më tej rruuga filloi përpjetë pas një shpati shkëmbor. Pas një dy orësh arrijtëm në katundin Gramoz. Është gjithë gërmadha e kalive prej druri. Veç kisha është e paprishur. Në pllajtat e pafund të Gramozit dukeshin tufat e mëdha të dheneve. Aty këtu kish edhe kope me kuaj e mëza. Çobanët rrojnë si nomadë dhe kalivet e tyre janë të rrumbullakta dhe prej thekërishte.

Duke udhëtuar në drejtim të perëndimit, arrijtëm në Qafa e Kazanit. Këtu vendi është plot me istikame të thellë mbetur nga lufta italo-greke. U afruam në një stan. Çobanët na vështruan me dyshim duke na pandehur për ballista. Na dhanë gjalpë e qumësht pa bukë. Morëm rrugën përpjetë. Këmbët na shkëlnin butë se pllajtat janë të shtruar me bar të vjetër. Mbasi kaluam përkrah disa piramidave të kufirit, dualëm diku mbi Bezhanin e Kolonjës sipër staneve të Milecit. Q'atje dukej gjithë Kolonja: Erseka, Borova, Boshanji, Qafëzezi më tej Kurtesi e Qafa e Dëllinjës.

U futëm në një istikam të vjetër dhe ndejtëm në pritje. Pas nja pesë minutash vumë re një njeri që po rrithej nga stanet e Milecit në drejtim tonë. Kish hedhur një kcop mbi supat dhe mbi të kish mbështetur dorën. E lamë të afrohet. Pas tij po vinte një grup tjetër me katër mushka të ngarkuara. Ardhën për në prita e jonë, vështruan një herë anembanë dhe kapërxyen kulmin e Gramozit. Atëhere dualëm dhe i qëndruam. Ata ngrinë në vënd. I kontrolluam mir e mirë të katër mushkat ishin të ngarkuara me shollë, me semenca, me cigare, çorape grash e karamele me mjaltë.

Më poshtë i lëshuam dy kontrabandistët dhe u mbajtëm mushkat e ngarkuara. U nisëm në drejtim të Slimnicës.

Poshtë, diku afër një burimi të madh, takuam një oficer t'EAM-it. E gostitëm me karamele dhe me dy paqeta cigare. Pas tij ardhni edhe një çoban plak. Ish trupgjatë, shpatullgjër e faqe kuq. Shqipen e fliste për bukuri. Kështu, u bëmë katër udhëtarë dhe vijuan tatëpjetë. Rruga kalonte anës Belicës nëpër shkëmbinj të bardhë e të kuq. Më tej na u lodhën mushkat dhe i zhgarkuam në një pllajë. Shtruam fjalë.

Oficerin e quajnë Taqi, çobanin Mihal.

Mihali na tregoi se dikur, në kohën e Turqisë, shteg-tonte me dhentë në kullotat dimërore të Myzeqesë. Pas-taj ktheu kokën pas shpatit të malit dhe na tregoi një grumbull gërmadhash. «Atje», tha Mihal, «ka qënë fshati shqiptar Vertenik, më tej janë gërmadhat e Zagarit dhe të Linotipit, edhe ata fshatra shqiptarë.»

Nuk më përton këmba kur është fjala për të parë diçka që më tërheq. Iu afrova gërmadhave të Vertenikut. Ishin gati duke u rafshuar; gurët e zinj kishin zënë myshk. Pas faqes së një muri shihej një dollap, më sipër ish va-rur një pishtar hekuri, pas oxhakut dukej një zinxhir kllaniku. Një grumbull ploçash ishin pas një burimi. Do kish qënë çezmë. Më punoi mëndja dhe për një çast i mbylla sytë. E m'u bë Verteniku një fshat i madh e i begatshëm me kroje shumë, me kopera, me kopështe, me

shtëpi të mëdha, me burra të fortë, me gra e vajza mble-  
dhur ne kroi i madh.

Kur u ktheva ne shokët, Mihali po tregonte si u shpëtua  
dhe u shkretua Verteniku, Zagari e Linotipi. Mu  
dridhej buza. Taqi kuptoi shqetësimin tim dhe më  
dorën:

— Perazmena ksehazmena... (1) Paskëtaj do të jem  
fqinjë të mirë.

Mihali e ndroi bisedën. Poshtë shtrihej lugina ku bu-  
çet Belica. Mihali më dha një fill dhe zura të hetonja.  
Po, vërtet, lumi diku gjatë rjedhës futej në tokë. Pyeta  
Mihalin:

— Po ku del pastaj?

— Del një a pesëqind çapa më poshtë.

Zbrita tatëpjetë nëpër pishat. Shkela lëndinën mbi  
rjedhën e lumit. U shtriva dhe vura veshin pas tokës, mbi  
bar: ndihej një buçitje e shurdhër e, ujrave të nënëdhesh-  
me. Ngrita kokën lart. Nga e djathta e rjedhës ngrihej  
lart një shkëmb thik përpjetë me gurë të thepisur. Ish  
i lartë nja dyqind çape.

Kur u ngjita ne shokët, Mihali më tregoi një «histo-  
ri» mbi shkëmbin e madh.

«Historija» e tij ish një legjendë:

«Shumë vjete të shkuara, pashaj i vendit kish parë  
një çupë të bukur në Vertenik dhe kish dhënë urdhër  
ta dërgonin në harem të Sulltanit. Vajza kish qënë shu-  
më trime. Tre ditë e tre netë i ishte falur Shëngjergjit  
që ta shpëtojë. Dhe ky mbrojtës i vashave të bardha dhe  
virgjëreshave jetime, i kish dalë krah. Një mëngjez vajza  
e bukur ish ndodhur në një sofat në mes të shkëmbit.  
Koshadhet e turqve me lutje e premtime i kishin folur  
të ikë prej shkëmbit me ndihmën e një litari q'i patën  
hedhur. Po ajo nuk pranonte. Kish vendosur të vdesë atje.  
Me zor e kishin zvarosur nënën e saj që t'i lutej të zbre-  
së, por nëna sypatrembur i kish thirur:

«— Më mirë vdis atje se të mbetesh pa nder...»

(1) Të shkuara të harruara.

«Dhe vajza vdiq atje. Kockat e saja janë edhe sot e kësaj dite në mes të shkëmbit.

Kështu tregoi Mihali. Dicka si skelet dukej vërtet në solati në mes të shkëmbit. Po kur hodha vështrimin më dytë nuk shquajta gjë të saktë.

Mbasi u çlodhën mushkat, i ngarkuam dhe muarëm rrugën. Afër mbrëmjes arrijtëm në Slimnicë.

## 29 Prill.

Sot ngarkuam mushkat me paqetat e cigareve, çorapet dhe një pjesë të karameleve. U nisa t'i shpije në Dardhë. Kalova nëpër Qytezë e Sinicë. Diku në rrugë takova rininë e Dardhës që vinin në një miting që do mbahej diku në Devoll. Me 'ta ishte edhe Joana. Qëndroi me Noin dhe shkëmbyem pak fjalë. Desha ta zgjatim muhabetin por isha bërë flagë nga fytyra dhe u largova.

Në Dardhë takova një pjesë të batalionit. Intendentit i dorëzova mallin. Ky kish dijeni mbi marëveshjen që patëm bërë me Myzaferin dhe më dha një sasi gjalpë, fasule, patate dhe gjizë. Më dorëzoi dhe njëmijë franga për spitalin e Slimnicës. Dikush nga shokët më hodhi një fjalë:

— Veç këto karamele kapët?

— Ka edhe të tjera, i thashë, po deshe ngjitu Gramozit se i gjen.

## 5 Maj

Mora një lajm të hidhur. Ballistët më datën tre maj kanë hyrë në Zicisht dhe kanë vrarë gruan 55 vjeçare Nërënxa Petra. Kanë djegur shtëpinë e Llambit dhe pastaj kanë bërë plaçkë nëpër fshat. Kur i thanë Nërënxës se ku ndodhet i nipi (Llaqi Zicishti), ajo u ish përgjegjur:

— Ju jini trima të plaçkës, ja ku është ay atje në mal, shkoni se u pret si u ka hije.

Pas këtyre fjalëve, ballistët e kishin qëlluar me pushkë.



8 Maj.

Këtu afër në Omockë ndodhet një stan i batalionit tonë me tremijë bagëti t'imta të mara ballit. Sot ardhin këtu shoku Piti dhe u muar me organizimin e punës së stanit. Na solli një teneqe me djathë e një me gjalpë.

9 Maj.

E shoh se gjithë e më shumë jam i ndarë nga jeta partizane. Këtu në Slimnicë jemi larg luftës e larg shokëve. Bëhemi gadi njëzet partizanë me puntorinë e spitalin. Lajmet mbi ngjarjet në Devoll i marrim veç nga njoftimet me shkrim të komisarit dhe i vemë në komunikatë. Dje shkua në lumin Belica dhe zëmë peshk me grep. Pasvaj u lamë në lumë. Vasilika nuk desh të lahej dhe shkoi më tutje në pyll.

Më vonë dollëm shëtitje nëpër pishat dhe ahet e Gramozit. U futëm thellë në pyll. Koha ishte e kthjellët, dielli ndriste për bukuri, por nuk mundëte të kalonte fletët dhe degët e drurëve. Dhe në na dukej koha e vrëjtur dhe si me shi. Vaska bisedonte me Vasilikën, këputnin fistikë prej pishë, kërkonin kërpudha, fole e lule. Zogjtë këndonin në majat e drurëve, dëgjoheshin ca zëra të çjera si prej macesh t'egërta, ketrat kërcenin nëpër degët e larta dhe na shihnin si të habitur. Pylli ushëtinte dhe nga një pllajë përtej vinin zërat e këmborëve të grigjës. Rallë herë duke ecur nëpër pyll shihnim tutje kundrejt ndonjë copë koriye të ndriçuar prej diellit. Gashi, me atë zërin e tij të thellë e bas, këndonte nëpër pyll. Dhe zëri i tija kalonte gjer tutje nëpër drurët. Unë këputa një lule shqere në një zabel, u pështeta pas një ahu me pulla të bardha dhe nisa të këpus petalet e lules: më do, s'më do, më do, s'më do. Ndënë këmbët gurgullonte ujët e burimit e ikte tatëpjetë duke mbartur fletë ahu, copa bisqesh e petalet e trëndafilin t'egër.

Vasilika kish qëndruar para një shkëmbi gjigand e thëriste. Zëri i saj jehonte i hollë dhe i fortë. Ajo thëriste gjithënjë dhe përsëri jehona kthente zërin e saj.

Dhe Vasilika qeshte e kënaqur. Zëri i saj i shkrifur tingëllonte aqë ëmbël nëpër pyllin madhështor.

Duke u kthyer në fshat kaluam pas jazit të centralit tonë dhe e meremetuam në disa vende.

Pasdite na ardhi një letër nga komisarit:

Njofton se me datën 6 maj, një skuadër e batalionit i ka bërë armikut një pritë në Poloskë. Armiku kish diktuar me kohë pritën. Gjatë përpjekjes është vrarë një ermen e janë plagosur dy të tjerë.

Në komunikatën që nxuarëm sot vumë edhe këto lajme që muarëm me radio:

Aviacioni Sovjetik ka bombarduar objektiva ushtarake në Lvov, Sebastopol dhe ay aleat ka bombarduar Bukureshtin e Podgoricën. Në frontin N.Çl. Jugosllav Spliti ndodhet i rrethuar nga partizanët. Janë mbytur katër vapore të vegjël gjermanë; një mijë minatorë austriakë janë bashkuar me partizanët Jugosllavë. Partizanët italianë luftojnë në Genova, Pulia e Alesandria.

### 12 Maj.

Në mëngjez, duke u ngjitur nga centrali në bazë, me baterinë në sup, shkava diku pas disa lëpushkave dhe bateria më ra atje e u bë cop e thërime. Më ardhi keq sa e qava me lot. Kështu mbetëm veç me një bateri. Lajmërova komisarin dhe iu luta të na gjejnë ndonjë bateri tjetër. Sot ardhi këtu mjeku grek dhe vizitoi të sëmurët dhe të plagosurit tanë. Mjeku është i veshur thjesh-të si fshatar dhe mban opinga kau. E solli fjalën me marifet dhe na u lut për një palë këpucë sholle. Vaska i dha një palë alpine të reja. Mjeku u gëzua dhe na falënderoi nga zemra. Me këtë rast mësova se opingave gër-qisht u thonë «caruqe».

### 16 Maj.

Vendësit këtu në Slimnicë janë njerëz të thjeshtë e shumë të varfër. Na duan dhe na nderojnë. Sot na ftuan në një dasmë. Vajtëm në mbrëmje dhe me të vërtetë u

argëtuam. Këtu mësova dhe diçka të papritur. Gratë këndonin shqip. Vura veshin mirë: Ish fare e kjartë, këndonin shqip:

Moj e vogla me lezet  
Le me gojë që s'na flet  
Pse s'na bën me isharet?  
Kam babanë në penxheret  
Nxjerr martinën e më vret!

Pyeta Janin që kisha pranë:

— Si këndojnë kështu?

— Ja, si i dëgjon.

— Po kënga është shqip, këto gratë nuk dijnë shqip. . .

Atëhere Jani më tregoi se kështu e kanë gjetur nga pleqtë. Këngët e grave këndohen shqip dhe mësohen përmëndësh fjalë për fjalë.

Veç vura re se theksimet e gjuhës çalonin. Po këngët që këndohen këtu janë pikërisht po ato të grave në Devoll.

18 Maj.

Nxora numurin dy të gazetës së xhepit të batalionit me materialin që dërgoi komisari. Shkrimi i parë mbi situatën politike është shkruar nga komisari, vijon një shkrim tjetër me titull «Lufta N.Çl. dhe balli» shkruar nga Andrea, pastaj është vjersha «partizanët në male» nga Malja, në faqen 4 e 5 vijon Fitimi me «Duam Shqiptari të lirë demokratike popullore», në faqen 5 e 6 «Rinjia shqiptare në rrugën e saj» shkruar nga unë me pseudonimin «Guri i Capit», në faqen 7 e 8 Endri ka shkruar shënimin «Ku do ta shpinte fashizmi Rininë shqiptare». Tefiku ka shkruar në faqet 8 e 9 me titull «Martirët e Devollit». Sofoku ka shkruar kronikën e faqeve 10 e 11 mbi ndeshjen e futbollit që u zhvillua më 14 maj në Dardhë midis dy kompanive të batalionit. Në faqen 12 Nasi Pavllo ka shkruar shënimin «Për ideal». Në faqen 14 është një vjershë mbi dy partizanë qose që paskan dashur të gjejnë një mënyrë për të patur mustaqe. Strofa e fundit mbaron kështu:

E ke parë mashalla  
Sa të bukura i ka?  
Me ilaç që vet e qiti  
Në një mot, aq shumë i rriti.

Në faqen e fundit në rubrikën «Thash e theme» lexohet:

«Pse Emin Suli qëndron me ballistët në Bilisht?

— Ay organizon ushtërinë për të ndaluar ofensivën e Ushtërisë së Kuqe.»

## 20 Maj.

Ditët e fundit disa çobanë të Gramozit më dërguan lajm të vete gjer ndër ta. Më shtyjti kureshta dhe u nisa herët. Mbassi kalova urën e Belicës dhe u ngjita për-pjetë sosa në katundin Gramoz. Aty më rrethuan një grup çelnikë dhe më kërkuan të bëhem ndërmjetës për shkëmbim mallrash. Këtu mungon buka dhe kërkojnë që bujqërit nga Devolli t'u sjellin grurë për ta shkëmbyer me prodhime qumështi. U thashë se unë nuk merem me punë të tillë, po me qënë se ata e kërkojnë unë do njoftoj atje ku duhet.

Më mbajti për drekë një nga çelnikët. Vajta në kaliven e tij. Kjo nuk ishte kalive, por një tendë moderne e sjellë nga Evropa. Më vunë të unjem mbi disa qilima të rinj e më shtruan drekë me shumë gjellë, duke filluar që nga mishi e të gjitha prodhimet që dalin nga qumështi. Bëra çudi me bukën; ishte prej misri dhe nga pamja nuk më pëlqeu. Po kur fillova të ha nuk ngopesha me të. Më tej mora vesh se ish e gatuar me qumësht në vend të ujit. Fëmijët këtu janë shumë të shëndoshë e me faqe të kuqe si zjarr. Pashë këtu edhe një çupë të bukur që pa e tepëruar mund të them se nuk më ka zënë syri herë tjetër.

## 23 Maj

Pardje lajmërova me një letër komisarin mbi kërkesën e çelnikëve të Gramozit dhe dje ardhën këtu në

Slimnicë katër fshatarë nga Devolli me gjashtë kuaj ngarkuar me grurë. I drejtova në Gramoz dhe pasdreke u kthyen. Sot ardhën atje një dyqind fshatarë të tjerë nga Devolli të cilët suallën karvane me grurë.

Pas dite komisari i batalionit na dërgoi një bateri të re për radion tonë. Mjeku grek na rekomandoi që të instalojmë një radio në spital për të sëmurët.

## 24 Maj.

Njësitë partizanë të Slimnicës na ndihmoi të kapim dy kondrbandistë. Janë nga Kolonja. Kishin katër mushka të ngarkuara me shollë, semenca e cigare. Njëri nga kondrbandistët, kur e suallën në bazën tonë, tentoi të rrëmbejë një nga automatikët, po Vaska e vuri re më parë dhe i dha një grusht hundëve sa e solli në vehte.

## 25 Maj.

Njësitë partizanë të Dardhës na solli sot një barrë sende për ne. Janë dërguar nga organizata e partisë së Korçës për teknikën tonë. I çelëm thasët dhe menjëherë lexuam adresën tonë: «Teknikës së batalionit Fuat Babani, Pozitë.»

Gjetëm brënda një makinë shkrimi »Olivet« fare të re, një sasi materialesh që nga letra e gjer në bojë shaptillografi dhe në fund një kuti të madhe me biskota. Në krye të kutisë ish një letër për ne. E lexuam: na dërgojnë urime nga qyteti për luftën dhe punën tonë. Na urojnë të durojmë vështirësitë e jetës së malit.

Kjo e fundit sikur na goditi megjithse dërgonjësit e letrës janë të sigurtë. Në është puna për të duruar, kjo u takon bash atyre shokëve në Korçë që punojnë nënë hundët e armikut; natyrisht edhe partizanëve të batalionit. Sa për ne, ç'është e drejta, po rrojmë shumë mirë, gati tremijë dhen i kemi këtu afër me gjith yshyrin e tyre, flejmë në krevate, shëtitim nëpër pishat e Gramozit, bëjmë mundje çdo ditë e rregullisht, sepse si duket po na shpon

elbi; pastaj mbi të gjitha rrojmë edhe me muzikë. Shpesh i bisedojmë këto gjëra midis nesh. Një ditë ia thamë edhe komisarit:

Na vjen si turp, shoku Faik, po rrojmë si bejlerët...

— Ky është fronti i juaj. Nëqoftëse ndjehi rehat mundohi t'ua shpërbleni shokëve që luftojnë duke punuar sa më mirë.

Nesër do të shkoj në fshatin tim për disa orë.

## 27 Maj.

Armiku filloi një goditje të gjërë kundër forcave partizane. Ndodhesha në Ziçisht dhe po u lexonja lajmet e fundit disa fshatarëve. Ishte ora dhjetë para dite. Pa pritje u ndje një batare mitrolozi nga ana e Poloskës. Dytshova menjëherë, sepse batareja zgjati më shumë nga sa e kanë zakon mitralierët tanë. Ngarenda mbi fshat dhe dolla në vreshtat. Nuk dukej asgjë. Ika përpjetë dhe arrijta te korijet e Gjyrezit. Q'aty holla vështrimin me dylbi nga fusha. Në Ziçisht po hynte një kollonë gjermane. Një grup gjermanësh ishin futur në jonxhën afër kishës dhe po shtinin në qiell me roketa jeshile e blu. Dylbija që kam (një Zaisë me një sy) është e mirë. Dukëshin nëpër të edhe lëvizjet më të vogla të armikut. Ata qëndruan diku prapa kishës dhe atje ngritën tytat e topave. Një grup oficerësh po vështronin me dylbi këtej nga korijet. Në një çast m'u duk se me një gjerman po shiheshim sy në sy me anën e dylbive, sepse ay filloi diçka t'u tregojë shokëve të tij duke zgjatur dorën këtej. Fill atëhere ndjeva thirrje nga krahu im i majtë. Kur ktheva vështrimin atej, vura re partizanët e batalionit që në formacion luftimi po hapeshin pas kodrave mbi Ziçisht. Në majën e kodrës Qezar, Petro Boboshtica vendosi mitrolozin Sharës dhe qëlloi gjermanët në Ziçisht. Gjermanët u shpërndanë prapa kishës. Pastaj shungulluan topat e armikut. Qitjet e tyre filluan të shpejta. Qëllojnë kodrën Qezar. Gjyle të tjera iknin përpjetë më hava. Në fshat nuk dukej gjë e gjallë. Gjermanët nuk tentuan të

sulmojnë. Ata u futën nëpër shtëpitë e katundit, kurse artilerija e tyre dëndësoi qitjet.

Diku prapa meje dikush po zvarrisej. Ktheva kryet dhe pashë Maqon me Tefikun. U thira me emër dhe u afruan. Tefiku është përgjegjës i rinisë në batalion, dhe më tregoi se në mëngjes kishin luftuar për një katër orë me gjermanët në Hoçisht. «Atje na mbeti i vrarë Pjetër Prenga», më tha Tefiku, «megjithëse nuk e pamë dot as të gjallë e as të vdekur».

Sipas lëvizjeve të armikut dhe forcave të tij të reja, duket se ata po fillojnë ndonjë operacion kundër nesh.

Ndërkohë rrähja e artilerisë gjermane vazhdonë e paprerë. Më tej e vunë në shënjë katundin Bradvicë dhe nisën ta qëllojnë me breshëri gjylesh. Si duket ata kishin vendosur mos avancojnë me trupat.

Dualëm në livadhet lart. Fshatarët pa qendin drejt pyjeve. Diku, në një zabel dëgjova qarje fëmijësh. Një grup kalamanësh po qanin të tmerruar nga plasjet e gjyleve. Ishin ata që kullotnin bagëtinë. Midis tyre njoha edhe vëllezërit e maj, Nasin dhe Ilin. Qesha për t'u dhe në zemër. Ata më shihnin në sy dhe m'u mbloodhë për rreth. U thashë të qëndrojnë në pyll dhe mos kthehen në fshat gjer nesër.

Afër mbremjes arrijtëm në Dardhë. Komisari mori një letër nga Korça. Edhe prej andej lajmërojnë se gjermanët po fillojnë një operacion të madh kundër lëvizjes Partizane. Disa informatorë tanë njoftuan se në Boboshticë dhe Kamenicë janë përqëndruar forca gjermane të porsa-ardhura dhe, po ndreqin disa ura të vogla. Shtabi i ynë urdhëroi që të fshihen depot tona që kemi në Dardhë. Në mbremje doli urdhëri të gatitemi për rrugë. Na thanë që të kërkojmë nëpër fshat nga një mbulesë për fjetje.

Shkova në shtëpi të Joanës dhe me një barrë turp u kërkova një shkorsë të vjetër. Më dhanë dy të reja veç vura re se ishin shumë të tronditura. Janë përhapur fjalë se po vijnë gjermanët ta djegin Dardhën dhe t'i vrasin gjithë banorët. Joana më foli:

— Do shkoni?

— Po, do shkojmë.

— Theodhori i vogël u mësua me ty, do qajë.

— E besoj.

— Do ta kujtosh Theodhorin?

— Do ta kujtoj posi edhe Theodhorin edhe ty edhe të gjithë...

— Po Vaska do vijë?

— Do vijë pa tjetër.

— Të kesh mëndjen andej nga do vini, se...

Asaj i shkuan lot. Më kot u mundua t'i fshehë.

— Po ti a më dashuron mua?

Kështu mendova t'i them, por nuk i thashë.

## 28 Maj.

Në mesnatën që kaloi ikëm nga Dardha. Kaluam nëpër Arëzë dhe dualëm në vijën e kufirit grek. Atje qëndruam për çlodhje. Një kompani e jona iu zuri prite gjermanëve në qafa e Kamenicës. Në agim gjermanët që vinin prej Kamenice u goditën nga prita e kompanisë sonë. Luftimi ish i ashpër dhe i shkurtër, sepse artilerija gjermane hyri në veprim duke qëlluar me breshëri qitjesh. Më vonë, nëpër dritën e dobët të agimit, i pamë gjermanët: si hije po kapnin lartësinë e Shënpjetrit e të Gurit të Vjeshtës mbi Dardhë.

Në një zabel, nga një mosmarëveshje a keqkuptim, desh u goditëm me shokët tanë që na pandehnë si gjermanë. Kur dha mëngjezi, arrijtëm në Slimnicë.

Sipas urdhërit mbledhëm gjithë materialet tona këtu, veglat e pëntorisë, teknikën dhe spitalin. Gjithashtu e çkullmë edhe centralin e vogël në muhilliri. Pastaj kapërxëm lumin Belica dhe ngritëm «kampon» tonë në livadhet e Zagarit. Këtu sajuam disa kalive me gardh të mbuluara me dushkerë. (Jemi gjithësej një katërqind e pesëdhjetë veta. Përveç partizanve të batalionit ndodhen edhe gjithë shokët dhe shoqet që punojnë në teren me rininë, gruan dhe frontin. Gjithashtu janë edhe disa kryetarë të këshillave N. Çl. të katundeve, aktivistë të L. N. Çl. si edhe disa prindër partizanësh.)



Që sot, dit' e parë, ndjemë nevojën e bukës, Kopeja, me tremijë kokë bagëti, që kishim në Omockë, sot u af-rua këtu. Komanda caktoi një dele për 12 partizanë. I the-rëm dhe i shkuam në hell, I mirë është mishi i pjekur, po a mund të hahet pa kripë? Nga e keqja e hëngrëm.

## 29 Maj.

Shtabi i batalionit urdhëroi intendentin të ngjitet në Gramoz për të blerë djathë. Vajta edhe unë me Riston dhe me Vaskën. Gjetëm djathë boll, por të pakripur. In-tendenti pagoi paratë dhe ngarkuam dhjetë barrë me dja-thë të fortë dhe të pa kripur. Këtëj ndjehet mungesë e ma-dhe për kripë. Poshtë në kamp ndamë nga një gjysëm oke djathë për njëri.

## 31 Maj.

Po ushqehemi me djathë dhe me mish të pa kripur. Në një pyll këtu afër ndodhen edhe të gjithë fshatarët e katundeve Qytezë dhe Sinicë, burra gra e fëmijë. Ata ka-në marë nga pak ushqime kur ikën nga fshatrat, por ne jemi shumë gojë që duam të hamë. Fshatarët na ftojnë me gjithë zemër dhe e ndajnë me ne gjithë sa u ndodhet. E mirëpo rezikohen fëmijët të mbeten pa bukë. Për këtë shtabi i batalionit dha urdhër sot që të largohemi nga li-vadhet e Zagarit. Muarëm rrugën drejt Jugut. Afër mbrëmjes arijtëm në një rafshnaltë afër katundit me emër Tuhul. Vëndi ku qëndruam është majë mali. Maja duket si e prerë dhe kështu formohet një si lëmë i madh i mbuluar gjithë ditën nga hijet e pishave shekulllore.

## 1 Qershor.

Sot shkoi në prapavijat e armikut, në zonën e Dar-dhës, një skuadër partizane. Skuadra do hetojë lëvizjet e armikut dhe përbëhet nga këta shokë: Maqua, Endri, Shabani, Kalua e Piti.

Me Kronin, Vaskën e Riston zbritëm në Tuhul për

të shikuar në mund të ketë ndonjë ushqim për të blerë. Fshati është shumë i varfër. Vëndësit janë muhaxhirë të ardhur nga Asia e Vogël dhe të shkëmbyer me shqiptarë. Kanë mbetur edhe katër familje shqiptare që nuk kanë dashur të shpërngulen.

Kryetari i këshillit munda të mbledhë dy barrë bukë dhe na i dha pa na kërkuar ndonjë pagesë. Në shtëpinë e një shqiptari hëngra një përshesh me dhallë që m'u duk si dreka më e rallë.

### 3 Qershor.

Pasdite u kthye nga shërbimi një pjesë e skuadrës e nisur pardje në zonën e Dardhës. Shokët na treguan se gjermanët kanë ngritur komandën e tyre në Dardhë. Atje ndodhet një gjeneral i tyre. Qyteza dhe Sinica janë plaçkitur nga ballistët. Dardha akoma nuk ka pësuar gjë.

Urija po na mundon. Shumë shokë përtypin në gojë fistike prej pishë, të tjerët mbledhin fara prej ahu e keqe.

Më punoi mëndja sot dhe kontrollova ngarkesat e teknikës. Më kujtohej se diku në fund të një thesi, mba-ja një qese miell që e përdornim për të ngjitur trakte. E gjeta qesen të ngatërruar me tubetat e bojës. Kish një tri okë miell. Minjtë e kishin vizituar dëndur. Ja tregova Vaskës dhe Gaqos dhe e pleqësua punën. Po si t'a gatuanim? Gjetëm një bythak pishë të prerë orizontalisht me sharrë. Atje, ndënë dritën e zjarrit, e derdhmë miellin. I hodhëm ujë sipër dhe e përziemë gjersa u bë një farë brumi. Pastaj e larguam më një anë zjarrin dhe hoqmë hirin. Atje vumë brumin dhe e mbuluam me shpuzë. Afër mesnatës buka u poq. Ish pa kripë, por nuk ish e keqe. E ndamë në copa të vogla dhe u a shpërndamë disa shokëve që nuk hanë dot fletë dhe fistika.

### 7 Qershor.

Dje ngritëm kampin tonë prej majës së malit mbi Tuhul. Vijuam rrugën drejt Jugut, nëpër pyje të dëndur

prej pishe. Pas dite arrijtëm në katundin e vogël të Merasllavicës. Të tetë familjet janë shqiptarë. Na pritën me dashuri e gëzim. Kopeja e bagëtive që kemi po pakësohet gjithnjë. Nuk ka ushqim më të pështirë se sa mishi i pjekur dhe pa kripë; e hamë se nuk kemi tjetër ushqim. Fshatarët e Merasllavicës e ndanë sot kafshatën e tyre dhe na dhanë drekë e mëngjes dhe mbi të gjitha një dhuratë shumë të vyer: Njëzet okë kripë!

Tashti e kuptoj sa të drejtë ka populli ynë që betohet: Për atë kripë!

E ndamë kripën dhe na ra nga një kupë kafeje për njeri. Sot në mëngjes komisari i kompanisë Ndrekua shkoi në Krisi ku ndodhet një qëndër e andartëve grekë. Pasdite provuam të dëgjojmë radion. Ngritëm antenën mbi një ah të madh, por nuk mundëm të kapim ndonjë stacion, mbassi bateritë janë zhgarkuar. Fshati këtu ka një mulli të vogël që e ka gurin sa një tigan. Mullisi na dha lejë dhe e montuam dinamon në faqen e brëndëshme të potit (atje ku bie mielli). Puna na shkoi mbarë. Pas nj'a dy orësh e hoqëm njerën bateri dhe vumë tjetrën. Atëherë mundëm të dëgjojmë radion. Hasëm një emision inglisht të radio Moskës. Vështronim Pandin me kuresht se ay di inglisht. Në fund ai ngriti kryet dhe na tregoi: Në bregun veri-perëndimor të Francës pas bombardimesh të tmerëshme ushtëritë aleate kanë zbarkuar trupa të motorizuara. Gjermanët janë tërhequr. Partizanët francezë, kanë qënë shumë aktivë në të gjithë Francën; ushtërija e Kuqe sulmon me furi trupat gjermane që tërhiqen gjithënjë.

Në mbrëmje baterija filloi të zbrazet (gjatë rrugës i është derdhur aqetoni). Mundëm të dëgjonim vetëm stacionin gjerman të Donaut. Zëri i folësit, i trashë, i ngadalshëm dhe si i dalë prej varrit, jepte në shqip komunikatën e kuarterit të madh hitlerian. Mbassi foli mbi frontin e lindjes, mbi pozitën elastiko-strategjike, mbi zbarkimin në Normandi e luftën e «rebelave» ay mbaroi kështu: Npër malet e egërta të Shqipnis vazhdojnë me u zhvilluë luftime t'ashpra kundër bandave teroris-

te bollçevike». Më pas vijoi me një koment: Q'aty ku shkon fronti gjerman e tëhu është ligja, drejtësia dhe rendi botnuer. Prej vijës së frontit e tutje, forcat e errësinës dhe të bollçevizmës mundohen më kot me shpartallue makinën famë-madhe të Reichut të tretë».

• Të gjitha sa dëgjuam sot në radio na gëzuan. Komunikata gjermane flet mbi luftën tonë. E na shan e na mallkon. Domethënë se lufta partizane shkon mirë. Gjermanët nuk kanë mundur të na shkatërrojnë ashtu sikundër mendonin. Zaten këtë u munduan ta bëjnë edhe n'opëracionin e parë të dimrit.

### 8 Qershor.

Në mëngjez komisari i kompanisë, Ndreku, u kthye nga Krisija. Ish takuar me disa komandantë të andartëve grekë. I kishin dhënë katër barrë me bukë e dy barrë me ullinj. Kemi ngrënë bukë e ullinj sa lëpimë edhe gishtat.

!Sot pasdite ardhni këtu Endri me Pitin. Janë të skuadrës së zbulimit. Treguan se forcat gjermane janë duke u tërhequr. Në mbrëmje muarëm rrugën në drejtim të tokës sonë.

### 10 Qershor.

Ndodhemi në livadhet e Zagari, në atë vënd ku qëndruam ditën e parë që ardhëm këtej. U bë mbledhja e batalionit. U fol mbi situatën e brëndëshme dhe të jashtëme. Pastaj u kritikuan disa shokë që, duke kërkuar ushqim, ishin larguar shumë nga batalioni. Pastaj partizani Gaço, kritikoi intendentin dhe komisarin për disa çështje që ay i qojti si shkelje të rregullit dhe të drejtësisë. Rreth kritikës së Gaços u zhvilluan mjaft diskutime dhe e muarën fjalën shumë shokë. Nuk u zgjidh gjë dhe u la që çështjet e ngritura nga Gaça të shihen kur të kthehemi në teritorin tonë.

## 11 Qershor.

Ditë e mbarë, ditë e lumtur, ditë suksesesh.

Sot, që në agim, pas njoftimeve të sjella nga skuadra e zbulimit, u nisëm drejt teritorit tonë. Zbuluesit thanë se gjermanët janë tërhequr e balli me xhandarët po zënë vënd në Qytezë, në Sinicë e Dardhë. Në Slimnicë qëndruam për çlodhje. Pyeta Piti si me marifet:

— Po rinia e Dardhës ç'bëhet?, o Piti?

— Janë në pyllin e Propasit.

— Ajo e zonja e shtëpisë ku kam ndenjtur unë, mirë ishte?

— Kush Joana?

— Po.

— Ç'e pyet, fare mirë, trëndafil me erë...

Dhe qeshi Piti duke mbyllur sytë përgjysëm. Dicka desh të thoshte, por e mbajti.

Në Slimnicë batalioni u nda në tri pjesë: Grupi i parë u nis të goditnin ballin që ndodhet në Qytezë, grupi i dytë u nis të sulmojë ballin që ndodhet në Sinicë. Grupi i tretë që përbëhet prej të sëmurve, plagosurve, partizanëve të puntorisë, dhe disa kryetarë këshillash të katundeve, do të qëndronin në Slimnicë. Zhgarkova mushkat në bazën tonë të vjetër e dolla nga shkolla e katundit. Atje ishte Maqua, Zv/komisar i batalionit tonë, i cili qe lënë si përgjegjës mbi grupin e tretë. Maqua po mendohej ndërsa po thithte fundin e një cigari, që mënd i digjte gishat. Befas ngriti kokën:

— «E, mo shokë, kush ndjehet si më mirë?»

Disa nga të sëmurët e shihnin në sy.

— E mo, si thoni a e sulmojmë Dardhën?

Maqua me inisiativën e tij po hynte thellë. Nga Shtabi ish vendosur që grupi i parë dhe i dytë, pasi të spastronin Sinicën dhe Qytezën, të drejtoheshin për në Dardhë. Duhet shtuar se me ne ndodheshin edhe një dy-mbëdhjetë partizanë të brigadës katërtë, që nuk di se nga ardhë.

Pas disa bisedimesh, u vendos që të niseshim drejt Dardhës. U bëmë gatë. Shumica ishin nga grupi i të së-

murëve. Mitrolozin e mban partizani Petro Boboshtica. Ky është i sëmurë, ka temperaturë, por është shumë rezistent, njeri i vojtur dhe kollos nga trupi. U vumë në rrugë. Nga drejtimi i Qytezës dhe Sinicës po kërciste pushka. Shokët kishin filluar luftimin.

Disa shokë ecnin vëngër e çalë çalë. Kaluam diku afër Nikolicës dhe duallëm nga Llofka e Dardhës. afër Fushëzës. Atje Maqua na ndau nëpër skuadra dhe na porosi për të fundit herë. U ndamë në formacion luftimi dhe vijuan të marshojmë për të kapur majat e Shënpjetrit dhe disa kodrina aty rreth. Pa pritur vura re tre njerëz t'armatosur që na afroreshin nga ana e Kamenicës. I vështruam edhe me dylbi, por nuk mund t'i dallonim, në ishin partizanë apo ballistë. Kur u afruan më tëhu, vumë re se kishin shami jeshile prej parashute në qafë. Pra ishin partizanë. Na treguan se ishin korierë të brigadës së katërtë. Vazhduam marshimin bashkë me 'ta. Na ish mbushur mëndja se majën e Shënpjetrit armiku e kish fortifikuar.

Kur filluam të merrnim të përtpjetën drejt asaj male, djersët na vinin rrëke. Dhe ishin dy arsye: Vapa dhe armiku që prisnim të na qëllonte nga çasti në çast. Me shpirt ndër dhëmbë, duke ngarendur në sulm, kapëm shkëmbin e Shënpjetrit. Për çudi asnjeri nuk ndodhej atje. Gjetëm veç disa kuti të zbrazura prej konservash gjermane. Hodhëm sytë poshtë në Dardhë, e cila shtrihëj ndënë ne. Nj'a dyqind xhandarë e ballistë ishin shpërndarë nëpër kodrën e Shënthanasit e silleshin vërdallë të çkujdesur. Përpara shkollës ishin mbledhur burrat e fshatit dhe një njeri me uniformë ushtarake po u mbante fjalë. Ngritëm armët dhe lëshuam bataretë.

Sa çudi! Sa e tmershme është befasia! Sa të hapësh e të mbyllësh sytë, njeri i gjallë nuk dukej në fshat. Dikush nga shokët po thëriste: Me dorë, me dorë!

Ashtu u vërsulëm drejt fshatit duke thirur dhe duke qëlluar. Kur po hynim në shtëpitë e para, disa nga ballistët e mblodhën vehten e filluan të na qëllojnë. E mirëpo ishte vonë. Shumicës së tyre u kishte hyrë ljepuri në bark dhe po iknin në panik.

U ndodha afër me dy shokë, dhe nëpër disa gradina

zhymë në fshat. Kalova nëpër kopshtin e Joanës. Todua i vogël ndodhej afër kumbullës dhe më priti me britma triumfi. Nuk pata kohë ta përkëdhel e as t'u jap dorën nënës e motrës së tij. U vërvitëm përpjetë fshatit. Kur mbrijtëm në kodrën e Shënthanasit, vura re një varg pushkë, çanta e pallto të hedhura nga ballistët. Përpara meje, një djalë i vogël nga Dardha nja katërbëdhjetë vjeç, me një patickë në dorë, po rendte drejt armikut. Mu duk si çudi dhe vura buzën në gaz. E arrijta dhe i fola, Ktheu kryet dhe sytë i xixëlluan:

— Si e ke emrin, o kapedan?

— Koço!

— Bravo se qënke trim.

Pas disa minutash pushkët pushuan. Armiku ish tërhequr në drejtim të Boboshticës. Zurmë trembëdhjetë ballistë rob. Të vrarë nuk patëm. Por pas luftimit një partizan u vetëvra padashur me pushkën e tij. Në luftim u dallua partizani pioner Kupe si dhe Maqua, Stili, Endri e Katina.

Dualëm nëpër rrugët e fshatit. Banorët na pritën me gëzim. Kjo është Dardha e jonë, baza e jonë. Po sa çudi! Gjermanët nuk e kanë djegur dhe as e kanë plaçkitur. Rrethanat nën të cilat Dardha ka shpëtuar nga prishja na i treguan burrat e fshatit një për një.

Filloi ndarja e partizanëve në baza. U nisa për poshtë fshatit kur Maqua më foli:

— Ku po shkon?

— E kam bazën unë, në të Laços.

— Pa eja këtu.

Vajta.

— Si i ke punët andej poshtë fshatit?

Unë shkova pështymën. Ay nënëqeshi.

— Nuk kam gjë, të betohem...

Maqua qeshte gjithënjë. Unë vajta më tej dhe e shihja Maqon me bishtin e syrit. Nënqeshte, tundte kokën e përsëri më vështronte mua. Në fund psherëtimi thellë e u gëlltit. Diçka kuptova: Atij i vjen keq rinija ime, mosha ime, atij i vjen mirë që më heq vërejtjen. Diçka do ketë kuptuar.

Më në fund bëra tatëpjetë. Joana ishte n'obor. Duket se më priste. I dhashë shkorsat që më pat dhënë. Ishim fill vetëm. Ajo ish shumë e turbulluar dhe kur fliste f' mirej zëri.

## 12 Qershor.

Mbrëmjen që shkoi ramë të flemë pa lënë roje. Sa na kish zënë gjumi krisi një batare mitrolozi. U zgjova nga gjumi gati i tmeruar, pa ditur ku ndodhem e çfarë po ngjiste. Xhamet e një dritoreje diku afër u thërmuan me potere nga të shtëna armësh. N'atë çast dëgjova një zë të çjerë thërriste me të madhe:

— Dorëzohuni! Dorëzohuni!

Ej bela e pa pritur. Ballistët të jenë bërë kaqe tri- ma sa u kthyen prapë? Pastaj dëgjova një djallog zërash me të thirrur: Mezi e kuptova. Ja ç'kishte ngjarë:

Shokët tanë pasi kishin pastruar Qytezën dhe Sini- cën nga ballistët, qenë drejtuar mbi Dardhë dhe na ki- shin rrethuar sipas planit që ish pregatitur që në Slimni- cë. Ata nuk dinin se ne «të prapavijës» kishim çliruar Dardhën. Askush nuk i kish lajmëruar për gjë. Duke e- patur të qartë se balli ndodhej në Dardhë, ata po shti- nin dhe po thërisnin që të rrethuarit të dorëzohen. Për- fat të mirë disa shokë kishin njohur zërin e Selmanit dhe u folën me emër. Mezi u kuptuam pasi shkëmbyem disa batare. Dualëm dhe i pritëm. Vijuam të bisedojmë e të këndojmë nëpër rrugët e fshatit gjer vonë afër agimit. Një shok më tregoi se ballistët në Qytezë e Sinicë nuk kishin bërë qëndresë të madhe. Ata i kishin thirur vra- pit në panik. Në Sinicë ish kapur i gjallë një ballist në moshë të re. Shokët nuk kishin patur kohë që ta shpien në shtabin e batalionit, kur disa vajza e gra e kishin vra- rë duke e qëlluar në kokë me kopanët që rahin rrobat. Arsyeya kish qënë se ballisti në fjalë, disa orë më parë, kish kërkuar as më pak e as më shumë po «një byrek, një kaurkë shtatëmbëdhjetë vjeçe dhe një gjym me raki».

Sot dëgjova dhe hollësi të tjera mbi qëndrimin e gjer- manëve në Dardhë. Ata, me të ardhur, kishin vendosur



shtabin e tyre të operacionit në shtëpinë e Mitit. Oficeri i tyre më i lartë ish një gjeneral nj'a pesëdhjetë vjeç. Që ditën e parë gjenerali kishte thirur burrat e fshatit dhe i kish porositur me një gjuhë të ashpër e plot inat që të mos bëjnë asgjë të keqe kundër ushtarëve të tij. Pastaj i kish pyetur nëse kishin patur partizanë në fshat, sa ishin dhe si ishin etj. etj. Në fund gjenerali kish vënë mbi tryezë një hartë; atje katundi Dardhë shënohej me një rreth të kuq lapsi. Gjenerali, në sy të fshatarëve, i kish hequr Dardhës në hartë shënjen e X-it. Pastaj kishte thënë: «Ditën që unë do të largohem prej këtej, Dardha do të zhduket krejt. I vetmi lëshim që mund t'u bëj është që të filloni të tërhiqni plaçkat dhe ushqimet. Këtu ka qënë baza e partizanve dhe ne s'mund të lejojmë që të bëhet edhe një herë kryeqëndër e rebelave».

Gjenerali fliste inglisht e merej vesh me disa pleq të Dardhës që e kanë mësuar këtë gjuhë në kurbet. Qënëmunduar pleqtë e Dardhës që ta zbutnin rreptësinë e gjeneralit, por ay rrinte i patundur. Nuk pranonte as cigaret që i ofronin e bile as linte njeri të ulej në zyrën e tij. Atëhere xha Kosta, plak, e kish marrë fjalën dhe me zgjuarësi dhe takt e kish bërë gjermanin të mendohet:

— «Zoti gjeneral, sikurse e dini ne kemi qënë shumë vjete në kurbet në Amerikë. Atje, si puntorë, kemi patur shumë shokë gjermanë. Bashkë me 'ta kemi punuar, kemi dëfryer dhe kemi bërë greva. Ishin gjithë njerëz të mirë, të dashur e puntorë të mbaruar. Bashkëatdhetarët e tu atje kishin kishat e tyre, shkollat e tyre bile dhe qytetet e tyre. Dhe atje kur pikturonin gjermanët ne mbeteshim me gojë të hapur; kur punonin ata ne mundoheshim t'i marrim shëmbëll dhe kur loznin muzikë gjermanët, ne nxirnim shamitë dhe fshinim lotët. Ne kështu i njohim bashkatdhetarët e Goethes puntorë të mbaruar, piktorë të zot e muzikantë me famë. Por sot, kur një bashkatdhetar i tyre na thotë se do t'a kthejë vendlindjen tonë në një pikturë tmerri e zije, ne çuditemi e nuk duam ta besojmë kursesi».

Gjenerali kish dëgjuar me sy të reptë e me gojë të mbyllur. Atëhere, xha Perua, një plak i thinjur me një këmbë në varr, e kish marrë fjalën dhe me zgjuarësi kish hedhur një gur të rëndë. Për mendimin t'im, xha Perua nuk kish bërë mirë, këtë e pranon edhe ay vetë, por guri i hedhur ish i rëndë:

— «Zoti gjeneral, unë kam qënë në shërbim të mbretit Wid që na solli Evropa më 1913. I kam ndejtur pranë si ushtar i tij dhe e kam dëgjuar kur mbante fjalë. Ay na premtonte se do ta bëjë Shqipërinë një parajsë mbi tokë. Kështu na thoshte ay, por nga rrethanat e kohës ay iku. Tashti juve si bashkatdhetar i Widit, do ta digjni folenë tonë. Unë nuk besoj që juve ta bëni këtë. Por nëse e bëni, unë mos vdeksha pa e parë Widin edhe një herë».

Gjenerali gjerman kish përpëlitur qerpikët dhe kish tundur kokën. Këtu ish thyer akulli. Gjermani u kish folur burrave të uien dhe kish marrë fjalën sërish:

— «Unë e çmoj shumë zgjuarësinë tuaj dhe pranoj se më kini vënë në një pozitë të vështirë. Por juve nuk i njihni rrethanat e kohës dhe të luftës. Sidoqoftë unë mund ta rishikoj vendimin tim, por me konditë që juve të më përgjigjeni drejt përsa do t'u pyes. A kini partizanë të fshehur në Dardhë? A kini armë këtu?»

— Jo.

N'atë çast dy çuna të vegjël hynë me vrull në dhomën ku ndodhesh gjenerali me burrat e fshatit:

— Xhaxho Miti, o xhaxho Miti, ushtarët po hyjnë në shtëpinë e Joros!

(Dhe në shtëpinë e Joros ishte depua me armë).

— Përse janë të çqetësuar djemat? — Kish thënë gjenerali.

Xha Miti kish shpjeguar se ushtarët po hynin në shtëpinë e një njeriu që ndodhet në qytet.

Atëhere gjenerali kish urdhëruar axhutantin të ndalojë hyrjen e ushtarve atje.

Dhe ne, kur mbrijtëm sot, gjetëm mbi derën e depeve sonë këtë shënim në gjermanisht:

«Kjo shtëpi është e rezervuar për komandaturën».

Këto dëgjova sot nga dardharët.

Sot ardhni vullnetar në batalionin tonë doktor Pëllumbi. Është mjek në moshë të re. Shtabi i batalionit urçhero i që puntorija e këpucarve dhe spitali të sillen në Dardhë kurse teknika të vendoset diku në Bradvicë.

Vajta në Slimnicë dhe i muarëm të gjitha materialet tona. Që atje u nisëm për në Bradvicë, por këtu nuk gjetëm ndonjë vend të përshtatshëm. U kthyem në Sinicë.

## 16 Qershor.

Pandi u transferua me shërbim si përkthenjës pranë shtabit të qarkut. Unë tashti mbeta vetëm. Nuk di në se do t'ua dal dot mb'anë punëve teknike në instalimin e centralit. Shtabi caktoi partizanin Feridun që të rrijë me mua. Vend qëndrimi i teknikës u caktua në një përrua mali në pyllin e Propasit. Vajtëm sot dhe zumë vend. Pas dite ardhni edhe partizani Koçi që do rrijë ca ditë këtu mbasi është i sëmurë.

## 18 Qershor.

Vendi ku ndodhemi është një ahishte që shushurin ditë e natë. Këtu kemi edhe një burim uji. Kundrejt nesh lajthitë janë të ngarkuara plot me kokra, por akoma nuk janë arirë.

Mbrëmë nuk më zinte gjumi. E lashë Feridunë në kaliven dhe u hodha përtej përroit. Desha të sodit qieillin e madh në natën e errët. Kjo më kujton femininë time. Edhe kohën kur dikur flinja jashtë. Ish paqe atëherë. Kur mblidhnim misrin në fushë, rinim e ruanim natën dhe flinim mbi kallëpët e tija. Në vend të jastëkut mblidhnim xhufka misri të buta si mëndafsh. Herë tjetër flinim në livadhet duke kullotur kuajt. Ndiznim zjarre, piqnim kallëpë misri të njomë, vidhnim rrush në vreshtat, qeshnim, këndonim, harbonim nëpër fushë si të marrë. Dhe zjarret që ndiznim ne ndritnin nëpër arat.

Po ja ardhë të huajtë, ardhë vrasësit, ardhë zjarr-

vënësit. Por ne nuk do përkulemi. Nuk do shtrijmë qafën të na vënë thikën. Prandaj muarëm malet, prandaj luftojmë, mundohemi, lodhemi; prandaj po na mbeten shokë nëpër fushat e luftës, po na digjen katundet, po na i syrgjynosin prindërit, po na i vrasin nënat. I lamë aratona. lamë shkollat, punët, fshatrat, qytetet.

Dhe riniya tashti është maleve. Prandaj flemë natën pyjeve.

Isha shtrirë në një rëzim mbi rrënjët e një lajthishte. Ndjenja purtekat e lajthisë pas shpinës që he-poheshin e më kolovitnin ngadalë. Vështronja qiellin të vulosur nga fletët e lajthisë. Retë iknin, nxittonin sikur ndiqnin njëra tjetrën. Dhe hëna aty në qoshe të qiellit, e prerë si drapër, hera herës, nxirte fytyrën e saja të verdhë sikur çuditej me retë që harbonin aqë shumë.

Frynte fllad behari, pylli shushurinte, larg lehnisqentë, nër dëllinjat kërcenin lepujt, në gëmushat cicërinin gollogushët.

Nga një herë flladi bëhej m'i fortë, drurët tundeshin me potere e dukej sikur pylli zëmërohej e buçiste sulmëmadh.

E sa pushonte flladi, pylli i erët heshtëte. Atëhere ndiheshin këmborët në stanet, ujrat e burimeve, cfilmat e brumbujve.

Pastaj retë u aratisën, qielli u la e hëna filloj të pështetet tutje pas Moravës. Një yll u këput nga qielli. Lëshoi prapa një bisht zjarri e humbi tutje maleve të Pindit.

Sa mirë të flesh jashtë, në pyll dhe mos ketë vrasës, mos ketë frikë, mos ketë të huaj, të jetë paqe!

## 19 Qershor.

Në njërin mulli të Sinicës munda t'instaloj dinamon. Mulliri nuk punon në verë mbassi uji është i pakët. Në vend të gurit i vumë një pulezho dhe e gjithë puna shkon mirë. Njësi i Sinicës na dha një ndihmë të madhe. Ata mbikqyrnin punën e centralit dhe unë vete natën atje, më dy ditë një herë, sa për të marrë ushqimet dhe për

të shkëmbyer bateritë. Lë baterinë e zbrasur e marr të mbushurën. Ditën e parë provova t'ja ngarkoj mushkës baterinë, por nuk dolli puna mbarë. Tashti me Feridunin i sjellim në shpinë. Nga fshatrat për rreth asnjëri nuk di ku ndodhemi mbassi gjatë ditës nuk bëjmë asnjë lëvizje. Edhe njësi i Sinicës nuk e di me saktësi se ku jemi.

Ngritme edhe një farë kaliveje prej gardhi dhe sipër i hodhëm një fletë çadre. Për dyshek kemi shtruar disa togje me fier. Në mbrëmjen e djeshme filluam të mbledhim lajmet me anën e radios dhe sot në mëngjez nxuarrëm komunikatën.

## 28 Qershor.

Komunikatat që nxjerrim herë me shaptillograf e herë me makinë, i vendos në mbrëmje në një brimë muri në mullirin e Sinicës. Aty venë dhe i marin korrierët e batalionit. Shpesh herë kur zbres në mulli gjej ne ajo brima letra me lajme dhe me udhëzime nga shtabi i batalionit.

Ditët e fundit mbarova në makinë daktillografimin e tetë kopjeve të librit «Dhjetë ditë që tronditën botën» nga Xhon Rid.

Makina e shkrimit po më priset thujse për ditë. Gjer më sot e kam ndrequr me një mijë mundime. Sot nxora nga shaptillografi treqind kopje të një broshure me këngë partizane; Feridunin po e stërvit në makinën e shkrimit. Sot ai po shkruante për familjen e tija. Unë rrinja i pështetur pas trungut të një ahu dhe e vërenja ndërsa shkruante. Ish përhumur i tëri pas letrës dhe dukej që shkruante me shpirt e me dhëmbje për njëzet e tij.

## 24 Qershor.

Përveç lajmeve të jashtëme, tashti në komunikatë po ve edhe lajme mbi luftimet e njërive partizane në qar-

Dje në agim ballistët, duke hyrë në katundin Braçan me ndihmën e një spiuni, kishin shkuar në vendin ku po flinte partizani Shaban Qamili. E kishin vrarë në gjumë. Ky lajm më tronditi. Nuk qëndroja dot në vend. E lashë punën dhe duke u dredhur zbrita tatëpjetë lajthishtave. Kudo Shabani më delte përpara syve. Fytyra e tij e gjërë ezmere, duart e ashpra prej shoferi, sytë gjithënjë të qeshur, dhëmbët e parë të florinjte e midis tyre çibuku i tij i madh. Më kujtohet lufta e fushës së Bilishtit më 30 Tetor të vitit të kaluar. Sa trim, sa zemërmadh u tregua Shabani në atë luftë. Nëpër qitjet e armikut ma mje-koi dorën dhe pastaj nëpër plumbat e gjermanit mori në kuriz dëshmorin Thoma Zhuri, gjysmë të vdekur. dhe e shpuri tej në prapavija. Dikur Shabani më pat marrë bazë në shtëpinë e tij bashkë me tre shokë. Më kujtohet sapo hymë brenda na u vërsulën fëmijët e tij tërë zhurmë e brohori. Na përqaфонin, na puthnin, na gëzonin me gazin e tyre. Dhe Shabani i mirë, aty ne qoshja, qeshte e nuk ngopej dot me atë pamje hareje. Pastaj na pat dalë vajza e tij. Ish nja tetëmbëdhjetë vjeç, e bardhë e bukur, shtat-hedhur me sy të gëzuar.

— Therni vëçin!

Kështu urdhëroi atëhere Shabani dhe e therën me gjith kundërshtimet tona.

Vallë ç'bëjnë sot fëmijët e Shabanit? Si e durojnë vdekjen e babajt? Po vajza e tij me ato sytë e mëdhenj? Sa humbje e trishtuar. Shabani i mirë nuk rron më. Kjo vdekje më ther në shpirt e më jep dridhma në trup.

Bëj ta harroj, por s'është e mundur. Mbyll sytë, i ka- loj duart mbi qerpikët, por megjithkëto fytyra e tij më hyn gjer brenda në retinë. Kështu po më ndjek kudo hija e Shabanit.

Duhet zhdukur nga rrënjët spiunët dhe vrasësit. Duhet zhdukur fara e keqe e gjakësorëve të huaj. Duhet zhdukur që paqja të mbretërojë gjithënjë.

## 31 Korrik.

Me të gëdhirë dëgjova krizma armësh në drejtim të Bozhigradit. Bashkë me Feridunë muarëm armët dhe dualëm në një çukë. Disa flagë ngriheshin drejt qiellit mbi Bozhigrad. Pas pak Feriduni shkoi në bazë dhe unë zbrita në Sinicë. Aty takova disa partizanë të batalionit. Më treguan se sonte batalioni i ynë dhe një batalion i brigadës së dytë kanë sulmuar në Bozhigrad. Të mbrojtur prapa frëngjive, ballistët kanë qëndruar të patundur. Nëndë shtëpive të ballit u është kallur zjarri e janë djegur.

### 1 Gusht.

Mora urdhër të mbartem në Dardhë. U gëzova. Me Feridunë ngarkuam mushkat me gjithë sa kemi dhe u nisëm. Vcnë natën arijtëm. Mushkat i kishim ngarkuar rëndë sa mezi barisnin. Kur hymë në fshat nga rruga e Drenovës qëndruam para portës së Isakut.

— Trokit këtu i fola Feridunit, në fisin e kësaj shtëpije besoj të bëhem dhëndër e doemos do na presin mirë.

— Po të njohin si dhëndër?

— Më duket se po...

— Rri ore rehat, eja të shkojmë nga të Ballit atje ku na thanë...

— Euh, kush vetë gjer atje tashti.

— Ë more se ja afër është.

— Jo, jo, bjeri portës këtu, bëj si të them unë.

Feriduni trokiti ngadalë. Pas pak e zonja e shtëpisë çeli portën e na ftoi të hyjmë brënda.

Por në shtëpi kish edhe partizanë të tjerë dhe Sofija, na vuri të flejmë në ashef.

Feriduni u shtri në një kënd të ngushtë mbi dyshek dhe u mbulua me batanije. Unë u solla rrotull dhe me që s'kish vënd tjetër u shtriva mbi një sofat të furrës të shtruar me plloça.

Më ish e pamundur të flinja se shtroja ish e fortë dhe e ftohtë. Kështuqë nisa të sillem e të vërtitem mbi plloçat duke sharë e mallkuar.

Ndjeva që Feriduni po qeshte ndënë batanijet e pastaj ma shkrepit:

— E mo dhëndër, si dukesh???

— Fli ore atje, mjaft na dërdëllise...

## 2 Gusht.

Filluam sot këtu në Dardhë të ndërtojmë një central për mbushjen e baterive. Katër marangozë nga fshati po punojnë për të përgatitur kadet dhe një grup partizanë dhe të rinj vullnetarë nga Dardha po hapin jazin. Vëndi ku po e ngrejtmë centralin është te prroi që ndan Dardhën nga pylli i Shënpetrit, kundrejt mullirit të Xegos.

Shtabi i batalionit dërgoi të banojë bashkë me mua mjekun e batalionit, Shabanin, dhe infermierin e tij Sefkën.

Pasdite, me Vaskën shkuaam nga Joana. Na priti me shumë përzëmësi. E ëma mungonte. Pa pritur, Vaska u ngrit e iku. Ne mbetëm vetëm. Rrinja si mbi gjëmbe. Desha të paktën të bisedonja mbi gjëra të ndryshme, por më ish e pamundur. Ajo rrinte kundrejt meje e kokëunjur. Thurte një triko. Fytyra i kish marrë zjarr dhe dridhej. Bëra t'i flas, por gjuha nuk m'u bind. Bëra t'ik, por këmbët nuk më dëgjuan. Veç zemra më përpëlitej dhe një ndjenjë e brendëshme më mbante mbërthyer në vend.

Pastaj ajo, me fytyrën e skuqur, me zë të dredhur, pa më vështruar më pyeti:

— Ç'njerëz ke në shtëpi?

I tregova.

— Motrat më të vogla janë?

— Po më të vogla.

— Nëna sa vjeç të ka lënë?

— Të vogël fare.

Pa pritur krisi porta, pastaj u çel dera:

— Bukë! Dua bukë!

Ish Theodhori i vogël. Kur më pa, disi u turpërua. E afrova.

— Di këngë ti?

— Di, po.



— Pa këndona një herë...

Dhe Theodhori hipi në sofatin e dritores, mbështolli gjunjët me krahë e ja thirri:

«Ne jemi pararoja...»

Fytyra i mori zjarr, dejet e qafës i kërcyen të mavijosura dhe kokën e mbante lart.

Pastaj ardhi e ëma e Joanës:

— E, more bir, si u bën njerëzija tashti... as të duan e as të pyesin, po nënë gjorat të mbyllin sytë një sahat e më parë dhe tjetër s'u duhet.

— Pse, moj teto?

— Po ja, more djalë, e bija e Lisavos e la në gjumë të jëmën dhe iku partizane; e bija e Dinov, ca më keq, u martua me kë i desh qefi, të jëmën as që e pyeti; punë është kjo? Si thua ti???

— Duhet t'i kishin pyetur.

— E më rrofsh, de.

— Unë besoj se çupa jote do të të pyesë.

— Hëëë. ja pres kokën, ja pres.

Joana qeshte ndënë buzë.

— Po nga një herë edhe prindërit e shkelin dhe u japin çupave burra në moshë të madhe.

— Aaa, jo! Ashtu nuk bën. Edhe unë nuk dua ashtu. Duhet t'u mbushet mëndja edhe prindërve edhe çupës.

— Ashtu vërtet.

— Ja çupa po më rritet, unë e di vetë, e kam evlat, si mund ta mbyl me dorën time. Duhet të marrë moshën e saj, shokun e saj, ja, ndonjë djalë në moshën tënde...

Unë u gëlltita. Joana ngriti kryet, vështroi nga unë dhe përpëliti qerpikët. Ngrita kryet e nënqesha. Më bishitin e syrit shihnja Joanën. Kish lënë grepin, kish ngulur vështrimin në gjergjef, fytyra i qeshte.

### 3 Gusht.

Pas dite një grup druvarësh nga Dardha lajmëruan se në pyllin përmbi Shënthanas ndodhen të hedhura nëpër driza disa armë e mitroloza. Bashkë me disa shokë

rendëm atje. Gjetëm katër mitroloza të lehtë dhe shtatë pushkë të lidhura në një samar. Armët ishin ndryshkur. Sipas hesapit tonë këto armë do jenë hedhur nga ballistët me datën 11 Qershor kur u vunë në ikje.

### 5 Gusht.

Populli dhe partizanët e batalionit, sot këtu në Dardhë, pritën një mik të rallë. Miku në fjalë është major i ushtrisë së Kuqe dhe quhet Ivanov. Është hedhur me parashutë diku në malet e Pindit dhe ka ardhur në vendin tonë si shef i misionit ushtarak Sovjetik pranë shtabit tonë të përgjithëshëm. Me të ndodhet edhe një kapter radist sovjetik.

Arriji në Dardhë sot n'agim. Baza iu caktua në shtëpinë e Mitit. Majorin Ivanov e shoqërojnë tre partizanë shqiptarë. Njëri nga këta është Alqi Kondi.

Në ballkonin e shtëpisë së Mitit, pas brohoritjeve të popullit dhe partizanëve doli majori Ivanov dhe iu përgjigj përshëndetjeve. Majori Ivanov mbajti një fjalim të shkurtër që u mbulua me duartrokitje. Pastaj fjalimit të tij iu përgjegj e reja Dhora nga Dardha. Më në fund një grup vajzash të veshura me kostume dardhëre i dhuruan Ivanovit tufa me lule.

Në mbrëmje majori Ivanov u nis për në shtabin e përgjithëshëm.

### 8 Gusht.

Mbaruan punimet për ngritjen e centralit tonë. Kadet janë të mëdha sa të një mulliri të zakonshëm. Veç janë pak më të ngushta. Centrali u vu në funksionim dhe fillimi i punës së tij u përshëndet me thirrje e brohoritje nga afro njëqind pionerë që ndihmuan me sa mundej në ndërtimin e tij.

Instaluan tre dinamo të vogla, të cilat punojnë vazhdimisht. Tashti bateritë i mbajmë në bazë dhe korentin e sjellim me linjë drejt nga centrali. Me interesimin e organizatës së pionierëve të katundit Dardhë, u vendos

sot që shpërndarjet e trakteve dhe komunikatave toña në katundet Dardhë, Sinicë dhe Arëzë t'i bëjnë pionerët Theodhori dhe Petriti.

## 11 Gusht

Aty nga mesdita e sotme një kompani e batalionit tonë solli në Dardhë pesëdhjet e tetë robër ballistë. Këta janë kapur mbrëmë në Baban gjatë një luftimi të shkurtër ku ra dëshmor partizani i vjetër Raqi Themeli.

Pra u nda prej nesh Raqi i ynë. Nuk rron më ay partizani ezmer e trup-madh, nuk rron më ay trimi i rallë që aqe shumë ka luftuar për çlirimin e vëndit! Ay ka qënë një nga partizanët e parë që krijuan çetën e Moravës, ay ka qën tmeri i spiunëve, i bejlerëve dhe i dhjetarëve. Ay ish një nga inisjatorët e shpërndarjes në popull të beqetët që kishin grumbulluar dhjetarët.

Nga robërit e kapur mbrëmë, pesëdhjet prej tyre qëndruan vullnetarë partizanë dhe tetë shkuan në familjet e tyre.

## 12 Gusht

Mbrëmëjen që shkoi, në sallën e madhe të shkollës, nga një grup vajza e djem të fshatit e nga disa partizanë u dha një çfaqje teatrale për batalionin dhe fshatarët. Kjo është një melodramë ku një nënë përcjell vajzën partizane. Joana ishte aktore edhe ajo. Çfaqja pati sukses dhe u duartrokoi. Pas melodramës u dha një skeç që u provua se ishte plot kripë e shëllirë.

Gjatë çfaqjes së këtij skeçi, të pranishmit mbanin ijet me dorë, e shumë të tjerë shkëlmuuan muret të gajasur nga të qeshurat. Unë qesha aq shumë sa nuk më ka takuar herë tjetër në jetën time. Edhe sot më dhëmbin ijet.

Skeçi u zhvillua pak a shumë kështu:

Aktori Petro loste si fotograf shëtites dhe i minutës. Në skenë dolli për t'u fotografuar aktori Soto. Ky është një zdruktar i shkurtër dhe kopërdak me ca grushte prej

boksieri. Aktori Petro gatiti «aparatin» dhe iu lut aktorit Soto që të ulet në një fron. Froni ishte tepër i lartë dhe nga ata që përdoren në birraritë. Gjer këtu skeçi u zhvillua sipas tekstit e provave të bëra më parë. Por, kur aktori Soto zuri të rrijë në fronin e lartë, aktori Petro (pa dijeninë e Sotos e jashtë tekstit) shpejt e tinëz ja hoqi fronin...

Sotua u përmbys matanë më kokëzaj po aqe me forcë sa gjëmoi dyshemeja. U ngrit i xhindosur dhe iu vërvit «fotografit» me grushta:

— Po më shojte kokën, o më të lërofsha...

Aktori Petro u mundua të mbrohet:

— Pusho, mor hajvan, se jemi në skenë, mos se je jashtë tekstit...

Po Sotua as që bëhej merak se ish jashtë tekstit. Atij i shkante gjaku çurkë nga koka e çarë dhe e qëllonte ku mundëte:

— Ç'tekst, mor rufjan, mor qen bir qeni, ti më shojte kokën, mor të lërofsha...

U desh të ndërhyjnë disa partizanë që ndodheshin më afër se ndryshe do të vinte e gjatë.

Më vonë, orkestra e djemve të fshatit, dy mandolina e një kitarë, lojtën disa pjesë.

Soton e mjekuan infermierët e batalionit dhe doktor Pëllumbi konstatoi një të çarë në kokë. Dikush ndërhyri ta pajtonte Soton me Petron por kokëçari nuk pranonte kursesi.

#### 14 Gusht.

Në mëngjez, bashkë me Vaskën, bëmë një shëtitje jashtë fshatit. Qëndruam nga Llofka në mes të pyllit mb'anë një burimi.

Me vetulla të ulura Vaska më pyeti:

— Si i ke punët me Joanën?

— Asgjë nuk kam gjer më sot.

— Nuk i ke thënë gjë?

— Akoma jo.

— As me sy?

— Ah, jo, këtu ndryshon puna. Por unë nuk ta fsheh. Edhe ajo më do .

— Këtë e di, vetëkuptohet. . .

— Të ka thënë gjë?

— Jo, po njihet njeriu edhe nga sjelljet, e nga fjalët. Dhe fjala shkoi gjatë. Pastaj e pyeta unë:

— Po ti ku qëndron? Si shumë silllesh nga Vasja. . .

— Eee, për mua ndryshon puna. I kisha dhënë një fotografi dikur, por pardje se si ish bërë xheloze dhe ma dërgoi prapë me këtë shënim:

Merre se mund të të duhet t'ja japësh ndonjë tjetre.

Me të mbaruar lufta do t'u drejtohem prindërve të saj.

Sot ardhën u dorëzuan në Dardhë një grup nga rinija e ballit. Ishin të veshur si afendikonj e mbanin armë të reja. Njëri kish një automatik amerikan me kondak druri. Pa tjetër ky automatik ka qënë arma e ndonjë partizani, e kapur në luftën gjatë operacioneve të gjermanve. Por ballisti e mbante si pa të keq. Më vuri re që ja kisha ngullur sytë dhe u turbullua. Më pyeti:

— Me ç'punë merresh ti shok?

I tregova.

— Po, sigurisht e vetkuptova, puna jote është shumë e mirë.

Kështu më tha, por mua m'u shkrep t'i kërkoj llogarë për atë automatikun që mbante në krah. Vaska që kisha pranë e kuptoi që u nxeha dhe më hoqi më një anë.

## 18. Gusht.

Në shtëpinë e Kovaçit këtu në Dardhë ndodhet Komanda Partizane e Vendit. Efektivi i saj, prej nja njëzet vetash, përbëhet nga partizanë që janë pleq ose që janë shumë të rinj në moshë. Kjo komandë merret me mbajtjen e rregullit dhe qetësinë në popull si dhe me mosmarëveshje që mund të dalin midis fshatarëve në zonën tonë.

Në komandën e Vendit midis të tjerve ndodhet edhe partizani plak Hysen Agolli. Është një tip i rallë dhe

shumë interesant. Në luftë ka qënë trim dhe gjithënjë ka dalë faqebardhë, po tashti këmbët nuk e dëgjojnë dhe qëndron këtu si roje vendi.

Thotë se me Kolin, komisarin e komandës së tij, nuk ja çon mirë.

— Po pse kështu, o xha Hysen?

— Po ja, ore bir, më shoji ky Koli gjith mua më dërgon roje në bigllën e Drenovës. Pastaj që thua zotrote më mban nga dy sahat në ditë konferencë sa unë gajsem më këmbë dhe më bije gjaku ndër pllazë...

Por sot n'agim midis Hysenit dhe komisarit të tij ngjau një ndodhi që po e mbajnë nëpër gojë gjithë partizanët. Ma tregoi Hyseni duke qeshur e me një barrë lezet:

— «Që thua zotrote, sonte isha roje në bigllën e Drenovës vet për vetë. Aty nga sabahu dëgjoj një zile që po tingëllonte gjith e më këtej. Prita dhe ca kur nëpër errësirën njoha dy kuaj të ngarkuar dhe tri gra pas tyre. U fola ndal dhe ato qëndruan. I pyeta:

— Prej nga ju kemi, moj motra?

— Prej Sinice.

— Ku vini?

— Korçë...

— Ç'kini ngarkuar në kuajt?

— Miell.

— Po nuk e dini që është e ndaluar të shpini ushqime në zonën e armikut, nuk e dini që pas rregullit ky miell tashti u mbahet nga komanda e Vëndit?

— Jo, nuk e dimë.

— Si nuk e dini, xhanëm? Po burrat tuaj nuk e dinë?

— Po ne nuk kemi burra.

— Lerini ato llafe, s'ma hidhni dot mua, këta thasë kaq të rëndë nuk janë ngarkuar prej grash, këtu është dashur dorë burri.

Bëra mjaft llafe me gratë po më në fund sikur më ardhni keq. Po mendohesha ta shkel detyrën dhe t'i lëshoj të ikin në punën e tyre. Në atë rahman, një rosak bëri uak që nga samari. ca zoga cicëruan pas kocaqeve; një nga gratë i foli tjetrës:

— Thuaji, moj që je e ëma e Kolit, e komisarit. . .  
Unë kërceva përpjetë.

— Si the, moj, si the?

— Ja ore, unë jam nëna e komisarit tënd, nëna e Kolit.

— Ç'thua moj e uruar! Po aman moj, se unë ty të kërkonja. Ama ti je e ëma e Kolit!!! Fol moj e bekuar folë! . . . Ay yt bir më nxori thinjë të reja duke më mbajtur konferencë për ligje e rregulla, gjaku më ka rënë në këmbë prej atij, më shuajti së dërguari këtu në bigëll. Hajde prapa ktheu, hajde drejt në komandë, drejt në Koli, t'i tregoj unë atij se si është ligji e rregulli. Mos e dinja se je e ëma e Kolit, vallahi do të lëshonja. . . Lerini llafet. . .

Dhe i solla në komandë karasaba. Koli po flinte. I vajta drejt e brenda dhe e shpova nga brinjët:

— Komisar, o shoku komisar, ngreu një çikë, ngreu. . .

Ay hapi sytë.

— Ç'ke, ore?

— Ngreu vallahi, ngreu së zura tët ëmë dhe tët motër me dy barrë miell kontrabandë.

Koli u hodh nga krevati, sytë iu çapluan nga habija dhe iu bënë sa një mexhite njëri.

— Ja ku i ke ne porta, hajde, bëji ato të shkrojturat sipas atij rregullit që ma ke thënë nga njëqind herë në ditë. Shkruaji, shoku komisar, shkruaji, se sot do ta hamë bukën të grunjte e do të bëjmë petanik me pulë daç edhe me rosë.

Dolli Koli në porta, u thartua nga surati dhe iu përvesh sëmës sa e bëri fare palarë. S'i kam faj, vallahi. Unë s'i kam faj, rregulli është një për të gjithë.»

Kështu më tregoi vetë xha Hyseni. Koli ish atje dhe dëgjonte. Vinte buzën më gaz dhe tundte kokën.

## 22 Gusht.

Më pllakosi një e keqe. Dhoma ku punoj m'u mbush citë me morra. Kjo ngjan sepse disa herë në ditë vijnë këtu popull e partizanë për të dëgjuar emisionet shqip të radios. Vura re se morrat kanë hyrë edhe në levenxet.

Këtu në bazën ku banoj është një vajzë e re me emrin Noi. Është një çupë e bëshme me faqe të kuqe dhe shumë e shkathët. I kërkova ndihmë për t'u pastruar nga morrat. Më tha se është e gatëshme të më ndihmojë dhe se do marrë për ndihmë shoqen e saj Joanën. Kur m'i tha këto, më vështroi drejt në sy. Unë pranova dhe i thashë:

— Po pse Joanën dhe jo një tjetër?

— Sepse ti ke qënë më parë bazë në shtëpinë e saj...

Kish edhe diçka tjetër për të thënë, por nuk ma tha.

Pas dite të dy vajzat vunë kazane me ujë në zjarr dhe i përvëluan të gjitha rrobat e mija. Pëstaj përvëluan edhe drasat e dyshemesë. Në mbrëmje vura një megafon në porta e oborrit dhe e lidha me radion. Atje vura edhe një tabellë me shënimin «ndalohet hyrja». Tashti popull e partizanë i dëgjojnë lajmet e radios në oborr. Kur ra nata, ardhi këtu shoqja Olimbi. Është një leshverdhë e re dhe mjaft e bukur që punon në teren. Ajo është shumë e rreptë dhe shumë e zgjuar. Kishim hyrë thellë në bisedim mbi disa broshura që ajo këkon t'ia shumëzoi. Pëpritur, ajo e preu fjalën dhe m'u kanos me inat:

— Pse më vështron kështu?

Mua m'u duk sikur më pllakosi shtëpia dhe faqet më morën zjarr. U ngrita rrëmbyer dhe e lëshova gojën me urof. E ndjej fare mirë se e vështronja si zakonisht dhe nuk i pata asnjë faj. Kur pa që unë u nxeva dhe mora zjarr si i tërbuar, ajo e shtroi fjalën.

Në mbrëmje, dy nga dy e tri nga tri, më ardhën në bazë thujse gjithë çupat e fshatit. Po hapnja sytë dhe po u bënja vend, kur Rina e mori fjalën:

«— Mirse të gjetëm, o i zoti i shtëpisë; bukë e gjellë kemi sjellë vetë, kemi edhe punët e dorës, do të çëndisim yje, ti do bësh mirë të na mbash elektrikun ndezur dhe të na gjesh në radio muzikë. Do të ta kemi borxh për gaz e për të mirë, në dasmë. Odën plot me çupa e ke, mer një mollë dhe qëllo ku të duash...»

Shoqet e saja trokitën duart. Edhe Joana ashtu bëri. Kur fjala shkoi thellë dhe shakatë u shtuan, u ngrit Nora, këputi një mollë nga tavani ku ishin lidhur disa kokra, e duke ma zgjatur më tha:



— Mere mollën dhe qëllo...

Fytyra më mori zjarr, veshët më digjnin, buzët më dridheshin.

E mora mollën dhe ngrita dorën... Ato po hapnin sytë. Dikush vështroi nga Joana. Ajo kish ulur sytë.

Pastaj e unja dorën dhe e vura në gojë...

Atëhere krisën të qeshurat:

— Ke qëlluar më parë!

— Jo! Pas lufte mundet.

— Nuk më dukesh kaqe shenjt.

Filluan të më thumbojnë me shakara, me romuze, me të hedhura, me të pritura. Isha në mes vajzash, në mes të gazit, në mes të haresë. Dhe ndjehesha i turbulluar fort. Nga saksitë e dritoreve kundërmonte borzilogu, nga kopështi vinte era e luleve dhe jashtë nata ish e qetë.

— A s'na këndonin o vajza një këngë të fshatit!

Nuk donin në fillim, po prapë ma dëgjuan fjalën. Dhe oda u mbush me zërat e vajzave. Zëra t'ëmbël me tinguj të hollë, me hov rinije. Këndonin buzagaz me sy të qeshur, me kokën lart me gushët e çelura:

**Me gajtan, moj çupë,**

**Me gajtan ta mata mesin;**

**Mesi yt e posi ngjalë**

**Jepja trimit q'është djalë,**

**Bash bandill me yll në ballë...**

Pastaj s'di sa kohë pat shkuar e u ndje jashtë një kërsëllim i lehtë. Dikush po hynte n'oborr. U ndjenë tinguj kitare:

— Pa shiko, serenatë...

Ishin djemtë e fshatit. Hynë e u bëmë vend. Njëri më foli ngadale thujse në vesh:

— Qënke si Lumani në mes të zonjave...

Dhe nata shkoi me këngë e muzikë gjer n'agim kur filloi të çelë dita.

## 26 Gusht.

Në komunikatën që nxuarëm sot, vumë lajme të jashtëme dhe të brendëshme:

Ushtëria e Kuqe ka çliruar në Rumani qytetet Vaslui, Benderi, Belica, Kishinev e Tartu. Në Jug-Perëndim të Kishinevit janë rrethuar dymbëdhjetë divizione gjermane dhe është kapur rob një gjeneral hitlerian.

Trupat amerikane dhe partizanët francezë kanë çliruar Marsejën.

N'Itali armata e V aleate kapërxeu lumin Metano e ndodhet afër qytetit Tesaro.

Lajme të brendëshme:

Më 15 Gusht armiku rrahu me artileri Biranjin, Melcanin e Porodinën. Pas rrahjes së artilerisë katërqind gjermano-ballistë sulmuan me furi. Në orët e mesditës armiku mundi të hyjë në katundet e sipërme. Më vonë njësitë partizane të batalionit «Skënder Çaçi», të përforcuara edhe nga një kompani e batalionit «Tomorri», e sulmuan armikun dhe e detyruan të tërhiqet duke lënë pesëmbëdhjetë të vrarë.

## 2 /Shtator.

Numuri i njësive partizane po shtohet gjithënjë. Ditë e për ditë vullnetarë të rinj po vinë në radhët tona. Batalioni ynë rritet me një ritëm të shpejtë dhe kapërxeu numurin që duhet të ketë si batalion. Sot nga Dardha u nisën 100 partizanë nga batalioni i ynë. Ata shkojnë të inkuadrohen në brigadën e Njëzetë që do formohet së shpejti në Rëzë të Korçës. Me ta u nis edhe Zv/Komisari i Batalionit Maqua.

## 4 Shtator

Mbrëmë, në sallën e shkollës së Dardhës, u dha një çfaqje teatrale për popull e partizanë. Çfaqja është përgatitur nga partizanët e Batalionit tonë, të brigadës së dytë dhe nga të rinj të fshatit. Pastaj Petrua dha skeçin «Doktor pilafi» dhe «Tre veta në një krevat». Tashti është duke u përgatitur pjesa e vogël teatrale «Akimi». Sot ndamë rolet dhe bëmë provën e parë. Unë mora pjesën e Naumit, Joana të Jamskajës, Gaqi të Pucmuqit etj.

Gjatë provës unë nuk e kisha mëndjen fare. Vaska më shihte ashtu e qeshte. Rrinja si më gjëmba. Pas provave hymë në një sallë të madhe ku është një kapicë gru-

rë e batalionit. Dërgova dy djema dhe sollën radiomë me gjithë baterinë. E instalova dhe mundëm e gjetëm një stacion me muzikë vallzimi. Dhe vallzuam. Është kjo shkelja e parë e rregullit të vendosur gjer më sot. Gjer tashti gjatë jetës partizane askush nga ne nuk ka vallzuar. Nasi Pavllua tha se ky «agjërim» u gjend i pavënd në Kongresin e Parë të Rinisë.

Pas disa minutash më ra radha dhe vallzova me Joanën. Zemra po më copëtohej. Më dukej se nuk isha më këmbët për tokë. Sa shumë e dua, sa shumë! Ndofta nuk më ka hije ta thom, po vallë a kam faj unë? A ka faj mosha ime?

Ja tashti e kisha pranë, fare pranë. Ndjenja frymën e saja në fytyrën time. Ndjenja dritën e syve të saj të zinj që më vështronin shpejt e rrëmbyer, kisha dorën e saj në dorën time. . . dhe dora i digjte si prush. Fije të flokëve të saja më kalonin pas faqeve, goja m'u tha e buzët më dridheshin. Isha si n'ëndër. E urdhërova vehten time t'i flas diçka por gjuha nuk m'u bind. Dridheshja si prej ethesh. Atëhere guxova dhe ja shtërngova dorën: Një herë, dy, tri. Të katërtën herë ajo nënëqeshi dhe uli sytë. Kur muzika pushoi, munda dhe i thashë:

— Kur të dalim takohemi?

— [Po, — u përgjegj. Dhe qeshi. Faqet i flakërinë, sytë iu ndezën dhe më vështroi me pasion, me gaz të dliër, me miratim.

Pas pak u takuam ne porta e saj:

Nata ish e kthjellët, pylli përtej shushurinte, krojet e fshatit gumëzhinin. Kaluam nëpër kopshtin e saja, nëpër drurë, nëpër lule, anës ledhave. Patëm shkelur lulet se u ngrit era e najzmës, u përzje aroma e pelinit, kundërmoi borzilogu.

Dhe ndejtëm mbi tufa bari. Bar shtatori, i trashë, i butë, me erë të fortë.

Pastaj m'u zgjidh gjuha:

— Ndofta nuk bëjmë mirë.

— Pse?

— Jemi në luftë, gjithçka mund të ngjasë.

— Mos thuaj ashtu, folë diçka tjetër.

Dhe më qëlloi në kokë me një bisk pjergulle.

Ajo më qëllloi dhe unë mora hakë. Hakë të vullëshme. Hëna ish e dobët, hija e pemëve e thellë dhe gjë nuk dukej. Ndejtëm gjersa na kujtoi flakërimi i agimit.

Pastaj shkova ne Vaska. Po flinte i shtritur përmbys. Ndeza një qiri dhe ja ngjita mbi krevatin e tija. Pastaj mora poçen e ujit dhe ja vërvita mbi kokë. Ay kërceu për-pjetë i lebetitur e s'po merte vesh gjë. Ja tërhoqa jorganin dhe e zvarosa për këmbë. Çela fletët e dritores, hapa krahët anash e duke u lëkundur mbi majat e këmbëve, mora frymë thellë. Gazi më këndonte përbrenda.

— Çou, Vaso! Kalaja u muar!

Ay fshinte kokën me peshqir dhe qeshte.

### 6 Shtator.

Në mesditë ardhë u dorëzuan pesëmbëdhjetë ballistë e xhandarë. Nga biseda që pata me disa prej tyre kuptova se balli është duke u prishur krejt. Krrerët e tij zihen për poste e të gjithë vetë quhen komandant e prefekta. Gjermanët nuk interesohen më për plane operacionesh që u paraqit balli. Si duket ata e ndjejnë që shpejt do të detyrohen të ikin prej këtej. Një oficer i xhandarve më tregoi këtë episod:

Ishim n'ja njëzet veta në Cangoj e rastisi që një major gjerman ta kalonte natën bashkë me ne. I gatitëm një darkë të mirë me raki e meze dhe pas buke njëri nga ne i bëri gjermanit këtë pyetje:

— Të lutem të na thuash cilët janë më trima, ballistët apo partizanët?

Gjermani na u përgjegj:

— Partisan lufton, balist ha pula!

Nxuarëm komunikatën, ku midis tjerave vumë këto lajme: Ushtria e Kuqe ka çliruar në Rumani qytetin Brasov, Valea Mare, Krajova e treqind lokalitete. Gjatë betejave kanë mbetur të vrarë trembëdhjet mijë gjermanë. Në Belgjikë trupat aleate çliruan Brukselin dhe Anversën dhe arijtën në kufirin gjerman. N'itali armata e V ndodhet 10 km. nga Rimini.

### 10 Shtator.

Sot vajta në një miting të madh në pyllin e Shën Konstandinit mbi Bradvicë. U nisëm nga Dardha në mën-

gjez me nj'a njëzet partizanë të «garnizonit» dhe me gjithë rininë e Dardhës.

Rruga kalon nëpër male të bukur, zbret nëpër përrrenj të thellë e të pyllëzuar ku dielli nuk ze as dimër e as verë. Afër Bradvicës rruga kalon nër disa livadhe ku duken si krëhërë të dalë prej dheut një varg maresh të vjetër. Pyeta një çoban plak mbi ata mure e gërmadha. Më tha se dikur aty ka qënë një fshat i madh me emërin Moravë.

Mëngjezin e hëngrëm në një burim afër Lëndinës së Shqerave. Nuk kisha bukë me vehte, por Noi dhe Joana më ftuan dhe hëngra bashkë me 'to.

Hanim dhe qeshnim dhe këtu afër është Joana me faqet e kuqe dhe sytë e thellë. Po më vështron me ngulm... Ndjej një shqetësim t'ëmbël. Natyra është e bukur e më duket sikur po qesh. E bashkë me pyllin që shushurin, me lajthishtat e portokallta që nanurisen nga filladi, me ujrat si shkumbë që gumëzhijnë nëpër shkëmbinjtë, me boçat e pishave që u xixëllojnë si inxhi bulëzat e shirës... bashkë me këto edhe unë qeshem. Ndjem lumtur; aqë i lumtur sa më vjen t'u bëhem shok pëllumbave dhe bashkë me 'ta t'i biem kryq e tërthori qiellit të kulluar.

Afër mesditës u mblodh populli nga të gjitha anët e Devollit. Pylli ushëtinte nga gazi e hareja. Fjalimin e rasti e mbajti shoku Mina, kryetar i Këshillit N. Çl. për rrethin e Devollit. Pastaj nga partizanët e batalionit u dha një çfaqje teatrale; Në një skenë të çfaqjes, një grup xhandarësh varin në litar një partizan. Rolin e partizanit që varej e lojti komisar Faiku. Ay diji ta interpretojë aqë mirë sa njerëzija nuk i mbanin lotët. Prapë skenës Joana qante e nuk e pushonja dot. Pas çfaqjes ngjau një e papritur: Një grua shtatzënë nga emocioni i çfaqjes, e zunë të prerat dhe dështoi.

Pak më vonë dikush ardhri nga Korça dhe dha lajmin se Ushëria e Kuqe ka çliruar Sofjen. Atëhere u bë një lëmsh e rrëmujë. Nga gazi filluan të shtënat e armëve, flakje bombash, britma e thirrje triumfi.

Gjer në mbrëmje vazhdoi festa. Pastaj u vumë në rrugë. Batalioni zbriti sërish në fushë.

## 25 Shtator.

Lajmet që vinë nga qyteti thonë se balli u shkatërua krejt. Bashibozukët e mbetur rrugëve u rrijnë pas gjermanëve si shërbëtorë. Hitlerianët po hiqen nga Greqia me kollona të gjata duke përshkuar xhadenë e madhe Janinë-Korçë-Manastir.

Në emisionin e saj të sotëm radio Bari tha:

Njësitë partizane të Brigadës shtatë çliruan Beratën dhe Kuçovën. Njësi të forta partizane kanë sulmuar Tiranën midis datave 4 e 7 Shtator. Kuislingët e Tiranës po ndërtojnë mbrojtje, ndërsa populli bashkëpunon hapur me partizanët. Këta kanë kapur afër Tiranës një autoveturë të shtabit gjerman.

Brigada e parë ka kapur në Krujë 61 gjermanë rob.

Njësi të Korparmatës së parë partizane kanë çliruar zonat e Dibërës dhe Peshkopisë. Në Greqi partizanët kanë çliruar Salaminën dhe Larisën.

## 27 Shtator.

Herët në mëngjez u nisa për në Boboshticë. Vajta atje të interesohem për një makinë shkrimi Oliveti që duhet të kish ardhur nga Korça dhe akoma nuk po duket.

Në Boboshticë takova shokun Nastas. Ky më tha se makinën do ta nxjerrë njësi i Drenovës. Më drejtoi për atje.

U nisa për në Drenovë, duke kaluar pas skërkës dhe livadheve. Ecnja me kujdes me pushkën në krah të djathtë e tytën poshtë, se ja, ndonjë kilometër më poshtë kalon xhadeja e madhe ku vozitin gjermanët.

Dhe këto ditë kollonat e gjermanëve, që tërhiqen në drejtim të Manastirit, nuk kanë të sosur. Si po duket kjo është tërheqja e gjithë forcave të tyre nga Greqia.

Në Drenovë takova Kiçon dhe i fola mbi makinën. Ay më tregoi se qysh në mëngjez një shok i njësitit të Korçës me emrin Mihal është duke u vërtitur poshtë e lart në post-bloku për të nxjerrë makinën. Pastaj u duk Mihal duke hequr pas një kalë të mbrehur në karrrocë. Na

tregoi se po bën sikur transporton plehë nga qyteti në arat gjer të gjejë rastin e volitshëm të futë makinën në mes të plehut. Gjer tashti kish bërë katër rrugë nga Korça në Drenovë dhe gjermanët e post-blokut e kishin kontrolluar tri herë karrocën me plehë. E pyeta:

— Po si ke ndërmënd ta nxjerësh?

— Po, ja, duke kaluar dendur me plehë atje, gjermanët mund të mos më kontrollojnë më...

— Po; mirë, po kjo «mund» s'është e sigurtë!

— E po si t'ja bëjmë ndryshe? Makina duhet nxjerrë.

— Po sikur të ta gjejnë makinën?

— Ikën makina, e marin...

— Po ti?

— Unë? — Mihali nënqeshi. Tundi kokën e foli duke ngritur supat:

— S'do mënd, unë mbaroj, s'u ik dot atje në post-blok, i kanë mitrolozat ngritur.

Ja kjo është heroizëm.

Atje në mal luftohet me pushkën në dorë e me shokët pranë, po këtu qënka më vështirë. Të kapin e nuk mund të mbrohesh.

Me Kriçon ndejtëm ne mulliri i fshatit në pritje të Mihalit. Ish ora nja 10 kur u ndje një uturimë aeroplanash. Që nga ana e Voskopojës u duk një valë tremotorësh. Ishin gjashtë. Njëri kalonte përpara. Vura dylbinë në sy. Menjëherë dallova shenjat aleatë. Aeroplani i parë, me të mbrritur në qiellin e Korçës, lëshoi një shënjë që m'u duk si një vetëtimë e kuqe. Kur mbrijtën pesë aeroplanët e tjerë ku xixëlloi shenja... lëshuan bombat.

I tronditur vështrova qytetin me dylbi. U mbulua nga një pluhur i murmë. Pra aeroplanat aleatë bombarduan qytetin. Pilotët e tyre nuk çanë kryet për banorët. Ata qëlluan mu në mes të qytetit bash në kohën kur kollonat gjermane po zvarisen pa krye e pa fund nëpër xhadenë e madhe..

Mendova në çast se mos ishin aeroplanë gjermanë, por jo, se kundërajrorët gjermanë po vazhdonin t'i qëllojnë. Pas gjysëm ore u dukën në Drenovë vargje e tur-

ma Korçarësh, që iknin nga qyteti. Na treguan se ishin vrarë shumë njerëz.

Dhe nëpër turmën që vështronte nga qyteti, Mihali mundi të dalë bashkë me makinën që prisnja.

E mora makinën në dorë. Ish fare e re. E falënderova Mihalin dhe Kiçon dhe u nisa për Dardhë me makinën në shpinë.

## 2 Tetor.

Ka disa ditë që jam duke shumëzuar në qindra kopje një deklaratë të Frontit Nacional Çlirimtar mbi të drejtat e qytetarve në regjimin e demokracisë popullore. Deklarata ka rëndësi të posaçme pasi komisari më ka urdhëruar të lë çdo punë tjetër dhe të merrem veç me shumëzimin e saj. Në 'të flitet mbi të drejtat e popullit, për lirinë e besimeve, pronën private, inisjativën private etj. etj.

Nga lajmet e radios dhe nga ngjarjet e përditëshme po duket e qartë se gjermanët dhe veglat e tyre këtu i kanë ditët e numëruara.

## 11 Tetor.

Vjeshta ardhë me të sajat: Shi, mjergull, erë e ftohtë, baltë. Askujt nuk i shkon mendja se dimri i ardhëshëm do të na gjejë nër male.

Dita me ditën pritet urdhëri të sulmojmë qytetet.

Sot nxuarën komunikatën me këto lajme:

Ushtria e Kuqe, në veri-lindje të Memel, çliroi 300 lokalitete dhe doli në breg-detin e Baltikut.

Në bregdetin shqiptar trupa komando-aleate dhe partizanët e ushtrisë N. Çl., me luftime t'ashpra dhe të kombinuara hynë në Sarandë dhe kapën shumë robër gjermanë.

Radio Bostoni, në emisionin shqip, para se të merrte «jastëkun e fjalës» tha:

Më shumë se 600 gjermanë u kapën në Sa-



randë nga trupat aleate dhe partizane. Veprimet e partizanve shqiptarë kanë bërë përshtypje të thellë n'opininion dhe shtypin amerikan. Komiteti i shqiptarëve t'Amërikës ka paraqitur një rezolutë me anën e të cilës kërkon që të njihet pushteti i patriotëve shqiptarë.

### 13 Tetor.

Sot na ardhì një urdhër i papritur:

I gjithë batalioni «Fuat Babani» të nisët për t'u inkuadruar në brigadën e IX që po formohet në Lozhan.

Mblodha gjithë materialet e teknikës i lidha në denge dhe i nxora në oborr. Pas pak më thiri shtabi i batalionit. Më urdhëruan që gjithë materialet e teknikës t'ja dorëzoj brigadës së dytë që ndodhet në Dardhë. Unë hezitova, por komisarì më tha se në Lozhan do të gjejmë një teknikë krejt të re, që është sjellë nga Korça.

M'ardhi keq që po ndahesha nga veglat e mija të punës. Duke m'u dredhur duart dhe me zëmër të vrarë i dorëzoza Nunit e Muços të gjitha e një e për një: Tri radio «Condor»; tre megafona, dy shaptillografë, dy makina «Olivetti» të mëdha, tri makina «Everest» të vogla, bateri, dinamo, ripa, llampa, letër, bojë, tela. U dorëzoza edhe tryezën me karigën (pronë e ish komunes). Në fund më lindi një ide. Një të thënë e një të bërë, nuk pyeta njeri, veprova «partizancë»: një radio «condor» ia dhurova këshillit N.ÇI. të katundit Dardhe.

Pastaj shkova në Joana për t'u lënë shëndet. Isha shumë i dëshpëruar megjithse mundohesha mcs dukem, i zyrtë. Ajo vuri re se më ish këputur një kopsë e palltos. Mori pe dhe gjëlpërë dhe më ftoi në kopësht për të ma qepur. Shkuam në kopësht. Ishim vetëm të dy në mes të drurëve pa fletë. Pas ndonjë ore dualëm nga kopështi. Isha pik e vrer.

I gjithë populli i Dardhës u mblodh në shkollë të na përcjellë. Disa qanin. Joana më shihte nga larg me sy të përplotur. Në kisha vargu i partizanëve filloi të kalojë në njëshkollonë. Tri mushkat e «teknikës» i ngarkuam me municione.

Duke kaluar bëmë toka me gjithë dardharët, u përshëndoshëm dhe shkëmbyem urime. Në fund zbrazëm një batare dhe vijuan rrugën drejt përpjetë nga Biglla.

#### 14 Tetor.

Mbrëmë udhëtuam gjer pas mesnate. Kaluam nëpër Boboshticë. Ndënë fshat dikujt nga ne, pa dashur, iu zbraz pushka. Kaluam me kujdes xhadenë ku vozitin gjermanët dhe arrijtëm në Dërsnik.

Këshilli i katundit na ndau në baza. Këtu ndodhen edhe partizanë të tjerë. Sot në mëngjez takova Noin. Është partizane në një batalion të Rëzës. Në shtëpinë e saj në Dardhë kam banuar një kohë të gjatë. Më pyeti se ç'thoshte e ëma kur ajo iku partizane pa i marrë lejë.

Pas dite u nisëm në drejtim të Lozhanit.

#### 15 Tetor.

Mbrëmë arrijtëm këtu në Lozhan. Fshati është i vogël dhe i mbushur plot me partizane. Në një dhomë ndodhemi nja dyzet veta. Të tjerë flenë në plevica dhe jashtë pas gjerdheve.

Koha u prish dhe veson shi. Rrugët janë plot me baltë, era fryn e ftohtë dhe ka rëzuar fletët për tokë. Fshati ka gjallëri. Rrugët janë plot me partizanë. Nëpër kopshtet po vjelin pemët. Vjen erë mollësh e dardhash. Kokrrat e mëdha të ftoit edhe nuk janë vjelë dhe kundërmojnë n'afomë. Degët u janë rëzuar e u mbahen pas gjerdheve.

Nga ora 12 më thirri shtabi i batalionit. Duke ngjitur shkallët e godinës, vura re një tog të madh me ruzh zbrazur në disa rrogoza. Më tej Loni me një fletore në dorë diçka shkruante. Dikush më tha se Loni do të jetë in-tendent i brigadës dhe komisar Llaqi Ziçishti. Kjo më gëzoi. Llaqi nuk ndodhet këtu e pritët të vijë nga zona e Gjirokastrës.

Lart në dhomë Faiku më tha:

— Këtu në Lozhan nuk gjetëm asgjë për teknikën e

brigadës, bëmë gabim, që teknikën tonë ja lamë brigadës së II. Prandaj nisu për në Dardhë e shko i merr të gjitha materialet që i dorëzove Nunit.

— Po kur të nisem?

— Po deshe ja, që tashti... Kërkoj Lonit bukë e gjellë.

Poshtë Loni më dha një copë bukë e një vesh rrush. U nisa për rrugë, kur jashtë fshatit më arrijti një partizan duke më thirrur:

— O shoko, o shok, dale qëndro.

— Ç'është, more?

— Prit një minutë, është një shoqe e terrenit që do vijë në Dardhë. Prite të shkoni bashkë.

Nuk vonoi dhe shoqja ardhi. E njihnja veç me emër. Është e re, e bukur, e veshur partizane me xhaketë e pantallona. Vijuam rrugën të dy. Udhës na ra mjergull. Vende-vende takuam druvarët dhe i pyetnim për rrugën. Afër mbrëmjes arrijtëm në Polenë. Na dhanë darkë, bukë e rrush para një porte. Aty u shtruam dhe hëngrëm dhe pastaj një djalë i njësitit na shoqëroi për në Dërsnik.

## 16 Retor.

Ndodhem në Dardhë. Natën që shkoi u lodha tej masës. Shoqja u ndodh e fortë e trime dhe i qëndroi provës së rrezikshme që kaluam.

Prej Polene arrijtëm në Dërsnik nëpër një errësirë të zezë sterrë.

Tre djem nga njësiti i Dërsnikut na shoqëruan sa kapërxyem xhadenë. Pastaj vijuam rrugën të dy me shoqen. Ecnim nëpër ara, rëzime e përrenj, pa ditur rrugën. Errësira ishte e zezë dhe në horizont shquhej veç një si farë tehu, kulmi i varg-maleve të Moravës. Ne ecnim drejt tij për të mbërritur në Boboshticë. Herë-herë vesonte, një shi i ngadalshëm, por i dëndur. Më tej shiu u bë më rreptë dhe ne ndëjtëm ndënë disa manafëra. Larg në xhade dëgjoheshin motorat e gjermanit.

Ndëjtur ndënë ferrat filluam bisedën. Folëm mbi kullonat gjermane që po iknin gjithënjë e pa pushim, për

markat e armëve, për efektin e bombave dhe granadave, për plumbat me plasje.

Kështu është koha: një djalë dhe një vajzë, në mes të natës dhe errësirës, vetëm dhe të strukur pas ferrave, bisedojnë për luftë.

Po vallë a nuk kishin gjë tjetër për të folur?

Po të them jo, gënjej.

Se ja, mbrëmë natën aty ndënë manaferra, për një çast na u pre fjala. Ah, sa e rrezikëshme është ajo heshtje kur një vajzë dhe një djalë janë vetëm dhe në mes t'errësirës. Unë heshta dhe ndjenja sikur zëmra më qëllonte me forcë dhe me ngulm. Dhe, po të mos ish zhurma e shiut që binte, unë do të dëgjonja edhe rrahjet e nxituara të zëmrës së shoqes aty pranë.

Desha t'i flas, t'i shprehem gjatë e me shpirt, por jo! i vura zëmrës gur dhe u ngrita për rrugë. E bëra këtë shpejt, nxituar dhe si me inat. I fola:

— Nisemi!

Dhe u nisëm.

Që mos humbisnim n'errësirë ajo mbante çipin e palltos sime. Ecnim nëpër misërore dhe kallëpët e misrit na rrihnin gjunjët.

Pa pritur dëgjuam këngën e një këndezi. Boboshtica duhet t'ish pranë. Nxituam hapin dhe ja, hymë në shtëpitë e para. Ecëm duke përkatur me dorë muret e shtëpive. Po mendonja të gjej ndonjë portë për të trokitur, kur ja disa hapa më tej pashë dritë. U afruam andej. Pastaj vumë re se drita delte nga një dritore mbi rrugë. Pra atje duhet të kish njerëz që rrinin zgjuar. Aty afër ndë në dritoren gjeta portën. U dëgjua një kafshë që shkrofë-tinte dhe përtypte me shijë diçka si fletë misri. Me kondakun e pushkës trokita tri herë në kanatën e portës. Brënda kërciti një derë. Një qen u mundua të lehë. Pastaj një çap i rëndë iu afrua portës nga brënda i hoqi llozin me nxitim dhe një zë i llahtarshëm u shkreh në gjermanisht disa fjalë që s'mora vesh në ishin fjalë apo sharje.

Në fshat ishin gjermanët!

I thirëm vrapit nga kishim ardhur, kûr gjermani lë-shoi disa të shara dhe qëlloi me revolver.

Nëpër oborre e rrugë kërcitën çape të rëndë, batare automatiku fishkëlluan n'ajër. Ne rendnim mëndje-marrë pa ditur ku vemë. Duke rendur anës mureve kaluan përbri nesh hije gjermanësh që nxirnin disa thirje e kërcënime në një gjuhë t'ashpër plot tmer.

Më tej, diku më larg, u ndez një roketë. U ngjit lart në qiell, qëndroi një çast aty dhe prapë u lëshua tatë-pjetë duke lëshuar një dritë të verdhë. Nëpër dritën e saja pashë shtëpitë e fshatit. Kishim bërë gabim: nuk ishim në Boboshticë, por ishim në Dvoran.

Gjermanët ishin n'alarm. Ay qeni i fëlliqur, që na hapi portën kur trokitëm, dyshoi nga rendja e jonë dhe kish dhënë alarmin.

Shoqja më vinte pas dhe shtërngonte çipin e palltos s'ime.

Për fat gjermanët po ndiznin roketa nga ana tjetër e fshatit. Diku pas një plevice u ndez një roketë tjetër. Kjo ishte m'afër nesh. Atëhere vura re se ndodheshim afër disa gjerdheve dhe rëndëm të fshihemi andej. Prapë ra erësira dhe një çap i rëndë po na afrohej. U turëm nga ana tjetër, u penguan nëpër disa trarë e makazë dhe u shtrimë barkaz.

Pastaj ra qetësia. Rokatat u shuan. Bataretë u prenë, dritat zunë të fiken. Veç zëra t'ashpër e çape të rëndë silleshin nëpër fshat. Me duar e këmbë filluam të zvarisemi. Pa pritur koka m'u përpoq në diçka të fortë. Qëndruam dhe me duar hetova përpara. Isha përpjekur pas një strumbullari. Pra ishim në lëminjtë e Dvoranit.

Tashti dinja se ku ndodheshim. Ja pikërisht këtu në lëminjtë e Dvoranit isha ndodhur disa muaj më parë. Shoqja për bri filloi të më thotë diçka. I vura dorën në gojë. Përsëri u ndjenë çape që afroheshin. Rashë barkaz dhe shoqja, pa ditur ku u shtrita unë, u plas mbi mua. Pushkët na u përpoqën dhe lëshuan një zhurmë të thatë. I foli ngadalë:

— Mos lëviz, mos folë.

Dhe n'atë çast, kur ajo ish ngjitur mbi mua, n'atë çast të vështirë kur gjermanët po nuhatnin për të na kapur, unë ndjenja për atë shoqen aty një dashuri të thellë prej zemre. Unë e desha n'atë çast shkuar motrën, shkuar nënën. E desha me shpirt ashtu si veten t'ime. Sepse s'mund të ketë më të fortë e më të sinqertë dashuri se ajo që të lidh me atë njeri që ke pranë kur ndodhesh në gojë t'ujkut ndënë hundën e vrasësve që të ndjekin.

N'ato çaste, kur ndjenja mbi trup trupin e asaj vajze trime e të bukur, unë isha me zëmë të larë.

Kush ka rojtur çaste të ngjashme n'orë frike, kur vdekja të përgjon mbi kokë, ay do të më kuptojë.

Sërish filloi të bjerë shi. Çapet e gjermanëve nuk po ndiheshin më. Atëhere u ngritëm dhe ngadale filluam të zvarosemi nëpër arat përpjetë. Pas gjysëm ore ndodheshin në Boboshticë.

Ne Kicua hëngrëm bukë. Na pyetën mbi të shtënat që kishin dëgjuar. U treguam ç'na kish ngjarë. Me gjith këmbënguljen e tyre, ne nuk qëndruam. Shoqja sikur u hepua e desh të qëndrojë, por unë u nisa. Atëhere edhe ajo m'u vu pas.

Muarëm përpjetë skërkën e Moravës nëpër xhadenë e Dardhës.

Ishim të lodhur për vdekje. Po përsëri ecnim. Ecnim dhe çlodheshim.

Shoqja më foli për rezikun që kaluam, u shpreh me zemër të hapur e desh të më lëvdonte, por unë ja preva:

— Kryesorja është që shpëtuam; e po të duash të dish për kusurin, mëso se unë jam një gomar pa samar që të futa edhe ty mu nënë hundët e gjermanëve. Në një bryll të rrugës, afër kaliveve të çobenve, qëndruam më gjatë.

Frynte erë e ftohtë dhe binte shi. Gjysmë të shtrirë na mori gjumi. Por shpejt ija e djathtë m'u mpi pas tokës së lagësht dhe u zgjova. Prapë u vumë në rrugë. Lart në Bigëll na zuri dita. Atëhere vumë re se ishim të mbytur në baltë nga koka në këmbë. Shoqja ish e zbehtë, por sytë i ndritnin dhe rrinte buzëgaz. Më tej më foli:

— Do të të kem vëlla për gjithënjë.  
— Edhe unë do të të kem motër.  
Sikur mori kurajo dhe më tha:  
— Po të kishim patur mëndime të liga gjatë rrugës,  
pa tjetër do na kishin vrrarë.

Më tej ajo kërkoi t'i jepnja kollanin e fishekëve duke e shkëmbyer me vezmet që kishte ajo.

E kuptova ku e kish hallin: Ndërsa kollani mbahet rreth mezit vezmet e fishekëve kanë dy ripa të gjërë, që duke kaluar mbi supa, rëndojnë mbi gjoks. I fola:

— Po ti mirë i ke vezmet?

Ajo qeshi.

— Ti kot thua ashtu... Ti e kupton se ripat e vezmeve më pengojnë.

Nxorra kollanin dhe ja dhashë. Pastaj më tha ta ndihmonja të nxjerë vezmet. Por unë nuk e ndihmova se kisha frikë nga duart e mija.

Kur lindi dielli, një diell i ftohtë i mjergulluar nga retë, hymë në Dardhë.

E mbajta frymën në shtëpija e Joanës. Më pritën me dashuri. Joana po hapte sytë. Përsëri më ishte këputur një kopsë e palltos. Vajtëm lart në koridor.

Theodhori i vogël më pyeste nëse i solla automatik «prej vërteti».

Gjer pas dite fjeta si i ngordhur, pastaj vajta në Nuni në teknikën e brigadës së dytë. U tregova arsye e ardhjes s'ime në Dardhë. Nuni m'u përgjegj:

— Komandanti i brigadës ka shkuar në Shtabin e Përgjithëshëm dhe pa dijeninë e tija unë nuk mund të bëj dalje një teknikë të tërë, që tashti figuron në inventarin e brigadës.

Kur e pashë se Nuni nuk tundej, i shkrova shtabit të brigadës së IX dhe i kërkova të ndërhyjë.

## 23 Tetor.

Po bëj një javë në Dardhë duke pritur përgjigje nga shtabi i brigadës s'ime, mbi çështjen e teknikës. Gjatë këtyre ditëve kam punuar bashkë me Muçon dhe Nunin.

Mbrëmë ardhi këtu një batalion i brigadës së IX. Përbërja e tij është afërsisht ajo e batalionit «Fuat Babani» Takova komisarin dhe i tregova mbi çështjen e teknikës. M'u përgjegj:

— Tashti do ta ngrejme teknikën në Korçë...

— Sikur nuk më besohet.

— Ja do të shikosh.

Pas dite batalioni u vu në rrugë tatëpjetë Devollit. U nisa edhe unë me shokët. Afër mbrëmjes arijtëm në Braçan të mbytur në baltë dhe të qullur nga shiu.

## 24 Tetor.

Natën që shkoi, nëpër një shi të dendur, mbrijtëm këtu në Trestenik. Fshati është mjaft i pasur dhe ka toka pjellore. Ka qënë fshat i ballit. Po balli tashmë ka vdekur. Një grup të rinjsh na pritën mirë dhe na ndanë nëpër baza.

Dualëm në një arë jashtë katundit dhe aty u shpërndanë nëpër partizanët një sasi mjaft e madhe veshmbathjesh të reja. Intendenti më dha mua një veshje të re komplet: Të brëndëshme, çorape, këpucë pantallona, xhaka-vento dhe mbi të gjitha një kapotë leshi kaq.

Ndjehem i gëzuar, jo aqë se u veshja me të reja, por kur njeriu vishet pastër e mirë ndjen një freski në vetete.

Në një qoshe t'arës komisarri filloi të thëresë komandantët e njërive të batalionit. Aty mora vesh se natën do të sulmojmë Bilishtin. Filluam të vajosim armët, u ndanë fishekë, bomba, granada.

Pas lajmeve që dëgjova në radio ditët e fundit në Dardhë, besoj se luftimi i Bilishtit do të jetë i fundit. Gjermanët u tërhoqën nga Greqia dhe kollonat e tyre po ikin gjithënjë nëpër xhadenë e madhe.

Afër mbrëmjes dualëm në një çukë mbi fshat dhe vështruam me dylbi nga Bilishti. Në bashkija dallova një bateri me nj'a njëzet topa të rëndë. Disa tankse ishin më poshtë dhe rrugët e qytetit ishin plot me gjermanë.



Pra sonte gjermanët do të na presin me armë të rën-  
da e forca të shumta.

Të shohim.

25 Tetor.

Mbrëmë natën u nisëm nga Tresteniku. Kaluam afër Kapështicës nëpër vreshtat dhe dollëm përmbi malin shkëmbor mbi Bilisht. Në errësirën montuam mortajën e rëndë. Një kompani e jona mbeti në fushë dhe ngriti priti në xhade.

Në mesnatë, me dy shokë, dualëm mbi majën e një shkëmbi dhe shihnim kandilat e fshatrave të Devollit.

Pas pak u dukën dritat e një autokollone gjermane në xhadenë e madhe. Autokollona kaloi nëpër Bilisht dhe, duke vijuar për Kapështicë, u godit nga prita e jonë. Filloi një luftim i ashpër që vazhdoi afro gjysëm ore. Autokolona do të kish patur edhe autoblanda se u dukën ngjyra si zinxhir që u përhapën gjatë fushës. Ishin qitjet në batare të autoblandave me plumba pëlçitës.

Atëhere u ndje një urdhër nga komanda e jonë:

— Të gjithë nëpër vendet!

E lamë shkëmbin. Mortaja e jonë hapi zjarr. Predha e parë fluturoi përpjetë e pastaj zbriti poshtë qytetit. Plasi diku përmbi bashki. Një kompani partizanësh u hodh në sulm drejt Bilishtit.

Edhe armiku nuk vonoi të na përgjigjet. Zjarri i tija ishte i dendur, i pa ndërprerë. Përveç mitrolozave sharës, ata vunë në përdorim edhe artilerinë e rëndë. Gjylet e armikut, të kuqe si zjarr, çanin erësirën e natës me fishkëllima të mprehta dhe vërviteshin pas përrenjve. Dukej sikur mori zjarr e flakë mali shkëmbor mbi Bilisht. Gjylet kërcisnin dhe e shtynin erën aqe me furi sa kur pëlçisnin afër, ndjenja një dhëmbje në bark sikur më qëllonte njeri me grusht në kërthizë.

Zhurma e plasjeve sa vinte bëhej m'e dendur. Toka po rrihej si me një kopan të pa dukur prej zjarri. Më dukej sikur të gjitha shpellat, të gjithë përrenjtë, gjithë gër-

xhet, shkëmbinjtë e rëpirat, kishin hapur nga një gojë të madhe e të pa dukur dhe ulërinin, çireshin, gjëmonin.

Kompania që u hodh në sulm nuk mundi të hyjë në Bilisht. Tre shokë ishin plagosur rëndë, kurse të tjerët kishin zënë vend në vreshtët e Bilishtit.

Dëgjova që thërisnin infermierin:

— O Llambi! O Llambi!

Më tej u dëgjua zëri i Ndrekos:

— Rrugën e Vërnikut, kush e di rrugën e Vërnikut?

Ja e dinja unë, po ku ta gjenje n'atë erësirë kur gjylet po shkallmonin shkëmbinjtë e malit. Filloi të bjerë shi i dendur, rallë herë vetëtinte. Dhe kur shkrepse rrufeja, gjylet që pëlcisnin n'atë çast nxirnin një dritë mavi të thellë.

I fola Ndrekos:

— Unë e di rrugën e Vërnikut, po në këtë erësirë...

— Leri llafet, — m'a ktheu ay, — nisu shpejt në krye të shokëve që po transportojnë të plagosurit. Shpjerini në Vërnik dhe që atje t'i nisin për në spitalin partizan të Maqedhonisë. Nisu!

I gjeta të plagosurit. I mbanin një grup shokësh shtrirë nëpër kapota në vend të barellave. U fola:

— Ejani pas meje, ta provojmë një herë në mund të gjejmë rrugën.

U vumë në udhë. Pëlcisnin gjyle, binte shi, frynte era si e marrë. Ish ftohët. Mendova ta gjej xhadenë e vogël e të ngushtë të Vërnikut gjatë zbritjes nga mali. Xhadeja kalon si brez pas shpatit dhe me zor dallohet natën. Infermier Llambi fliste me të plagosurit. Njëri nga ata më pëshpëriti:

— Shiko hap sytë mirë ta gjejmë rrugën, se nuk më mbahet gjaku.

E njoha nga zëri:

— Ti Lefter je?

— Unë jam, po aman të lutem ki mëndjen.

— Mos ki merak, do të bëj të pamundurën; po vjen edhe Gjergjua që është nga Vërniku.

Zbritëm tatëpjetë nëpër gurrë e shkëmbinj të the-

pisur. Më dukej se isha bërë i tëri sy e vesh. Hera herës zvarisesha tatëpjetë me këmbë e duar dhe përkitnja me gishta shkëmbenjtë e thepisur. Pushka më varej nëpër këmbë dhe më pengonte. Diku më ra kapella po nuk u vura ta kërkoj. Filloi të vetëtijë më dendur. Lufta ulurinte nga ana e Bilishtit. I mbanja sytë çelur e mundohesha të mos i lëviz për vetëmbylljen që bëjnë qerpikët, se vetëtimat ishin aqe të shkurtëra sa nuk kish kohë të shihnja ku ndodheshim.

Për fat të mirë, kur iu afruam xhadesë, vetëtimat u shtuan. E shquajta mirë atë rrip rruge që pret malin si brez dhe u fola shokëve:

— O burra këtu, nga e majta, e gjetëm xhadenë.

Hymë në rrugën që donim dhe filluam të ecnim nxituar.

Shiu ridhte pa pushim. Isha i tëri qull. Më digjnin sytë nga ujrat që më ridhnin nëpër ballë. Shenjë se kokën e kisha pis të palarë.

Afër Vërnikut takuam njerëz. Ishin djemat e njësitit. U sulën pas nesh. Na i muarën të plagosurit. Njëri nga ata foli:

— Veç infermieri të rrijë me ne, ju të tjerët shkoni në baza se jini qull të lagur.

Po fekste agimi

Kam këtu një kushëri. I vajta ne porta. Kur trokita, ay u dha që prapa. Kish qënë me djemtë e njësitit.

I ndrova robat e lagura. Bukë më hahej por nuk më linte gjumi. Fjeta si i vdekur.

Në një kohë ndjeva se Tashkua po më tundëte për supi. Hapa sytë e rënduar:

— Ç'është?

— Ngreu, se partizanët hynë në Bilisht!

Kërceva përpjetë. Vesha rrobat, rrëmbeva pushkën, u lashë shëndetin dhe u nisa nxituar drejt Bilishtit. Gjatë gjithë rrugës nuk gjeta njeri.

Po sikur mos jetë e vërtetë që shokët janë në Bilisht?

Vendosa mos hyj nga xhadeja. Vrapova malit përpjetë aty ku u ndava mbrëmë nga shokët. Mendova: Të

shoh një herë me dylbi nga Bilishti, të hetoj mirë e pastaj të nisem për atje. M'u kujtua ajo që pësova në Dvoran më 15 Tetor. Mirë e thotë fjala e popullit: «Kush digjet nga qulli i fryn kosit».

Arrijta ne vendi ku isha mbrëmë. Gjeta veç gëzhojat e fishekëve. Pashë me dylbi nga Bilishti. Në ballkonin e bashkisë valavitej flamuri Kuq e Zi. Ashtu u lëshova tatëpjetë me një rendje të marrë. Shkëmbinjtë më dukeshin shesh. Në hyrje të Bilishtit vura re tufa lulësh të hedhura në rrugë. Pra populli i kish pritur shokët me lule.

Ne shatrivani hasa një grup partizanësh. U përqafoam të gëzuar. Më thanë se shokët kanë çliruar edhe Korçën.

Gjermanët ikën. Balli është varosur. Vendi u çlirua.

Por vendi është i prishur nga lufta. Bilishti është djegur dhe plaçkitur. Një varg dyqane kundrejt bashkisë akoma po tymojnë e mbajnë erë shkumb.

Lufta po mbaron. Makina ushtarake gjermane ka marrë tatëpjetën. Mundimet dhe gjaku i derdhur nuk na shkuan kot. Jeta paskëtaj do të jetë pa luftë, pa vrasje pa gjak. Do të vlojë jeta e punës. Se djemtë e rinj, që gadi u mplakën nga vojtjet e maleve, do t'i shtrohen jetës dhe punës dhe do ta duan si askush tjetër.

Kaluan vjete duke mbajtur ndër duar hekurin e ftohtë të armëve. Vjete kaluan duke përkëdhelur në pëllëmbët orë e çast çelikun e ashpër të granadave, vjete kaluan duke thirur erën e athët të barutit të djegur. Ditë për ditë derdhej gjak. Lulja e rinisë mbeti rrugëve të luftës.

Këto vjete t'ashpër i takuan brezit tonë. Ne që duhet të mbanim penat, kazmat dhe duart e vajzave. Brezat e ardhmë le ta dinë therorinë tonë.

E mbi të gjitha nuk duhen harruar ata që ranë theror: Ata që u vranë në fushat e luftës, që u varën në rrugët e qyteteve, që vdiqën me thonj të çkukur, ata që u dogjën të gjallë në furrat e Dachaut, ata që lanë në mal mushkëritë, rininë, sytë dhe gjymtyrët. Se ja, vargu i shokëve sakatë na mbeti i madh.

Kjo fitore pati vojtje e mundime të mëdha. E nuk

duhen harruar as fshatrat e djegur, Barova martire, nënat kërcure, nuset e veja, vajzat që pritën më kot.

## 27 Tetor.

Dje u nisa për në Korçë, për në shtabin e brigadës. Dikush tha se gjermanët e kanë minuar rrugën Bilisht-Korçë. Kjo më ardhni për hesap dhe u nisa nga ana e Dardhës. Rrugës takova Vaskën me shokët e puntorisë që zbrisnin në Bilisht. E kandisa Vaskën të vijë me mua.

U vumë në rrugë të lumtur, të gëzuar, plot jetë, plot vrull. Zemra na këndonte. Lufta ndër ne mbaroi. Dhe jemi gjallë.

Me çap të nxituar i ramë Devollit mes për mes. Nga Bilishti në Dardhë. Rruga që kaluam është vendi i luftrave të kaqe vjeteve. Çdo arë, çdo livadh, çdo kodër, fshat e gur na kujton atë që sapo kaloi, na kujton shokët e rënë, dimrin e rëndë, luftrat, tufanet, ngricat, përpjekjet, urinë. Tashti mund të shkojmë të çkujdesur në tokën tonë. Po sa shtrenjtë na kushtoi!

Afër Dardhës kcha u çel. Dielli sikur i shkriu retë e zeza dhe doli mbi Bigëll i madh e rrezendritur. Kështu m'u duk sikur u kallu zjarr pyjeve për rreth. Se pyjet e Moravës janë ujë të përzierë. Ne i njohim kaqe mirë: pishë e ahishte dushk e panjë, frashër e lajthishte. Dhe çdo fis i pyllit mban ngjyrën e vet. E sapo ardhni vjeshta, fletët e drurëve u ngjyrosën dhe ndruan faqe si të punuara me filigran. Ja, prandaj korijet an' e mb'anë duken sikur kanë shtruar një qilim të shumëngjyrëshëm, sikur i rahin syrin qiellit mavi, sikur gëzohen me gazin tonë.

Dardha ish në festë. Flamurët ishin ngritur në çdo shtëpi. Dhe çdo portë ish e çelur. Por unë zgjodha «portën t'ime». Joana më priti me gaz të zemrës. Ndejti edhe Vaska për darkë. Më vonë u nisëm për në mbrëmjen e vallëzimit në shkollë. U nisëm, por nuk vajtëm. Vaska, edhe ay shkoi gjetiu...

Ndejta me Joanën gjer u dha agimi.